



Politikë
e

“kriminalizuar”

Autor: Leotrim Gashi

Me kontribut të veçantë të hulumtuesve: Tringa Ramadani, Lavdim Bajraktari, Mirvet Thaqi dhe Gzime Hashani si dhe të gjithë monitoruesve dhe hulumtuesve të IKD-së

Ekipi redaktues: Betim Musliu, Ehat Miftaraj, Gzim Shala dhe Yll Zekaj

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Institutit të Kosovës për Drejtësi - IKD dhe ajo nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë së Narkotikëve Ndërkombëtar dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan dhe NED-it.

Ky botim është produkt i projektit “Kërko Drejtësi: Fuqizimi i qasjes në drejtësi në Kosovë”, i cili mbështetet nga Departamenti i Shtetit Amerikan përmes Byrosë Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Çështjeve të Zbatimit të Ligjit (INL) dhe zbatohet nga Instituti i Kosovës për Drejtësi – IKD në partneritet me Iniciativa për Progres – INPO.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Rr. Rustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

Përkrahur nga:



**National Endowment
for Democracy**
Supporting freedom around the world

Dhjetor 2020

Prishtinë, Republika e Kosovës

Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive	6
2. Metodologjia	8
3. Rëndësia e dekriminalizimit të politikës	9
4. Akuzimi dhe gjykimi i përfaqësuesve politik sipas prokurorive dhe gjykatave kompetente	13
4.1 Aktakuzat e ngritura sipas Prokurorive	13
4.2. Proceset gjyqësore në Gjykatat Themelore	14
5. Politika kosovare me politikanë të pandehur	15
6. “Morali politik” pas ngritjes së aktakuzave	17
7. Politikanët e pandehur sipas nivelit të pushtetit	19
7.1. Politikanët e pandehur të pushtetit qendror	20
7.2. Politikanët e pandehur të pushtetit lokal	21
7.2.1 Politikanët e pandehur të pushtetit lokal sipas komunave	22
8. Dallimi gjinor i politikanëve me aktakuza	25
9. Përkatësia etnike e politikanëve të akuzuar	26
10. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e pandehur	27
11. 216 politikanë - 298 aktakuza	28
12. Profilet e politikanëve të akuzuar	32
12.1. Procedimet e aktakuzave të profilin të lartë	32
12.2. Procedimet e aktakuzave të profilin të mesëm	36
12.3. Procedimet e aktakuzave të profilin të ulët	37
12.4. Procedimet e aktakuzave të politikanëve pa profil	38
13. Politikanët e akuzuar sipas partive politike	39
14. Politikanët aktivë në institucione me dënime të plotfuqishme dhe me aktakuza aktive	41
15. Procedimet e aktakuzave të politikanëve	42
16. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PDK-së	48
17. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LDK-së	54
18. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LVV-së	59
19. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AAK-së	63
20. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të Nismës Socialdemokrate	67
21. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PSD-së	71
22. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AKR-së	74
23. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të tjera	76
24. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të paidentifikuara	80
25. Përfundimet	82
26. Rekomandimet	89
I. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të PDK-së	90
II. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të LDK-së	176

III. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të LVV-së.....	220
IV. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të AAK-së.....	243
V. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të PSD-së.....	273
VI. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të NISMËS.....	285
VII. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të AKR-së.....	309
VIII. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të partive tjera	312
IX. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve të partive të paidentifikuara nga IKD	356

Lista e shkurtesave

AAK	Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës
AKR	Aleanca Kosova e Re
IKD	Instituti i Kosovës për Drejtësi
KPRK	Kodi Penal i Republikës së Kosovës
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
LDK	Lidhja Demokratike e Kosovës
LVV	Lëvizja Vetëvendosje
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
MKRS	Ministria e Kulturës-Rinisë dhe Sportit
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MTPT	Ministria e Transportit dhe Postë-Telekomunikacionit
NISMA	Nisma Socialdemokrate
Partitë e tjera	Partitë e tjera shqiptare dhe të komuniteteve jo-shumicë (Lista Rugova, Alternativa, Partia e Drejtësisë, Partia Euroatlantike, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) Sloboda, Lista Serbe (LS), Kualicioni Vakrat, Partia e Ashkalinjëve për Integrim (PAI), Partia e Bashkuar Gorane, Iniciativa qytetare Klllokot-Verbovac, Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Iniciativa për Partesh, Kosova Demokratik Turk Partisi, Iniciativa Qytetare e Komunës së Ranillugut, Iniciativa për Progres, Partia Shqiptare-Demokristiane e Kosovës (PSHDK), Nova Demokratska Strank (NDS)
PDK	Partia Demokratike e Kosovës
PSD	Partia Socialdemokrate
PSRK	Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës
WFD	Fondacionin Westminster për Demokraci

1. Përmbledhje ekzekutive

Të gjitha kafshët janë të barabarta, por disa janë më të barabarta se të tjerat", ligj i cili u imponua në fund të novelës "Ferma e Kafshëve", e autorit George Orwell. Morali i kësaj thënie qëndron në faktin se "Të gjithë janë të barabartë, por disa janë më të barabartë se të tjerët", është shndërruar në realitetin e ri që po kalon sot Republika e Kosovës. Ky realitet përshkruan raportin mes drejtësisë, qytetarëve dhe politikanëve në Kosovë. Në aspektin teorik, politikani duhet të jetë sinonim i një përfaqësuesi të popullit, i m'veshur me pushtet, të cilin pushtet e ushtron me përgjegjësi, integritet dhe besueshmëri në raport me qytetarin, përderisa në aspektin praktik, së paku në Republikën e Kosovës, pozita e tillë është shndërruar në sinonim i privilegjeve, ushtrimit të ndikimit dhe realizimit të të drejtave dhe beneficioneve në kundërshtim jo vetëm me vlerat morale dhe etike, por edhe në kundërshtim me vlerat dhe parimet kushtetuese që promovojnë sundimin e ligjit dhe qeverisjen e mirë në Kosovë.

Si rezultat i kësaj qasje të skenës politike në Kosovë, për afërsisht 13 vite shtet, administrata publike, të emëruarit dhe të zgjedhurit politik, kanë ndërtuar dhe janë duke e zhvilluar kulturën e pandëshkueshmërisë deri në atë masë sa kriminalizimi i skenës politike të konsiderohet si "standard" i qeverisjes.

IKD në këtë raport hulumtues ka pasqyruar nivelin e kriminalizimit të secilës parti politike që nga shpallja e pavarësisë së Republikës së Kosovës e deri në vitin 2020. Përkatësisht, ky raport pasqyron numrin e aktakuzave dhe procedimet e aktakuzave ndaj politikave të të gjitha partive politike. Gjatë monitorimit të sistemit të drejtësisë

tash e disa vite, IKD ka gjetur se niveli i politizimit të sistemit të drejtësisë është i lartë, dhe i manifestueshëm në drejtim të amnistimit dhe persekutimit të zyrtarëve të caktuar, përmes ngritjes së aktakuzave, me apo pa qëllim, jo profesionale dhe nxjerrjen e vendimeve liruese në rastet kur ka pasur prova për fajësinë e të pandehurëve. Në instancë të fundit, fajtorë për këtë është pikërisht politika kosovare, që ka ndikuar në ndërtimin e një sistemi të politizuar të drejtësisë. Në këtë raport, IKD paraqet nivelin e përfshirjes së politikanëve të akuzuar dhe dënuar në secilën parti politike, derisa nuk vlerëson apo komenton fajësinë e asnjë emri të përfshirë në këtë raport.

IKD në këtë periudhë raportuese ka gjetur se janë ngritur 298 aktakuza kundër 216 politikanëve. Në 210 raste, aktakuzat janë ngritur gjatë kohës kur ata kanë qenë duke ushtruar pozita zyrtare. Por, përderisa dorëheqja të paktën për arsye morale është një standard i qeverisjes së mirë, në Kosovën e pas shpalljes së pavarësisë kjo është vetëm përjashtim. Kjo pasi që deri më tani, përballë 298 aktakuzave të ngritura, vetëm tetë (8) politikanë kanë dhënë dorëheqje, derisa në tetë (8) raste të tjera, politikanët janë larguar nga eprorët e tyre pas ngritjes së aktakuzave ndaj tyre.

Nga gjithsej 216 politikanë të akuzuar, IKD ka gjetur se 186 prej tyre janë të përkatësisë shqiptare, 22 u takojnë përkatësisë serbe, katër (4) janë boshnjakë, dy (2) nga komuniteti ashkali si dhe një (1) turk dhe një (1) goran. Institucionet më të larta të shtetit si Kuvendi e Qeveria, por edhe pushteti lokal nëpër komuna, jo rrallë udhëhiqen nga persona që kanë probleme me ligjin. Nga 298 aktakuzat e ngritura, sipas gjetjeve të IKD-së, 189 të tilla janë

ngritur ndaj zyrtarëve apo ish-zyrtarëve të nivelit lokal, ndërsa 109 të tjerë ndaj atyre të nivelit qendror.

Në këtë grup të politikanëve, janë 55 raste në të cilat janë akuzuar zyrtar shtetëror të profilit të lartë, asnjë prej të cilëve i dënua me burgim efektiv, sipas aktgjykimit të formës së prerë.

Në 298 aktakuzat ndaj politikanëve janë të përfshira 351 vepra penale. Pjesën më të madhe të tyre apo 204, e përbëjnë veprat penale për të cilat zyrtarët publik janë akuzuar për vepra që bëjnë pjesë në kapitullin e veprave korruptive.

Nga 298 aktakuzat e ngritura, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë përfaqësuesit e PDK-së. 67 anëtarë të kësaj partie janë të ngarkuar me 89 aktakuza, pasuar nga LDK me 37 persona me 48 aktakuza, 22 përfaqësues të AAK me 32 aktakuza, 19 zyrtarë të LVV me 26 aktakuza, 10 anëtarë të PSD me 17 aktakuza, 19 anëtarë të Nismës Socialdemokrate me 26 aktakuza dhe tre (3) zyrtarë të AKR-së me tri (3) aktakuza. Përpos tyre janë analizuar edhe partitë tjera me të vogla shqiptare dhe partitë e minoriteteve, të cilat kanë pasur një numër të përgjithshëm prej 32 politikanëve që kanë 47 aktakuza, ndërsa, shtatë (7) persona të partive të paidentifikuara nga IKD me 10 aktakuza.

IKD më qëllim të pasqyrimin sa më gjithëpërfshirës, ka analizuar edhe përfaqësimin aktual të partive politike në institucione publike. Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se pjesë e institucioneve publike janë 60 politikanë të përfshirë në 70 raste penale, ndaj të cilëve janë shqiptuar 26 aktgjykime dënuese dhe 44 aktakuza janë ende aktive.

Pra, në këtë mënyrë, pothuajse të gjitha partitë politike në Republikën e Kosovës në radhët e tyre kanë persona të cilët kanë ose kanë pasur probleme me ligjin. Një fakt i tillë ka bërë që edhe institucionet publike, qendrore dhe lokale, të udhëhiqen nga persona që kanë probleme me ligjin.

Skemat kur një pjesë e ditës së zyrtarëve është në draftim dhe miratim të politikave publike ndërsa pjesa tjetër në sallat e gjyqimit duke u përballur me akuza, ndikojnë në humbjen e besimit të publikut në institucionet publike në përgjithësi, ndërsa në veçanti, mungesa e rezultateve konkrete në ndjekjen dhe dënimin e politikanëve, bën që besimi i qytetarëve në sistemin gjyqësor të mbetet vazhdimisht i ulët.

Për këtë arsye, me qëllim të dekriminalizimit të politikës kosovare, ngritjes së nivelit të qeverisjes së mirë dhe besimit të qytetarëve në institucionet publike, IKD rekomandon që të gjitha institucionet publike ti qasen me seriozitet dekriminalizimit të politikës, në atë mënyrë që personat të cilët kanë probleme me ligjin, mos të jenë pjesë e listave zgjedhore apo institucioneve publike. Po ashtu, IKD rekomandon që me qëllim të ngritjes së besimit të qytetarëve në institucionet publike dhe procedura të paanshme penale, zyrtarët publik të japin dorëheqje në rastet kur të njëjtit kanë probleme me ligjin, e nëse nuk ndodh kjo, të njëjtit të lirohen nga detyra nga ana e eprorëve të tyre. Lidhur me nivelin e kriminalizimit të politikës që konsiston në problemet e anëtarëve të subjekteve politike me ligjin, ky raport jep të dhëna të detajuara të gjithë politikanët e evidentuar të cilët kanë pasur apo kanë probleme me ligjin.

2. Metodologjia

IKD me qëllim që të përpiloj një raport sa më gjithëpërfshirës dhe analitik, në lidhje me trajtimin e aktakuzave të anëtarëve të subjekteve politike, ka përdorur një metodologji të përzier të analizimit.

Gjetjet bazë të këtij hulumtimi, vijnë nga monitorimi i drejtpërdrejtë dhe sistematik i të gjitha rasteve në sistemin gjyqësor e përpos kësaj janë bërë edhe hulumtime nga publikimet mediatike, në mënyrë që të ketë një pasqyrë sa më gjithëpërfshirëse lidhur me procedimin e aktakuzave në të cilat bëjnë pjesë zyrtarët dhe ish-zyrtarët politik, të cilët kanë ushtruar funksione publike.

IKD përveç monitorimit të drejtpërdrejtë të këtyre rasteve në procedimin e tyre në gjyqësorin e Kosovës, vazhdimisht ka siguruar të dhënat statistikore nga Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës.

Raporti përfshinë analizimin e 298 aktakuzave të 216 politikanëve, të cilat janë proceduar në shtatë Gjykatat Themelore, Gjykatën e Apelit në Prishtinë si dhe Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, për periudhën kohore nga 17 shkurti 2008 e deri më 31 maj 2020.

Raportet e siguruara nga IKD janë përmbledhur në një bazë të detajuar të të dhënave, e cila ka përfshirë aktakuzat dhe personat e përfshirë në këto raste në të gjitha fazat e procedurës penale në sistemin prokurorial dhe sistemin gjyqësor, duke pasqyruar të gjitha llojet e statistikave të cilat janë në interes të publikut lidhur me përfaqësuesit e tyre me aktakuza.

Duke marrë parasysh se politikanët e akuzuar nuk kanë qëndruar në të njëjtën parti në këtë periudhë raportuese, IKD përpos analizimit gjithëpërfshirës të të gjithë aktakuzave të zyrtarëve apo ish-zyrtarëve publik, ka bërë edhe krahasimin në mes zyrtarëve të partive të ndryshme. Kjo është bërë në atë mënyrë që politikanëve të akuzuar që janë aktualisht pjesë e një subjekti politik të caktuar, i janë shtuar edhe aktakuzat e politikanëve të cilët më herët kanë mbajtur pozita zyrtare, ndërsa aktualisht nuk kanë ndonjë përgjegjësi shtetërore. Në anën tjetër, politikanët të cilët në kohën e akuzimit kanë qenë pjesë e një partie politike, ndërsa më vonë i janë bashkuar një partie tjetër politike, janë trajtuar si pjesë e partisë së fundit politike. Një mënyrë e tillë e analizimit është bërë me qëllim të pasqyrimin gjithëpërfshirës dhe aktual të profilit të të gjitha partive politike, në kuptim të dekriminalizimit.

Monitoruesit dhe hulumtuesit e IKD-së, nga janari i vitit 2016 monitorojnë sistematikisht të gjitha rastet e korrupsionit, ndërsa fokus të veçantë kanë edhe monitorimin e procedimit të rasteve në të cilat janë përfshirë zyrtarët shtetërorë për veprat e ndryshme penale.

Gjetjet e IKD-së janë trajtuar me anë të krahasimit të rasteve, punës me të dhëna statistikore dhe analizimi i thuktë i çdo veprimi apo vendimi nga sistemi i drejtësisë përkitazi me pajtueshmërinë e tyre me legjislacionin në fuqi.

3. Rëndësia e dekriminalizimit të politikës

Gjetjet e këtij hulumtimi, të cilat tregojnë se nga shpallja e pavarësisë e tutje, 216 politikanë të shumicës së partive politike të cilat kanë pasur shtrirje në Kosovë janë përfshirë në 298 aktakuza janë sinjal i qartë për domosdoshmërinë që partitë politike në Kosovë të mos kenë në radhët e tyre persona të cilët kanë probleme me ligjin e në veçanti kur ata dyshohen apo dënohen me vendime të formës së prerë për akuza për keqpërdorime me detyrës zyrtare dhe vepra të tjera korruptive, të cilat ata i kanë kryer gjatë kohës sa kanë qenë në pozita të caktuara zyrtare.

Studimet në shkencën sociale tregojnë se krimi dhe politika nuk e kanë burimin vetëm nga financat e partive politike, por lidhja e politikës me krimin është e shumëfishtë dhe më rrënjësore sesa që zakonisht perceptohet. Sociologu Stanley Cohen nënvizon rrezikun e mos dallimit të dhunës politike prej asaj kriminale, duke përfunduar se për shumë vende, e sidomos ato në tranzicion, e gjithë perspektiva për konsolidimin e demokracisë varet pikërisht nga aftësitë e shoqërive për të dalluar krimin prej politikës.¹

Rreth çështjes së dekriminalizimit të skenës politike, IKD edhe më parë ka shprehur qëndrimet se në asnjë rast nuk duhet të kemi një përzierje në mes krimi dhe politikës dhe në rastet kur këto vijnë në një pikë të përbashkët, atëherë menjëherë duhet

ndërtuar mekanizma të cilat e ndajnë krimin nga politika.

Në demokracitë e konsoliduara, sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për të dalluar krimin prej politikës. Në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike që i përcakton shoqëria. Kështu, secili zyrtar që hetohet për krime, publiku i kërkon automatikisht dorëheqjen nga përgjegjësitë publike. Kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodhë që dorëheqja të kërkohej; zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëhiqen menjëherë, me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin. Anë pse kodi etik në këtë rast nuk e garanton një shkoqitje absolute të politikës prej krimi, të paktën e krijon përshtypjen e funksionimit të sistemit politik e shoqëror.²

Por, në anën tjetër, aktakuzat e ngritura të cilat janë trajtuar më poshtë, janë ngritur nga një sistem i drejtësisë i cili nga raportet ndërkombëtare dhe vendore cilësohet si një sistem i ndikuar nga politika, përkatësisht “*lehtë i ndikueshëm nga politika*”. Raportet e IKD-së vazhdimisht kanë shprehur shqetësimet se mënyra e ngritjes së aktakuzave ndaj zyrtarëve, veçanërisht atyre të profil të lartë, dhe gjykimet të tyre paraqet amnestim dhe persekutim të këtyre zyrtarëve nga ana e sistemit të drejtësisë.

Sa i përket aktakuzave, shumica dërrmuese e aktakuzave të ngritura ndaj zyrtarëve të

¹ Cohen, S. (1996) Crime and Politics: Spot the Difference, The British Journal of Sociology, Vol. 47, No.1, pp.1-23.

² “*Dekriminalizimi i politikës në Kosovë*”. IKD. 21.10.2018. (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/1.-Ship-final-Dekriminalizimi-i-Politikës-ne-Kosove-ALB-21.10.2018-1-2.pdf>).

[content/uploads/2018/10/1.-Ship-final-Dekriminalizimi-i-Politikës-ne-Kosove-ALB-21.10.2018-1-2.pdf](https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/1.-Ship-final-Dekriminalizimi-i-Politikës-ne-Kosove-ALB-21.10.2018-1-2.pdf)). (Qasur për herë të fundit më 05.12.2020).

profilin të lartë kanë dështuar. Ngritja e aktakuzave të cilat me apo pa qëllim nuk kanë qenë profesionale paraqet një manifestim të sistemit të drejtësisë në drejtim të persekutimit dhe amnistimit të zyrtarëve publik.

Në këtë linjë janë edhe aktgjykimet e nxjerra, të cilat kanë liruar të pandehurit, përkundër se ka pasur prova lidhur me fajësinë e tyre. Për këtë mënyrë të veprimit në raport me aktakuzat e profilin të lartë, tanimë ka edhe një numër të aktgjykimeve të Gjykatës Supreme që konstatojnë se të pandehurit ishin liruar duke u shkelur ligji në favor të tyre.

Duke vepruar në këtë mënyrë, sistemi kosovar i drejtësisë ka amnistuar edhe politikanë të caktuar përmes aktakuzave dhe aktgjykimeve të nxjerra ndaj tyre, derisa edhe ka persekutuar të tjerë, të cilët janë pjesë e këtij raporti. Përmes këtij raporti, IKD paraqet përfshirjen e politikanëve nëpër procedura gjyqësore, por në asnjë rrethanë nuk komenton apo vlerëson fajësinë e ndonjërit prej tyre.

Por, nëse kërkojmë shkaktarin, për këtë mënyrë të veprimit, përsëri fajtorë është politika kosovare, e cila që nga përfundimi i luftës, vazhdimisht ka investuar për të politizuar sistemin e drejtësisë, i cili investim sot ka prodhur një sistem të drejtësisë i cili cilësohet si *“lehtë i ndikueshëm nga politika”*.

Në anën tjetër, sa i përket dekriminalizimit të politikës, ligji nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, ka përcaktuar kategoritë e personave, të cilët konsiderohen të papërshtatshëm për tu

certifikuar si kandidatë për zgjedhje të përgjithshme apo zgjedhje lokale. Në mesin e 19 kriterëve në të cilat përjashtohen kandidaturat e mundshme për të qenë i zgjedhur, hynë edhe kategoritë:

- Personat që janë duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë;
- Personat nën akuzë nga Tribunali dhe ka dështuar të veprojë në përputhje me urdhrin për t’u paraqitur para Tribunalit;
- Personat të cilëve një e drejtë e tillë iu është kufizuar me anë të vendimit të gjykatës, përfshirë edhe vendimin e KZAP-it i është hequr e drejta për të qenë kandidat;
- Personat të cilëve kjo e drejtë iu është hequr e drejta për të qenë kandidat me anë të vendimit të gjykatës, dhe
- Personat të cilët janë shpallur fajtor për vepër penale me një vendim përfundimtar të gjykatës në tri (3) vitet e fundit.³

Duke u bazuar në nenin 29 të Ligjit për Zgjedhje, më 12 shtator 2017, KQZ-ja kishte marr vendim për decertifikimin e të gjithë kandidatëve që kishin garuar për kryetar të komunave dhe asamble komunale për zgjedhjet lokale të 22 tetorit 2017, që kishin aktgjykim të formës së prerë nga gjykatat e Kosovës. Në mesin e atyre që iu mohua kjo e drejtë për të garuar për kryetar komune ishte edhe deputeti i Nismës, Zafir Berisha, që kishte kandiduar për kryetar të Prizrenit.

³ Ligji nr. 03/l-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Neni 29 (Shih linkun

<https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2544>). (Qasur për herë të fundit më 05.12.2020).

Ndaj vendimit të KQZ-së, kandidatët e decertifikuar, duke përfshirë edhe kandidatin Zafir Berisha kishin paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, e cila gjykatë e kishte miratuar ankesën e Berishës, dhe kishte obliguar KQZ-në, të bëjë certifikimin e Berishës, për zgjedhjet lokale të 22 tetorit.

Sipas Aktgjykimit AA.-Uzh.nr. 16/2017, të Gjykatës Supreme të datës 19 shtator 2017, askujt nuk mund t'i mohohet e drejta për të garuar në zgjedhje nëse një e drejtë e tillë nuk i është hequr me vendim gjyqësor, e që do të thotë se kandidati duhet me vendim të formës së prerë të gjykatës të shpallet fajtor dhe gjykata t'i ketë shqiptuar edhe dënim plotësues "heqjen e të drejtës për t'u zgjedhur". Aktgjykimi i Gjykatës Supreme po ashtu, kishte konstatuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme bie ndesh me nenin 45 të Kushtetutës, ku sipas interpretimit të kësaj gjykate kur në një anë kemi normën kushtetuese, e cila përcakton se e drejta për të garuar në zgjedhje mund të kufizohet vetëm me vendim gjyqësor dhe në anën tjetër neni 29 i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme parasheh mundësinë e kufizimit të kësaj të drejte pa vendim gjyqësor, mbizotëron Kushtetuta si akt më i lartë juridik.

Si rezultat i interpretimit të Gjykatës Supreme dhe paqartësisë ligjore, respektivisht Kushtetutës së Kosovës dhe Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme vetëm në zgjedhjet lokale të mbajtura më 22 tetor 2017, janë certifikuar dhe kanë kandiduar

mbi 600 persona me të kaluar kriminale për kryetar komune apo asamble komunale.⁴

IKD si në vitin 2018 e po ashtu në bashkëpunim me Fondacionin Westminster për Demokraci (WFD) edhe në vitin 2019, ka publikuar raporte analitike në të cilat është trajtuar çështja e dekriminalizimit të skenës politike me qëllim që partitë politike të mos përfshijnë në listat e tyre zgjedhore persona të cilët bien ndesh me ligjin.

Në këto raporte është rekomanduar që të bëhet miratimi i rregullave etike, që mund të realizohet me një iniciativë të përbashkët të partive politike përmes miratimit të një Kodi Etik i cili do të aplikohet nga të gjitha partitë; ose secila parti politike të miratojë rregulla etike brenda statuteve të tyre ose si akt i veçantë me dispozita të qarta për largimin e çdo anëtari të partisë, nga funksionet partiake dhe shtetërore, nëse ndaj anëtarit ngritët aktakuzë apo ka aktvendim gjyqësor për vepra penale.

Miratimi i Kodeve të Etikës do të kishte karakter obligativ, vet rregullues dhe përjashtues ndaj individëve që kanë probleme me ligjin. Kodet e Etikës mund të marrin për bazë dhe të përfshijnë parimet e ndërtuara nga Komisioni i Venedikut dhe shtetet me përvojë të gjatë të demokracisë parlamentare.

Si alternativë e kodeve etike të partive politike nga IKD dhe WFD ishte rekomanduar ndalesa legislative, e cila mund të realizohet përmes një iniciative ligjore të ndryshimit të një numri të akteve

⁴ "IKD reagon ndaj shkeljes së ligjit nga KQZ, kërkon largimin e kandidatëve të certifikuar që kanë aktgjykime dënuese përfundimtare dhe fton Prokurorin e Shtetit të hetojë vendimmarrjen e KQZ-së". Instituti i Kosovës për

Drejtësi. 10 shtator 2017. (Shih linkun <http://kiks.org/ikd-reagon-ndaj-shkeljes-se-ligjit-nga-kqz-kerkon-largimin-e-kandidateve-te-certifikuar-qe-kane-aktgjykime-denuese-perfundimtare-dhe-ften-prokurorin-e-shtetit-te-hetoje-vendimmarrjen-e-kqz-se/>). (Qasur për herë të fundit më 05.12.2020).

ligjore. Në situatën aktuale të krijuar në Kosovë, veçanërisht pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme por edhe të Kodit Penal të Kosovës, konsiderohen si kundër kushtetuese dhe jo të zbatueshme. Mirëpo për të adresuar këtë dukuri përmes ndalesave legjislative është i domosdoshëm edhe amandamentimi i Kushtetutës⁵.

Siç ka avokuar në vazhdimësi IKD, edhe Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj të 21 dhjetorit 2020, me të cilën e ka konsideruar të pavlefshëm mandatin e deputetit Etem Arifi, i cili është dënuar me dënim me një vit e tre muaj burgim, ka përcaktuar një standard të ri sa i përket të drejtës së personave për të kandiduar për deputet, për tu zgjedhur dhe për të ushtruar mandatin e tillë në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Ky standard i ri i vendosur nga Gjykata Kushtetuese konsiston në faktin se tanimë përcaktohet qartë, pa asnjë dilemë, se asnjë person nuk mund të fitoj dhe mbaj mandat të vlefshëm të deputetit nëse është i dënuar për veprë penale me një vendim gjyqësor të formës së prerë në tri (3) vitet e fundit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 71.1 të Kushtetutës të Republikës së Kosovës, në ndërlidhje me nenin 29.1 (q) të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, me

vendim gjyqësor të formës së prerë, nëse kundër tij/saj ka një vendim dënues që është në fuqi në Republikën e Kosovës.⁶

Pra, Gjykata Kushtetuese, ka dhënë një arsytim të kundërt me atë të dhënë nga Gjykata Supreme duke theksuar se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk kërkon që personave të dënuar për vepra penale t'u shqiptohet medoemos si dënim plotësues "heqja e të drejtës për t'u zgjedhur", në mënyrë që ata të mos lejohen të kandidojnë në zgjedhje parlamentare.

Sipas Gjykatës Kushtetuese, normat kushtetuese dhe ligjore, të cilat përcaktojnë kriteret, të cilat pamundësojnë kandidimin apo ushtrimin e mandatit të deputetit, nuk kanë qëllim parësor ndëshkimin e individëve të caktuar duke ua pamundësuar atyre ushtrimin e funksionit të deputetit, por kanë si qëllim themelor mbrojtjen e integritetit kushtetues dhe besueshmërisë qytetare në organin ligjdhënës, si shtyllë e demokracisë parlamentare.⁷

Sipas IKD-së, ky standard i ri i ndërtuar me këtë vendim të Gjykatës Kushtetuese, do të duhej të jetë pikë referimi për të gjitha institucionet e vendit dhe që në institucione, të mos ketë asnjë zyrtarë, i cili punon duke qenë i akuzuar apo i dënuar me vendim të formës së prerë.

⁵ . "Qeverisje me Integritet". Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Fondacioni Westminster për Demokraci (WFD). Shtator 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-shqip-ne-PDF-Qeverisje-me-integritet.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 05.12.2020).


⁶ Aktgjykimi KO 95/20 i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i publikuar më 21 dhjetor 2020. (Shih linkun <https://gjk-ks.org/vendimet-nga-seanca-shqyrtuese-e-mbajtur-me-21-dhjetor-2020/>). (Qasur për herë të fundit më 24.12.2020)

⁷ Po aty

4. Akuzimi dhe gjykimi i përfaqësuesve politik sipas prokurorive dhe gjykatave kompetente

4.1 Aktakuzat e ngritura sipas Prokurorive

IKD ka gjetur se nga 298 aktakuzat e ngritura ndaj politikanëve, 104 nga to janë të ngritura nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, 51 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), 47 nga Prokuroria e Gjilanit, 37 nga ajo e Prizrenit, 21 nga Prokuroria Themelore e Gjakovës, 18 nga Prokuroria e Pejës, 14 nga Prokuroria e Mitrovicës, pesë (5) nga ajo e Ferizajt si dhe një (1) padi private⁸.



Grafiku 1: Aktakuzat e ngritura nga prokuroritë për politikanët e akuzuar.

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ("PSRK") - Nga 51 aktakuzat e ngritura nga PSRK, 14 nga to kanë

përfunduar me vendime të formës së prerë, prej të cilave janë vërtetuar me aktgjykim dënues në vetëm **katër (4)** raste, ndërsa **10** të tjera kanë dështuar të mbrohen në gjykatë. **Pesë (5)** prej tyre kanë përfunduar me aktgjykime liruese, **tri (3)** aktakuza janë hedhur poshtë ndërsa **dy (2)** të tjera janë refuzuar.

Përpos tyre, janë edhe **14** aktgjykime të shpallura nga gjykatat e shkallës së parë, të cilat akoma nuk kanë marrë formën e prerë, **gjashtë (6)** prej të cilave janë aktgjykime dënuese si dhe **tetë (8)** aktgjykime të tjera liruese, ndërsa edhe **23** aktakuza të tjera janë akoma në proces pranë këtyre gjykatave.

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur 104 aktakuza ndaj politikanëve, nga të cilat **59** kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë. Në këtë grup bëjnë pjesë **20** aktgjykime dënuese, **nëntë (9)** liruese, **18** aktgjykime refuzuese, **10** aktakuza janë hedhur ndërsa në procedurë të ndërmjetësimit kanë shkuar **dy (2)** raste.

Në gjykatën e shkallës së parë kanë përfunduar **pesë (5)** raste, **tri (3)** nga të cilat janë aktgjykime liruese, ndërsa **dy (2)** të tjera aktgjykime dënuese, ndërsa në proces janë edhe **40** raste.

Nga **47** aktakuzat ndaj politikanëve të ngritura nga **Prokuroria Themelore në Gjilan**, **39** nga to e kanë marrë formën e prerë ndërsa **29** prej tyre to nuk kanë mund të mbrohen para gjykate. Gjykatat për këto aktakuza kanë shpallur **10** aktgjykime dënuese, **21** aktgjykime liruese, **pesë (5)** aktgjykime refuzuese dhe **tri (3)** hedhje të

⁸ Shënim: Në kuadër të këtij raporti është edhe rasti i padisë private që KEK-u ka bërë ndaj ish-kryetarit të Komunës së Klinës Sokol Bashota, e cila procedurë është rregulluar me Kodin e Përkoshëm të

Procedurës Penale, por që është eliminuar nga 1 janari i vitit 2013, kur ka hyrë në fuqi Kodi i Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

aktakuzës. Në instancën e parë gjyqësore janë përfunduar **katër (4)** raste, **tri (3)** nga të cilat me aktgjykime liruese e **një (1)** me aktgjykim dënues. Në këtë gjykatë janë edhe **katër (4)** aktakuza në proces gjyqësor.

Prokuroria Themelore në Prizren ka ngritur **37** aktakuza, nga të cilat **24** kanë fituar formën e prerë. **11** nga to, kanë qenë aktgjykime dënuese, **tetë (8)** aktgjykime liruese **tri (3)** të tjera aktgjykime refuzuese dhe janë hedhur **dy (2)** aktakuza. Po ashtu janë shpallur edhe **dy (2)** aktgjykime nga gjykatat e shkallës së parë, në të cilat të pandehurit janë liruar nga akuzat. Në këtë grup bëjnë pjesë edhe **11** aktakuza të cilat janë në proces në gjykatat e shkallës së parë.

Prokuroria Themelore në Gjakovë i ka ngritur **21** aktakuza ndaj zyrtarëve politik. **15** nga to kanë marrë formën e prerë, ndërsa **dy (2)** të tjera kanë përfunduar vetëm në shkallën e parë. Nga **15** vendimet e formës së prerë janë shqiptuar **tetë (8)** aktgjykime dënuese, **gjashtë (6)** të tjera liruese, ndërsa **një (1)** aktakuzë është hedhur. Ndërsa nga vendimet e shkallës së parë, **njëra (1)** është përfunduar me aktgjykim lirues ndërsa **një (1)** tjetër me atë dënues. **Katër (4)** aktakuza të tjera janë në proces.

Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur **18** aktakuza, nga të cilat **11** kanë përfunduar

me aktgjykim të formës së prerë, e në këtë grup bëjnë pjesë **tri (3)** aktgjykime dënues. Ndërsa janë katër **(4)** aktgjykime liruese, në **dy (2)** rast është refuzuar akuza, ndërsa në **dy (2)** tjetër gjykata ka hedhur aktakuzën. Në shkallën e parë ka përfunduar vetëm **një (1)** rast, me të cilin i pandehuri është shpallur i pafajshëm, , ndërsa edhe **gjashtë (6)** raste pa ndonjë vendim gjyqësor.

Prokuroria Themelore në Mitrovicë ka ngritur **14** aktakuza ndaj politikanëve, ku **tetë (8)** nga këto raste kanë përfunduar me vendim të formës së prerë, **tri (3)** nga të cilat kanë qenë dënuese, **dy (2)** aktakuza janë refuzuar, **dy (2)** hudojnë të aktakuzave, ndërsa **një (1)** rast ka përfunduar me aktgjykim lirues.. Në shkallën e parë kanë përfunduar proceset gjyqësore për **dy (2)** politikan, për njërin është shpallur aktgjykim dënues, ndërsa për tjetrin aktgjykim lirues. Ndërsa janë edhe **katër (4)** raste të cilat janë akoma në procedurë gjyqësore.

Prokuroria Themelore në Ferizaj ka ngritur vetëm **pesë (5)** aktakuza ndaj politikanëve, prej të cilave **dy (2)** kanë përfunduar me aktgjykim të formës së prerë, **një (1)** lirues dhe **një (1)** dënues, **një (1)** rast është përfunduar vetëm në shkallën e parë, me të cilin i akuzuari është liruar nga akuza, ndërsa janë edhe **dy (2)** raste në proces gjyqësor.

4.2. Proceset gjyqësore në Gjykatat Themelore


Nga **298** aktakuzat ndaj politikanëve, IKD ka hulumtuar edhe gjykatat në të cilat ata janë gjykuar apo po vazhdojnë të gjykohen rastet ndaj tyre.

Numri më i madh prej **138** rasteve janë trajtuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, ndërsa ajo e Gjilanit ka trajtuar **47** politikanë të akuzuar.

Gjykata Themelore në Prizren ka gjykuar **32** raste, ajo e Pejës **17**, Gjykata e Mitrovicës **15**, e Gjakovës **11**, e Ferizajt

pesë (5), ndërsa edhe pse komunë më e vogël, Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega në Malishevë ka gjykuar dhe gjykon **11** raste.

Dega e Klinës, Dragashit, Kamenicës dhe Drenasit me **katër (4)** raste, **dy (2)** aktakuza janë trajtuar nga dega në Viti, ndërsa nga **një (1)** rast kanë trajtuar degët e Lipjanit, Podujevës, Suharekës, dhe Vushtrrisë.



Grafiku 2: Gjykatat që kanë trajtuar politikanët e akuzuar.

5. Politika kosovare me politikanë të pandehur

Ashtu siç është thënë në fillim të këtij raporti, që nga koha e shpalljes së pavarësisë, Kosova është karakterizuar me figura politike të cilët përveç ushtrimit të detyrave në zyrat e objekteve shtetërore, janë ballafaquar edhe me organet e drejtësisë, në të cilat janë zhvilluar gjykime në lidhje me pretendimet se ata kanë kryer krime të veprave të ndryshme. Jo rrallë herë, në sallat e gjykimit si të akuzuar për vepra të rënda penale si krim i organizuar e korrupsion, janë ulur zyrtarët e lartë publik si zëvendëskryeministra, ministra, deputet,


kryetar të komunave, ish-zyrtar të këtyre pozitive, e shumë të tjerë, të cilët ballafaqohen me akuzat për mos përmbushjen e detyrave për çka ishin zgjedhur nga qytetarët e Kosovës.

Duke marrë parasysh se në edicionet e lajmeve të televizioneve është e pamundur që të kaloj një ditë pa pasur kronika në të cilat pasqyrohen seancat gjyqësore në të cilat për akuza për krim të organizuar, korrupsion e vepra të tjera penale, ngarkohen politikanët kosovar, pa dyshim se ndikon negativisht në syrin e popullit apo zgjedhësve të këtyre politikanëve e normalisht që krijon edhe një njollë të keqe në rrugën e Kosovës në anëtarësimin e

Kosovës në organizatat e Bashkimit Evropian dhe Kombeve të Bashkuara.

Fakti se përfaqësuesit më të lartë të shtetit, të cilëve i është dhënë besimi nga qytetarët ballafaqohen me akuza për krim të organizuar dhe keqpërdorime serioze të parasë publike, ka shpërfaqur në publik mos përshtatshmërinë për të pasur mbi supet e tyre menaxhimin e organeve shtetërore. Përpos kësaj, edhe fakti se ata bëjnë në organizime të ndryshme ku gjuajtja me armë është veprim i dëfrimit, pasqyron më së miri mosbindjen e tyre ndaj ligjeve të cilat ata vetë i kanë miratuar dhe në këtë mënyrë të njëjtit “ndalohen” që të avokojnë respektimin e ligjit nga të tjerët.

Sipas hulumtimit të IKD-së, bazuar në kohën e ngritjes së aktakuzave për politikanët e pandehur rezulton se shumica nga ta janë akuzuar gjatë kohës sa kanë qenë duke ushtruar pozita shtetërore. Koncretisht nga **298** aktakuzat ndaj politikanëve, **210 nga to apo 70%** janë akuzuar në kohën kur ata kanë qenë në funksione publike, **62 të tjera apo 21%** janë ngritur pasi kanë përfunduar mandatin e tyre, **20 aktakuza të tjera apo 7%** janë ngritur para se ata të merrnin rolin e zyrtarit publik, kurse **për 6 apo 2%** prej tyre, IKD nuk ka mundur të siguroj të dhëna lidhur me kohën e akuzimit të tyre.



Grafiku 3: Pozitat e personave në kohën kur është ngritur aktakuza.

6. “Morali politik” pas ngritjes së aktakuzave

Nga numri i përgjithshëm i ngritjes së aktakuzave, 210 prej tyre janë ngritur në kohën kur personat zyrtar kanë qenë në pozita zyrtare, nga të cilët vetëm tetë (8) nga ta kanë dhënë dorëheqje nga këto pozita në kohën kur janë akuzuar.

Në demokracitë e konsoliduara, sfera publike shërben si mjet kryesor i shoqërisë për të dalluar krimin nga politika. Në secilën shoqëri demokratike, zyrtarët e lartë të shtetit, politikanët dhe të gjithë ata që mbajnë përgjegjësi publike, u nënshtrohen normave etike dhe morale nga funksioni që ushtrojnë. Kështu, secili zyrtar që hetohet për krime, publiku pret automatikisht dorëheqjen si akt moral dhe etik nga përgjegjësitë publike. Kodi etik, gjithnjë nën vëzhgimin e publikut, funksionon aq mirë sa që rrallë ndodhë që dorëheqja të kërkohej; zyrtarët që janë nën hetime zakonisht dorëhiqen menjëherë, me t'u bërë publike dyshimet për lidhjet e tyre me krimin. Ani pse kodi etik në këtë rast nuk

garanton shkoqitje absolute të politikës nga krimi, të paktën krijon përshtypjen e funksionimit të sistemit politik e shoqëror.⁹¹⁰



Në bazë të këtij hulumtimi është gjetur se nga ky numër, (210 raste), vetëm në tetë (8) raste apo 2.68%, politikanët kanë dhënë dorëheqje pas ngritjes së aktakuzës ndaj tyre, tetë (8) të tjerë apo 2.68%, janë larguar nga pozitat e tyre nga eprorët që kanë pasur, ndërsa në 194 raste të tjera apo 65.10% nuk kanë ndikuar që politikanët e akuzuar të japin dorëheqje nga pozitat e tyre.

Ndërsa janë evidentuar edhe 82 raste apo 27.52%, kur politikanët e akuzuar nuk kanë qenë në pozita zyrtare, ndërsa për gjashtë (6) raste apo 2.01%, nuk janë gjetur të dhëna se në cilën kohë janë ngritur aktakuzat.

⁹ “Dekriminalizimi i politikës në Kosovë”. IKD 21.10.2018 (shih linkun: <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2018/10/1.-Ship-final-Dekriminalizimi-i-Politikës-ne-Kosove-ALB-21.10.2018-1-2.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020)

¹⁰ *Shënim*: IKD si në vitin 2018 e po ashtu edhe në vitin 2019, në bashkëpunim me Fondacionin Uestminster për Demokraci (WFD) ka publikuar raporte analitike në të cilat është trajtuar çështja e dekriminalizimit të skenës politike me qëllim që partitë politike të mos përfshijnë në listat e tyre zgjedhore persona të cilët bien ndesh me ligjin. Në këto raporte është rekomanduar që të behët miratimi i rregullave etike, që mund të realizohet me një iniciativë të përbashkët të partive politike përmes miratimit të një Kodi Etik i cili do të aplikohet nga të gjitha partitë; ose secila parti politike të miratojë rregulla etike brenda statuteve të tyre ose si akt i veçantë me dispozita të qarta për largimin e çdo anëtari të partisë, nga funksionet partiake dhe shtetërore, nëse ndaj anëtarit ngritet aktakuzë apo ka aktvendim gjyqësor për vepra penale. Miratimi i

Kodeve të Etikës do të kishte karakter obligativ, vet rregullues dhe përjashtues ndaj individëve që kanë probleme me ligjin. Kodet e Etikës mund të marrin për bazë dhe të përfshijnë parimet e ndërtuara nga Komisioni i Venedikut dhe shtetet me përvojë të gjatë të demokracisë parlamentare ose si mundësi tjetër ishte rekomanduar ndalesa legjislative. Kjo mund të realizohet përmes një iniciative ligjore të ndryshimit të një numri të akteve ligjore. Në situatën aktuale të krijuar në Kosovë veçanërisht pas aktgjykimit të Gjykatës Supreme, dispozita ligjore të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme por edhe të Kodit Penal të Kosovës, konsiderohen si kundër kushtetuese dhe jo të zbatueshme. Mirëpo për të adresuar këtë dukuri përmes ndalesave legjislative është i domosdoshëm amandamentimi i Kushtetutës dhe i ligjeve të lartpërmendura. “*Qeverisje me Integritet*”. Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) dhe Fondacioni Uestminster për Demokraci (WFD). Shtator 2019. (Shih linkun <https://kli-ks.org/wp-content/uploads/2019/09/Raporti-shqip-ne-PDF-Qeverisje-me-integritet.pdf>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020)



Grafiku 4: “Morali politik” i politikanëve pas aktakuzave.



Instituti i Kosovës për Drejtësi
Kosovo Law Institute
Kosovski Institut Pravde

6.1 Rastet e dorëheqjeve me rastin e ngritjes së aktakuzave

Kryetari i Partisë së Drejtësisë, Ferid Agani, në vitin 2016 ishte duke udhëhequr Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, por në atë kohë ai u akuzua nga PSRK, me pretendimin se gjatë kohës sa ka qenë Ministër i Shëndetësisë ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare.¹¹

Përveç Aganit, dorëheqje nga detyrat gjatë qeverisjes në Qeverinë “Thaçi 2” të vitit 2012, për veprimet e tyre paraprake kishin dhënë edhe ish-zëvendëskryeministri i Kosovës, Bujar Bukoshi dhe ish-zëvendësministri i Financave, Astrit Haraqija, që përfaqësonin “Listën Rugova”.¹² Bukoshi akuzohej se si Ministër i Shëndetësisë, së bashku me ish-sekretarin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe tetë zyrtar të tjerë për keqpërdorime me tender në këtë ministri, ndërsa Haraqija akuzohej për keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë kohës sa ka qenë ministër i Kulturës.

Pas ngritjes së aktakuzës për keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë vitit 2019 edhe Durim Sheremeti, shefi i kabinetit të kryetarit të Komunës së Pejës Gazmend Muhaxheri, ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij.

Ndërsa i fundit që ka dhënë dorëheqje pas ngritjes së aktakuzës, është tashmë ish-drejtori i Financave në komunën e Prizrenit,

Ertan Simitqiu, i cili është akuzuar për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” gjatë kohës kur ka udhëhequr me Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa. Ai e ka ofruar dorëheqjen më 26 gusht 2019.¹³

Pas zotimit të Kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli, se të akuzuarit me korrupsion nuk do të bëhen pjesë e institucioneve, dorëheqje patën dhënë edhe ministri i atëhershëm i Ndërmarrësisë dhe Inovacionit, Besim Beqaj, si dhe zëvendësministri i atëhershëm i Ministrisë së Mbrojtjes, Agim Çeku.

Së fundmi, pasi kryeministri Albin Kurti kishte emëruar si këshilltar politik Nenad Rashiq, pas ngritjes së aktakuzës me të cilën ai ngarkohej për veprën penale të korrupsionit, i njëjti kishte dhënë dorëheqje.

7. Politikanët e pandehur sipas nivelit të pushtetit

Gjetjet e IKD-së tregojnë se nga numri i përgjithshëm i aktakuzave ndaj politikanëve, 189 të tilla janë ngritur ndaj zyrtarëve apo ish-zyrtarëve të nivelit lokal, ndërsa 109 të tjerë ndaj atyre të nivelit qendror.

¹¹ “Ferid Agani jep dorëheqje”. *Lajmi.net*. 17 qershor 2016. (Shih linkun <https://lajmi.net/lajmi-fundit-ferid-agani-jep-doreheqje/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020)

¹² “Jep dorëheqje Bujar Bukoshi e Astrit Haraqija” *Rajonipress*. 9 korrik 2012 (shih linkun: <https://rajonipress.com/jep-doreheqje-bujar->


[bukoshi-e-astrit-haraqija/](https://rajonipress.com/jep-doreheqje-bujar-)). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020)

¹³ “Pas aktakuzës, jep dorëheqje drejtori i Financave në Prizren”. *Koha.net*. 26 gusht 2019 (shih linkun: <https://www.koha.net/kosove/180918/pas-aktakuzes-jep-doreheqje-drejtori-i-financave-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020)

7.1. Politikanët e pandehur të pushtetit qendror

Nga 109 aktakuzat ndaj politikanëve të nivelit qendror, 70 janë për deputet, 16 aktakuza ndaj ministrave, 12 të tjera ndaj

zyrtarëve të tjerë në pozita qeveritare, katër (4) ndaj atyre që janë zyrtarë në organe të tjera, katër (4) ndaj zëvendësministrave dhe tri (3) aktakuza ndaj zëvendëskryeminstre.



Grafiku 5: Politikanët e akuzuar të pushtetit qendror.

Nga 70 aktakuzat ndaj deputetëve, 17 prej tyre i takojnë partisë LVV, 11 i takojnë AAK-së, 11 i takojnë PDK-së, 15 PSD-së, tetë (8) u takojnë partive të tjera (shqiptare dhe të komuniteteve), pesë (5) nga Nisma dhe tre (3) nga LDK.

Nga 16 aktakuzat ndaj ministrave, shtatë (7) i takojnë partive të tjera, nga tre (3) u takojnë Nismës dhe PDK-së, dy (2) i takojnë LDK-së, ndërsa një (1) AKR-së. Nga 12 aktakuzave ndaj politikanëve në

pozita të tjera qeveritare, gjashtë (6) vijnë nga PDK, tre (3) nga AAK, dy (2) nga Nisma, dhe një (1) nga AKR. Nga katër (4) aktakuzat ndaj zëvendësministrave, dy (2) prej tyre vijnë nga partitë e tjera, një (1) nga Nisma dhe një (1) nga AAK. Nga katër (4) aktakuzat ndaj politikanëve në pozita tjera të pushtetit qendror, nga një (1) u takojnë PDK-së, LDK-së, AAK-së dhe Nismës. Si dhe nga tre (3) aktakuzat ndaj zëvendëskryeminstre, dy (2) i përkrasin partive të tjera dhe një (1) është nga Nisma.

Partia/ Pozita	PDK	LDK	AAK	LVV	AKR	NISMA	PSD	Të tjera	Të gjitha
Zv. Kryeministër	0	0	0	0	0	1	0	2	3
Ministër	3	2	0	0	1	3	0	7	16
Zv. Ministër	0	0	1	0	0	1	0	2	4
Pozitë tjetër qeveritare	6	0	3	0	1	2	0	0	12
Deputet	11	3	11	17	0	5	15	8	70
Pozita tjera të pushtetit qendror	1	1	1	0	0	1	0	0	4
Të gjitha	21	6	16	17	2	13	15	19	109


Tabela 1: Numri i aktakuzave të politikanëve të pushtetit qendror sipas partive politike.

7.2. Politikanët e pandehur të pushtetit lokal

Numrin më të madh të politikanëve të akuzuar e përbëjnë individët që kanë pasur përgjegjësi publike e që i kanë takuar pushtetit lokal. 189 aktakuza janë ngritur ndaj zyrtarëve apo ish-zyrtarëve komunal, duke përfshirë kryetar komunash, kryetar të kuvendëve komunale, drejtor komunal e këshilltar komunal janë akuzuar për vepra të ndryshme penale, shumica nga të cilat vepra që ndërliken me korrupsionin.

Në këtë listë të zyrtarëve komunal, një numër jashtëzakonisht i madh i aktakuzave është ndaj kryetarëve të komunave. Prokuroria ka ngritur 51 aktakuza ndaj kryetarëve të komunave, në mesin e të cilëve ka pasur raste kur ndaj tyre janë ngritur dy (2), tri (3), katër (4), e deri në shtatë (7) aktakuza.

Ndaj drejtorëve komunal, prokuroritë kanë ngritur 91 aktakuza, 28 ndaj asamblistëve, tetë (8) ndaj zyrtarëve në organe të tjera komunale gjashtë (6) ndaj kryesuesve të Kuvendit Komunal si dhe pesë (5) aktakuza ndaj nënkryetarëve të komunave.



Grafiku 6: Politikanët e akuzuar sipas pozitës së pushtetit lokal.

7.2.1 Politikanët e pandehur të pushtetit lokal sipas komunave

Lidhur me zyrtarët komunal të akuzuar, IKD ka analizuar edhe shtrirjen gjeografike të politikanëve të akuzuar, ku ka rezultuar se Komuna e Prizrenit me **25 aktakuza**, ku bënë pjesë edhe ish-kryetari Ramadan Muja, i akuzuar për korrupsion, është komuna me më së shumti zyrtar apo ish-zyrtar të saj të akuzuar.

Pas saj, komuna e re e Klllokotit, edhe pse e vogël me territor e me numër të popullsisë, e udhëhequr tradicionalisht nga partitë e komunitetit serb, ka numrin më të madh të zyrtarëve me aktakuza, gjithsej **24 aktakuza** ndaj zyrtarëve të saj, në mesin e të cilëve bëjnë pjesë edhe dy ish-kryetarët Sasha Mirković me shtatë (7) aktakuza dhe Sreqko Spasiq me tri (3) të tjera e të gjitha këto 10 aktakuza janë ngritur nën dyshimet për vepra korruptive.

Pas Komunës së Klllokotit, radhitet Komuna e Drenasit me **17 aktakuza**, ku vetëm ish-kryetari i kësaj komune Nexhat Demaku është përballur me katër (4)


aktakuza, tre (3) nga të cilat për korrupsion dhe një (1) tjetër për krime lufte, për të vazhduar me Malishevën me **12 aktakuza**, ndaj zyrtarëve të Klinës, janë ngritur **11 aktakuza**¹⁴, dhe Dragashin me **10 aktakuza**, Lipjani dhe Gjilani, me nga nëntë (9) aktakuza, ku bëjnë pjesë edhe ish-kryetari i Gjilanit Qemajl Mustafa dhe ai i Lipjanit Shukri Buja,

Tetë (8) aktakuza janë ngritur ndaj zyrtarëve të Skenderajt, katër (4) nga të cilat janë ndaj ish-kryetarit Sami Lushtaku, ndaj zyrtarëve të Mitrovicës së Jugut janë ngritur **shtatë (7) aktakuza**, në mesin e të cilëve janë edhe Kryetari i Mitrovicës Agim Bahtiri dhe Sadri Ferati. Me **gjashtë (6)** aktakuza janë zyrtarët e Pejës ku bën pjesë edhe kryetari aktual i Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri. ndërsa ndaj zyrtarëve të komunave të Kamenicës, Suharekës dhe Novobërdës, ku bëjnë pjesë kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ish-kryetari i Suharekës, Sali Asllanaj si dhe kryetari aktual i Novobërdës, Svetislav Ivanović, janë ngritur **pesë (5)** aktakuza. Me numër më të vogël të zyrtarëve të

¹⁴ Shënim: Këtu është përfshirë edhe padia private ndaj kryetarit aktual Zenun Elezaj.

akuzuar, gjithsej **katër (4)** është Prishtina, Ferizaj dhe Vitia. Me nga **tre (3)** aktakuza janë komuna e Obiliqit, Gjakovës dhe Fushë Kosovës. **Dy (2)** zyrtarë të akuzuar kanë komunat Deçan, Rahovec, Ranilluk, Vushtrri dhe Podujevë, dhe me nga **një (1)** zyrtar të akuzuar bëjnë pjesë komuna e

Istogut, Kaçanikut, Parteshit, Shtimes dhe Mitrovicës së Veriut. Bazuar në të gjeturat e IKD-së, në gjashtë (6) komunat e tjera të Kosovës, Junik, Leposaviq, Shtërpçë, Zveqan, Mamushë, dhe Graçanicë nuk ka asnjë zyrtarë të akuzuar.



Grafiku 7: Politikanët e akuzuar të pushtetit lokal-sipas komunave.

Sipas gjetjeve të IKD-së, nga aktakuzat e zyrtarëve të pushtetit lokal, numrin më të madh të tyre e përbëjnë anëtarët e PDK-së, me 68 aktakuza, ku vlen të theksohet se në këtë numër pjesa më e madhe e aktakuzave (17) janë në Drenas e po ashtu edhe në Prizren (12). Pas PDK-së, 41 aktakuza janë ngritur ndaj anëtarëve të LDK-së, 29 aktakuza ndaj anëtarëve të partive të tjera,

shumica prej tyre nga komunat me shumicë serbe, 16 ndaj atyre të AAK-së, 13 ndaj anëtarëve të Nismës Socialdemokrate, nëntë (9) ndaj zyrtarëve të LVV-së dhe nga dy (2) aktakuzë është ngritur ndaj anëtarëve të PSD-së, ndërsa një (1) ndaj atyre të AKR-së, si dhe 10 aktakuza janë ngritur ndaj anëtarëve të partive të paidentifikuara nga IKD.

Partia/ Komuna	PDK	LDK	AAK	LVV	AKR	NISMA	PSD	Të tjera	Pa parti	Të gjitha
Deçan	0	0	2	0	0	0	0	0	0	2
Dragash	8	1	0	0	0	0	0	1	0	10
Drenas	16	0	1	0	0	0	0	0	0	17
Ferizaj	1	2	1	0	0	0	0	0	0	4
Fushë Kosovë	0	2	0	0	0	0	0	0	1	3
Gjakovë	1	0	2	0	0	0	0	0	0	3
Gjilan	3	6	0	0	0	0	0	0	0	9
Istog	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Kaçanik	1	0	0	0	0	0	0	0	0	1
Kamenicë	0	3	1	0	0	0	1	0	0	5
Klinë	5	1	2	1	0	0	0	2	0	11
Lipjan	5	2	0	0	1	0	0	1	0	9
Klllokot	0	0	0	0	0	0	0	16	8	24
Malishevë	1	0	0	2	0	9	0	0	0	12
Mitrovicë	0	6	0	1	0	0	0	0	0	7
Novobërdë	1	0	0	0	0	0	0	4	0	5
Obiliq	1	1	1	0	0	0	0	0	0	3
Partesh	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Pejë	0	4	2	0	0	0	0	0	0	6
Podujevë	1	1	0	0	0	0	0	0	0	2
Prishtinë	0	1	0	2	0	0	1	0	0	4
Prizren	12	3	3	2	0	3	0	2	0	2
Rahovec	2	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Ranillug	0	0	0	0	0	0	0	1	1	2
Shtime	0	1	0	0	0	0	0	0	0	1
Skënderaj	8	0	0	0	0	0	0	0	0	8
Suharekë	0	5	0	0	0	0	0	0	0	5
Viti	1	1	0	1	0	1	0	0	0	4
Vushtrri	1	0	1	0	0	0	0	0	0	2
Mitrovicë Veriore	0	0	0	0	0	0	0	1	0	1
Të gjitha	68	41	16	9	1	13	2	29	10	189

Tabela 2: Politikanët e akuzuar të pushtetit lokal, sipas komunave dhe partive politike.

8. Dallimi gjinor i politikanëve me aktakuza

Nga numri i përgjithshëm prej **216 personave** me **298 aktakuza**, rezulton se në aspektin gjinor, politikanët burra janë

përfshirë në numër më të madh të pjesëmarrjes në aktakuzat e prokurorisë.

Nga 298 aktakuza, **267** prej tyre janë ngritur ndaj **193** politikanëve të gjinisë mashkullore, kurse nga **31** aktakuza të tjera akuzohen **23** politikane të gjinisë femërore.




Grafiku 8: Dallimi gjinor i politikanëve me aktakuza.

9. Përkatësia etnike e politikanëve të akuzuar

Nga gjithsej 216 politikanë të akuzuar, IKD ka gjetur se 186 prej tyre janë të përkatësisë

shqiptare, 22 u takojnë përkatësisë serbe, katër (4) janë boshnjakë, dy (2) nga komuniteti ashkali si dhe një (1) turk dhe një (1) goran.



Grafiku 9: Aktakuzat e politikanëve sipas përkatësisë etnike.

10. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e pandehur


Sipas aktakuzave të ngritura për numrin e përgjithshëm të politikanëve pasqyrohet një laramani e veprave penale të pretenduara dhe të vërtetuara nga personat që ushtrojnë ose kanë ushtruar pozita zyrtare.

Edhe pse janë ngritur **298** aktakuza ndaj tyre, për një numër të caktuar, prokuroria një person e ka ngarkuar me dy ose më shumë vepra penale, çka ka ndikuar që numri i përgjithshëm i veprave penale ta tejkaloi numrin e aktakuzave.

Në bazë të kësaj, në 298 aktakuzat ndaj politikanëve janë të përfshira **351** vepra

penale. Pjesën më të madhe të tyre apo **204** e përbëjnë vepra penale për të cilat zyrtarët publik janë akuzuar për vepra penale që bëjnë pjesë në kapitullin e veprave korruptive.

33 vepra të tjera penale kanë të bëjnë me veprat penale lidhur me armët, **shtatë (7)** për krime lufte, **gjashtë (6)** për krim të organizuar dhe **tre (3)** për terrorizëm. Përpos këtyre veprave, politikanët akuzohen edhe për **98** vepra tjera duke filluar prej veprave penale të vrasjes, mashtrimit, pengimit të personit zyrtar, shmangie nga tatimi, ngacmimi, lëndim trupor, sulm kanosje, vjedhje të shërbimeve komunale dhe vepra të tjera penale.



Grafiku 10: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët.


11. 216 politikanë - 298 aktakuza

Nuk janë të rralla rastet kur politikanët kosovarë janë përballur më shumë se me një aktakuzë me të cilat ata janë ngarkuar për vepra të ndryshme penale. Edhe pse numri i përgjithshëm i aktakuzave është **298**, jo të gjitha këto janë llogaritur si persona.

Kjo për faktin se nga ky numër (216), vetëm **53** prej tyre kanë prodhuar **135 aktakuza**, pasi ata janë ngarkuar me më shumë se dy (2) aktakuza, ndërsa 163 persona të tjerë bëjnë pjesë vetëm në një (1) aktakuzë, e që

të gjithë përbëjnë **216 politikanë me 298 aktakuza**.

IKD ka gjetur se **33 politikanë** janë akuzuar me **dy (2)** aktakuza, **15** të tjerë me **tri (3)** aktakuza, **tre (3)** politikanë bëjnë pjesë në **katër (4)** aktakuza, **një (1)** politikan ka **pesë (5)** aktakuza, ndërsa “rekordmeni” është ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, tani nënkryetari i kësaj komune, Sasha Mirkoviq, mbi të cilin kanë rënduar **shtatë (7) aktakuza**. Në këtë listë me dy ose më shumë aktakuza, përpos zyrtarëve lokal bëjnë pjesë edhe figura të larta publike si zëvendëskryeministra, ministra e kryetar komunash.



Grafiku 11: Politikanët sipas numrit të aktakuzave të ngritura ndaj tyre.

11.1. Sasha Mirkoviq, Kryetari i Komunës së Klllokotit, me shtatë aktakuza

Me numrin më të madh të aktakuzave është ngarkuar ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, Sasha Mirkoviq. Nga prokuroria ai është ngarkuar me shtatë (7) aktakuza për korrupsion, mirëpo deri më tani asnjë aktakuzë ndaj tij nuk është vërtetuar. Në dy

(2) raste prokuroria është tërhequr nga ndjekja penale ndërsa në katër (4) ai është liruar me vendim të formës së prerë, ndërsa një rast është ende duke u gjykuar.

11.2.. Deputeti Frashër Krasniqi me pesë aktakuza

Pas Mirkoviqit, me një numër të madh të aktakuzave është edhe deputeti i PSD-së, Frashër Krasniqi. Për veprimet e tij gjatë kohës sa ka qenë aktivist i LVV-së, Krasniqi është akuzuar për veprat penale “Kryerja e veprës terroriste” i cili rast është në rigjykim, “sulm ndaj personit zyrtar”, i cili rast është në proces, në një (1) aktakuzë e cila është hudhur poshtë është akuzuar për veprën penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi”, në një (1) aktakuzë e cila është refuzuar është akuzuar për “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi” dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, ndërsa pasi që është zgjedhur deputet, përlëshja në studion e Klan Kosovës, me deputetin Milaim Zeka, u shndërruar në aktakuzë për lëndim të lehtë trupor, i cili ka rast ka përfunduar në procedurë të ndërmjetësimit.

11.3. Ish-ministri i Infrastrukturës Pal Lekaj, ish-kryetari i Skenderajt Sami Lushtaku dhe ai i Drenasit Nexhat Demaku me nga katër (4) aktakuza.

Ish-ministri i Infrastrukturës, Pal Lekaj, bënë pjesë në katër aktakuza të prokurorisë. Në dy raste ai është akuzuar për keqpërdorime sa ishte kryetar i Komunës së Gjakovës, ku në njërin prej këtyre është hedhur aktakuza, ndërsa rasti tjetër është akoma në proces. Lekaj akuzohet edhe në dy raste për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës, të cilat janë akoma në proces.

Me katër (4) aktakuza është ngarkuar edhe ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku. Në njërin rast, lidhur me tenderin gashtë milionësh të KEK-ut, ai ishte akuzuar për

korupsion mirëpo është liruar nga gjykata e shkallës së parë, në një rast tjetër, ai ishte akuzuar për përdorim të armës në odën e Fatmir Limaj për të cilin ai është dënuar me vendim të formës së prerë me dënim me gjobë në lartësi prej 1.700 euro. Lushtaku ishte akuzuar nga Eulex-i për krime të luftës por pas një procesi të gjatë, ai ishte liruar nga akuza, ndërsa për rastin për arratisjen e tij nga QKUK, gjykata e shkallës së parë e ka dënuar me 12,000 euro gjobë.

Ish-kryetari i Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku, është akuzuar në tri aktakuza për korupsion, dy nga të cilat i ka përfunduar me aktgjykime liruese, të cilat kanë marrë formën e prerë, ndërsa në një tjetër ai është liruar vetëm nga gjykata e shkallës së parë. Demaku po ashtu ka qenë i akuzuar për krime lufte, mbi bazën e së cilës akuzë, me vendim të formës së prerë, është dënuar me tri (3) vite burgim.

11.4. Ish-zëvendëskryeministri Fatmir Limaj dhe 14 politikanë të tjerë me nga tre (3) aktakuza

45 aktakuza janë prodhuar vetëm nga 15 politikanë, ndërsa në mesin e tyre bënë pjesë edhe ish-zëvendëskryeministri, Fatmir Limaj, por i cili është shpallur i pafajshëm në të tri këto procese gjyqësore, në njërin për krim të organizuar e korupsion sa ishte ministër i MTPT-së dhe dy të tjera për krime lufte. Përpos Limajt, me tri aktakuza liruese për korupsion bënë pjesë edhe ish-kryetari i Komunës së Kamenicës, Shqip Surdulli, ku për njërin prej veprave është shpallur aktgjykim refuzues, ndërsa për dy (2) nga to ai është liruar. Ndërsa ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, Sreqko Spasiq është dënuar me 10 muaj burgim me kusht për një aktakuzë

për korrupsion, për një të ishte hedhur aktakuza e për tjetër të ishte marrë aktgjykim lirues.

Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja, po ashtu bënë pjesë në listën e politikanëve me tre (3) aktakuza, ku në dy raste ai është në proces gjyqësor për akuza për korrupsion, ndërsa për mos raportim të pasurisë ai ishte dënuar me 2.500 euro dhe katër muaj burgim me kusht.

Në listën e zyrtarëve me nga tri (3) aktakuza bëjnë pjesë edhe deputetët Endrit Shala, Donika Kadaj-Bujupi, Salih Zyba, ish-deputeti Milaim Zeka, ish-këshilltari komunal i Komunës së Drenasit, Ajet Demiri, ish-drejtori i arsimit në Komunën e Suharekës, Sherif Berisha, ish-drejtori i urbanizmit në Komunën e Gjilanit, Valon Shefkriu, ish-drejtoresha e inspeksionit në Komunën e Drenasit, Hyrije Xhemajli-Thaqi dhe ish-drejtori i arsimit të kësaj komune, Sadik Tahiraj. Me tri (3) aktakuza është ngarkuar edhe ish-drejtori i Arsimit në Komunën e Klokotit, Miroslav Stoliq.

11.5. 33 politikanë me nga dy (2) aktakuza

Ish-kryeministri i Kosovës në ekzil, ish-zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Shëndetësisë Bujar Bukoshi është duke u përballur me dy (2) aktakuza të cilat janë akoma në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Në njërin prej proceseve ai është duke u akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare sa ishte pjesë e Ministrisë së Shëndetësisë, ndërsa aktakuza tjetër ka të bëjë me dyshimet se ai si Kryeministër i Kosovës në ekzil, ka bërë keqpërdorime me “Fondin e 3%”. Të dyja këto procese janë ndërprerë për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të Bukoshit. Dy (2) aktakuza janë ngritur edhe ndaj ish-ministrit të

MASHT-it, Astrit Haraqija. Në njërin nga to që ka pasur të bëjë me keqpërdorime në MASHT, është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit, ndërsa tjetra që ka të bëjë me krim të organizuar dhe kontrabandë me migrantë në rastin e njohur si “Vizat Italiane”, është akoma në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Me nga dy (2) aktakuza lidhur me veprimet e tyre si të parët e komunave janë akuzuar edhe ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa, ku në një rast është refuzuar aktakuza ndërsa rasti tjetër është në proces, dhe ish-kryetari i Dragashit, Salim Jenuzi, i cili për një rast është liruar nga akuza, ndërsa rasti tjetër është parashkruar. Ish-kryetari i Klinës, Sokol Bashota, në një rast, është në proces të rigjyimit për veprën penale “mos raportim të pasurisë” derisa në rastin e njëjtë është liruar paraprakisht për veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare”, ndërsa në rastin tjetër, të ngritur si padi private sipas Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale, për shkak të parashkrimit është hedhur padia private e KEK-ut me të cilin ai është ngarkuar për “ushtrim arbitrar të të drejtave”.

Kryetari i Malishevës, Ragip Begaj, në një rast është liruar kurse në një rast tjetër është hedhur aktakuza me vendim të formës së prerë për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ndërsa kryetari i Novobërdës, Svetislav Ivanoviq, në një rast e kishte pranuar fajësinë për vepra të korrupsionit dhe është dënuar me 4500 euro, ndërsa për të njëjtën vepër në një rast tjetër, ai është dënuar me 3000 euro gjobë.

Në këtë grup të politikanëve me dy aktakuza bëjnë pjesë edhe deputeti Shkumbin Demalijaj, ish-ministri i Ministrisë së Inovacionit, Besim Beqaj, ish-ministri i Ministrisë së Diasporës, Dardan Gashi, ish-deputetët Naser Osmani, Xhelal

Sveqlla, Aida Dërguti, Besa Baftiu, Ismajl Kurteshi, Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu, kryetari i Komunës së Klinës,

Zenun Elezaj, dhe zyrtarë të tjerë të pushtetit lokal.


2 Aktakuza 33 Politikanë	Bujar Bukoshi, Astrit Haraqija, Besim Beqaj, Qemajl Mustafa, Salim Jenuzi, Sokol Bashota, Ragip Begaj, Svetislav Ivanoviq, Zenun Elezaj, Naser Osmani, Glauk Konjufca, Albulena Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Xhelal Sveqlla, Dardan Mulliqaj, Aida Derguti, Besa Baftiu, Dardan Gashi, Njazi Kryeziu, Rasim Hasani, Ajmane Barani, Lulzim Rifaj, Nexhat Çoçaj , Valon Hoti, Qazim Maloku, Leonard Shabanaj, Blerim Thaqi, Zoran Markoviq, Ilir Baldeadaj, Shkumbin Demalijaj, Bujar Hasani, Fatmir Memaj, Goran Marinkoviq
3 Aktakuza 15 Politikanë	Fatmir Limaj, Shukri Buja, Shaip Surdhulli Sreqko Spasiq, Endrit Shala, Miliam Zeka, Donika Kadaj-Bujupi, Sali Zyba, Hyrije Xhemajlaj-Thaqi, Ajet Demiri, Valon Shefkiu, Sherif Berisha, Sadik Tahiraj, Marko Svillanoviq, Miroslav Stoliq
4 Aktakuza 3 Politikanë	Sami Lushtaku, Nexhat Demaku, Pal Lekaj
5 Aktakuza 1 Politikan	Frasher Krasniqi
7 Aktakuza 1 Politikan	Sasha Mirkoviq

Grafiku 12: Politikanët e ngarkuar me dy ose më shumë aktakuza.

12. Profilet e politikanëve të akuzuar¹⁵

Sa i përket profilit të personave të akuzuar, nga 298 aktakuzat e prokurorisë rezulton se numrin më të madh e ka profili i mesëm dhe atë **206 aktakuza**, ndërsa pas tyre radhitën

personat që i takojnë profilit të lartë, me **55 aktakuza**. **Gjashtë (6)** aktakuza janë ngritur ndaj personave të profilit të ulët, ndërsa **31** të tjera të zyrtarëve pa profil, pasi janë akuzuar për veprime në kohën kur nuk kanë qenë duke ushtruar përgjegjësi shtetërore.



Grafiku 13: Profili i politikanëve të akuzuar.

12.1. Procedimet e aktakuzave të profilit të lartë

Nga 55 rastet në të cilat janë akuzuar zyrtar shtetëror të profilit të lartë, tashmë **33 raste** kanë përfunduar me vendim të formës së prerë. Prej 33 rasteve, kemi **vetëm tri (3) raste** në të cilat janë shqiptuar **aktgjykime dënuese**, ndërsa **në 30 raste të tjera**, gjykata nuk kanë gjetur përgjegjësi penale ndaj zyrtarëve të profilit të lartë. Prej tyre, **15 aktakuza** kanë përfunduar me aktgjykime liruese, **nëntë (9) aktakuza** janë hedhur pa filluar shqyrtim gjyqësor,


ndërsa **gjashtë (6) të tjera** kanë përfunduar me aktgjykime refuzuese, qoftë për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja penale ose për shkak të parashkrimit të lëndëve.

Nga **pesë (5)** aktakuzat që kanë përfunduar vetëm në shkallën e parë, **tre (3) prej tyre** kanë përfunduar me aktgjykime liruese, ndërsa **dy (2)** të tjera me aktgjykime dënuese.

Ndërsa edhe 17 raste të tjera janë akoma në procedurë gjyqësore në instancën e parë.

¹⁵ *Shënim:* Përcaktimi i profileve të personave të akuzuar është bërë në dy mënyra. Profili i lartë është përcaktuar sipas udhëzuesit të KPK-së, të miratuar më 3 nëntor 2013, ndërsa profili i personave i

mesëm dhe i ulët, është përcaktuar në bazë të standardit të hulumtimit të cilin e ka ndërtuar IKD ndër vite, varësisht prej pozitës në institucione, organizata apo të personave pa pozita publike.



Grafiku 14: Procedimi i aktakuzave të politikanëve që i takojnë profilit të lartë.

12.1.2 Aktgjykimet përfundimtare ndaj profilit të lartë

12.1.3 Aktgjykimet dënuese

Nga 55 aktakuzat e profilit të lartë, janë shpallur vetëm **tri (3) aktgjykime dënuese** të formës së prerë, dy nga të cilët vijnë nga partitë e minoriteteve dhe **një (1) nga PDK**.

Kryetari aktual i komunës së Novobërdës, **Svetislav Ivanoviq**, ish-kryetari i Kllkotit, **Sreqko Spasiq** dhe ish-kryetari i

Komunës së Vitisë të akuzuar për vepra korruptive janë të vetmit politikanë, që i takojnë profilit të lartë, që janë dënuar me vendim të formës së prerë. Por edhe pse me aktgjykime dënuese, asnjëri nga ta nuk është dënuar me dënim me burgim efektiv. Ivanoviq kishte bërë marrëveshje për pranim fajësie dhe ishte dënuar me **4500 euro gjobë**, ish-kryetari i Vitisë Nexhmedin Arifi është dënuar me 18 muaj burgim me kusht, ndërsa ish-kryetari i Kllkotit, Sreqko Spasiq, është dënuar me **10 muaj burgim me kusht**.



Sreqko Spasiq Ish-kryetar i Kllkotit
10 muaj burgim me kusht



Nexhmedin Arifi Ish-kryetar i Vitisë
18 muaj burgim me kusht



Svetislav Ivanoviq Kryetar i Novobërdes
4.500 euro gjobë

Grafiku 15: Aktgjykimet dënuese të formës së prerë që i takojnë profilit të lartë.

12.1.4 Aktgjykimet liruese

Numrin më të madh të aktgjykimeve të formës së prerë, e përbëjnë ato liruese (15). Ish-ministri i MTPT-së dhe ish-zëvendëskryeministri në dorëheqje, tani deputeti **Fatmir Limaj** dhe ish-këshilltari i tij, ish-ministër i MTI-së, tani deputeti **Endrit Shala**, janë liruar nga akuzat për krim të organizuar e korrupsion në rastin e njohur si MTPT, ndërsa me aktgjykime

liruese për korrupsion janë edhe ish-kryetari i Klllokotit **Sasha Mirkoviq** me katër (4) raste, dhe me nga dy raste janë ish-kryetari i Kamenicës **Shaip Surdulli** dhe ai i Drenasit **Nexhat Demaku**, ndërsa janë liruar nga një aktakuzë kryetari i Malishevës Ragip Begaj, ish-ministri i MKRS-së **Valton Beqiri**, ish-kryetari i Obiliqit **Mehmet Krasniqi**, ish-kryetari i Dragashit **Selim Jenuzi** dhe ish-kryetari i Klllokotit, **Sreqko Spasiq**.



Fatmir Limaj
Ish-ministër i
MTPT-së



Endrit Shala
Ish-këshilltar i
ministrit të
MTPT-së



Shaip Surdulli
Ish-kryetari i
Kamenicës (2
raste)



Ragip Begaj
Kryetar i
Malishevës



Nexhat
Demaku
Ish-kryetar i
Drenasit (2
raste)



Valton Beqiri
Ish-ministër i
MKRS-së



Mehmet
Krasniqi
Ish-kryetar i
Obiliqit



Selim Jonuzi
Ish-kryetar i
Dragashit



Sreqko Spasiq
Ish-kryetar i
Klllokotit



Sasha
Mirkoviq
ish-kryetar i
Klllokotit (4
raste)

Grafiku 16: Aktgjykimet liruese të formës së prerë që i takojnë profilin të lartë.


12.1.5 Aktgjykimet refuzuese

Edhe pse ishin ngritur aktakuzat për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Gjilanit **Qemajl Mustafa**, ish-kryetarit të Kamenicës **Shaip Surdulli** (në rastin e tretë ndaj tij), ish-kryetarit të Klllokotit **Sasha Mirkoviq** në dy raste, ish-kryetarit të Dragashit **Salim Jenuzi**,¹⁶ ishte

prokuroria ajo që kishte hequr dorë nga akuzat që vetë kishte ngritur. Ndërsa, përpos këtyre, shkak i vjetërsimit të lëndës kishte pushuar procedura edhe ndaj ish-ministrit të MKRS-së, **Astrit Haraqija**. Si për arsyen e parë, ashtu edhe për të dytën, gjykata ka marrë gjashtë (6) aktgjykime refuzuese për pesë (5) zyrtar të lartë publik, të gjithë të akuzuar për korrupsion.

¹⁶ Shënim: Sokol Bashota në këtë rast për veprën penale të “mos raportimit të pasurisë”, ishte dënuar me gjashtë muaj me kusht dhe 1000 euro gjobë, por

ai ishte dënuar për mos raportim të pasurisë, e cila veprë sipas udhëzuesit të KPK-së, nuk bënë pjesë në veprat penale karakterizuese të profilin të lartë



Grafiku 17: Aktgjykimet refuzuese të formës së prerë që i takojnë profilin të lartë.

12.1.6 Hudhjet e aktakuzave

Një numër i konsiderueshëm i rasteve që kanë marrë formën e prerë për zyrtarët e profilin të lartë janë rastet e hudhjeve të aktakuzave. **Nëntë (9)** aktakuza për korrupsion janë hudhur nga gjykatat e Kosovës, pa pasur nevojë që të fillohet me provat e propozuara nga prokuroria të cilat gjykata i ka cilësuar të pamjaftueshme për të hyrë në fazat e shqyrtimit gjyqësorë.

Në këtë listë bëjnë pjesë ish-ministri i Infrastrukturës dhe ish-kryetari i Gjakovës, **Pal Lekaj**, Kryetari i Gjilanit **Lutfi Haziri**, ai i Mitrovicës **Agim Bahtiri**, ai i Malishevës **Ragip Begaj**, ish-ministri i arsimit **Ramë Buja**, ish-zëvendëskryeministri tani Ministri për Komunitete dhe Kthim, **Dalibor Jevtiq**, e po ashtu edhe ish-kryetari i Komunës së Mitrovicës **Sadri Ferati**, ai i Komunës së Klllokotit, **Sreqko Spasiq** dhe ai i Komunës së Vushtrrisë, **Muharrem Shabani**.



Grafiku 18: Hudhjet e aktakuzave që i takojnë profilin të lartë.

12.1.7. Aktgjykimet e shkallës së parë të profilit të lartë

12.1.8 Aktgjykimet dënuese

Gjykatat e shkallës së parë kanë shpallur dy aktgjykime dënuese ndaj dy (2) personave, të akuzuar për korrupsion. Ish-kryetari i Prizrenit **Ramadan Muja**, është dënuar me një (1) vit burgim me kusht dhe kryetari i Novobërdës **Svetislav Ivanoviq** është dënuar me 3000 euro gjobë.

12.1.9 Aktgjykimet liruese

Janë tri (3) raste kur gjykatat e shkallës së parë kanë liruar zyrtarët e profilit të lartë. Përkatësisht, gjykatat themelore kanë liruar ish-kryetarin e Komunës së Skenderajt, **Sami Lushtaku** në rastin “KEK 2”, ish-kryetarin e Suharekës, **Sali Asllanaj** dhe ish-kryetarin e Drenasit, **Nexhat Demaku**.

12.1.10 Rastet në proces

Janë 17 politikanë të profilit të lartë, procedurat e të cilëve janë akoma në procedim pranë gjykatave themelore.

Përkatësisht, duke u gjykuar në procedurë penale në shkallë të parë është ish-kryeministri **Agim Çeku**, ish-ministri i mbrojtjes **Rrustem Berisha**, deputeti **Shkumbin Demalijaj**, ish-deputeti **Nuredin Lushtaku** dhe ish-kryetari i Lipjanit **Shukri Buja**, janë pjesë e procesit gjyqësor të rastit të njohur si “Veteranët”. **Buja**, përpos këtij rasti është në proces të rigjyimit edhe për akuzat për korrupsion për kohën sa ka qenë kryetar komune.¹⁷

¹⁷ Shënim: Pas procesit të rigjyimit, Bujës përseri është dënuar nga gjykata e shkallës së parë. “*Shukri Buja i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)*”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet->

Përpos tyre në procedurë gjyqësore janë akoma ish-ministri i Infrastrukturës, tani deputeti **Pal Lekaj**, për akuza për korrupsion sa ishte kryetar i komunës së Gjakovës e po ashtu edhe ish-zëvendëskryeministri **Bujar Bukoshi**, ish-deputeti **Azem Sylja** e ish-kryetari i Gjilanit **Qemajl Mustafa**, ish-ministrat **Mimoza Kusari-Lila**, **Besim Beqaj**, **Dardan Gashi**, **Nenad Rashiq**, **Nenad Rikallo** dhe në proces të rigjyimit është ish-ministri i Shëndetësisë **Ferid Agani** dhe ish-deputeti **Naser Osmani**.


12.2. Procedimet e aktakuzave të profilit të mesëm

Ashtu siç u tha edhe më lartë, numrin më të madh të politikanëve me aktakuza, me **206 raste** të tilla e përbëjnë personat e profilit të mesëm.¹⁸

Në këtë grup të aktakuzave, **114 aktakuza** kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, prej të cilave **47 raste** janë shqiptuar aktgjykime dënuese, **35 raste** tjera kanë përfunduar me aktgjykime liruese, në **12 raste** janë hudhur aktakuzat, janë refuzuar **18 aktakuza** të tjera, ndërsa dy (2) raste të akuzuarit e kanë përfunduar procesin në procedurën e ndërmjetësimit. **22 aktakuza** tashmë kanë marrë epilogun vetëm në shkallën e parë, prej të cilave **nëntë (9)** janë dënuese, ndërsa **13** të tjera kanë përfunduar me aktgjykime liruese. Ndërsa, **70 aktakuza** janë akoma në procedurë gjyqësore pranë gjykatave të shkallës së parë.

[denimi-dënohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/](#)). (Qasur për here të fundit më 07.12.2020).

¹⁸ Shënim: Në këtë grup personash bëjnë pjesë deputet, drejtor komunal e këshilltar komunal.




Grafiku 19: Procedimi i aktakuzave të politikanëve që i takojnë profilit të mesëm¹⁹.

12.3. Procedimet e aktakuzave të profilit të ulët

Në grupin e personave që i takojnë profilit të ulët bëjnë pjesë vetëm **gjashtë (6)** raste, **katër (4)** nga të cilët janë vendime përfundimtare, ndërsa **dy (2)** të tjerë janë akoma në proces gjyqësor. Nga rastet

përfundimtare, **dy (2)** raste kanë përfunduar me aktgjykime liruese dhe nga një (1) rast ka përfunduar me aktgjykim refuzues dhe dënues. **Një (1)** aktgjykim dënues është dhënë nga shkalla e parë, ndërsa **një (1)** rast është në proces në gjykatën e shkallës së parë.

¹⁹ Shënim: Rastet ndaj dy (2) politikanëve kanë përfunduar në procedurën e ndërmjetësimit




Grafiku 20: Procedimi i aktakuzave të politikanëve që i takojnë profilin të ulët.

12.4. Procedimet e aktakuzave të politikanëve pa profil

Nga numri i përgjithshëm i aktakuzave ndaj politikanëve, 31 aktakuza janë trajtuar si të pa profilizuara në këtë metodologji për arsye se veprat për të cilat ata janë akuzuar pretendohet se janë kryer para se ata të marrin pozita shtetërore apo pasi kanë përfunduar mandatet e tyre, e në të cilat bëjnë pjesë akuzat për krime lufte, huliganizëm e shmangie nga tatimi.

Në këtë grup të aktakuzave janë shqiptuar 22 aktgjykime të formës së prerë, prej të cilave **nëntë (9)** janë aktgjykime dënuese, **tri (3)** aktgjykime liruese dhe **tri (3)** vendime të tjera për hudhje të aktakuzave si dhe **shtatë (7)** aktgjykime refuzuese. Ndërsa në gjykatën e shkallës së parë janë shqiptuar **dy (2)** aktgjykime liruese dhe **një (1)** dënues, ndërsa edhe **gjashtë (6)** aktakuza ndaj politikanëve janë akoma në procedurë gjyqësore.



Grafiku 21: Procedimi i aktakuzave të politikanëve pa profil në kohën e akuzimit.


13. Politikanët e akuzuar sipas partive politike

Përveç analizimit të përgjithshëm të politikanëve të cilët kanë pasur probleme me ligjin, IKD ka analizuar në detaje edhe përfaqësimin e tyre politik sipas subjekteve politike që aktualisht veprojnë ose kanë vepruar më parë.

Në bazë të gjetjeve të IKD-së, rezulton se përkundër dallimeve në numra, nuk është asnjë prej partive politike që në përbërjen e saj nuk ka anëtarë të cilët kanë probleme me ligjin.

Përkatësisht, nga **298** aktakuzat e ngritura nga politikave që nga 17 shkurti 2008 e deri më 31 maj 2020, pjesën më të madhe të tyre

e përbëjnë përfaqësuesit e PDK-së. **67** anëtarë të kësaj partie janë ngarkuar me **89** aktakuza apo 30% të aktakuzave të ngritura ndaj politikanëve, pas saj radhitet LDK-ja me **37** persona **me 48** aktakuza, apo 16%, **22** përfaqësues të AAK-së kanë **32** aktakuza, apo 11 %, **19** zyrtarë të LVV-së kanë **26** aktakuza, apo 9%, **10** anëtarë të PSD-së kanë **17** aktakuza, apo 5%, **19 anëtarë** të Nismës Socialdemokrate kanë **26** aktakuza apo 9%²⁰ dhe **tre (3)** zyrtarë të AKR-së janë me **tri (3)** aktakuza, apo 1%. Përpos tyre janë analizuar edhe partitë tjera me të vogla shqiptare dhe partitë e minoriteteve, të cilat kanë pasur një numër të përgjithshëm prej **32** politikanëve që kanë **47** aktakuza, apo 16% ndërsa, **shtatë (7)** persona të partive të paidentifikuara nga IKD, kanë prodhuar **10** aktakuza, apo 3%²¹



Grafiku 22: Politikanët e akuzuar të partive politike.


²⁰ Shënim: Më 6 korrik 2020, deputeti Haxhi Shala, ka aderuar në AAK, mirëpo për shkak se raporti përfshinë të dhënat deri më 31.05.2020, ai është përfshirë tete aktakuzat e Nismës.

²¹ Shënim: Përcaktimi i politikanëve sipas subjekteve politike është bërë në atë mënyrë që fillimisht janë shikuar pozitat aktuale të tyre në subjektet aktuale politike dhe këtyre i janë shtuar

edhe politikanët të cilët kanë pasur më herët pozita shtetërore si anëtarë të partive politike, ndërsa aktualisht janë pa parti. Nëse një politikan është akuzuar gjatë kohës sa ka qenë në një parti të caktuar politike e më pas e ka ndërruar partinë, ai/ajo është përfshirë në partinë aktuale ose në partinë që më së voni ka pasur pozitë zyrtare.

Ndërsa më poshtë IKD, ka pasqyruar në mënyrë grafike edhe përqindjen e

pjesëmarrjes së partive politike në listat e aktakuzave të prokurorisë.




Grafiku 23: Aktakuzat e politikanëve të partive politike, të shprehura në përqindje.

14. Politikanët aktivë në institucione me dënime të plotfuqishme dhe me aktakuza aktive

IKD më qëllim të pasqyrimit sa më gjithëpërfshirës, ka analizuar edhe përfaqësimin aktual të partive politike në institucione publike.²² Gjetjet e IKD-së dëshmojnë se pjesë e institucioneve publike janë 60 politikanë të përfshirë në 70 raste penale, ndaj të cilëve janë shqiptuar 26 aktgjykime dënuese dhe janë 44 aktakuza aktive.

Nga gjithsej **26** dënime të formës së prerë, nga **gjashtë (6)** prej tyre u takojnë zyrtarëve të PDK-së dhe NISMA-s, **katër (4)** të AAK-së, nga **tre (3)** kanë zyrtarët e LVV-së dhe partive të tjera, **dy (2)** dënime të formës së prerë kanë zyrtarët e LDK-së, ndërsa nga **një (1)** dënim të plotfuqishëm kanë anëtarët e PSD-së dhe AKR-së.

Nga **44** aktakuza aktive, numrin më të madh e përbëjnë rastet e partive të tjera, me gjithsej 13 raste, 11 prej tyre u takojnë zyrtarëve të AAK-së dhe **nëntë (9)** akuza aktive kanë zyrtarët e LVV-së, **pesë (5)** të NISMA-s, **tre (3)** të LDK-së dhe **tre (3)** akuza aktive kanë zyrtarët e PDK së.



Grafiku 24: Zyrtarët aktual të institucioneve me dënime të formës së prerë dhe aktakuza aktive.

²² Shënim: Këto të dhëna janë deri me datë 31.05.2020, kur ka qenë edhe dita e fundit e gjenerimit të të dhënave të këtij raporti.


15. Procedimet e aktakuzave të politikanëve

Nga numri i përgjithshëm prej 298 aktakuzave, është arritur që për **204** prej tyre të ketë vendime gjyqësore, ku **174** nga të cilat janë vendime përfundimtare ndërsa **31** të tjera kanë përfunduar vetëm në gjykatën e shkallës së parë. Përpos tyre janë edhe **93** aktakuza të cilat janë akoma duke u trajtuar në instancën e parë gjyqësore.

Nga 174 rastet e përfunduara me aktgjykim të formës së prerë, prokuroria ka dështuar të mbrojë akuzat në 111 raste apo 63.79%,

ndërsa me aktgjykime dënuese kanë përfunduar vetëm **60** raste apo 34.48% derisa një (1) rast ka përfunduar me vërejtje gjyqësore dhe dy (2) raste janë zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit. Sa i përket aktakuzave të cilat kanë dështuar të provohen në gjykata, në **55** prej tyre janë nxjerrë aktgjykime liruese, **32** aktakuza kanë përfunduar me aktgjykime refuzuese, ndërsa gjykatat kanë hudhur edhe **24 aktakuza**.

Ndërsa nga 30 vendimet e shkallës së parë janë shqiptuar **12** aktgjykime dënuese dhe **18** aktgjykime liruese.



Grafiku 25: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve politik.

15.1 Dënimet e politikanëve sipas llojit të dënimit

15.1.1 Dënimet e formës së prerë


Në bazë të gjetjeve të IKD-së rezulton se gjatë kësaj periudhe të raportimit në 298 aktakuzat ndaj 216 politikanëve të akuzuar, deri më tani me vendim të formës së prerë janë shpallur aktgjykime dënuese në vetëm **60** prej këtyre aktakuzave. Nga këto

aktgjykime dënuese, janë shqiptuar 77 dënime, prej të cilave janë vetëm **nëntë (9)** dënime me burgim efektiv, **shtatë (7)** nga të cilët janë anëtarë të PDK-së, **një (1)** nga Nisma Socialdemokrate dhe **një (1)** nga Partia e Ashalinjëve për Integrim ndërsa **31** dënime të tjera janë dënime me burgim me kusht, **shtatë (7)** prej të cilave janë shqiptuar ndaj anëtarëve të PDK-së, **gjashtë (6)** ndaj anëtarëve të Nismës

Socialdemokrate, **pesë (5)** për ata të LDK-së, nga **katër (4)** për ata të LVV-së dhe partive të tjera, **tre (3)** ndaj anëtarëve të AAK-së, kurse nga **një (1)** dënim me kusht është shqiptuar ndaj anëtarëve të PSD-së dhe AKR-së.

Përpos këtyre vendimeve, janë shqiptuar edhe **36** dënime me gjobë, **12** ndaj anëtarëve të PDK-së, **shtatë (7)** ndaj

anëtarëve të Nismës Socialdemokrate, **gashtë (6)** ndaj atyre të LDK-së, **pesë (5)** ndaj anëtarëve të partive të tjera, nga **dy (2)** dënime me gjobë janë shqiptuar ndaj politikanëve të PSD-së dhe AAK-së, kurse me nga **një (1)** aktgjykim dënues me gjobë janë shqiptuar ndaj një anëtari të LVV-së dhe një tjetër të partive të paidentifikuara, ndërsa ndaj një (1) zyrtari të PDK-së, është shqiptuar edhe një (1) dënim plotësues.²³



Grafiku 26: Dënimet e formës së prerë për të gjithë politikanët.

Në tabelën në vijim, IKD ka paraqitur të dhënat që kanë të bëjnë me politikën ndëshkimore në rastet e politikaneve, të

cilat kanë përfunduar me aktgjykime dënuese të formës së prerë, të ndara sipas partive politike.

²³ Shënim: Në këtë grup të dënimeve janë 14 raste të cilët janë dënuar edhe dënim me burgim ose burgim me kusht dhe dënim me gjobë.

Dënimi/ Partia	Burgim efektiv	Gjobë	Kusht
PDK	7	12	7
LDK	0	6	5
LVV	0	1	4
AAK	0	2	3
PSD	0	2	1
NISMA	1	7	6
AKR	0	0	1
Të tjera	1	5	4
Pa parti	0	1	0
Gjithsej	9	36	31

Tabela 3: Aktgjykimet dënuese të ndara sipas politikanëve të partive politike dhe numrit të dënimit të formës së prerë.²⁴

Nga aktgjykimet dënuese të formës së prerë janë shqiptuar nëntë (9) dënime me burgim **shtatë (7)** ndaj politikanëve të PDK-së, **një (1)** të Nismës Socialdemokrate dhe **një (1)** të Partisë së Ashkalinjëve për Integrim. Totali i këtyre dënimeve me burgim efektiv përbënë 233 muaj burgim efektiv apo 19 vite e pesë (5) muaj me burgim efektiv.

Shumica nga këto dënime janë shqiptuar ndaj zyrtarëve të PDK-së, konkretisht 210 muaj apo 17 vite e gjashtë (6) muaj, ndaj një (1) zyrtarit Partisë së Ashkalinjëve për Integrim janë shqiptuar 15 muaj apo një (1) vit e tre (3) muaj, ndërsa ndaj zyrtarëve të NISMA-s janë shqiptuar tetë (8) muaj burgim efektiv.

Ndaj zyrtarëve të partive janë shqiptuar 36 dënime me gjobë, 12 PDK, shtatë (7)

Nisma Socialdemokrate, gjashtë (6) ndaj atyre të LDK-së, pesë (5) ndaj atyre të partive të tjera shqiptare dhe të komuniteteve, nga dy (2) AAK, PSD, nga një (1) LVV dhe partitë e pa identifikuar, dhe AKR pa asnjë dënim) në shumë totale prej 36,240 euro.

Me 10,740 euro gjobë janë dënuar zyrtarët e NISMA-së, 8,400 euro gjobë ndaj zyrtarëve të partive të tjera, 6,150 euro gjobë ndaj zyrtarëve të LDK-së, 5,200 euro ndaj atyre të AAK-së, 2,500 ndaj zyrtarëve të partive të pa identifikuar, me 1,950 euro gjobë janë dënuar zyrtarët e PDK-së, me 900 euro ata të PSD-së dhe me 400 euro gjobë zyrtarët e LVV-së.

Ndaj politikanëve të partive të ndryshme janë shqiptuar gjithsej 31 dënime me kusht

²⁴ Shënim: Përpos të dhënave në tabelë, është shqiptuar edhe një (1) dënim plotësues ndaj një zyrtari të PDK-së.

(shtatë (7) PDK, gjashtë (6) Nisma, pesë (5) LDK, nga katër (4) LVV dhe partitë e tjera, tre (3) AAK, nga një (1) PSD dhe AKR).

Llogaritur me muaj, dënime me kusht kanë pasur më së shumti anëtarët e PDK-së, me 47 muaj burgim me kusht, 46 muaj burgim me kusht janë shqiptuar ndaj zyrtarëve të partisë NISMA Socialdemokrate, 44 muaj

burgim me kusht janë shqiptuar ndaj anëtarëve të LDK-së, 40 ndaj atyre të LVV-së, 26 ndaj zyrtarëve të AAK-së, 21 ndaj partive të tjera të shqiptarëve dhe komuniteteve, 14 muaj burgim me kusht janë shqiptuar ndaj zyrtarëve të PSD-së, tre (3) ndaj zyrtarëve të AKR-së, kurse ndaj partive të pa identifikuar nuk është shqiptuar asnjë dënim i tillë.


Dënimi/ Partia	Burg/Muaj	Gjobë/Shuma	Kusht/Muaj
PDK	210	€ 1,950.00	47
LDK	0	€ 6,150.00	44
LVV	0	€ 400.00	40
AAK	0	€ 5,200.00	26
PSD	0	€ 900.00	14
NISMA	8	€ 10,740.00	46
AKR	0	€ -	3
Të tjera	15	€ 8,400.00	21
Pa parti	0	€ 2,500.00	0
Gjithsej	233	€ 36,240.00	241

Tabela 4: Aktgjykimet dënuese të ndara sipas politikanëve të partive politike dhe llojit të dënimit të formës së prerë.

15.1.2 Dënimet e shkallës së parë

Si në vendimet përfundimtare, ashtu edhe në vendimet e shkallës së parë, janë shpallur pak aktgjykime dënuese. Deri më tani janë shqiptuar vetëm **tre (3)** aktgjykime me dënim me burgim efektiv, një nga radhët e LVV-së, një nga radhët e Listës Serbe dhe një tjetër të partive të

paidentifikuar. Në **katër (4)** raste është shqiptuar dënim me gjobë, përkatësisht nga një rast për anëtarët e PDK-së, AAK-së, të partive minoritare dhe partive të paidentifikuar, ndërsa në **gjashtë (6)** raste janë dhënë dënime me kusht, përkatësisht ndaj katër anëtarëve të PDK-së, ndaj një anëtari të AAK-së dhe LDK-së.



Grafiku 27: Dënimet e shkallës së parë për të gjithë politikanët.

Dënimi/ Partia	Burg/Dënime	Gjobë/Dënime	Kusht/Dënime
PDK	0	1	4
LDK	0	0	1
LVV	1	0	0
AAK	0	1	1
PSD	0	0	0
NISMA	0	0	0
AKR	0	0	0
Të tjera	1	1	0
Pa parti	1	1	0
Gjithsej	3	4	6

Tabela 5: Aktgjykimet dënuese të ndara sipas politikanëve të partive politike dhe numrit të dënimit të shkallës së parë.

Nga aktgjykimet dënuese të shkallës së parë janë shqiptuar tri (3) dënime me burgim, ku **një (1)** anëtar i takon të Nismës Socialdemokrate, **një (1)** LVV-së dhe **një (1)** partive të paidentifikuara, me ç'rast në total janë shqiptuar 92 muaj burgim apo

shtatë (7) vite e tetë (5) muaj me burgim efektiv.

Ndaj një (1) zyrtari të LVV-së janë shqiptuar 60 muaj burgim efektiv apo pesë (5) vite, ndaj një zyrtari të partive të tjera janë shqiptuar 24 muaj apo dy vite burgim

dhe ndaj një (1) zyrtari të partive të paidentifikuara nga IKD, janë shqiptuar tetë (8) muaj burgim.

Ndaj zyrtarëve të partive janë shqiptuar edhe katër (4) dënime me gjobë (nga një PDK, AAK, të partive të tjera dhe të partive të pa identifikuar) ku në total janë shqiptuar 16,600 euro dënim me gjobë. Me 12,000 euro është dënuar një zyrtar i PDK-së, me 1,000 euro një zyrtar i AAK-së, 3,000 euro një zyrtar i partive të tjera dhe ndaj një zyrtari të partive të pa identifikuar, është shqiptuar 600 euro gjobë.

Ndaj politikanëve të partive janë shqiptuar po ashtu gjithsej 6 dënime me kusht, përkatësisht katër (4) dënime me kusht janë shqiptuar ndaj anëtarëve të PDK-së, dhe nga një ndaj anëtarëve të LDK-së dhe AAK-së, në të cilat janë shqiptuar 49 muaj burgim me kusht apo katër (4) vite e një (1) muaj. Llogaritur me muaj, dënime me kusht kanë pasur më së shumti anëtarët e PDK-së, me 29 muaj apo dy (2) vite e pesë (5) muaj burgim me kusht, 1 vit burgim me kusht ka një zyrtar i LDK-së dhe tetë (8) muaj burgim me kusht ka një zyrtar i AAK-së.

Dënimi/ Partia	Burg/Muaj	Gjobë/Shuma	Kusht/Muaj
PDK	0	€ 12,000.00	29
LDK	0	€ -	12
LVV	60	€ -	0
AAK	0	€ 1,000.00	8
PSD	0	€ -	0
NISMA	0	€ -	0
AKR	0	€ -	0
ETJ	24	€ 3,000.00	0
PA PARTI	8	€ 600.00	0
Gjithsej	92	€ 16,600.00	49

Tabela 6: Aktgjykimet dënuese të ndara sipas politikanëve të partive politike dhe llojit të dënimit të shkallës së parë.

16. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PDK-së

Partia Demokratike e Kosovës, me **89 aktakuza ndaj 67** anëtarëve apo ish-anëtarëve të saj, të cilët aktualisht nuk përfaqësojnë ndonjë parti tjetër, e mban primatin mes partive me numrin më të madh të personave dhe aktakuzave të ngritura ndaj tyre. Nga 89 aktakuzat e ngritura ndaj zyrtarëve të kësaj partie, **52** prej tyre tani kanë përfunduar me vendim të formës së prerë, **15** të tjera kanë marrë verdiktin vetëm të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa në procedurë gjyqësore në gjykatat themelore janë edhe **22** të tjera.


16.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e PDK-së

Në **89 aktakuzat** ndaj politikanëve të PDK-së janë të përfshira **105 vepra penale**. Pjesën më të madhe të tyre prej **74** veprave

e përbëjnë vepra penale për të cilat zyrtarët e PDK-së janë akuzuar për vepra penale që bëjnë pjesë në kapitullin e veprave penale të korrupsionit.

Për dyshimet se ata kanë keqpërdorur pozitat e tyre, pra vepra penale e “keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar”, është pretenduar në rastet më të shpeshta, e nuk kanë munguar as veprat tjera të korrupsionit si siç janë mashtrimi e përvetësim në detyrë, “mos raportimit të pasurisë”, por edhe vepra të tjera të kësaj natyre.

Në **dy (2)** raste si vepër bazë është ajo e krimit të organizuar, dhe në **dy (2)** të tjera vepra lidhur me armët, në **pesë (5)** të tjera ajo për krime të luftës. Përpos këtyre veprave më të zakonshme politikanë e PDK-së, në **89** aktakuzat ndaj tyre ata janë ngarkuar edhe për **22** vepra tjera penale.




Grafiku 28: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e PDK-së.

Nga të gjitha rastet në të cilat janë gjykuar zyrtarët e PDK-së, janë shqiptuar 27 aktgjykime **dënuese**, prej të cilave 22 janë të formës së prerë dhe **pesë (5)** të tjera të gjykatës së shkallës së parë, në 24 raste janë shqiptuar aktgjykime **liruese**, prej të cilave 14 janë të formës së prerë, ndërsa 10

të tjera të gjykatës së shkallës së parë. Me vendim të formës së prerë janë **refuzuar** edhe **nëntë (9)** aktakuza, ndërsa janë **hedhur** edhe **shtatë (7)** të tjera.

Përpos kësaj edhe 22 raste janë akoma në proces pranë gjykatës së shkallës së parë.



Grafiku 29: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PDK-së.

16.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të PDK-së

Në 27 raste ndaj anëtarëve të PDK-së janë dënuar nga gjykatat pas pretendimeve të prokurorisë se ata kanë kryer vepra penale të ndryshme (22 raste me vendim të formës së prerë dhe **pesë (5)** me vendim të shkallës së parë) dhe për këtë ndaj tyre janë shqiptuar **32 dënime**, për faktin se një person përpos dënimit me burgim ose me kusht, i është shqiptuar edhe dënim me gjobë ose dënim plotësues.

16.2.1. Dënimet e formës së prerë

Ish-deputeti dhe këshilltari aktual i Presidentit Hashim Thaçi, **Rrustem Mustafa**, është dënuar për krime lufte me katër (4) vite burgim, ish-deputeti **Latif Gashi**, për krime lufte ishte dënuar me

gjashtë (6) vite burgim, ndërsa me tri (3) vite burgim për vepër të njëjtë është dënuar edhe ish-kryetari i Drenasit **Nexhat Demaku**, e dënim të njëjtë me të kishte marrë edhe vëllai i tij, ish-deputeti **Fadil Demaku**. Për “detyrim” dhe “armëmbajtje pa leje” me tri (3) vite burgim dhe 1500 euro gjobë ishte dënuar ish-kryetari i Kaçanikut, **Xhabir Zharku**, ndërsa për “përdorim të armës” me 1700 euro gjobë ishte dënuar edhe ish-kryetari i Skenderajt, **Sami Lushtaku**.

Ish-kryetari i Lipjanit **Shukri Buja**, është dënuar me katër (4) muaj burgim me kusht dhe 2,000 euro gjobë, për mos raportim të pasurisë, ndërsa me dy (2) vite burgim për rrezikim të trafikut publik është dënuar ish-kryetari i Ferizajt, **Bajrush Xhemajli**.


Përpos tyre, aktgjykime dënuese të formës së prerë janë shqiptuar edhe ndaj kandidatit të komunës së Hanit të Elezit, këshilltarit aktual të Komunës së Hanit të Elezit, **Florim Shkreta**, i cili për “mashttrim me votime” është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim efektiv.

Lidhur me akuza për korrupsion, ish-kryetari i Komunës së Vitisë, **Nexhmedin Arifi**, ishte dënuar me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me kusht, ish-drejtori komunal i Dragashit **Hajri Ramadani**, ishte dënuar me një (1) vit burgim me kusht dhe dy (2) vite mos ushtrim të profesionit ndërsa me 1,800 euro gjobë ishin dënuar edhe ish-drejtorët komunal të Skenderajt **Halim Gecaj** dhe **Lulzim Kadriu**, ndërsa ish-drejtori i arsimit në komunën e Drenasit, **Sadik Tahiraj**, është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht. Ish-drejtori komunal në Prizren, **Hasan Hasani**, është dënuar me 3,000 euro gjobë, ish-drejtori komunal në Lipja, **Nazmi Krasniqi**, është dënuar me shtatë (7) muaj burgim me kusht dhe 3000 euro gjobë. Këshilltari i komunës së Malishevës, **Izet Morina**, është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht dhe 400 euro gjobë. Ish-këshilltari komunal në Drenas, **Ajet Demiri**, është dënuar me 1,800 euro gjobë

për veprën penale “konflikt interesi”. Ndërsa, këshilltari aktual në Komunën e Podujevës, **Fatmir Rudari**, i akuzuar për mos raportim të pasurisë është dënuar me 750 euro gjobë. Këshilltari Komunal në Gjilan, **Riza Abdyli**, po ashtu i akuzuar për mos raportim të pasurisë, është dënuar me 600 euro gjobë. Për të njëjtën vepër, këshilltari komunal në Dragash, **Granit Rifaj**, është dënuar me 100 euro gjobë, ndërsa një (1) muaj burgim me kusht i është shqiptuar konsullit të Kosovës në Bullgari, **Lulzim Rifaj**.

16.2.2. Dënimet e shkallës së parë

Përpos vendimeve përfundimtare, janë edhe pesë (5) persona që kanë marrë aktgjykime dënuese në gjykatën e shkallës së parë. Ish-kryetari i Prizrenit **Ramadan Muja** dhe tre ish-drejtorët komunal të kësaj komune, **Sadik Paçarizi**, **Minir Krasniqi** dhe **Avni Ademaj**, për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” janë dënuar me dënime me kusht. Muja është dënuar me një (1) vit burgim me kusht, ndërsa drejtorët komunal me gjashtë (6) muaj dënim me kusht. Ndërsa, për veprën penale “arratisja e personit të privuar nga liria”, ish-kryetari i Komunës së Skenderajt, **Sami Lushtaku**, është dënuar me 12,000 euro gjobë.



Grafiku 30: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e PDK-së.

16.3. Aktgjykimet liruese të anëtarëve të PDK-së

Me vendimet aktuale, janë **24 raste** kur gjykatat kanë shpallur të pafajshëm anëtarët e PDK-së, prej tyre **14 janë liruar** me vendim të formës së prerë, ndërsa **10 të tjerë** me vendim të shkallës së parë.

16.3.1. Lirimet e formës së prerë

Ish-kryetari i Skenderajt **Sami Lushtaku**, ishte liruar për “krime lufte”, ndërsa nga akuzat për korrupsion është liruar ish-kryetari i Dragashit **Salim Jenuzi**, si dhe në **dy raste** të ndara ish-kryetari i Drenasit, **Nexhat Demaku**. Ndërsa për akuza për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” është liruar edhe ish-drejtori i komunës së Skenderajt, **Musa Lushtaku**, ish-drejtoresha e Drenasit **Hyrije Xhemajlaj-Thaqi**, ish-drejtori i Komunës së Prizrenit, **Nexhat Çocaj**, ish-drejtori në Komunën e Rahovecit, **Behar Rama** dhe ai i Komunës së Novobërdës, **Adem Abazi**, ish-drejtori i Komunës së Klinës, **Zeqir Morina**, ish-

drejtori komunal në Prizren, **Bujar Hasani**, kryetari i Kuvendit Komunal në Rahovec, **Xhemali Haxhimustafa** si dhe ish-kryesuesi komunal në Dragash, **Lulzim Rifaj**. Me aktgjykim lirues kishte përfunduar edhe gjykimi ndaj ish-deputetit **Nait Hasani**, i cili ishte akuzuar për mos raportim të pasurisë.

16.3.2. Lirimet e shkallës së parë

Përpos zyrtarëve të liruar me vendim përfundimtar, janë edhe 10 zyrtarë të tjerë të cilët janë liruar nga akuza nga gjykatat themelore.

Për veprën penale “shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, për të akuzuarit **Adem Grabovci**, **Zenun Pajaziti**, **Besim Beqaj**, **Njazi Kryeziu**, dhe **Ilhami Gashi** është shpallur aktgjykim lirues.

Për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo i autoritetit zyrtar”, janë liruar **Nexhat**

Demaku, Sami Lushtaku dhe në dy raste Sadik Tahiraj.

Për veprën penale “lehtësim në arratisje e personit të privuar nga liria”, është liruar edhe **Mërgim Lushtaku**.

16.4. Aktgjykimet refuzuese të anëtarëve të PDK-së

Nëntë (9) aktakuza të tjera ndaj zyrtarëve të PDK-së janë refuzuar, disa pasi prokuroria kishte hequr dorë, e disa të tjera për shkak të të parashkrimit. Të gjitha këto vendime tanimë janë të formës së prerë.

Prokurorët kishin hequr dorë nga akuzat ndaj ish-kryetarit të Gjilanit **Qemaj Mustafa**, ish-kryetarit të Dragashit **Selim Jenuzi**, të akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe ish-deputetit **Elmi Recica**, që akuzohej për mos raportim të pasurisë. Ndërsa prokurori kishte hequr dorë nga akuza për korrupsion edhe ndaj këshilltarit të Komunës së Dragashit të akuzuar për “kanosje” **Artan Loshaj**, dhe ish-drejtorit të Komunës së Drenasit, **Mehdi Kurrumeli**.

Aktgjykim refuzues është shpallur edhe ndaj udhëheqësit të Elkos Group, **Ramiz Kelmendi**, i akuzuar për veprën penale “vjedhja e shërbimeve komunale”, si dhe ndaj **Tefik Malokut**, i akuzuar për veprën penale “lidhja e kontratës së dëmshme”.

Ndërsa, për shkak të parashkrimit, gjykata kishte refuzuar akuzën për korrupsion ndaj ish-drejtorit të komunës së Drenasit, **Ajet Demiri**, në njërin nga tri akuzat ndaj tij dhe anëtarit tjetër të kësaj partie, **Lulzim Berisha**, i cili ishte akuzuar për ndihmë në kryerjen e veprave korruptive.

16.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të PDK-së

Shtatë (7) aktakuza të zyrtarëve të PDK-së ishin hedhur poshtë akoma pa filluar shqyrtimi gjyqësor. Gjkata kishte hedhur aktakuzën për korrupsion ndaj ish-ministrit të MASHT-it **Ramë Buja** si dhe ndaj ish-kryetarit të Klinës, **Sokol Bashota**.

Gjkata kishte hedhur edhe **dy (2)** aktakuza të ndara ndaj drejtoreshës së komunës së Drenasit **Hyrije Xhemajlaj-Thaqi**, në njërin rast të akuzuar për korrupsion e në rastin tjetër për “mbikëqyrje të pandërgjegjshme të trafikut publik” si dhe ndaj drejtorëve tjerë të kësaj komune, **Shyqeri Bublaku** dhe **Ajet Demiri**, që të dy të akuzuar për korrupsion, si dhe **Bujar Hasani**, po ashtu i akuzuar për korrupsion.

16.6. Rastet në proces të anëtarëve të PDK-së

Përpos rasteve të cilat tashmë kanë marrë vendime gjyqësore, qoftë ato përfundimtare, qoftë vetëm vendime të shkallës së parë, janë edhe **22** aktakuza tjera me të cilat në procedurë gjyqësore para gjykatave të shkallës së parë janë duke u përballur anëtarët e PDK-së.

Për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar janë duke u akuzuar ish-ministri i Inovacionit **Besim Beqaj**, deputeti **Kujtim Gashi**, ish-drejtor i Urbanizmit në Skenderaj, **Hasan Shala**, ish-drejtorët komunal në Prizren, **Njazi Kryeziu** dhe **Nexhat Çoqaj**, ish-nënkryetari i Komunës së Klinës, **Enver Berisha** dhe ish-drejtori i kësaj komune, **Esat Rraci**, si dhe ish-

drejtori i Komunës së Obiliqit, **Avdi Mjeku**.

Për veprën penale “ndotja e ujit të pijshëm” është duke u akuzuar drejtori komunal në Drenas, **Idriz Hysenaj**. Për krim të organizuar e korrupsion, në rastin e njohur si “Toka” është duke u akuzuar ish-deputeti **Azem Syla**, ndërsa në një rast tjetër që bënë pjesë në rastet e njohura si “raste të mëdha”, është edhe ai i “Veteranëve”, në të cilin për akuza për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, janë duke u akuzuar ish-kryeministri **Agim Çeku**, ish-deputeti **Nuredin Lushtaku** dhe ish- kryetari i komunës së Lipjanit, **Shukri Buja**.

Shukri Buja është në proces të rigjyimit edhe në rastin e shënjestruar për liberalizimin e vizave të njohur si “Feronikeli”, pasi Gjykata e Apelit e kishte kthyer në rigjykim vendimin e themelores me të cilin ai ishte dënuar me tri (3) vite burgim. Bashkë me Bujën, në këtë proces janë duke u akuzuar edhe ish-drejtorët komunal të Lipjanit **Edmond Regjepi** dhe **Bajram Rizani**.²⁵

Ish-kryetari i Komunës së Gjilanit **Qemajl Mustafa**, vazhdon të përballët me akuza për korrupsion e krim të organizuar, ndërsa për mos raportim të pasurisë po akuzohen ish-kryetari i Komunës së Klinës, **Sokol Bashota** dhe ish-këshilltari komunal në Gjakovë, **Ilir Beqiri**.

Për veprën penale të “sulmit”, lidhur me një përleshje në Kuvendin e Kosovës me deputetin Arben Gashi, në muajin maj të vitit 2019 është ngritur aktakuzë ndaj ish-

nënkryetarit të Kuvendit, **Xhavit Haliti**, por gjykimi ndaj tij akoma nuk ka filluar

Për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” janë në proces gjyqësore edhe dy ish-drejtorët e komunës së Dragashit **Avni Nebiu** dhe **Ahmet Bahtijari**.

²⁵ *Shënim:* Pas procesit të rigjyimit, Bujës përseri është dënuar nga gjykata e shkallës së pare. “*Shukri Bujës i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)*”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun:

<https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet-denimi-denohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për here të fundit më 07.12.2020).


17. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LDK-së

Pas PDK-së, me numër të konsiderueshëm të zyrtarëve e ish-zyrtarëve të saj që kanë pasur probleme me ligjin, është Lidhja Demokratike e Kosovës. **37 persona** janë ngarkuar me **48 aktakuza**.

17.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e LDK-së

Në **48 aktakuzat** ndaj politikanëve të LDK-së janë të përfshira **54 vepra penale**. Pjesën më të madhe të tyre prej **36** veprave penale e përbëjnë veprat penale që bëjnë pjesë në kapitullin e korrupsionit.

Përpos korrupsionit, në **dy (2)** raste si vepër bazë është ajo e krimit të organizuar dhe në **një (1)** rast vepra penale e “armëmbajtjes pa leje”. Përpos këtyre veprave më të zakonshme, politikanët e LDK-së dyshohen edhe për **15** vepra tjera penale.




Grafiku 31: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e LDK-së.

Nga 48 aktakuzat ndaj zyrtarëve të LDK-së, tashmë **31** raste kanë marrë formën e prerë, në të cilat janë shqiptuar **nëntë (9)** aktgjykime **dënuese**, **11** aktgjykime **liruese**, janë **refuzuar shtatë (7)** aktakuza, ndërsa **katër (4)** të tjera janë **hudhur** poshtë, ndërsa në një (1) rast është shqiptuar vërejtje gjyqësore. Përveç aktgjykimeve të formës së prerë, janë edhe

katër (4) aktgjykime të shkallës së parë, **tri (3)** nga të cilat janë aktgjykim **liruese**, ndërsa është marrë edhe **një (1)** aktgjykim **dënues**.

Përpos tyre, janë edhe **12 aktakuza** të tjera ndaj zyrtarëve të kësaj partie, që janë në proces para gjykatave të shkallës së parë.



Grafiku 32: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LDK-së.²⁶

17.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të LDK-së

Nga 48 aktakuzat ndaj anëtarëve të LDK-së, rezulton se deri më tash gjykatat ndaj tyre kanë marrë **10** aktgjykime dënuese, **nëntë (9)** prej të cilave janë të formës së prerë, në të cilat raste janë shqiptuar gjithsej 11 dënime, për faktin se ka pasur raste kur një person përpos dënimit me burgim ose me kusht, i është shqiptuar edhe dënim me gjobë. Ndërsa duhet theksuar se në këtë grup nuk bënë pjesë asnjë dënim me burgim efektiv dhe po ashtu nuk bënë pjesë asnjë zyrtar i nivelit qendror. Ndërsa, **një (1)** aktgjykim dënues është shqiptuar në shkallë të parë.

17.2.1. Dënimet e formës së prerë

Ish-drejtori i arsimit të Komunës së Suharekës **Sheri Berisha**, është gjetur fajtor për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe është dënuar me 4,000 euro gjobë, ndërsa për veprën penale “cenim i të drejtave të punësimit dhe papunësisë”, me

dënim me gjobë prej 900 eurove është dënuar edhe ish-drejtori i arsimit të Komunës së Vitisë, **Qahil Sahiti**. Ndërsa ndaj drejtorit të Inspeksionit në Komunën e Suharekës **Sedat Kuqi**, i akuzuar për mos raportim të pasurisë, është shqiptuar vërejtje gjyqësore. Për të njëjtën vepër, drejtoresha komunale e Gjilanit, **Shpresa Hajdari**, është dënuar me 400 euro gjobë, ndërsa për pengim të personit zyrtar, ish-drejtori komunal i Prizrenit, **Fatmir Memaj** është dënuar me tre (3) muaj burgim me kusht.²⁷

Për “përvetësim në detyrë”, me dy (2) muaj burgim me kusht dhe 250 euro gjobë ishte dënuar ish-këshilltari i Komunës së Mitrovicës, **Qazim Azemi**, ndërsa këshilltarja e Komunës së Lipjanit **Imrije Sadriu**, ishte dënuar me një (1) vit burgim me kusht dhe 200 euro gjobë për mos raportim të pasurisë.

Me tre (3) muaj burgim me kusht, për veprën penale të “lëndimit të lehtë trupor”,

²⁶ Shënim: Në tabelë nuk është paraqitur edhe një rast në të cilin është shqiptuar një (1) vërejtje gjyqësore.


²⁷ Shënim: Për këtë rast, Fatmir Memaj është akuzuar para marrjes së pozitës së drejtorit.

është dënuar këshilltari i Komunës së Dragashit, **Samedin Xheladini**.

Shefi i kabinetit të kryetarit të Komunës së Pejës, **Budak Shala**, i akuzuar për mashtrim, është dënuar me dy (2) vite burgim me kusht.

17.2.2. Dënimet e shkallës së parë

Ish-drejtoresha e Komunës së Mitrovicës, Ajmane Barani, është dënuar me një (1) vit burgim me kusht për keqpërdorim të pozitës zyrtare.



Grafiku 33: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e LDK-së.

17.3. Aktgjykimet liruese të anëtarëve të LDK-së

17.3.1. Lirimet e formës së prerë

11 zyrtarë të LDK-së me vendim të formës së prerë tashmë janë liruar nga akuzat e ngritura ndaj tyre.

Ish-ministri i MKRS-së **Valton Beqiri**, edhe pse për akuza për korrupsion ishte dënuar nga shkalla e parë me një (1) vit burgim me kusht, Gjykata e Apelit atë e kishte shpallur të pafajshëm. Përpos tij, aktgjykime liruese për korrupsion janë shqiptuar në **dy (2) aktakuza** edhe ndaj ish-kryetarit të Kamenicës, **Shaip Surdulli**,

dhe ndaj ish-kryetarit të Obiliqit, **Mehmet Krasniqi**.

Nga **tri (3) aktakuza** për korrupsion është liruar edhe ish-drejtori i Urbanizmit në Komunën e Gjilanit, **Valon Shefkriu**, ndërsa nga akuza për korrupsion janë liruar edhe drejtori aktual i Shërbimeve Publike, në komunën e Gjilanit, **Naser Korça**, dhe ish-drejtori i arsimit në Suharekë **Sherif Berisha**.

Për veprën penale të “dhënies apo marrjes së ryshfetit gjatë votimeve” është liruar edhe këshilltari aktual i Komunës së Ferizajt, **Balton Dërguti**.

Ish-drejtori komunal në Lipjan, **Rasim Hasani**, i akuzuar për veprën penale

“cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë” po ashtu është liruar nga akuza.

17.3.2 Lirimet e shkallës së parë

Aktgjykim lirues në gjykatën e shkallës së parë është shqiptuar ndaj ish-kryetarit të Komunës së Suharekës, **Sali Asllanaj**, ish-drejtori i kësaj komune, **Sherif Berisha**, të cilët akuzohen për keqpërdorim të pozitës zyrtare si dhe ish-drejtori i Komunës së Mitrovicës, **Pajazit Hajzeri**, i cili akuzohet për falsifikim të dokumentit zyrtar.

17.4 Aktgjykimet refuzuese të anëtarëve të LDK-së

Ish-ministri tjetër i MKRS-së **Astrit Haraqija**, me vendim të Gjykatës së Apelit, për shkak të parashkrimit të ndjekës penale, i është refuzuar aktakuza, që atë e ngarkonte me “keqpërdorim të pozitës zyrtare”.

Për shkak të parashkrimit të veprave penale, nga ndjekja penale për akuza për korrupsion prokuroria kishte hequr dorë nga akuza ndaj ish-kryetarit të Kamenicës **Shaip Surdulli** dhe ish-drejtorit komunal të Prizrenit, **Fatmir Memaj**, i akuzuar për kanosje.

Prokuroria ka hequr dorë nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare edhe ndaj ish-këshilltarit të Komunës së Klinës **Fadil Gashi**, ndërsa aktgjykime refuzuese për këtë vepër është marrë edhe ndaj ish-kryesuesit të Kuvendit dhe ish-drejtorit të arsimit, të Komunës së Prishtinës **Halim Halimi**. Aktgjykime refuzuese për mos raportim të pasurisë, janë marrë edhe ndaj ish-këshilltares komunale të Komunës së Fushë Kosovës **Merita Sllamniku** dhe ndaj

ish-këshilltarit të Komunës së Mitrovicës, **Rexhë Feka**.

17.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të LDK-së

Gjykatat kanë hudhur katër (4) aktakuza të zyrtarëve të LDK-së, tri (3) nga të cilat tashmë kanë marrë formën e prerë.

Kryetari aktual i Komunës së Gjilanit **Lutfi Haziri**, ishte akuzuar për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, por kjo aktakuzë ishte hudhur poshtë nga gjykata pa filluar me shqyrtimin gjyqësor. E fatin e njëjtë me aktakuzën e Hazirit e kishte edhe padia private ndaj ish-kryetarit të Mitrovicës **Sadri Feratit**, që akuzohej për korrupsion dhe ajo ndaj ish-drejtorit të arsimit të Komunës së Lipjanit, **Rasim Hasani**.

Aktakuza që e ngarkon kryetarin aktual të Komunës së Pejës, **Gazmend Muhaxheri** me veprën penale të “mosekzekutimit të vendimeve gjyqësore”, është hudhur poshtë nga gjykata e shkallës së parë, por e njëjta akoma nuk e ka fituar formën e prerë.

17.6. Rastet në proces të anëtarëve të LDK-së

Ish-deputeti **Naser Osmani** është duke u përballur me akuzat për keqpërdorime me “Fondin e 3%”, ndërsa për keqpërdorim të pozitës zyrtare në rastin e njohur si “FAN”, është në proces të rigjyimit. Në procedurë gjyqësore për “krim të organizuar” e “kontrabandim me migrantë” janë edhe ish-deputeti **Ukë Rugova** dhe ish-ministri i MKRS-së, **Astrit Haraqija**.

Përpos tyre, në procedurë gjyqësore për “konflikt të interesit” është duke u akuzuar kryetari aktual i Komunës së Istogut, **Haki Rugova**.

Për akuzë të korrupsionit po vazhdojnë të akuzohen ish-drejtori i urbanizmit në komunën e Ferizajt, **Faik Grainca**, ish-drejtori i Inspeksionit në Komunën e Pejës, **Demë Gashi**, ish-drejtoresha e Komunës së Mitrovicës, **Ajmane Berani**, drejtori komunal në Fushë-Kosovë, **Jakup Tërnavë** si dhe drejtori komunal në Prizren, **Fejzë Kabashi**. Përpos tyre, për veprën penale “mashtrimi”, janë duke u zhvilluar gjykimet ndaj ish-shefit të kabinetit të kryetarit të Pejës, **Durim Sheremeti**. Lidhur me akuzën për “vrasja e kryer në gjendje të tronditjes së fortë mendore”, në një proces të rigjyimit është duke u gjykuar ish-deputeti **Gani Geci**.

Ish-drejtori i Komunës së Podujevës, **Avni Maloku**, është duke u akuzuar për veprën penale “cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë”.²⁸

²⁸ *Shënim:* Për këtë rast është shpallur aktgjykim refuzues më 6 korrik 2020 nga Gjykata Themelore e Prishtinës, Dega në Podujevë, 6 korrik 2020, Betimi për Drejtësi (Shih linkun:


<https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-drejtorit-te-arsimit-ne-podujeve-ge-akuzohet-per-cenim-te-drejtave-te-punesimit/>)

18. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LVV-së

Lëvizja Vetëvendosje është njëra nga partitë të cilës i ka ndryshuar shumë numri i politikanëve që kanë aktakuza, për shkak se disa anëtarë të kësaj partie kanë shkuar në parti të tjera, mirëpo ka pasur edhe raste kur personat me aktakuza nga një parti tjetër, kanë shkuar në Lëvizjen Vetëvendosje.

18.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e LVV-së

Janë **19 anëtarë** të LVV-së që kanë prodhuar **26 aktakuza**, në të cilat janë të përfshira **33 vepra penale**. Për dallim nga dy partitë paraprake, PDK dhe LDK, LVV-ja numrin më të madh të veprave penale i ka ato që kanë të bëjnë me gjuajtjen e gazit lotsjellës, apo **12 aktakuza** që kanë të bëjnë me veprat penale të pengimit të personit zyrtar, dëmtimit të pasurisë e pjesëmarrjes në turmë, **pesë (5)** aktakuza përmbajnë vepra penale korruptive, **një (1)** për vepra terroriste dhe **15** për vepra të tjera penale.




Grafiku 34: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e LVV-së.

Nga 19 anëtarët e LVV-së, me 26 aktakuza, shumë raste kanë mbetur akoma pa u trajtuar, pasi **11** aktakuza ndaj tyre janë akoma në trajtim në gjykatat themelore.

Përpos rasteve në proces, gjykatat ndaj zyrtarëve të LVV-së kanë shqiptuar **katër**

(4) aktgjykime dënuese, të cilat e kanë fituar formën e prerë. Të formës së prerë janë edhe **një (1)** aktgjykim lirues si dhe **gjashtë (6)** aktgjykime refuzuese e **tri (3)** hudhje të aktakuzës. Ndërsa një (1) aktgjykim dënues është shpallur nga gjykata e shkallës së parë.



Grafiku 35: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të LVV-së.

18.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të LVV-së


18.2.1. Dënimet e formës së prerë

Kryetari aktual i LVV-së dhe ish-kryeministri, **Albin Kurti**, është njëri nga katër anëtarët e kësaj partie që kanë aktgjykime dënuese të formës së prerë. Ai për veprimet e tij brenda Kuvendit të Kosovës, duke kundërshtuar votimin e marrëveshjeve të Demarkacionit të kufirit me Malin e Zi dhe Asociacionit të komunave serbe në Kosovë, është akuzuar për veprat penale “përdorim i armës” dhe “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së

detyrës zyrtare”, për të cilat vepra është dënuar me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me kusht.

Bashkë me Kurtin, në procesin e njëjtë gjyqësor, me një (1) vit e katër (4) muaj për veprat e njëjta penale është dënuar ish-deputetja e LVV-së, **Albulena Haxhiu**.

Këshilltari i Komunës së Klinës, **Xhevxhet Berisha**, për mos raportim të pasurisë është dënuar me tre (3) muaj burgim me kusht, ndërsa për veprën e njëjtë penale, me 400 euro gjobë dhe gjashtë (6) muaj burgim me kusht është dënuar ish-këshilltari i komunës së Malishevës, **Valon Hoti**.



Grafiku 36: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e LVV-së.

18.2.2. Dënimet e shkallës së parë

Ish-këshilltari komunal në Prishtinë, **Sadri Ramabaja**, në rastin “Syri i Popullit”, i akuzuar për terrorizëm, është dënuar me pesë (5) vite burgim.²⁹

18.3. Aktgjykimet liruese për anëtarët e LVV-së

Ish-deputeti **Rexhep Selimi**, me vendim të formës së prerë është liruar nga akuza për “lëndim të lehtë trupor”, lidhur me përleshjen në oborrin e Kuvendit të Kosovës me ish-deputetin e PDK-së, Bekim Haxhiu.

18.4. Aktgjykimet refuzuese për anëtarët e LVV-së

Ish-nënkryetari i Vitisë **Xhavit Bislimi**, ishte akuzuar për “keqpërdorim të pozitës zyrtare” në kohën sa ishte në atë pozitë, si anëtar i PDK-së. Por pasi prokurori kishte hequr dorë nga aktakuza ndaj tij, gjykata e

kishte refuzuar atë aktakuzë. Për shkak të heqjes dorë nga aktakuza nga ana e prokurorit, aktgjykim refuzues është marrë edhe ndaj këshilltarit të komunës së Prizrenit, **Adem Shabanaj**, i cili është akuzuar për veprën penale “ngacmimi”.

Ndërsa prokuroria ishte tërhequr nga aktakuza për veprën penale të “përdorimit të armës” edhe nga ish-deputeti **Ismajl Kurteshi** lidhur me hedhjen e gazit lotsjellës.

Për pjesëmarrje në turmë janë marrë aktgjykime refuzuese ndaj ish-ministrit të Punëve të Jashtme, **Glauk Konjufca**, ish-zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, **Xhelal Sveqlla**, si dhe ndaj deputetit **Salih Zyba**.

18.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të LVV-së

Kryetari i Mitrovicës **Agim Bahtiri**, ishte akuzuar për “keqpërdorim të pozitës

²⁹ Shënim: Rasti ndaj Ramabajës është kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit dhe tashmë është

duke u proceduar nga Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë.

zyrtare”, në kohën kur ai ishte pjesë e AKR-së. Gjykata aktakuzën ndaj tij, në mungesë të provave e kishte hudhur poshtë, i cili vendim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme.

Për shkak të heqjes së flamurit shtetëror nga “Rrethi i Spitalit”, që ishte akuzuar për “*asgjësim apo dëmtim të pasurisë*”, është hedhur aktakuza ndaj deputetit **Salih Zyba**, ndërsa për pengim të personit zyrtar është hedhur poshtë aktakuza edhe ndaj deputetit **Liburn Aliu**.

18.6. Rastet në proces të anëtarëve të LVV-së

Përpos rasteve që kanë marrë vendime gjyqësore, janë edhe 11 raste të cilat janë ende duke u gjykuar. Deputetet **Salih Zyba**, **Fitore Pacolli**, **Arbërie Nagavci**, **Valon Ramadani**, dhe ish-deputetet **Glauk Konjufca**, **Albulena Haxhiu**, **Ismajl Kurteshi**, **Drita Millaku**, **Xhelal Svegla**, janë në procedurë lidhur me akuzat me hedhjen e gazit lotsjellës,

Ndërsa për “*pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare*”, është duke u akuzuar këshilltari komunal i Malishevës, **Valon Hoti**.


Për keqpërdorim të pozitës zyrtare po akuzohet drejtori komunal në Prizren, **Levënt Kasemi**.

19. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AAK-së

22 anëtarë të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës janë të përfshirë në **32 aktakuza**, **15** nga të cilat tashmë kanë një vendim të formës së prerë, ku në këtë grup të vendimeve janë shqiptuar **katër (4)** aktgjykime dënuese, **katër (4)** aktgjykime liruese, janë refuzuar **dy (2)** aktakuza dhe po ashtu janë hudhur edhe **pesë (5)** të tjera.

19.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e AAK-së


Nga **32 aktakuzat e 22 anëtareve të AAK-së**, janë të përfshira **35 vepra penale**. Numri më i madh i tyre, përkatësisht **18** vepra penale, kanë të bëjnë me vepra penale të korrupsionit, **tetë (8)** vepra të tjera penale ndërlidhen me hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend, ndërsa janë edhe **nëntë (9)** vepra penale të natyrave të tjera.



Grafiku 37: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e AAK-së.

Në gjykatën e shkallës së parë janë vetëm **tri (3)** raste të cilat kanë përfunduar, dy nga të cilat me aktgjykime dënuese dhe një

tjetër liruese, ndërsa janë edhe 14 aktakuza të cilat janë në procedim para instancave të para gjyqësore.



Grafiku 38: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AAK-së.

19.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të AAK-së

19.2.1. Dënimet e formës së prerë

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-zëvendësministri i Zhvillimit Rajonal, **Musa Cena**, është dënuar me 5,000 euro gjobë ndërsa ish-drejtori i Komunës së Prizrenit, **Ilir Baldedaj**, është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht.


Ish-deputetja **Donika Kadaj-Bujupi**, lidhur me veprimet e saj brenda Kuvendit të Kosovës, për të parandaluar votimin e marrëveshjeve të “Demarkacionit” me Malin e Zi dhe “Asociacionit të komunave serbe në Kosovë”, është akuzuar për veprat

penale “përdorim i armës” dhe “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, për të cilat vepra është dënuar me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me kusht.

Ndërsa për mos raportim të pasurisë me gjashtë (6) muaj dënim burgim me kusht dhe 200 euro gjobë është dënuar këshilltari i komunës së Kamenicës **Isah Hoda**.

19.2.2. Dënimet e shkallës së parë

Ish-këshilltarja e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, aktualisht ministre e Punëve të Jashtme, Meliza Haradinaj-Stublla, është dënuar me 1,000 euro gjobë dhe tetë (8) muaj burgim me kusht.



Grafiku 39: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e AAK-së.

19.3. Aktgjykimet liruese për anëtarët e AAK-së

Ish-drejtori i arsimit në komunën e Deçanit, **Qazim Maloku**, në një rast të cilat ai akuzohet, me vendim të formës së prerë është liruar nga akuza që atë e ngarkonte me veprën penale “*keqpërdorim i pozitës zyrtare*”.

Ndërkaq, aktgjykime liruese të formës së prerë, lidhur me akuzat për korrupsion janë shqiptuar në dy rastet në të cilat akuzohej ish-shefi i personelit të drejtorisë së arsimit në komunën e Pejës, **Leonard Shabanaj**, si dhe ish-drejtoresha e Teatrit Kombëtar, **Elmaze Nura**.

19.3.1 Aktgjykimet liruese të shkallës së parë

Ish-deputeti **Fatmir Shurdhaj** është liruar nga shkalla e parë për veprën penale “*shkelja e statusit të barabartë të shtetasve apo banorëve të Republikës së Kosovës*” në rastin “PRONTO”.

Nga shkalla e parë është liruar edhe ish-drejtori komunal në Ferizaj, **Muhamet Halili**, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe për veprën penale “*cenimi i të drejtave të punësisë dhe papunësisë*”.

19.4. Aktgjykimet refuzuese për anëtarët e AAK-së

Dy (2) aktgjykime refuzuese janë shpallur ndaj zyrtarëve të AAK-së. Rasti i parë i kësaj natyre është rasti ndaj kryetarit aktual i komunës së Suharekës **Bali Muharremaj**, i cili akuzohej “*përdorim të armës*”, apo gazit lotsjellës sa ishte deputet i Kuvendit të Kosovës. Ky aktgjykim erdhi pasi prokurorja kishte hequr dorë nga ndjekja penale ndaj tij.

Ndërsa për arsye të parashkrimit të veprës penale të “*falsifikimit të dokumentit zyrtar*”, aktgjykim refuzues ishte marrë edhe ndaj ish-drejtorit të arsimit në komunë e Deçanit, **Qazim Maloku**, në një rast tjetër ndaj tij.

19.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të AAK-së

Gjykatat kanë hudhur katër (4) aktakuza ndaj katër zyrtarëve të lartë të AAK-së. Lidhur me akuzat për korrupsion, janë hudhur aktakuzat e ish-ministrit të Infrastrukturës dhe ish-kryetarit të Gjakovës **Pal Lekaj**, ndaj ish-kryetari të Vushtrisë **Muharrem Shabani**, dhe po ashtu ndaj ish-drejtorit komunal në Prizren, **Ilir Baldedaj**.

Ndërsa për “mosekzekutim të vendimeve gjyqësore”, është hudhur aktakuza ndaj kryetarit aktual të komunës së Obiliqit **Xhafer Gashi**, e për “shmangie nga tatimi”, padia private ndaj kryetarit aktual të komunës së Klinës, **Zenun Elezaj**.

19.6. Rastet në proces të anëtarëve të AAK-së

Përpos rasteve që kanë marrë vendime gjyqësore janë edhe 14 raste të cilat janë në procedurë gjyqësore. Lidhur me akuzat për korrupsion në rastin e njohur si “Veteranët”, është duke u akuzuar ish-ministri i FSK-së **Rrustem Berisha** dhe ish-deputeti **Shkumbin Demalijaj** në dy raste, për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe për kanosje.

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare po akuzohet edhe ish-zëvendësministri i Administratës Publike, **Bujar Nerjovaj** si dhe kryetari i Komunës së Klinës, **Zenun Elezaj**.

Për akuzën për korrupsion sa ishte kryetar i komunës së Gjakovës është duke u akuzuar në një rast edhe ish-ministri i

Infrastrukturës **Pal Lekaj**. Lekaj është në proces edhe për akuzat në **dy (2) raste** për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës.

Për hedhjen dhe mbajtjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës janë duke u akuzuar edhe ish-deputetet **Teuta Haxhiu dhe Time Kadriu**, si dhe në dy raste **Donika Kadaj-Bujupi**.³⁰

Ndërkaq për veprën penale të “kanosjes” ndaj ish-deputetit Arben Gashi, është duke u akuzuar ish-deputeti **Gani Dreshaj**, kurse për veprën penale të “lëndimit të lehtë trupor” është në proces edhe këshilltari i Komunës së Drenasit, **Naim Bazaj**.

³⁰ *Shënim:* Për njërin rast, më 4 qershor 2020, pas pranimit të fajësisë nga Kadaj-Bujupi, gjykata ka shpallur aktgjykim dënues ndaj saj, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 200 euro. “Donika Kadaj-Bujupi dhe Aida Dërguti dënohen me nga 200 euro gjobë për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend”. Betimi për Drejtësi 4 qershor 2020. (Shih linkun;


[https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IeAR0h82oEJNJETo_x4SoqVyiEqr_dOXiBfkrEhB-uO2GqëëK-cfAs4yI9ugB9s.\)](https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IeAR0h82oEJNJETo_x4SoqVyiEqr_dOXiBfkrEhB-uO2GqëëK-cfAs4yI9ugB9s.)) (Qasur për here të fundit më 8 dhjetor 2020).

20. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të Nismës Socialdemokrate

Nisma Socialdemokrate si një parti e themeluar në vitin 2014 nga ish-zyrtari i lartë i PDK-së Fatmir Limaj ka përfshirë në këtë subjekt **19 persona** ndaj të cilëve janë ngritur **26 aktakuza** për vepra penale të kryera para dhe gjatë ushtrimit të funksioneve publike.

20.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e Nismës Socialdemokrate

Në **26** aktakuzat e ngritura ndaj 19 zyrtarëve të Nismës Socialdemokrate janë të përfshira **36** vepra të ndryshme penale, shumica prej të cilave vepra penale që ndërliken me korrupsion. Përkatësisht, **21** vepra penale janë të natyrës korruptive, **tri (3)** të tjera për vepra që ndërliken me armët, **dy (2)** raste janë vepra të natyrës së krimit të organizuar, **dy (2)** për krimet e luftës, si dhe **tetë (8)** të natyrave të tjera.




Grafiku 40: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e Nismës Socialdemokrate.

Ndaj anëtarëve të akuzuar nga radhët e Nismës Socialdemokrate janë shqiptuar **19** vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë, **një (1)** rast është gjykuar në shkallë të parë dhe **gjashtë (6)** raste të tjera janë akoma të hapura për trajtim në gjykatat themelore.

Ndaj zyrtarëve të Nisma-s, gjykatat kanë shqiptuar **10** aktgjykime dënuese, prej të

cilave **nëntë (9)** vendime gjyqësore e kanë fituar formën e prerë. Të formës së prerë janë edhe **tetë (8)** aktgjykime liruese dhe **një (1)** vendim për hedhje të aktakuzës. Ndërsa, në shkallë të parë është nxjerrë edhe nga **një (1)** aktgjykim dënues dhe një (1) tjetër lirues, ndërsa janë dhe gjashtë (6) raste që po trajtohen nga gjykata e shkallës së parë.



Grafiku 41: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të Nismës Socialdemokrate.

20.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të Nismës Socialdemokrate

10 anëtarë të Nisma-s janë dënuar nga gjykatat pas pretendimeve të prokurorisë se ata kanë kryer vepra penale të ndryshme

20.2.1. Dënimet e formës së prerë

Ish-zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Diasporës dhe Investimeve Strategjike, **Dardan Gashi**, për veprën penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” është dënuar me 1,700 euro gjobë, dhe për të njëjtën vepër penale, ish-ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, tani deputeti **Endrit Shala**, është dënuar me 2,400 euro gjobë.


Ish-deputeti **Zafir Berisha** për veprën penale “heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave” është dënuar me gjobë në lartësi prej 140 euro, ndërsa me tetë (8) muaj burgim efektiv dhe 5,000 gjobë është dënuar ish-drejtori komunal në Prizren,

Nysret Durmishi për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar.

Ish-zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Besnik Berisha** është dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht për zbulim të fshehtësisë zyrtare.

Për mos raportim të pasurisë janë dënuar këshilltarët komunal të Malishevës, **Filloreta Bytyqi** me gjashtë (6) muaj burgim me kusht, **Aziz Thaqi** me 600 euro gjobë dhe gjashtë (6) muaj burgim me kusht si dhe **Gazmend Krasniqi** me 300 euro dhe katër (4) muaj burgim me kusht.

Drejtori i Komunës së Malishevës, **Murat Hoxha** është dënuar me 600 euro dhe gjashtë (6) muaj burgim me kusht për mos raportim të pasurisë kurse për veprën penale “legalizim i përmbajtjes së pavërtetë” dhe “falsifikim i dokumentit” drejtori i Komunës së Prizrenit, **Ehat Oreshka**, është dënuar me një (1) vit e gjashtë (6) muaj burgim me kusht.



Grafiku 42: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e Nismës Socialdemokrate.

20.3. Aktgjykimet liruese të anëtarëve të Nismës Socialdemokrate

Bazuar në vendimet gjyqësore të nxjerra nga gjykatat, janë **tetë (8)** raste gjyqësore kur gjykatat kanë shpallur të pafajshëm zyrtarë të Nisma-s, vendime këto të cilat janë vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

20.3.1. Lirimet e formës së prerë

Ish-zëvendëskryeministri i Republikës së Kosovës, ish-Ministri i Transportit, dhe kryetari aktual i Nisma-s **Fatmir Limaj**, është liruar në formë të prerë për “*krime lufte*” në **dy (2) procese** gjyqësore të ndara, e po ashtu edhe për “*krim të organizuar*” e korrupsion gjatë kohës sa ushtronte detyrën e Ministrit të Transporteve.

Aktgjykim lirues në rastin e MTPT-së, ishte nxjerrë edhe ndaj ish-Ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, **Endrit Shala**, i cili ishte akuzuar për “*keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar*”, gjatë kohës sa ishte ish-këshilltar i ministrit të MTPT-së, Fatmir Limaj.

Ndërsa, kryetari aktual i Komunës së Malishevës, **Ragip Begaj**, ishte shpallur i pafajshëm për “*keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar*”, vendim ky i cili ishte vërtetuar edhe nga shkalla e dytë.

Për **dy (2) aktakuza** të ngritura ndaj tij për “*keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar*”, ishin nxjerrë aktgjykime liruese edhe ndaj drejtorit të Drejtorisë për Arsimit dhe Edukim në Komunën e Malishevës, **Blerim Thaçi**.

Ish-zyrtari i Komunës së Vitisë, **Daut Xhemajli**, po ashtu është liruar nga akuza për korrupsion.

20.3.2. Lirimet në shkallë të parë

Ish-zëvendësministri i Bujqësisë, aktualisht ministri i Tregtisë dhe Industrisë, **Vesël Krasniqi**, është liruar nga akuza për vetëgjyqësi.

20.3.3. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të Nismës Socialdemokrate

Aktakuza tjetër e ngritur ndaj kryetarit të Komunës së Malishevës, **Ragip Begaj**, për “*keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar*”, ishte hedhur poshtë nga Gjykata Themelore në Gjakovë dhe i njëjti vendim për hedhje të kësaj aktakuze ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

20.3.4 Rastet në proces të anëtarëve të Nismës Socialdemokrate

Përpos rasteve të lartë përmendura të cilat kanë arritur të kenë një epilog, qoftë në shkallë të parë, qoftë edhe të marrin formën e prerë, janë edhe **gjashtë (6)** procese të tjera gjyqësore të cilat janë duke u gjykuar nga gjykatat themelore.

Ish-deputeti **Haxhi Shala** është duke u gjykuar për veprën penale “*përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm*”.³¹

Ndërsa anëtari më i ri i kësaj partie, mjeku **Agim Krasniqi** është duke u përballur me akuzat për “*keqpërdorim të pozitës zyrtare*” dhe “*marrje ryshfeti*”, në rastin e njohur si “Stenta”.

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare po akuzohet ish-zëvendëskryeministri **Dardan Gashi**, këshilltarja komunale e Prizrenit, **Ganimete Babunja**, drejtori në Komunën e Malishevës, **Islam Vrenezi**, ndërsa për veprën penale “*sulmi*” po akuzohet deputeti **Endrit Shala**.

³¹ *Shënim:* Më 6 korrik 2020, deputeti Haxhi Shala, ka aderuar në AAK, mirëpo për shkak se raporti

përfshinë të dhënat deri më 31.05.2020, ai është përfshirë te aktakuzat e Nismës.


21. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PSD-së

Edhe pse Partia Socialdemokrate ishte themeluar para shumë vitesh, anëtarësimi i ish-anëtareve të LVV-së ka ndikuar që në këtë parti të ketë **10 zyrtarë me 17 aktakuza**. Në këto aktakuza, janë të përfshira gjithsej 21 vepra penale për të cilat akuzohen zyrtarët e PSD-së.

Numri më i madh i këtyre aktakuzave lidhen me veprimet që ata kanë bërë në Kuvendin e Kosovës qoftë me hedhjen e gazit lotsjellës si dhe me përleshjet fizike në atë vend, e po ashtu edhe nga veprimet në protestat e organizuara nga LVV-ja.

21.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e PSD-së

Nga **10** zyrtarët e PSD-së **me 17 aktakuza**, përveç **dy (2)** rasteve për “*mos raportim të pasurisë*”, nuk janë përfshirë në asnjë aktakuzë tjetër për vepra penale korruptive, ndërsa përfshihet **një (1)** vepër penale që ndërlidhet me terrorizëm. Te anëtarët e këtij subjekti politik, numri më i madh i këtyre aktakuzave lidhen me veprimet që ata kanë bërë në Kuvendin e Kosovës qoftë me hedhjen e gazit lotsjellës (6) si dhe me përleshjet fizike në atë vend, e po ashtu edhe nga veprimet në protestat e organizuara nga LVV.




Grafiku 43: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e PSD-së.

Ndaj zyrtarëve të PSD-së, tashmë në nëntë (9) raste kanë përfunduar gjykimet ndaj tyre, tetë (8) nga të cilat kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, nga të cilat bëjnë pjesë **tri (3)** aktgjykime dënuese, **tri (3)** refuzime të aktakuzave, **një (1)** aktgjykim lirues dhe **një (1)** hudhje të

aktakuzave, derisa **një (1)** rast ka përfunduar në procedurë të ndërmjetësimit.

Përpos këtyre rasteve, ndaj zyrtarëve të kësaj partie, janë edhe tetë (8) raste në proces, që pritet të gjykohen nga gjykata e shkallës së parë.



Grafiku 44: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të PSD-së.


21.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të PSD-së

21.2.1. Dënimet e formës së prerë

Ish-deputeti **Faton Topalli** është akuzuar për veprat penale “përdorim i armës” dhe “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së

detyrës zyrtare”, për të cilat vepra është dënuar me një (1) vit e dy (2) muaj burgim me kusht.

Për mos raportim të pasurisë, asamblisti **Ardian Berisha** është dënuar me 600 euro gjobë kurse **Arta Gashi**, drejtoreshë në Komunën e Kamenicës, me 300 euro gjobë.



Grafiku 45: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e PSD-së.

21.3. Aktgjykimet liruese për anëtarët e PSD-së

Ish-kryetari i LVV-së, aktualisht nënkryetar i PSD-së **Visar Imeri**, është liruar me vendim të formës së prerë për “*lëndim të lehtë trupor*” lidhur me përleshjen në oborrin e Kuvendit të Kosovës që kishte ndodhur më 28 qershor të vitit 2012, në mes deputetëve të LVV-së dhe atij të PDK-së, Bekim Haxhiu.

21.4. Aktgjykimet refuzuese për anëtarët e PSD-së

Së bashku me Ymerin, pjesë e rastit për “*lëndim të lehtë trupor*”, ishte edhe ish-deputeti **Florin Krasniqi**, lënda ndaj të cilit ishte parashkuar. “*Për pjesëmarrje në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi*” dhe “*asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë*” është shpallur aktgjykim refuzues edhe ndaj ish-deputetëve **Frashër Krasniqi** dhe **Dardan Molliqaj**.

21.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të PSD-së

Në njërin nga pesë (5) aktakuzat me të cilat ish-deputeti **Frashër Krasniqi** ngarkohet, prokuroria kishte hequr dorë lidhur me akuzën për pjesëmarrje në turmë dhe në këtë mënyrë gjykata kishte hedhur aktakuzën akoma pa filluar me shqyrtimin gjyqësor.

Për rastin tjetër, në të cilën Krasniqi akuzohet për veprën penale “*lëndim i lehtë trupor*”, rasti ndaj tij është zhvilluar në procedurë të ndërmjetësimit.

21.6. Rastet në proces të anëtarëve të PSD-së

Ish-deputeti **Frashër Krasniqi** është në proces edhe për **dy (2)** aktakuza të tjera të ngritura ndaj tij. Ai është në një proces të rigjyimit në rastin në të cilin ai së bashku edhe me tre (3) aktivistë të LVV-së ishin akuzuar për terrorizëm lidhur me gjuajtjen me zollë në Kuvendin e Kosovës në gushtin e vitit 2015, ndërsa ai është në procedurë gjyqësore edhe për sulm ndaj personit zyrtar.

Ndërkaq, me nga dy raste ish-deputetja **Aida Dërguti**³², dhe ish-deputetja **Besa Baftiu**, janë duke u akuzuar për veprimet e tyre në Kuvendin e Kosovës lidhur me gjuajtjen e gazit lotsjellës.

Për akuzat lidhur me mbajtjen e gazit lotsjellës në Kuvendin e Kosovës është duke u rigjykuar ish-deputeti **Fisnik Ismajli**.³³

Ndërsa, ish-deputeti **Dardan Molliqaj** është duke u akuzuar për veprën penale “sulmi”.

³² Shënim: Për njërin rast, më 4 qershor 2020, pas pranimit të fajësisë nga Dërguti, gjykata ka shpallur aktgjykim dënues ndaj saj, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 200 euro. “*Donika Kadaj-Bujupi dhe Aida Dërguti dënohen me nga 200 euro gjobë për hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend*”. Betimi për Drejtësi 4 qershor 2020. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IëAR0h82oëNJËT0_x4SoqVyiëëqr

[dOXiBfkrEhB-uO2GqëëK-cfAs4yI9ugB9s\).](https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IëAR0h82oëNJËT0_x4SoqVyiëëqr) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).


³³ Shënim: Më 11 qershor 2020, gjykata pas rigjyimit e ka liruar nga akuza Fisnik Ismailin. “*Ish-deputeti Fisnik Ismaili lirohet nga akuza për posedim të gazit lotsjellës*”. Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-deputeti-fisnik-ismaili-lirohet-nga-akuza-per-posedim-te-gazit-lotsjelles/>) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

22. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AKR-së

Aleanca Kosova e Re, si një parti e cila ka bashkë qeverisur në tri (3) qeverisjet e kaluara, ka tre (3) persona me aktakuza, derisa në Qeverinë “Haradinaj 2”, nga **tre** (3) ministra sa kishte në qeveri, **dy** (2) nga ta kishin aktakuza.

22.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e AKR-së


Nga tre (3) politikanët e AKR-së, që kanë prodhuar **tri** (3) aktakuza, janë të përfshira po ashtu **tri** (3) vepra penale, **dy** (2) nga të cilat janë vepra penale që ndërlidhen me korrupsion, ndërsa **një** (1) tjetër është e rrezikimit të trafikut publik.



Grafiku 46: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e AKR-së.

Nga **tre** (3) anëtarë të AKR-së ndaj të cilëve janë ngritur tri aktakuza, gjykatat kanë nxjerrë **dy** (2) vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe **një** (1) rast është duke u proceduar në gjykatë.

Në dy (2) vendimet gjyqësore të nxjerra në këto raste, gjykatat ndaj zyrtarëve të AKR-së kanë shqiptuar **një** (1) aktgjykim dënues dhe një (1) aktgjykim lirues, të dyja këto të formës së prerë.



Grafiku 47: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të AKR-së.

22.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të AKR-së

22.2.1. Dënimet e formës së prerë

Ish-drejtori i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Lipjanit dhe aktualisht nënkryetari i Komunës së Lipjanit, **Fauz Xhemajli** është dënuar me tre (3) muaj burgim me kusht për “keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar”.

22.3 Aktgjykimet liruese të anëtarëve të AKR-së

Ish-Ministri i Zhvillimit Ekonomik dhe ish-kryeshefi i Agjencisë për promovimin e investimeve në kuadër të MTI-së, **Valdrin Lluka**, është liruar nga akuzat që e ngarkonin atë për veprën penale “konflikti i interesit”.

22.4. Rastet në proces të anëtarëve të AKR-së

Për dallim nga dy rastet e sipër theksuara të cilët kishin arritur të kenë një epilog përfundimtar, rezulton vetëm një rast i cili është duke u trajtuar nga gjykatat.

Ish-ministri i Ministrisë së Brendshme, **Ekrem Mustafa**, aktualisht është duke u gjykuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, për veprën penale “rrezikimi i trafikut publik”.


23. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të tjera

Përpos partive kryesore në vend, IKD ka analizuar edhe politikanët e subjekteve të tjera politike si shqiptarë, ashtu edhe ato të minoriteteve, në të cilin grup hynë Lista Rugova, Alternativa, Partia e Drejtësisë, Partia Euroatlantike, Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD) Sloboda, Lista Serbe (LS), Kualicioni Vakrat, Partia e Ashkalinjëve për Integritim (PAI), Partia e Bashkuar Gorane, Iniciativa qytetare Klokot-Verbovac, Samostalna Liberalna Stranka (SLS), Iniciativa për Partesh, Kosova Demokratik Turk Partisi, Iniciativa Qytetare e Komunës së Ranillugut, Iniciativa për Progres, Partia Shqiptare-Demokristiane e Kosovës (PSHDK) dhe Nova Demokratska Stranka (NDS).

Në këtë grup bëjnë pjesë **32 politikanë** me **47 aktakuza**, ku nga numri i përgjithshëm, janë **shtatë (7)** politikanë shqiptarë me **10** aktakuza, ndërsa janë edhe **25** politikanë që vijnë nga subjektet e minoriteteve jo-shumicë, të cilët kanë krijuar **37 aktakuza**.

23.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e partive të tjera

Në grupin e veprave penale të pretenduara për anëtarët e partive të tjera, në **47** aktakuzat e ngritura janë të përfshira **54** vepra penale. Nga këto vepra penale, shumicën absolute e përbëjnë veprat penale që ndërlidhen me korrupsion (38 vepra penale). Në **një (1)** rast është e përfshirë vepra e terrorizmit, **një (1)** tjetër lidhur me armët, ndërsa në **14** raste janë të përfshira vepra tjera penale, në të cilat hynë mashtrimi, shmangia nga tatimi, sulmi, kanosja dhe vepra të tjera penale.




Grafiku 48: Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e partive të tjera.

Në këtë grup, në pjesën më të madhe të procedurave penale apo në **25** raste është marrë vendim i formës së prerë. Në këtë grup të vendimeve bëjnë pjesë **11** aktgjykime liruese, **shtatë (7)** aktgjykime dënuese, **katër (4)** aktgjykime refuzuese

dhe **tri (3)** hushje të aktakuzave. Në gjykatën e shkallës së parë deri më tash janë shpallur edhe **tri (3)** aktgjykime, **dy (2)** nga të cilat janë dënuese, **një (1)** lirues, ndërsa një rast tjetër ka përfunduar me procedurë alternative-ndërmjetësim. E para gjykatës

së shkallës së parë janë duke u trajtuar edhe 18 raste të tjera.



Grafiku 49: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të tjera³⁴.

23.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të partive të tjera

23.2.1. Dënimet e formës së prerë

Lidhur me tri aktakuzat të cilat është akuzuar ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, **Sreqko Spasiq**, në njërin nga to, ai është gjetur fajtor dhe është dënuar me 10 muaj burgim me kusht.

Ndërkaq, i akuzuar për “*keqpërdorim të pozitës zyrtare*”, Kryetari i Komunës së Novobërdës, **Svetivall Ivanoviq**, pasi kishte bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë, ishte dënuar me 4,500 euro gjobë. Ish-zëvendësministri i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, **Qazim Rrahmani**, është dënuar me gjashtë (6) muaj burg me kusht dhe 3,000 euro dënim me gjobë, për “*keqpërdorim të pozitës zyrtare*”, për kohën kur ishte zëvendësministër i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete (MKK). **Milan Artonovic**, këshilltar në Kuvendin

Komunal të Ranillugës, për veprën penale të mos raportimit të pasurisë ishte dënuar me 500 euro gjobë, ndërsa këshilltari i Komunës së Klinës, nga radhët e PSHDK-së, **Tush Deda**, për “*mos raportim të pasurisë*” ishte dënuar me 200 euro gjobë dhe dy (2) muaj burgim me kusht.

Mrika Marku-Gashi, këshilltare komunale në Klinë, për mos raportim të pasurisë është dënuar me 200 euro gjobë dhe tre (3) muaj burgim me kusht.

Ndërsa, deputeti **Etem Arifi** është dënuar me një (1) vit e tre (3) muaj burgim për “*mashttrim me subvencione*”.


23.2.2. Dënimet e shkallës së parë

Ish-ministri i Administratës së Pushtetit Lokal, **Ivan Teodosjeviq**, është dënuar me dy (2) vite burgim për kryerjen e veprës penale “*nxitja e urrejtjes, përqasjes ose mos durimit kombëtar racor apo etnik*”.

³⁴ Shënim: Përpos të dhënave të paraqitura në tabelë, një rast tjetër i këtij grupi të partive politike është referuar në procedurë të ndërmjetësimit.

Ndërsa, Kryetari i Komunës së Novobërdës, **Svetislav Ivanoviq**, është

dënuar me 3,000 euro për keqpërdorim të detyrës zyrtare.



Grafiku 50: Dënimet e shqiptuara për anëtarët e partive tjera.

23.3. Aktgjykimet liruese për anëtarët e partive të tjera

23.3.1. Lirimet e formës së prerë

Ish-kryetarët e Komunës së Klllokotit, **Sreqko Spasiq** në aktakuzën ndaj tij dhe **Sasha Mirkoviq** në katër (4) nga shtatë (7) aktakuzat ndaj tij, janë liruar me vendim të formës së prerë për vepra korruptive. Për vepra të natyrës së njëjtë ishin liruar edhe nënkryetari i Klllokotit **Marko Svillanoviq** në dy (2) raste, dhe kryetari i kuvendit komunal të kësaj komune **Zharko Dejanoviq**. Edhe deputetja **Duda Balje**, është liruar për “mos raportim të pasurisë”.

Nga akuzat për korrupsion janë liruar edhe ish-drejtori i urbanizmit në Komunën e Dragashit **Bean Haxhihasani** dhe ish-drejtoresha e arsimit në Komunën e Parteshit, **Vesna Jovanoviq**.

23.3.2. Lirimet e shkallës së parë

Ish-zëvendësministri i Administratës Publike në Qeverinë “Haradinaj” dhe ish-ministri i Shëndetësisë, **Numan Balliq**, është liruar nga akuza për veprën penale të “ngacmimit”.

23.4 Aktgjykimet refuzuese për anëtarët e partive të tjera

Dy (2) aktakuza, për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Klllokotit, **Sasha Mirkoviq**, janë refuzuar, pasi prokurori kishte hequr dorë nga ndjekja penale, e në njërin nga rastet bashkë me Mirkoviqin për shkak të heqjes dorë nga akuza, është refuzuar edhe aktakuza ndaj nënkryetarit të Klllokotit **Marko Svillanoviq**. Aktgjykim lirues ishte shqiptuar edhe ndaj ish-deputetit **Dragan Dimiq** për “mashttrim në votime”.

23.5. Hudhjet e aktakuzave të anëtarëve të partive të tjera

Gjykata pa filluar shqyrtimin gjyqësor, ka hudhur aktakuzat për korrupsion ndaj ish-

ministrit për komunitete dhe kthim **Dalibor Jevtiq** si dhe në një rast ndaj ish-kryetarit të Klllokotit **Sreqko Spasiq**, i akuzuar për korrupsion. Për të njëjtën vepër është hedhur aktakuza edhe ndaj drejtorit të Komunës së Klllokotit, **Goran Marinković**. Për veprën penale “*kanosje*”, rasti ndaj ish-deputetit **Milaim Zeka** lidhur është zgjidhur në procedurë ndërmjetësimit.

23.6. Rastet në proces të anëtarëve të partive të tjera

Përkundër vendimeve gjyqësore, janë edhe 18 raste të tjera të cilat janë akoma në procedurë gjyqësore. Ish-zëvendëskryeministri dhe ish-ministri i Shëndetësisë **Bujar Bukoshi**, është duke u akuzuar në dy procese të ndara, në njërën për keqpërdorim të pozitës zyrtare sa ishte ministër i Shëndetësisë, e në tjetrën për shpërdorim dhe shmangie nga tatimi lidhur me keqpërdorimet në “Fondin e 3%”. Edhe ish-deputeti **Milaim Zeka**, është akuzuar në dy (2) raste, në njërin ai është akuzuar për “*mashttrim*” dhe *shmangie nga tatimi*”, që ndryshe njihet si rasti “Vizat”, ndërsa në rastin tjetër ai akuzohet për “*kanosje*”, ndaj prokurorit Afrim Shefkiu. Lidhur me akuzat për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, po vazhdojnë të gjykohen, ish-drejtori për ekonomi dhe financa në Komunën e Prizrenit **Ertan Simitqiu**, ish-drejtori për gjeodezi dhe kadastrë **Halit Gashi**, Për veprën penale të “*sulmit*” dhe të “*kanosjes*”, në procedurë gjyqësore është edhe ish-deputeti i mandatit të fundit **Adem Hoxha**. Ish-ministri i Shëndetësisë **Ferid Agani**, për dyshimet se gjatë kohës kur e ka

udhëhequr këtë ministri ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, është duke u rigjykuar.

Për keqpërdorim të pozitës zyrtare po akuzohen ish-kryetari i Komunës së Klllokotit **Sasha Mirković**, rasti i të cilit është në rigjykim, , ish-ministrat, **Mimoza Kusari-Lila**, **Nenad Rashiq** dhe **Nenad Rikallo**, drejtori i Kadastrit dhe Gjeodezisë në Komunën e Prizrenit, **Refik Shaqiri**, drejtori komunal i Mitrovicës Veriore, **Branislav Klajiq**, si dhe drejtori komunal i Novobërdës, **Goran Maksimović**. Deputeti **Rasim Demiri**³⁵ po akuzohet për armëmbajtje pa leje, kurse për “*shkelje të statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës*” po akuzohet Kryetari i Komunës së Klllokotit, **Bozhedar Dejanović** dhe drejtori i kësaj komune, **Goran Marinković**.

³⁵ Shënim: Demiri, më 10 qershor 2020, është dënua 500 euro gjobë dhe me katër (4) muaj burgim, të cilin me pelqimin e tij, mund ta zëvendësoj me 600 euro gjobë. Betimi për Drejtësi. 10.06.2020 (Shih

linkun; <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-rasim-demiri-dhe-i-akuzuari-tjeter-denohen-per-perdorim-te-arnes/>)


24. Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të paidentifikuara

Përpos partive kryesore në vend, IKD ka analizuar edhe politikanët e subjekteve të tjera politike si shqiptare, ashtu edhe ato të minoriteteve, të cilat nuk kanë mundur të identifikohen nga IKD.³⁶

Në këtë grup bëjnë pjesë **shtatë (7) politikanë me 10 aktakuza**.

24.1. Veprat penale me të cilat janë akuzuar politikanët e partive të tjera

Në grupin e veprave penale të pretenduara nga Prokurori i Shtetit për anëtarët e partive të paidentifikuara, në **10** aktakuzat e ngritura ndaj shtatë (7) politikanëve janë përfshira **10** vepra penale. Nga këto vepra, shumicën e përbëjnë veprat penale të korrupsionit (8 vepra penale), ndërsa dy (2) raste kanë të bëjnë me “*cenim i të drejtave të punësimit dhe papunësisë*”.



Grafiku 51: Veprat penale me të cilat janë akuzuar zyrtarët e partive të paidentifikuara.


Në këtë grup, pjesa më e madhe e procedurave penale apo gjashtë (6) raste kanë marrë vendimin e formës së prerë. Prej tyre, janë shpallur 4 aktgjykime liruese, **një (1)** dënues dhe **një (1)** tjetër refuzues. Në gjykatën e shkallës së parë deri më tash janë

shpallur edhe **tri (3)** aktgjykime, **dy (2)** nga të cilat janë dënuese, ndërsa **një (1)** është lirues.

Aktualisht, në shkallën e parë është duke u trajtuar një (1) rast.

³⁶ *Shënim:* Në këtë kategori të politikanëve në të cilën bëjnë pjesë 10 persona, IKD nuk ka mundur të identifikoj në asnjë mënyrë se në cilat subjekte politike kanë qenë të njëjtit. Këto raste, IKD i ka monitoruar nga afër. Të njëjtat raste, kanë të bëjnë me drejtorë komunal të komunave të caktuara, përkatësia politike e të cilëve nuk ka mundur të

identifikohet me saktësi. Për këto arsye, me qëllim të pasqyrimin të drejtë, të njëjtit janë trajtuar në ndonjë kategori të veçantë. Nisur nga mundësia që drejtorë komunal të emërohen edhe persona jashtë subjekteve politike, potencialisht, nuk përjashtohet mundësia që ndonjëri të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike.



Grafiku 52: Procedimet e aktakuzave të zyrtarëve të partive të paidentifikuara.

24.2. Aktgjykimet dënuese të anëtarëve të partive të tjera

Miroslav Stoliq, drejtor komunal i arsimit në Kllkotit, është dënuar me dënim të formës së prerë me 2,500 euro gjobë për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ndërsa nga gjykata e shkallës së parë për “*cenim i të drejtave të punës dhe papunësisë*”, drejtori komunal në Komunën e Kllkotit, **Miroslav Stoliq** është dënuar me 600 euro gjobë kurse për keqpërdorim të pozitës zyrtare, **Nikolla Nojkiq**, me tetë (8) muaj burgim efektiv.

24.3. Aktgjykimet liruese për anëtarët e partive të tjera

Ish-drejtori në drejtorinë për Administratë dhe Personel **Zoran Mirkoviq** (në dy (2) raste), ai i Arsimit **Goran Maksimoviq** dhe ai i Shëndetësisë **Miroslav Stoliq**, të gjithë

drejtorë në Komunën e Kllkotit, janë liruar me aktgjykime përfundimtare për veprat e “*keqpërdorimit të pozitës zyrtare*”, ndërsa me aktgjykim të shkallës së parë, është liruar ish-drejtori i arsimit në Komunën e Ranillugut, **Dabor Petkoviq**, i akuzuar për veprën penale “*cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë*”.

24.5. Aktgjykimet refuzuese dhe në proces për anëtarët e partive të tjera

Ndaj drejtorit komunal në Komunën e Kllkotit, **Dejan Vllajkoviq**, është shpallur aktgjykim refuzues për keqpërdorim të pozitës zyrtare, i cili vendim ka marrë formën e prerë, ndërsa akoma në procedure gjyqësore është drejtori i Inspektoratit në Komunën e Fushë-Kosovë, **Afrim Krasniqi**, i cili është duke u akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare.

25. Përfundimet

Në bazë të aktakuzave të ngritura ndaj politikanëve, rezulton se numri më i madh i tyre janë ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë (104), çka dëshmon se politikanët të cilët aktivitetin e tyre e kryejnë në rajonin e Prishtinës, kanë rënë më së shumti ndesh me ligjin. Kjo ndërlidhet edhe me faktin se institucionet qendrore janë të vendosura në Komunën e Prishtinës, si dhe territori i kësaj komune është më i madh se sa i komunave të tjera. Nga analizimi i aktakuzave të ngritura nga kjo prokurori rezulton se si në aktgjykimet e formës së prerë (66.10%) e po ashtu edhe ato të shkallës së parë (60%), të njëjtat kanë dështuar të mbrohen në gjykatë.

Ngjashëm me Prokurorinë Themelore në Prishtinë, edhe aktakuzat e PSRK-së (51), si të formës së prerë (71.42%) e po ashtu të shkallës së parë (57.14%), kanë dështuar të mbrohen në gjykatë.

Gjykata më e ngarkuar me trajtimin e rasteve ndaj politikanëve ka qenë Gjykata Themelore në Prishtinë me 138 raste apo 46.30 % të numrit të përgjithshëm prej 298 rasteve.

Nga 298 rastet në të cilat janë akuzuar politikanët, rezulton se në 70% të rasteve (210), politikanët janë akuzuar gjatë kohës sa kanë qenë duke ushtruar pozita zyrtare, ndërsa nga ta vetëm 2.68% prej tyre apo 8 prej tyre, kanë dhënë dorëheqje pas aktakuzave të ngritura, ndërsa numër i njëjtë i tyre (8), janë larguar nga pozitat e tyre, nga eprorët e tyre. Në 65.10% apo në 194 raste, politikanët nuk kanë dhënë dorëheqje pas aktakuzave të ngritura, ndërsa në 27.52% apo 82 raste, politikanët janë akuzuar në kohën kur nuk kanë qenë duke ushtruar pozita zyrtare.

Nga numri i përgjithshëm i aktakuzave ndaj politikanëve, 189 të tilla apo 63.42%, janë ngritur ndaj zyrtarëve apo ish-zyrtarëve të nivelit lokal, ndërsa 109 të tjerë apo 36.57% ndaj atyre të nivelit qendror.

Nga 109 politikanë të nivelit qendror, 70 janë deputet, tre (3) zëvendëskryeministra, 16 ministra, katër (4) zëvendësministra, 12 zyrtarë të tjerë në pozita qeveritare dhe katër (4) zyrtarë në organe të tjera publike, të pushtetit qendror. 21 prej tyre i takojnë PDK-së, 19 partive të tjera, 17 LVV-së, 16 AAK-së, 15 PSD-së, 13 Nismës Socialdemokrate, gjashtë (6) LDK-së dhe dy (2) AKR-së.

Nga 189 politikanë të nivelit lokal, prokuroria ka ngritur 51 aktakuza ndaj kryetarëve të komunave, në mesin e të cilëve ka pasur raste kur ndaj tyre janë ngritur dy, tri, katër e deri në shtatë aktakuza, 91 aktakuza janë ngritur ndaj drejtorëve komunal, 28 të tjera ndaj asamblistëve, tetë (8) ndaj zyrtarëve në organe të tjera komunale, gjashtë (6) ndaj kryesuesve të Kuvendit Komunal si dhe pesë (5) aktakuza ndaj nënkryetarëve të komunave. Komuna e Prizrenit me 25, ajo e Klllokotit me 24 dhe e Drenasit me 17 raste, janë komunat me numrin më të madh të rasteve me aktakuza, ndërsa komunat Istog, Partesh, Shtime dhe Mitrovicë e Jugut me vetëm nga një (1) rast janë komunat me më së paku raste të proceduara në gjykatë. Bazuar në të gjeturat e IKD-së, në gjashtë (6) komunat e tjera të Kosovës, Junik, Leposaviq, Shtërpçë, Zveqan, Mamushë, dhe Graçanicë nuk ka asnjë (0) zyrtarë të akuzuar.

Sikurse në rastet e politikanëve të pushtetit qendror, edhe në atë lokal, nga 189 aktakuzat e zyrtarëve të pushtetit lokal, numrin më të madh të tyre e përbëjnë anëtarët e PDK-së, me 68 aktakuza, 41 aktakuza janë ngritur ndaj anëtarëve të LDK-së, 29 aktakuza ndaj anëtarëve të partive të tjera, shumica prej tyre nga komunat me shumicë serbe, 16 ndaj atyre të AAK-së, 13 ndaj anëtarëve të Nismës Socialdemokrate, nëntë (9) ndaj zyrtarëve të LVV-së dy (2) aktakuza janë ngritur ndaj anëtarëve të PSD-së, ndërsa një (1) ndaj atyre të AKR-së, si dhe 10 aktakuza janë ngritur ndaj anëtarëve të partive të paidentifikuara nga IKD.

Nga numri i përgjithshëm prej 216 personave me 298 aktakuza, rezulton se në aspektin gjinor burrat janë përfshirë në numër më të madh të pjesëmarrjes në aktakuzat e prokurorisë. Nga 298 aktakuza, 267 prej tyre janë ngritur ndaj 193 politikanëve të gjinisë mashkullore, kurse nga 31 aktakuza të tjera akuzohen 23 politikanë të gjinisë femërore.

Nga gjithsej 216 politikanë të akuzuar, IKD ka gjetur se 186 prej tyre janë të përkatësisë shqiptare, 22 u takojnë përkatësisë serbe, katër (4) janë boshnjakë, dy (2) nga komuniteti ashkali si dhe një (1) turk dhe një (1) goran.

Edhe pse në këtë hulumtim janë gjetur 216 politikanë të akuzuar, është parë se të njëjtit kanë bërë pjesë në 298 aktakuza. Vetëm 53 prej tyre janë ngarkuar në 135 aktakuza pasi ata janë ngarkuar me më shumë se dy (2) aktakuza, ndërsa 163 persona të tjerë bëjnë pjesë vetëm në një (1) aktakuzë. 33 politikanë janë ngarkuar me dy (2) aktakuza, 15 të tjerë me tri (3) aktakuza, tre (3) politikanë bëjnë pjesë në katër (4) aktakuza, një (1) politikan ka pesë (5) aktakuza, ndërsa ndaj ish-kryetari i Komunës së Klllokotit, tani nënkryetari i kësaj komune, Sasha Mirkoviq, janë ngritur gjithsej shtatë (7) aktakuza.

Sipas aktakuzave të ngritura ndaj politikanëve pasqyrohet një laramani e veprave penale të pretenduara dhe të vërtetuara nga personat që ushtrojnë ose kanë ushtruar funksione politike. Në 298 aktakuzat ndaj politikanëve janë të përfshira 351 vepra penale. Pjesën më të madhe të tyre apo 204, e përbëjnë vepra penale për të cilat zyrtarët publik janë akuzuar për vepra penale që bëjnë pjesë në kapitullin e veprave korruptive. 33 vepra të tjera penale kanë të bëjnë me veprat penale lidhur me armët, shtatë (7) për krime lufte, gjashtë (6) për krim të organizuar dhe tre (3) për terrorizëm. Përpos këtyre veprave, politikanët akuzohen edhe për 98 vepra tjera duke filluar prej veprave penale të vrasjes, mashtrimit, pengimit të personit zyrtar, shmangie nga tatimi, ngacmimi lëndim trupor, sulm kanosje, vjedhje të shërbimeve komunale dhe vepra të tjera penale.

Nga 298 aktakuzat e prokurorisë rezulton se numri më të madh i tyre (206 raste) janë të profililit të mesëm 55 raste janë të profililit të lartë, gjashtë (6) aktakuza janë ngritur ndaj personave të profililit të ulët, ndërsa 31 të tjera të zyrtarëve pa profil, pasi janë akuzuar për veprime në kohën kur nuk kanë qenë duke ushtruar përgjegjësi shtetërore.

Nga 55 rastet e profililit të lartë, 33 raste kanë përfunduar me vendim të formës së prerë. Mirëpo prej tyre janë vetëm tri (3) raste në të cilat janë shqiptuar aktgjykime dënuese, ndërsa në 30 raste të tjera, gjykata nuk kanë gjetur përgjegjësi penale ndaj zyrtarëve të profililit të lartë. 15 aktakuza kanë përfunduar me aktgjykime liruese, nëntë (9) aktakuza janë hedhur pa filluar

shqyrtim gjyqësor, ndërsa gjashtë (6) të tjera kanë përfunduar me aktgjykime refuzuese, qoftë për shkak të heqjes dorë të prokurorit nga ndjekja penale ose për shkak të parashkrimit të lëndëve. Nga pesë (5) aktakuzat, që kanë përfunduar vetëm në shkallën e parë, tre (3) prej tyre kanë përfunduar me aktgjykime liruese, ndërsa vetëm dy (2) të tjera me aktgjykime dënuese. Ndërsa edhe 17 raste të tjera janë akoma në procedurë gjyqësore në instancën e parë.

Nga 55 aktakuzat e profilit të lartë, janë shpallur vetëm tri (3) aktgjykime dënuese të formës së prerë, dy nga të cilët vijnë nga partitë e minoriteteve dhe një (1) nga PDK.

Kryetari aktual i komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanoviq, ish-kryetari i Kllkotit Sreqko Spasiq dhe ish-kryetari i Komunës së Vitisë Nexhmedin Arifi të akuzuar për vepra korruptive janë të vetmit politikanë, që i takojnë profilit të lartë, që janë dënuar me vendim të formës së prerë. Por edhe pse me aktgjykime dënuese, asnjëri nga ta nuk është dënuar me dënim me burgim. Ivanoviq ishte dënuar me 4500 euro gjobë, Arifi është dënuar me 18 muaj burgim me kusht, ndërsa Spasiq është dënuar me 10 muaj burgim me kusht.

Gjykatat e shkallës së parë kanë shpallur dy aktgjykime dënuese ndaj dy (2) personave, të akuzuar për korrupsion. Ish-kryetari i Prizrenit Ramadan Muja, është dënuar me një (1) vit burgim me kusht dhe kryetari i Novobërdës Svetislav Ivanoviq është dënuar me 3000 euro gjobë.

Në 206 rastet e profilit të mesëm, 114 aktakuza kanë përfunduar me vendime të formës së prerë, prej të cilave 47 raste janë shqiptuar aktgjykime dënuese, 35 raste tjera kanë përfunduar me aktgjykime liruese, në 12 raste janë hudhur aktakuzat, janë refuzuar 18 të tjera, ndërsa dy (2) raste të akuzuar e kanë përfunduar procesin në procedurën e ndërmjetësimit. 22 aktakuza tashmë kanë marrë epilogun vetëm në shkallën e parë, prej të cilave nëntë (9) janë dënuese, ndërsa 13 të tjera kanë përfunduar me aktgjykime liruese, ndërsa, 70, aktakuza janë akoma në procedurë gjyqësore pranë gjykatave të shkallës së parë.

Nga gjashtë (6) rastet e profilit të ulët, katër (4) janë vendime përfundimtare, dy (2) nga të cilat kanë përfunduar me aktgjykime liruese dhe nga një aktgjykim refuzues dhe dënues. Një (1) aktgjykim dënues është dhënë nga shkalla e parë, ndërsa një (1) rast është në proces nga gjykata e shkallës së parë.

Nga numri i përgjithshëm prej 31 aktakuza që janë trajtuar si të pa profilizuara, janë shqiptuar 22 aktgjykime të formës së prerë, prej të cilave nëntë (9) janë aktgjykime dënuese, tri (3) aktgjykime liruese dhe tri (3) të tjera për hudhje të aktakuzave si dhe shtatë (7) aktgjykime refuzuese. Ndërsa në gjykatën e shkallës së parë kemi dy (2) aktgjykime liruese dhe një (1) dënues, ndërsa edhe gjashtë (6) politikanë janë akoma në procedurë gjyqësore.

Nga 298 aktakuzat e ngritura, pjesën më të madhe të tyre e përbëjnë përfaqësuesit e PDK-së. 67 anëtarë të kësaj partie janë ngarkuar me 89 aktakuza apo 30%, pas saj radhitet LDK-ja me 37 persona me 48 aktakuza, apo 16%, 22 përfaqësues të AAK-së kanë 32 aktakuza, apo 11 %, 19 zyrtarë të LVV-së kanë 26 aktakuza, apo 9%, 10 anëtarë të PSD-së kanë 17 aktakuza, apo 5%, 19 anëtarë të Nismës Socialdemokrate kanë 26 aktakuza apo 9% dhe tre (3) zyrtarë të

AKR-së janë me tri (3) aktakuza, apo 1%. Përpos tyre janë analizuar edhe partitë tjera me të vogla shqiptare dhe partitë e minoriteteve, të cilat kanë pasur një numër të përgjithshëm prej 32 politikanëve që kanë 47 aktakuza, apo 16% ndërsa, shtatë (7) persona të partive të pidentifikuara nga IKD, kanë prodhuar 10 aktakuza, apo 3%.

Sipas gjetjeve të IKD-së, rezulton se deri më 31 maj 2020 pjesë e institucioneve publike janë 60 politikan të përfshirë në 70 rastendaj të cilëve janë shqiptuar 26 aktgjykime dënuese ndërsa janë edhe 44 aktakuza aktive. Nga gjithsej 26 dënime të formës së prerë, gjashtë nga (6) prej tyre u takojnë zyrtarëve të PDK-së dhe NISMA-s, katër (4) të AAK-së, nga tre (3) janë zyrtarë të LVV-së dhe partive të tjera, dy (2) dënime të formës së prerë kanë zyrtarët e LDK-së, ndërsa nga një (1) dënim të plotfuqishëm kanë anëtarët e PSD-së dhe AKR-së. Nga 44 aktakuza aktive, numrin më të madh e përbëjnë rastet e partive të tjera, me gjithësej 13 raste, 11 prej të tjera u takojnë zyrtarëve të AAK-së, nëntë (9) akuza aktive kanë zyrtarët e LVV-së, pesë (5) të NISMA-s, tre (3) të LDK-së dhe tre (3) akuza aktive kanë zyrtarët e PDK së.

Nga numri i përgjithshëm prej 298 aktakuzave, është arritur që për 204 prej tyre të ketë vendime gjyqësore, 174 nga të cilat janë vendime përfundimtare ndërsa 31 të tjera kanë përfunduar vetëm në gjykatën e shkallës së parë. Përpos tyre janë edhe 93 aktakuza të cilat janë akoma duke u trajtuar në instancën e parë gjyqësore. Nga 174 rastet e përfunduara me aktgjykim të formës së prerë, prokuroria ka dështuar të mbroj akuzat në 111 raste apo 63.79% ndërsa me aktgjykime dënuese kanë përfunduar vetëm 60 raste apo 34.48%. Janë shqiptuar 55 aktgjykime liruese, 32 aktakuza kanë përfunduar me aktgjykime refuzuese, ndërsa gjykatat kanë hedhur edhe 24 aktakuza. Në mënyra të tjera janë zgjidhur tri (3) raste apo 1.71%, një (1) rast është përfunduar me vërejtje gjyqësore dhe dy (2) raste në procedurë të ndërmjetësimit. Ndërsa nga 31 vendimet e shkallës së parë janë shqiptuar 13 aktgjykime dënuese dhe 18 aktgjykime liruese.

Në bazë të gjetjeve të IKD-së rezulton se gjatë kësaj periudhe të raportimit për vendimet e formës së prerë është gjetur se nga 298 aktakuzat ndaj 216 politikanëve të akuzuar, deri më tani me vendim të formës së prerë janë dënuar vetëm 75 prej tyre, ndaj të cilëve janë shqiptuar 77 dënime. Nga këto dënime të shqiptuara janë vetëm nëntë (9) dënime me dënim me burgim, shtatë (7) nga të cilët janë anëtarë të PDK-së, një (1) nga Nisma Socialdemokrate dhe një (1) nga Partia e Ashalinjëve për Integrim, ndërsa 31 dënime të tjera janë dënime me burgim me kusht, shtatë (7) prej të cilave janë shqiptuar ndaj anëtarëve të PDK-së, gjashtë (6) ndaj anëtarëve të Nismës Socialdemokrate, pesë (5) për ata të LDK-së, nga katër (4) për ata të LVV-së dhe partive të tjera, tre (3) ndaj anëtarëve të AAK-së, kurse nga një (1) dënim me kusht është shqiptuar ndaj anëtarëve të PSD-së dhe AKR-së.

Përpos këtyre vendimeve, janë shqiptuar edhe 36 dënime me gjobë, 12 ndaj anëtarëve të PDK-së, shtatë (7) ndaj anëtarëve të Nismës Socialdemokrate, gjashtë (6) ndaj atyre të LDK-së, pesë (5) ndaj anëtarëve të partive të tjera, nga dy (2) dënime me gjobë janë shqiptuar ndaj politikanëve të PSD-së dhe AAK-së, kurse me nga një (1) aktgjykim dënues me gjobë janë shqiptuar ndaj një anëtar të LVV-së dhe një tjetër të partive të pidentifikuara. Po ashtu, është shqiptuar edhe një (1) dënim plotësues.

Nga aktgjykimet dënuese të formës së prerë janë shqiptuar nëntë (9) dënime me burgim [shtatë (7) ndaj politikanëve të PDK-së, një (1) të Nismës Socialdemokrate dhe një (1) të Partisë së Ashkalinjëve për Integrim] prej të cilave janë shqiptuar 233 muaj apo 19 vite e pesë (5) muaj me burgim efektiv. Shumica nga këto dënime janë shqiptuar ndaj zyrtarëve të PDK-së, konkretisht 210 muaj apo 17 vite e gjashtë (6) muaj, ndaj zyrtarëve të partive të tjera janë shqiptuar 15 muaj apo një (1) vit e tre (3) muaj, ndërsa ndaj zyrtarëve të NISMA-s janë shqiptuar tetë (8) muaj burgim efektiv. Ndaj zyrtarëve të partive janë shqiptuar edhe 35 dënime me gjobë [12 PDK, shtatë (7) Nisma Socialdemokrate, nga pesë (5) PDK dhe partitë e tjera shqiptare dhe të komuniteteve, nga dy (2) AAK, PSD, një (1) LVV dhe nga partitë e pa identifikuar, dhe AKR pa asnjë dënim] në shumë prej 35,840 euro. Me 10,740 euro gjobë janë dënuar zyrtarët e NISMA-s, 8400 euro gjobë ndaj zyrtarëve të partive të tjera, 5750 euro gjobë ndaj zyrtarëve të LDK-së, 5200 euro ndaj atyre të AAK-së, 2500 ndaj zyrtarëve të partive të pa identifikuar, me 1950 euro gjobë janë dënuar zyrtarët e PDK-së, me 900 euro ata të PSD-së, me 400 euro gjobë zyrtarët e LVV-së, dhe me asnjë gjobë ata të AKR-së.

Nga 89 aktakuzat e ngritura ndaj zyrtarëve të PDK-së, 52 prej tyre tani kanë marrë formën e prerë, 15 të tjera kanë marrë verdiktin vetëm të gjykatës së shkallës së parë, ndërsa në procedurë gjyqësore në gjykatat themelore janë edhe 22 të tjera. Në 89 aktakuzat ndaj politikanëve të PDK-së janë të përfshira 105 vepra penale, ndërsa pjesën më të madhe të tyre prej 74 veprave e përbëjnë vepra penale për të cilat zyrtarët e PDK-së janë dyshuar për vepra penale që bëjnë pjesë në kapitullin e korrupsionit. Nga të gjitha rastet në të cilat janë gjykuar zyrtarët e PDK-së, janë shqiptuar 27 aktgjykime dënuese, prej të cilave 22 janë të formës së prerë dhe pesë (5) të tjera të gjykatës së shkallës së parë, në 24 raste janë shqiptuar aktgjykime liruese, prej të cilave 14 janë të formës së prerë, ndërsa 10 të tjera të gjykatës së shkallës së parë. Me vendim të formës së prerë janë refuzuar edhe nëntë (9) aktakuza, ndërsa janë hedhur edhe shtatë (7) të tjera.

Në 48 aktakuzat ndaj politikanëve të LDK-së janë të përfshira 54 vepra penale. Pjesën më të madhe të tyre prej 36 veprave e përbëjnë vepra penale për të cilat zyrtarët e LDK-së janë dyshuar për vepra penale që bëjnë pjesë në kapitullin e korrupsionit. Nga 48 rastet ndaj zyrtarëve të LDK-së, tashmë 31 raste kanë marrë formën e prerë, nga këto janë shqiptuar nëntë (9) aktgjykime dënuese, 11 aktgjykime liruese, janë refuzuar shtatë (7) aktakuza, ndërsa katër (4) të tjera janë hedhur poshtë. Përveç aktgjykimeve të formës së prerë, janë edhe katër (4) aktgjykime të shkallës së parë, tri (3) nga të cilat janë aktgjykim liruese, ndërsa është marrë edhe një (1) aktgjykim dënues. Përpos tyre, janë edhe 13 aktakuza të tjera ndaj zyrtarëve të kësaj partie, që janë në proces para gjykatave të shkallës së parë.

Nga 26 aktakuzat e zyrtarëve të LVV-së janë të përfshira 33 vepra penale. Për dallim nga dy partitë paraprake PDK dhe LDK, LVV-ja numrin më të madh të veprave penale i ka ato që kanë të bëjnë me gjuajtjen e gazit lotsjellës [12]. Nga 19 anëtarët e LVV-së me 26 aktakuza, shumë raste kanë mbetur akoma pa u trajtuar, pasi 11 aktakuza ndaj tyre janë akoma në trajtim në gjykatat themelore. Përpos rasteve në proces, gjykatat ndaj zyrtarëve të LVV-së kanë shqiptuar katër (4) aktgjykime dënuese, të cilat e kanë fituar formën e prerë. Të formës së prerë janë edhe një (1) aktgjykim lirues si dhe gjashtë (6) aktgjykime refuzuese e tri (3) hudhje të

aktakuzës. Ndërsa një (1) aktgjykim dënues është shpallur nga gjykata e shkallës së parë dhe 11 raste të tjera janë në proces gjyqësor.

Në 32 aktakuzat e zyrtarëve të AAK-së, 15 nga të cilat tashmë kanë një vendim të formës së prerë janë shqiptuar katër (4) aktgjykime dënuese, katër (4) aktgjykime liruese, janë refuzuar dy (2) aktakuza dhe po ashtu janë hudhur edhe pesë (5) të tjera. Nga 32 aktakuzat e 22 anëtareve të AAK-së, janë të përfshira 35 vepra penale. Numri më i madh i tyre prej 18 veprave, ka të bëjë me vepra penale të korrupsionit, tetë (8) vepra që lidhen me hedhjen e gazit lotsjellës në Kuvend, ndërsa janë edhe nëntë (9) vepra të natyrave të tjera. Në gjykatën e shkallës së parë janë vetëm **tri (3)** raste të cilat kanë përfunduar, dy nga të cilat aktgjykime dënuese dhe një tjetër liruese, ndërsa janë edhe 14 aktakuza të cilat janë në procedim para instancave të para gjyqësore.

Nisma Socialdemokrate si një parti e themeluar në vitin 2014 nga ish-zyrtari i lartë i PDK-së Fatmir Limaj ka përfshirë në këtë subjekt 19 persona ndaj të cilëve janë ushtruar 26 aktakuza për vepra penale të kryera para dhe gjatë ushtrimit të funksioneve, në 26 aktakuzat ndaj tyre janë përfshirë 36 vepra penale të ndryshme, 21 nga të cilat janë vepra të natyrës korruptive. Për anëtarët e akuzuar të Nisma-s janë shqiptuar 19 vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë, ku një (1) rast është gjykuar në shkallë të parë dhe gjashtë (6) raste të tjera janë akoma të hapura për trajtim në gjykatat themelore. Ndaj zyrtarëve të Nisma-s, gjykatat kanë shqiptuar 11 aktgjykime dënuese, prej të cilave 10 vendime gjyqësore e kanë fituar formën e prerë. Të formës së prerë janë edhe tetë (8) aktgjykime liruese dhe një (1) vendim për hedhje të aktakuzës. Ndërsa, në shkallë të parë është nxjerrë edhe një (1) aktgjykim lirues, i cili akoma nuk ka marrë formën e prerë.

Nga 10 zyrtarët e PSD-së me 17 aktakuza, përveç dy (2) rasteve për “mos raportim të pasurisë”, nuk është e përfshirë asnjë aktakuzë për vepra korruptive, ndërsa përfshihet një (1) vepër terroriste. Te anëtarët e këtij subjekti politik, numri më i madh i këtyre aktakuzave lidhen me veprimet që ata kanë bërë në Kuvendin e Kosovës qoftë me hedhjen e gazit lotsjellës [6] si dhe me përleshjet fizike në atë vend, e po ashtu edhe nga veprimet në protestat e organizuara nga LVV. Janë tetë (8) raste të cilat janë akoma në proces pranë gjykatave të shkallës së parë, ndërsa janë edhe tetë (8) aktgjykime të formës së prerë, nga të cilat bëjnë pjesë tri (3) aktgjykime dënuese, tri (3) refuzime të aktakuzave, nga një (1) aktgjykim lirues, refuzues dhe një (1) hedhje të aktakuzave, ndërsa një (1) rast ka përfunduar në procedurë të ndërmjetësimit.

Nga tre (3) politikanët e AKR-së, që kanë prodhuar tri (3) aktakuza, janë të përfshira po ashtu tri (3) vepra penale, dy (2) nga të cilat janë të korrupsionit, ndërsa një (1) tjetër është e rrezikimit të trafikut publik. Nga tre anëtarë të AKR-së ndaj të cilëve janë ngritur tri aktakuza, gjykatat kanë nxjerrë dy (2) vendime gjyqësore të formës së prerë, dhe një (1) rast është duke u proceduar në gjykatë.

Në grupin e veprave penale të pretenduara për anëtarët e partive të tjera përpos atyre që kanë shumicën e votuesve, në 47 aktakuza janë të përfshira 54 vepra penale. Nga këto vepra, shumicën absolute e përbëjnë 38 vepra penale të korrupsionit. Në këtë grup, pjesa më e madhe e proceseve apo 25 raste kanë marrë vendimin e formës së prerë. Prej tyre, janë shpallur 11

aktgjykime liruese shtatë (7) aktgjykime dënuese, katër (4) aktgjykime refuzuese dhe tri (3) hujdhje të aktakuzave. Në gjykatën e shkallës së parë deri më tash janë shpallur edhe tri (3) aktgjykime, dy (2) nga të cilat janë dënuese, një (1) dënues, ndërsa një rast tjetër ka përfunduar me procedurë alternative-ndërmjetësim. E para gjykatës së shkallës së parë janë duke u trajtuar edhe 18 raste të tjera.

Në grupin e veprave penale të pretenduara për anëtarët e partive të paidentifikuara, në 10 aktakuza janë të përfshira 10 vepra penale. Nga këto vepra, shumicën e përbëjnë 8 vepra penale të korrupsionit, ndërsa në dy (2) raste janë të përfshira vepra tjera penale. Në këtë grup, pjesa më e madhe e proceseve apo gjashtë (6) raste kanë marrë vendimin e formës së prerë. Prej tyre, janë shpallur 4 aktgjykime liruese, një (1) dënues dhe një tjetër refuzues (Në gjykatën e shkallës së parë deri më tash janë shpallur edhe tri (3) aktgjykime, dy (2) nga të cilat janë dënuese, ndërsa një (1) lirues. Në shkallën e parë është duke u trajtuar një (1) rast.

26. Rekomandimet

- ❖ Prokurori i Shtetit të ngrisë efikasitetin dhe efektivitetin e hetimit ndaj zyrtarëve të lartë pasi shumica e aktakuzave kanë duke dështuar të mbrohen para gjykatave.
- ❖ Në aktakuzat e prokurorisë në rastet e akuzimit të personave zyrtar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, në çdo rast të bëhet edhe propozimi për shqiptimin e dënimit plotësues të ndalimit të së drejtës për tu zgjedhur. Por, edhe në mungesë të këtij propozimi, gjykatat të shqiptojnë këto dënime plotësuese sipas detyrës zyrtare.
- ❖ Prokurori i Shtetit të njoftojnë opinionin publik lidhur me aktakuzat e ngritura ndaj zyrtarëve të lartë të shtetit.
- ❖ Gjykatat kompetente të njoftojnë lidhur me seancat gjyqësore në të cilat si të akuzuar janë zyrtarët e lartë të shtetit.
- ❖ Në gjykimet ndaj zyrtarëve të lartë publik, të respektohet parimi kushtetues i publicitetit të gjykimeve.

Gjykatat, në aktgjykimet dënuese, ndaj zyrtarëve publik, të zbatojnë Udhëzuesin për Politikë Ndëshkimore, të miratuar nga Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës.

- ❖ Gjykatat duhen që proceset gjyqësore ndaj zyrtarëve publik në afat sa më shpejtë kohor e në asnjë mënyrë nuk duhet lejuar që këto lëndë të arrijnë afatin e parashkrimit.
- ❖ Partitë politike të mos përfshijnë në listat e tyre zgjedhore persona të cilët janë dënuar nga gjykatat ose kanë aktakuza aktive.
- ❖ Partitë politike të mos emërojnë në pozita publike persona të cilët janë dënuar nga gjykatat ose kanë aktakuza aktive.
- ❖ Politikanët të cilët akuzohen gjatë kohës kur ata janë duke ushtruar pozita publike, e posaçërisht për vepra penale korruptive, me qëllim të zhvillimit të një procesi të drejtë gjyqësor dhe ngritjen e besimit të publikut në trajtimin e drejtë të këtyre rasteve, të japin dorëheqje.
- ❖ Partitë politike të miratojnë kode të mirësjelljes me të cilat anëtarëve të subjekteve të tyre me aktakuza të mos mund përfshihen në lista zgjedhore.

I. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të PDK-së

Në
proces



AGIM ÇEKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Zëvendësministër i MSFK-së; Ministër i FSK-së; Kryeministër

Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale, Agim Çeku akuzohet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si Kryetar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës, në vlerë prej 88,769,217.04 euro. Bashkë me Çekun, në këtë rast janë të akuzuar edhe Nuredin Lushtaku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Procesi – Ish-kryeministri Çeku dhe të akuzuarit tjerë në këtë rast, ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur për këtë rast më 14 mars 2019. Të njëjtit, kishin kërkuar nga gjykatësja e rastit, Nushe Kuka-Mekaj, hudhjen e aktakuzës.³⁷ Megjithatë, aktakuza ndaj Çekut dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e gjykatës në qershor të këtij viti.³⁸

³⁷ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-ceku-rustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸ “Konfirmohet aktakuza ndaj Rustem Berishës, Agim Cekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në gusht 2019, aktakuzën ndaj Çekut dhe të tjerëve e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.³⁹

Procesi, ndaj Çekut dhe të tjerëve është akoma duke vazhduar, ndërsa deri më tani janë caktuar tetë (8) seanca gjyqësore, ndërsa njëra (1) nga to kishte dështuar të mbahej⁴⁰. Gjatë këtij gjykimi deri më tani janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve edhe politikanë tjerë e ish-komandant të UÇK-së, si ish-kryeministri Ramush Haradinaj, ish-kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku, kandidati i PDK-së për deputet Hisen Berisha, ndërsa ishin refuzuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen edhe presidenti Hashim Thaçi dhe ish-kryeministri Isa Mustafa.

Pas iniciativës së kryetarit të partisë të cilës i takon Ceku, Kadri Veseli, për largimin nga pozita të personave me aktakuza, kryeministri Ramush Haradinaj e kishte liruar nga detyra Çekun.

³⁹ Rasti “Veteranët”, Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Agim Çekut, Rrustem Berishës e të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-agim-cekut-rrustem-berishes-e-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁰ Shënim: Kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka-Mekaj, ka marrë vendim me të cilin ka ndaluar që të publikohen në media dëshmitë e dëshmitarëve e po ashtu që emrat e tyre të jepen vetëm me initiale derisa të përfundohet procedura e provave, duke lënë kështu publikun të painformuar për dëshmitë e dëshmitarëve të këtij procesi gjyqësorë. Kuka-Mekaj, këtë vendim e ka arsyetuar mbi bazën se me publikimin e dëshmimeve të dëshmitarëve dëmtohet procesi gjyqësorë, pasi sipas saj humb rëndësia që të largohen dëshmitarët nga salla e gjyqimit, derisa të merret në pyetje një dëshmitar tjetër. Mirëpo një formë e tillë e vendimit është aplikuar për herë të parë, pasi e njëjta situatë ndodh edhe në raste të tjera, por më parë nuk ka pasur vendime të ngjashme.



BESIM BEQAJ

1.
Lirim

2. Në
proces

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Ministër i Zhvillimit Ekonomik/ Ministër i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë /Deputet

Vepra penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)
2. Në proces

Aktakuza – Bashkë me Adem Grabovcin dhe nëntë të akuzuarit tjerë, në rastin e njohur si “Pronto”, po akuzohet edhe ish-ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë Besim Beqaj. Aktakuza ndaj tyre ishte ngritur me 6 prill 2018, me pretendimin se ata duke keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurrar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë,⁴¹ ndërsa me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku edhe Beqaj se bashku me dhjetë të akuzuarit tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë.⁴² Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë Beqaj dhe të tjerët më 3 janar 2020 janë liruar nga akuzat⁴³, ndërsa lënda po trajtohen në shkallën e dytë.⁴⁴ Pas iniciativës së kryetarit të partisë të cilës i takon Beqaj,

⁴¹ *Shënim:* Por nga ngritja e aktakuzës e deri kur u caktua seanca fillestare, edhe kjo aktakuzë kaloi në një proces jo të zakonshëm. Kryetari i trupit gjykues Shashivar Hoti, gjyqtar i Departamentit të Krimeve të Rënda, në Gjykatën Themelore në Prishtinë, pas një kërkesë të mbrojtësit të Grabovcit, avokatit Florent Latifaj, më 13 gusht 2018, e kishte konsideruar këtë departament si jo-kompetent për ta gjykuar këtë rast, me arsyetimin se vepra penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, nuk bënë pjesë në veprat të cilat gjykohen në Krime të Rënda. Por PSRK-ja, këtë vendim të Hotit, e kishte dërguar në Gjykatën e Apelit, duke konsideruar se ky rast duhet të kthehet në Krime të Rënda, të cilën ankesë e kishte aprovuar Gjykata e Apelit, e cila kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke e konsideruar Departamentin e Krimeve të Rënda si kompetent për ta gjykuar këtë vepër. Pas vendimit të instancës së dytë, gjyqtari Hoti, kishte caktuar shqyrtimin fillestar më 1 tetor 2018, po i njëjti ishte shtyrë për 15 nëntor 2018.

⁴² *Shënim:* Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

⁴³ “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin “Pronto”- Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴ *Shënim:* Gjykata e Apelit, me 30 qershor 2020, kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë për rastin “Pronto” dhe i kishte shpallur fajtor Adem Grabovcin, Ilhami Gashin dhe Sedat Gashin, për veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, kurse për të akuzuarit tjerë ishte vërtetuar aktgjykimin lirues. Këtë vendim më 29 shtator 2020, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e

Kadri Veseli, për largimin nga pozita të personave me aktakuza, kryeministri Ramush Haradinaj e kishte liruar nga detyra Beqjan.

Aktakuza 2. Sipas aktakuzës së ngritur më 10 prill 2020, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Beqaj akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, kryesues i Bordit të KKDFE-së, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me qëllim që t'i mundësoj çfarëdo përfitimi pasuror dhe që të shkaktoj dëm personit tjetër, i kishte tejkaluar kompetencat e veta.

Së bashku me të pandehurin Beqaj, në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, po akuzohet edhe ish-ministrja dhe deputetja aktuale Mimoza Kusari-Lila, si dhe ish-ministrat Nenad Rashiq Dardan Gashi si dhe 15 persona të tjerë.⁴⁵

Procesi 2. Procesi në këtë rast nuk ka filluar akoma.

Kosovës. “Rasti “Pronto”: Gjykata Supreme vërteton vendimin dënues të Apelit ndaj Adem Grabovcit dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-gjykata-supreme-verteton-vendimin-denues-te-apelit-ndaj-adem-grabovcit-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵ PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë. Betimi për Drejtësi, 10 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**RAMË BUJA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Ministër i Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - PSRK më 7 nëntor të vitit 2016, kishte ngritur aktakuzë me të cilën e akuzonte ministrin Ramë Buja se në cilësi të Ministrit të Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Xhavit Dakaj si sekretar i Përgjithshëm në MASHT pretendohet se kishin lidhur marrëveshje të kundërligjshme me operatorin ekonomik “Alb – Architect”, pronar i të cilës është i akuzuari tjetër Afrim Demiri, ndërsa bashkë me ta akuzohet edhe drejtori i prokurimit në MASHT Xhemajl Buzuku. Ata akuzoheshin lidhur me projektin “Mbikëqyrja Profesionale e Objekteve Kapitale të Ndërtuara nga MASHT”

Procesi - Pas mbajtjes së shqyrtimit të dytë, gjykata më 28 prill 2017, ka hedhur poshtë aktakuzën ndaj ish-ministrit, Ramë Buja dhe ish-sekretarit, Xhavit Dakaj, me arsyetimin se PSRK-ja, nuk ka mundur me asnjë provë të vetme të vë në pah faktin e tejkalimit të kompetencave zyrtare apo keqpërdorimit të pozitës, nga të akuzuarit Buja dhe Dakaj, , ndërsa aktakuza ishte konfirmuar për dy të akuzuarit e tjerë Xhemajl Buzuku dhe Afrim Demiri.⁴⁶ Vendimi për hudhjen e aktakuzës ndaj Bujës e kishte vërtetuar më pas edhe Gjykata e Apelit.⁴⁷ Gjykata Themelore në Prishtinë, pas shqyrtimit gjyqësor kishte liruar nga akuza edhe Buzukun dhe Demirin, i cili vendim po ashtu ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit.

⁴⁶ “Prokurori Special nuk është në dijeni për hedhjen e aktakuzës ndaj ish-ministrit, Ramë Buja”. Betimi për Drejtës. 16 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-special-nuk-eshte-ne-dijeni-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-rame-buja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁷ “Apeli vërteton vendimin për hedhjen e aktakuzës ndaj ish-ministrit Buja”. Betimi për Drejtës. 5 qershor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-vendimin-per-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-ministrit-buja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**AZEM SYLA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet i Kuvendit të Kosovës**Vepra penale:** “Krim i organizuar” etj**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Prokurori i PSRK-së, nga radhët e Eulex-it, më 24 tetor 2016 kishte ngritur aktakuzë ndaj Sylës dhe 21 personave të tjerë, pas pretendimeve se të njëjtit duke vepruar si grup kriminal i organizuar i kanë privuar Kosovës pronat shoqërore, duke përfshirë falsifikimin e vendimeve dhe dokumenteve zyrtare, mashtrim dhe veprime tjera korruptive, ndërsa pasuria e fituar në mënyrë të kundërligjshme kap vlerën e mbi 30 milion eurove.

Procesi - Ky rast edhe pse ka një aktakuzë të ngritur në fundin e vitit 2016, është vetëm në hapat e parë të shqyrtimit gjyqësor. Zvarritjet e këtij rasti kanë filluar fillimisht gjatë kohës kur është gjykuar nga gjykatësit e misionit të Eulex-it^{48,49}, e më pas ngjashëm ka vazhduar edhe kur gjykimi ka kaluar te gjykatësit vendor, duke caktuar seancat gjyqësore me tepër se dy muaj nga njëra tjetra.^{50 51} Deri më tani në këtë proces gjyqësorë janë caktuar 25 seanca gjyqësore, 15 nga të cilat ishin shtyrë, ndërsa 10 të tjera janë mbajtur. Pas përfundimit të deklaratave të dëshmitarëve, më 19 shkurt 2020 ka filluar dëgjimi i të akuzuarve, në të cilën seancë Sylja aktakuzën ndaj tij e ka quajtur politike dhe të orkestruar nga Beogradi⁵².

⁴⁸ *Trupi gjykues jo i plotë, shtyhen seancat e kësaj jave ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka”*. Betimi për Drejtësi. 9 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/trupi-gjykues-jo-i-plote-shtyhen-seancat-e-kesaj-jave-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁹ *EULEX-i e transferon te vendorët rastin e Azem Sylës, prokurori e quan të turpshëm vendimin*. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/eulex-i-e-transferon-te-vendoret-rastin-e-azem-syles-prokurori-e-quan-te-turpshem-vendimin/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵⁰ *Mungojnë katër të akuzuar, sërish dështon gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka”*. Betimi për Drejtësi. 29 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-kater-te-akuzuar-serish-desh-ton-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵¹ *Mungon njëri nga të akuzuarit, sërish dështon gjykimi ndaj Azem Sylës dhe të tjerëve në rastin “Toka”*. Betimi për Drejtësi. 16 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-njeri-nga-te-akuzuarit-serish-desh-ton-gjykimi-ndaj-azem-syles-dhe-te-tjereve-ne-rastin-toka/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵² *“Rasti “Toka”, Azem Sylja aktakuzën ndaj tij e quan politike e të orkestruar nga Beogradi*. Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-toka-azem-syla-aktakuzen-ndaj-tij-e-quan-politike-e-te-orkestruar-nga-beogradi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ADEM GRABOVCI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Deputet; Zëvendësministër i Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit

Vepra penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”.

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza Procedurale – Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – PSRK aktakuzën ndaj Grabovcit dhe dhjetë të akuzuarve tjerë në rastin e njohur si “Pronto”, e kishte ngritur me 6 prill 2018, sipas aktakuzës, ata duke keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurruar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë, ndërsa me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku Grabovci së bashku me të akuzuarit tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë.⁵³

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në të cilin ishin caktuar nëntë (9) seanca gjyqësore, Grabovci dhe të tjerët më 3 janar 2020 janë liruar nga akuzat,⁵⁴ ndërsa lënda po trajtohet në shkallën e dytë.⁵⁵

⁵³ *Shënim:* Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

⁵⁴ “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵⁵ *Shënim:* Gjykata e Apelit, me 30 qershor 2020, kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë për rastin “Pronto” dhe i kishte shpallur fajtor Adem Grabovcin, Ilhami Gashin dhe Sedat Gashin, për veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, kurse për të akuzuarit tjerë ishte vërtetuar aktgjyrimi lirues. Këtë vendim më 29 shtator 2020, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës. “Rasti “Pronto”: Gjykata Supreme vërteton vendimin dënues të Apelit ndaj Adem Grabovcit dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-gjykata->



ZENUN PAJAZITI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Deputet i Kuvendit të Kosovës

Vepra penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”.

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – I bashkakuzuar në rastin “Pronto”, është edhe deputeti i PDK-së, Zenun Pajaziti. Aktakuza ndaj tyre ishte ngritur me 6 prill 2018, me pretendimin se ata duke keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurrar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë, me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku edhe Pajaziti se bashku me dhjetë të akuzuarit tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë.⁵⁶ Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në të cilin ishin caktuar nëntë (9) seanca gjyqësore,

Pajaziti dhe të tjerët më 3 janar 2020 janë liruar nga akuzat, ndërsa lënda po trajtohet në shkallën e dytë⁵⁷.

[supreme-verteton-vendimin-denues-te-apelit-ndaj-adem-grabovcit-dhe-dy-te-tjereve/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵⁶ *Shënim:* Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

⁵⁷ “Aktgjykim liruës ndaj të akuzuarve në rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

4 vite
burgim**RRUSTEM MUSTAFA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet; Këshilltar i Presidentit Hashim Thaçi**Vepra penale:** “*Krime lufte*”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Dënim - Katër vite burg (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ish-deputeti i PDK-së Rustem Mustafa ka bërë pjesë në aktakuzën e Eulexit, që atë dhe bashkëluftëtarët e UCK-së Latif Gashi dhe Nazif Mehmeti, të njohur si Grupi i Llapit⁵⁸, ishin akuzuar për krime lufte ndaj popullatës civile. Ata akuzoheshin se nga muaji tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paidentifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë, në përpjekje të detyrimit me forcë të këtyre të burgosurve që t’i pranojnë aktet e pabesisë së tyre ndaj UÇK-së.

Procesi - Me një vendim të 7 qershorit 2013, trupi gjykues në përbërje të gjykatësve të Eulexit dhe atyre vendas, kishte gjetur fajtor Mustafën dhe i njëjti ishte dënuar me katër (4) vite burgim.⁵⁸ Këtë vendim të Themelores më pas e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 11 gusht të vitit 2015, kishte konsideruar si të bazuar vendimin ndaj Mustafës, prej katër viteve heqje lirie.⁵⁹

Mustafa, pas këtij vendimi kishte vuajtur dënimin prej tri viteve e tre muaj e 11 ditë, ndërsa ai ishte liruar me kusht për një periudhë tetë muaj e 18 ditë. Pas vërtetimit të aktgjykimit ndaj tij, Mustafa kishte dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit.

⁵⁸ “Grupi i Llapit” dënohet me 13 vjet burg”. Telegrafi. 7 qershor 2013 .(shih linkun: <https://telegrafi.com/grupi-i-llapit-denohet-me-13-vjet-burg/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵⁹ “Apelit konfirmon dënimin e Rustem Mustafës, Latif Gashit dhe Nazif Mehmetit” Zeri.info. 6 nëntor 2015 (shih linkun <https://zeri.info/kronika/60414/apelit-konfirmon-denimin-e-rrustem-mustafes-latif-gashit-dhe-nazif-mehmetit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

6 vite
burgim**LATIF GASHI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet i Kuvendit të Kosovës**Vepra penale:** “*Krime lufte*”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Dënim - Gjashtë vjet burg (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Edhe ish-deputeti i PDK-së Latif Gashi, ishte pjesë në aktakuzën e Eulexit, që atë dhe bashkëluftëtarët e UCK-së Rustem Mustafa dhe Nazif Mehmeti, të njohur si Grupi i Llapit”, ishin akuzuar për krime lufte ndaj popullatës civile. Ata akuzoheshin se nga muaji tetor 1998 deri në fund të prillit 1999, me përgjegjësi mbikëqyrëse dhe personale, duke vepruar në bashkëpunim me individë të tjerë të paidentifikuar dhe në bazë të ndërmarrjes së përbashkët kriminale, kanë urdhëruar dhe kanë marrë pjesë në rrahjen dhe torturimin e civilëve shqiptarë të Kosovës të mbajtur në mënyrë të kundërligjshme në qendrën e mbajtjes së të burgosurve në Llapashticë, në përpjekje të detyrimit me forcë të këtyre të burgosurve që t’i pranojnë aktet e pabesisë së tyre ndaj UÇK-së.

Procesi - Me një vendim të 7 qershorit 2013, trupi gjykues në përbërje të gjykatësve të Eulexit dhe atyre vendas, kishte gjetur fajtor Gashin dhe i njëjti ishte dënuar me gjashtë vite burg.⁶⁰ Këtë vendim të Themelores më pas e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 11 gusht të vitit 2015, kishte konsideruar si të bazuar vendimin ndaj Gashit, prej gjashtë viteve burgim.⁶¹ Pas vërtetimit të aktgjykimit ndaj tij, Gashi kishte dhënë dorëheqje nga pozita e deputetit.

⁶⁰ “Grupi i Llapit” dënohet me 13 vjet burg”. Telegrafi. 7 qershor 2013. (shih linkun: <https://telegrafi.com/grupi-i-llapit-denohet-me-13-vjet-burg/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁶¹ “Apelit konfirmon dënimin e Rustem Mustafës, Latif Gashit dhe Nazif Mehmetit” Zeri.info. 6 nëntor 2015. (shih linkun <https://zeri.info/kronika/60414/apelit-konfirmon-denimin-e-rrustem-mustafes-latif-gashit-dhe-nazif-mehmetit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Refuzim

**ELMI REÇICA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet**Vepra penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Refuzim / Heqje dorë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, në qershorin e vitit 2015, e kishte akuzuar Reçicen me veprën penale “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, pasi pretendonte se në formularin e pasurisë së vitit 2013 Reçica kishte deklaruar të hyra prej 17.760.00 euro, ndërsa ishte zbuluar se gjatë atij viti Reçica kishte pasur të hyra vjetore prej 24.056.00 eurove.

Procesi - Pas më pak se një viti, më 25 prill 2016, prokurori Rexhep Maqedonci, kishte hequr dorë nga ndjekja penale ndaj Reçices, me arsyetimin se nuk janë arritur të provohen pretendimet fillestare të prokurorisë. Pasi prokuroria kishte hequr dorë nga ndjekja penale, Gjykata Themelore në Prishtinë, ndaj Reçicës kishte shpallur aktgjykim refuzues.

**NAIT HASANI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet i Kuvendit të Kosovës, Ambasador i Kosovës në Shqipëri**Vepra penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, deputeti Nait Hasani nuk i ka paraqitur saktë të hyrat vjetore të kërkuara në deklaratën për Agjencinë Kundër Korrupsion, nga 1 janari 2012 deri më 31 dhjetor 2012. Sipas pretendimit të prokurorisë dallimi mes të hyrave që kishte deklaruar Hasani dhe atyre që ishin bërë të ditura nga Kuvendi i Kosovës, ishte 5 mijë e 285 euro e katër centë.

Procesi - Më 14 janar 2015, Gjykata Themelore në Prizren e kishte shpallur të pafajshëm Hasanin sepse sipas gjykatës prokuroria nuk kishte arritur të vërtetonte se ai ka kryer veprën penale për të cilën ishte akuzuar, pasi ishte konsideruar se gjatë deklaratimit të pasurisë ishin bërë lëshime teknike nga Hasani e jo ndonjë fshehje të pasurisë.⁶²

⁶² Deputeti Nait Hasani lirohet nga akuza për mosdeklarim të pasurisë”. Lajmi.net, 14 janar 2015. (Shih linkun <https://lajmi.net/deputeti-nait-hasani-lirohet-nga-akuza-per-mosdeklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**XHAVIT HALITI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet/Nënkryetar i Kuvendit**Veprat penale:** “Sulmi”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 31 maj 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Xhavit Halitit, me të cilën pretendohet se më 18 maj 2018, në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, i njëjti me dashje e kishte sulmuar deputetin Arben Gashi duke e shtyrë me krah dhe bërryl në gjoks.⁶³ Prokuroria, bashkë me aktakuzë, ka bërë propozimin që ndaj tyre të shqiptohet urdhër ndëshkimor, në dënim me gjobë.⁶⁴

Procesi - Me datë 14 tetor 2019 Gjykata kishte aprovuar kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe ka lëshuar aktgjykim me urdhër ndëshkimor. Mirëpo ndaj këtij vendimi më 15 nëntor 2019, mbrojtja e Halitit, kishte ushtruar kundërshtim ndaj urdhrit ndëshkimor.

Me vendimin e gjyqtarit kundërshtimi i ushtruar nga avokati mbrojtës ishte hudhur për shkak të paraqitjes jashtë afatit ligjor. Ndaj këtij vendimi mbrojtësi i Halitit, kishte ushtruar ankesë, të cilën e kishte aprovuar Kolegji i Gjykatës dhe pas këtij vendimi, lënda është në pritje për tu caktuar shqyrtimi gjyqësor.⁶⁵

⁶³ “Ekskluzive, aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi”. 16 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halitit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁶⁴ “Ekskluzive, aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi”. 16 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halitit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁶⁵ Shënim: Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Në
proces**KUJTIM GASHI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Deputet/Ish-kryesues i Kuvendit Komunal – Prizren**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur së ngritur më 17 dhjetor 2019, nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, i pandehuri Gashi akuzohet se gjatë vitit 2015 e deri në tetor të vitit 2016, në cilësinë e kryesuesit të Asamblesë Komunale në Prizren, pa procedurë të tenderimit, kishte lidhur kontratë me “TV Besa” dhe “TV Opinion” për ritransmetimin e seancave të Asamblesë Komunale në Prizren. Gjatë periudhës kohore 8 janar 2015, kishte lidhur kontratë me TV “Besa”, në vlerë prej 250 euro për çdo seancë, ndërsa pagesat për këto shërbime janë autorizuar gjatë vitit 2016 në shumën prej 1,750 euro, ndërsa me TV “Opinion” kishte lidhur kontratë në shumë prej 400 euro, ndërsa pagesat janë autorizuar gjatë vitit 2015 dhe 2016, në shumë prej 6,700 euro.⁶⁶

Procesi - Pas ngritjes së aktakuzës ndaj të pandehurit Gashi, i njëjti kishte bërë kërkesë për hudhje të aktakuzës, e cila kërkesë me vendim ishte refuzuar nga Gjykata Themelore e Prizrenit. Pas apelimit të këtij vendimi, Gjykata e Apelit kishte konfirmuar aktakuzën.

Në seancën fillestare të mbajtur më 3 janar 2020, i akuzuari Gashi është deklaruar i pafajshëm, ndërsa në shqyrtimin e dytë të mbajtur më 5 shkurt 2020, ai përsëri ka kërkuar që aktakuza ndaj tij të hudhet poshtë si e pabazuar, mirëpo aktakuza ndaj tij është konfirmuar si nga shkalla e parë e po ashtu edhe Gjykata e Apelit,

⁶⁶ Aktakuzë për korrupsion ndaj Kujtim Gashit në kohën kur ishte kryesues i Kuvendit Komunal në Prizren. Betimi për Drejtësi. 17 dhjetor 2019, (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuze-per-korrupsion-ndaj-kujtim-gashit-ne-kohen-kur-ishte-kryesues-i-kuvendit-komunal-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**NUREDIN LUSHTAKU****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Nënkyetar i Komunës së Skenderajt/ Deputet i Kuvendit të Kosovës**Veprat penale:** “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale, Nuredin Lushtaku akuzohet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Bashkë me Lushtakun, në këtë rast janë të akuzuar edhe Agim Ceku, Sadik Halitjaha, Shkumbin Demaliaj, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Procesi – Lushtaku dhe të akuzuarit tjerë në këtë rast, ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur për këtë rast më 14 mars 2019. Të njëjtit, kishin kërkuar nga gjykatësja e rastit, Nushe Kuka-Mekaj, hudhjen e aktakuzës.⁶⁷ Megjithatë, aktakuza ndaj Lushtakut dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e gjykatës në qershor të këtij viti.⁶⁸ Procesi, ndaj Çekut dhe të tjerëve është akoma duke vazhduar, ndërsa deri më tani janë caktuar tetë (8) seanca gjyqësore, ndërsa njëra (1) nga to kishte dështuar të mbahej.

⁶⁷ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-cekut-rustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁶⁸ “Konfirmohet aktakuza ndaj Rustem Berishës, Agim Cekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



MËRGIM LUSHTAKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Deputet i Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: “Lehtësim i arratisjes së personave të privuar nga liria”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – Deputeti i Kuvendit të Kosovës nga radhët e PDK-së, akuzohet nga ana e Prokurorisë Speciale për veprën penale të lehtësimit të arratisjes së personave të privuar nga liria”. Lushtaku akuzohet se në mëngjesin e 20 majit 2014 dhe orët e mbrëmjes të 22 majit 2014, në objektin e Spitalit Rajonal në Prishtinë, ka ndihmuar babain e tij, Sami Lushtakun, të arratiset dhe të shkojë në një vend të panjohur ku ai ka qëndruar i fshehur deri më 22 maj 2014.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 prill të vitit 2018, kishte refuzuar kërkesat e mbrojtjes së Lushtakut dhe të akuzuarve tjerë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, me arsyetimin se kishte vërtetuar se nuk ka parashkrim të veprës penale dhe se mbrojtja nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për t’i aprovuar ato⁶⁹, i cili vendim u konfirmua edhe nga Gjykata e Apelit, ndërsa Gjykatës Themelore në Prishtinë i ishte dashur plotë një vit kohë për të caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor për këtë rast, kur edhe e kishte caktuar seancën më 28 gusht 2019.⁷⁰ Më 14 prill 2020, Mërgim Lushtaku ishte shpallur i pafajshëm nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë⁷¹, ndërsa tash kjo lëndë po trajtohet nga Gjykata e Apelit.⁷²

⁶⁹ “Refuzohen kërkesat për hudhje të aktakuzës në rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohen-kerkesat-per-hudhje-te-aktakuzes-ne-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷⁰ “Pas më shumë se një viti që nga vërtetimi i aktakuzës, gjykata cakton seancën për rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja”. Betimi për Drejtësi. 12 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-me-shume-se-nje-viti-qe-nga-vertetimi-i-aktakuzes-gjykata-cakton-seancen-per-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷¹ “Sami Lushtakut lirohet për arratisjen nga QKUK, dënohet me 12 mijë euro për dy arratisjet e tjera”. Betimi për Drejtësi. 14 prill 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtakut-lirohet-per-arratisjen-nga-qkuk-denohet-me-12-mije-euro-per-dy-arratisjet-e-tjera/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷² Shënim: Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. “Arratisja nga QKUK”, Apeli e lë në fuqi dënimin për Sami Lushtakun kurse e kthen në rigjykim rastin për dy të akuzuar”. Betimi për Drejtësi. 6 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arratisja-nga-qkuk-apeli-e-le-ne-fuqi-denimin-per-sami-lushtakun-kurse-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-per-dy-te-akuzuar/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

3 vite
burgim


FADIL DEMA KU

Partia: PDK
Pozita shtetërore: Deputet
Veprat penale: “*Krime lufte kundër popullatës civile*”
Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë
Faza procedurale: Dënim - Tre vite burgim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Fadil Demaku ishte i akuzuar në rastin “Drenica 2”, ku aktakuza pretendonte ekzistimin e një qendre ndalimi të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) ku, sipas prokurorisë, pretendohet se pjesëtarët e UÇK-së kishin kryer krime të luftës kundër popullatës civile, mes tjerash, duke ushtruar qëllimshëm dhunë, trajtim mizor, rrahje, torturë dhe trajtim poshtërues dhe degradues ndaj civilëve shqiptarë të Kosovës të ndaluar në ambientet e ndalimit të UÇK-së në Likoc, ku të gjitha këto pretendohet se kanë ndodhur në gusht dhe shtator 1998.

Procesi – Lidhur me këtë rast, Fadil Demaku ishte shpallur fajtor dhe dënuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në maj 2015 dhe ishte dënuar me tre vjet burgim.⁷³ Ky dënim ishte vërtetuar pastaj edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. Pas vërtetimit të aktgjykimit nga Apeli, Demaku ishte dorëhequr nga pozita e deputetit.

⁷³ “Drenica 2 verdict”. Eulex-Kosova.eu. 27 maj 2015. (Shih linkun: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,229>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Refuzim

**RAMIZ KELMENDI****Partia:** PDK**Pozitat shtetërore:** Deputet; Zëvendëskryeministër**Vepra penale:** “Vjedhje të shërbimeve komunale”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Deputeti Ramiz Kelmendi, më 12 dhjetor 2012 është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë për veprën penale “vjedhje e rëndë”, për shkak të dyshimit se prej datës së pavërtetuar e deri më 30 qershor 2011, kompania “Elkos”, në Fushë Kosovë, pronë e Kelmendit ka bërë keqpërdorim të energjinë elektrike, duke i shkaktuar dëm KEK-ut në vlerë prej 22.801.19 euro.

Procesi - Ramiz Kelmendi ishte akuzuar për “vjedhje të rëndë” më 12 dhjetor 2012 por edhe kjo aktakuzë ishte mbajtur larg syve të publikut. Për ekzistencën e kësaj aktakuze u kuptua vetëm pas pak më shumë se shtatë viteve nga ngritja e aktakuzës, më 29 janar 2018, kur edhe ishte mbajtur shqyrtimi i dytë e këtij procesi.⁷⁴

Pasi Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte konfirmuar aktakuzën ndaj tij, në procedurën e ankesës lidhur me këtë vendim, kishte ndodhur që në mënyrë të pazakontë prokuroria të i bie pishman për aktakuzën ndaj Kelmendit, duke kërkuar nga Apeli që ta hedh aktakuzën me pretendimin se ka arritur parashkrimi absolut.⁷⁵

Por edhe përkundër kësaj kërkesë, Apeli nuk e kishte hedhur aktakuzën por atë e kishte kthyer në rivendosje në shkallën e parë. Shkalla e parë më 26 prill 2018, pavarësisht kërkesës së prokurorisë së Apelit kishte konfirmuar përsëri aktakuzën ndaj Kelmendit, por në seancën e 20 nëntorit 2018, prokurori Blerim Igrishta, kishte ri kualifikuar veprën penale nga “vjedhje e

⁷⁴ “Deputeti Ramiz Kelmendi mohon fajësinë për vjedhje të rrymës, kompania e tij akuzohet se dëmtoi KEK-un 22 mijë euro”. Betimi për Drejtësi. 29 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-ramiz-kelmendi-mohon-fajesine-per-vjedhje-te-rrymes-kompania-e-tij-akuzohet-se-demtoi-kek-un-22-mije-euro/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷⁵ “Prokuroria bëhet pishman, kërkon nga Gjykata e Apelit që të hudhet poshtë aktakuza ndaj Ramiz Kelmendit për vjedhje të rrymës”. Betimi për Drejtësi. 22 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-behet-pishman-kerkon-nga-gjykata-e-apelit-qe-te-hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-ramiz-kelmendit-per-vjedhje-te-rrymes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

rëndë”, në “vjedhje të shërbimeve komunale” dhe me arsyetimin se për veprën e ri kualifikuar në vitin 2017 ka arritur afati i parashkrimit, kishte hequr dorë nga ndjekja penale, i cili vendim më pas kishte ndikuar që gjykatësi Rrustem Begolli, të merr aktgjykim refuzues dhe të pushoi procedurën penale ndaj tij⁷⁶

⁷⁶ “Aktgjykim refuzues ndaj deputetit Ramiz Kelmendi, pas rikualifikimit të veprës penale është arritur parashkrimi”. Betimi për Drejtësi. 12 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-deputetit-ramiz-kelmendi-pas-rikualifikimit-te-vepres-penale-eshte-arritur-parashkrimi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces

2.
Refuzim



QEMAJL MUSTAFA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Gjilanit

Vepra penale: 1. 'Shpërdorimi i pozitës zyrtare'
2. "Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar"

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Pejë; 2. Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 1. Në proces; 2. Refuzim (Heqje dorë)

Aktakuza 1 - Më 16 shtator 2016, PSRK për shkak të dyshimeve për korrupsion, kishte akuzuar ish-kryetarin e Gjilanit Qemajl Mustafa dhe 38 persona të tjerë. Sipas PSRK-së Mustafa, zyrtarë të tjerë të komunës dhe përfaqësues të operatorëve ekonomik kanë keqpërdorë detyrën zyrtare, përkatësisht kanë ushtruar veprimtari ekonomike me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm, e të gjithë këta me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror, lidhur me aktivitetet e prokurimit të kësaj komune.

Procesi 1 - Edhe pse aktakuza në këtë rast është ngritur para më shumë se katër viteve, rasti vazhdon të mbetet ende në fazën fillestare. Më 25 korrik 2017, gjykata e shkallës së parë e kishte hudhur pjesërisht si të parregullt aktakuzën e PSRK-së.⁷⁷ Pas ankesës së PSRK-së, Gjykata e Apelit, në shtator të 2017 e kishte kthyer rastin në rivendosje.⁷⁸ Në prill të vitit 2018, gjykata e shkallës së parë sërish e kishte konfirmuar vetëm pjesërisht aktakuzën, mirëpo, në shtator të këtij viti, rasti është kthyer sërish në rivendosje nga Apeli, duke vazhduar kështu ping-pongun Themelore⁷⁹ - Apeli.⁸⁰ Në fillim të dhjetorit të vitit 2018, gjykata e Pejës, kishte

⁷⁷ "Hudhet pjesërisht aktakuza ndaj ish-Kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe 38 të akuzuarve tjerë në këtë rast". Betimi për Drejtësi. 2 gusht 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-pjeserisht-aktakuzandaj->). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷⁸ Ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa kthehet në bankën e të akuzuarve për të gjitha pikat e aktakuzës". Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-gjilanit-qemajlmustafa-kthehet-ne-banken-e-te-akuzuarve-per-te-gjitha-pikat-e-aktakuzes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁷⁹ "Konfirmohet pjesërisht aktakuza për korrupsion ndaj ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe të tjerëve". Betimi për Drejtësi. 18 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-pjeserishtaktakuza-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸⁰ "Apeli e kthen në rivendosje rastin e ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe të akuzuarve tjerë për

konfirmuar pjesërisht aktakuzën, i cili vendim ishte vërtetuar përfundimisht në shkurt të këtij viti.⁸¹ Gjykata Themelore në Pejë, është akoma duke zhvilluar shqyrtimin gjyqësor në këtë proces.

Aktakuza 2 - Mustafa, lidhur me akuza për korrupsion është akuzuar edhe me aktakuzën e 28 qershorit 2017 nga Prokuroria Themelore në Gjilan. Ai akuzohej se më 23 maj 2012, si kryetar i komunës, në emër të autoritetit kontraktues publik të ish-Kompanisë Rajonale për Mbeturina (KRM) “Higjiena”, në Gjilan, ka nënshkruar marrëveshjen e partneritetit publiko-privat, për themelimin e ndërmarrjes së përbashkët aksionare “Eco Higjiena”, me autoritetin kontraktues privat Christian Moser – “Moser Group”, përkatësisht i degës së saj “ECO Vision”, në Gjilan. Mirëpo, sipas aktakuzës, Mustafa, këtë e kishte bërë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.

Procesi 2 - Pas mbajtjes edhe të tri seancave gjyqësore për këtë rast, më 20 korrik 2018, gjykata kishte nxjerrë aktgjykim refuzues ndaj Mustafës pasi që, paraprakisht, prokurori Shaban Spahiu kishte hequr dorë nga ndjekja penale me arsyetimin se për këtë çështje është vendosur njëherë në PSRK dhe siç kishte thënë prokurori Spahiu, sipas parimit ligjor, ndaj një personi nuk mund të vendoset dy herë për të njëjtën çështje penale, për çka edhe kishte vendosur të heqë dorë nga ndjekja penale në këtë rast.⁸²

korruption”. Betimi për Drejtësi. 14 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-nerivendosje-rastin-e-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-te-akuzuarve-tjere-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸¹ “Apeli vendos që ish-kryetari i Gjilanit, Qemajl Mustafa dhe 38 të akuzuar të tjerë të gjykohen për korrupsion dhe vepra tjera”. Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-vendos-qe-ish-kryetari-i-gjilanit-qemajl-mustafa-dhe-38-te-akuzuar-te-tjere-te-gjykohen-per-korrupsion-dhe-vepra-tjera/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸² “Shpallet aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Gjilanit, Qemajl Mustafa”. Betimi për Drejtësi. 20 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-aktakuza-per-korrupsion-ndaj-ish-kryetarit-te-gjilanit-qemajl-mustafa/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



RAMADAN MUJA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Prizrenit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: Dënim - Një vit burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - PSRK-ja më 26 shkurt të vitit 2013, kishte ngritur aktakuzë ndaj ish kryetarit të Komunës së Prizrenit, Ramadan Muja, ndaj tre ish-drejtorëve komunal Sadik Paqarizi dhe Avni Ademaj si dhe ndaj dy zyrtarëve të tjerë të komunës së Prizrenit. Muja dhe të tjerët akuzohen se kanë keqpërdorur pronat komunale të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, në mesin e pronave bëjnë pjesë edhe dy parcelat ku janë ndërtuar shkolla “Mehmet Akif” dhe fabrika e çokollatës “Kamila” në Prizren, të cilat sipas akuzës nuk kanë kaluar fare përmes Kuvendit Komunal por me vendim direkt të ish-kryetarit Muja.

Procesi - Edhe pas me shumë se gjashtë vjetëve që nga ngritja e aktakuzës, ende nuk kemi një aktgjykim të plotfuqishëm në këtë rast. Ky proces i nisur nga Gjykata Themelore në Prizren kishte prodhur një aktgjykim dënues që ishte anuluar nga Gjykata e Apelit.

Më 13 mars 2014, pas rreth 30 seancave gjyqësore, GjTh në Prizren, kishte shpallur aktgjykim dënues për ish-kryetarin Muja dhe të tjerët. Muja ishte dënuar me dy vjet burgim me kusht, që do të thotë se dënimi nuk do të ekzekutohej nëse Muja nuk kryen vepër penale për periudhën tre vjeçare. Ndaj Mujës ishte shqiptuar edhe dënimi plotësues i ndalimit të ushtrimit të funksioneve në administratën publike për 30 muaj. GjTh në Prizren, kishte shpallur aktgjykim dënues edhe ndaj të akuzuarve të tjerë në këtë rast, Paqarizi, Ademaj, Tejeci, Krasniqi dhe Ukimeri, duke iu ndaluar edhe atyre funksionin në administratën publike për periudha të caktuara kohore.

Gjykata e Apelit kishte anuluar një vendim të tillë dhe e kishte kthyer rastin në rigjykim, por me ankesë të prokurorisë, rasti kishte shkuar në Gjykatën Supreme, ku më pas Supremja kishte vendosur që lëndën sërish ta shqyrtojë Apeli. Apeli sërish në korrik 2017, kishte vendosur që lënda të kthehet në shkallë të parë për rishqyrtim dhe rivendosje, por Gjykata Themelore në Prizren kishte kërkuar që të përjashtohet nga ky rast. Gjykata e Apelit, pas kërkesës së bërë nga kryetari i Gjykatës Themelore të Prizrenit, Ymer Hoxha, me 8 gusht të vitit të kaluar kishte

vendosur që rigjykimi ndaj Ramadan Mujës dhe pesë të akuzuarve të tjerë të zhvillohet nga Gjykata Themelore në Gjiilan.

Kjo gjykatë rigjykimin ndaj Mujës dhe të tjerëve kishte filluar më 14 dhjetor 2017, ndërsa e kishte përfunduar me një aktgjykim dënues ndaj Mujës me një vit burgim me kusht më 19 dhjetor 2018.⁸³ Lënda aktualisht është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit, e cila më 7 nëntor 2019, kishte mbajtur seancën e kolegjit, por kjo gjykatë akoma nuk ka vendosur lidhur me këtë rast.⁸⁴

⁸³ “Ish-kryetari i Prizrenit, Ramadan Muja dhe të tjerët dënohen me kusht pasi shpallen fajtorë për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-prizrenit-ramadan-muja-dhe-te-tjeret-denohen-me-kusht-pasi-shpallen-fajto-re-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸⁴ Shënim: Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. “Apeli ia vërteton dënimin për korrupsion ish-kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja”. Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-verteton-denimin-per-korrupsion-ish-kryetarit-te-prizrenit-ramadan-muja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

3 vite
burgim dhe
1500 euro
gjobë



XHABIR ZHARKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Kaçanikut

Vepra penale: “Detyrim”, “Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata e Qarkut në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim – Tre vite burg dhe 1500 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Zharku akuzohej nga prokuroria e Eulex-it lidhur me dyshimet se ai në vitin 2006, kur ishte privatizuar nga ish-AKM-ja një fermë e deleve në fshatin Rakaj, të Ferizajt. Sipas Prokurorisë, të dëmtuarit në këtë rast, Xhelil dhe Emrush Suma, kishin qenë fitues të tenderit si ofertues të parë. Mirëpo pas kërcënimeve nga të akuzuarit në fjalë, fituesit ishin detyruar të tërhiqeshin për ta fituar atë Arsim Kolshi, i cili kishte qenë ofertuesi i dytë.

Procesi - Pas shqyrtimit gjyqësor, më 21 prill 2011, Gjykata e Qarkut në Prishtinë e kishte shpallur Xhabir Zharkun fajtor për kryerjen e veprave penale “Detyrimi” dhe “Mbajtja në pronësi, në kontrollë, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve”. Në bazë të këtij aktgjykimi, Zharku ishte dënuar me tre vjet burgim dhe 1,500 euro gjobë.⁸⁵ Këtë vendim më pas më 8 maj 2012 e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme. Zharku ishte akuzuar edhe për veprën penale të “kanosjes”, por për këtë vepër ishte liruar.

Pasi vendimi ndaj Zharkut ishte bërë i formës së prerë, ai kishte zgjedhur që të ikë nga Kosova në mënyrë që t’i shmanget vuajtjes së dënimit të shqiptuar. Në muajin maj të vitit 2018, Gjykata Themelore në Ferizaj, dega në Kaçanik, kishte marrë vendim për të ndaluar ekzekutimin e dënimit pasi ky ekzekutim i dënimit kishte arritur afatin e parashkrimit. Në këtë situatë, Zharku më 7 qershor të vitit 2018, kishte hyrë përsëri në Kosovë, por jo në çeli të burgut.⁸⁶

⁸⁵ “Xhabir Zharku dënohet me 3 vjet burg”. Albeu. 21 prill 2011. (Shih linkun: <http://www.albeu.com/kosove/xhabir-zharku-denohet-me-3-vjet-burg/34931/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸⁶ “Xhabir Zharku kthehet në Kosovë” -Koha.net. 7 qershor 2018 (shih linkun <https://www.koha.net/arberi/97958/xhabir-zharku-kthehet-ne-kosove/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

2 vite
burgim**BAJRUSH XHEMAJLI****Partia:** Nënkyetar i PDK-së**Pozita shtetërore:** Kryetar i Komunës së Ferizajt**Vepra penale:** “Rrezikim i trafikut publik”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Dënim – Dy vite burgim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Lidhur me aksidentin e shkaktuar më 21 maj 2009, në rrugën Prishtinë-Ferizaj në të cilin aksident kishte mbetur i vdekur një 21 vjeçar, Prokuroria e Qarkut, më 24 nëntor 2009, ndaj tij kishte ngritur aktakuzë, duke e ngarkuar atë me veprën penale të “rrezikimit të trafikut publik”.

Procesi - Gjykata e Qarkut në Prishtinë më 26 nëntor 2010, kishte shpallur fajtor Xhemajlin dhe atë e kishte dënuar me dy vite e gjysmë burgim, të cilin vendim e kishte vërtetuar edhe nga Gjykata Supreme më 8 mars 2012. Pasi vendimi ishte bërë i formës së prerë, Xhemajli dy herë kishte arritur të shtyjë afatin për ekzekutimin e dënimit, përkatësisht më 17 prill 2012 dhe 18 korrik 2012.

Xhemajli rastin e kishte dërguar edhe në Gjykatën Kushtetuese nga e cila kishte kërkuar që të konstatohet nëse atij i ishin shkelur të drejtat e tij në procedurën gjyqësore, e cila edhe ishte vërtetuar pasi sipas Kushtetueses gjykatat e rregullta nuk kishin aprovuar një kundër ekspertizë si propozim i mbrojtjes që ka ndikuar që të këtë parim të kontradiktoritetit dhe shkelje të së drejtës për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm dhe të drejtën për proces të rregullt.⁸⁷ Kjo gjykatë e kishte kthyer në rivendosje rastin ndaj Xhemajlit, pas të cilit Xhemajli e kishte pranuar fajësinë dhe ishte dënuar me dy vite burgim të cilat edhe i kishte mbajtur.⁸⁸

⁸⁷ “Vendimi i Gjykatës Kushtetuese- Rasti Nr. 78/2012”. 22 qershor 2012. (shih linkun http://gjk-ks.org/wp-content/uploads/vendimet/gjkk_ki_78_12_v_shq.pdf). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁸⁸ “Bajrush Xhemajli dorëzohet në burg”. Zeri.info. 17 nëntor 2014. (Shih linkun <https://zeri.info/aktuale/7236/bajrush-xhemajli-dorezohet-ne-burg/>)

1. 1700 euro	2. 12.000 euro	3. Lirim	4. Lirim
 SAMI LUSHTAKU Partia: PDK Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Skenderajt Veprat penale: : 1. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” ; 2. “Arratisje e personit të privuar nga liria”, “Pengim të dëshmisë apo procedurës zyrtare si dhe frikësim gjatë procedurës zyrtare”, “për pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal”; 3. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 4. Krime lufte kundër popullatës civile Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë 2. Gjykata Themelore në Prishtinë; 3. Gjykata Themelore në Prishtinë; 4. Gjykata Themelore në Prishtinë Faza procedurale: 1. 1700 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë); 2. 12 mijë euro gjobë (Aktgjykim i shkallës së parë); 3. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë). 4. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)			

Aktakuza 1 - Prokuroria e ngarkon Sami Lushtakun me veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, par. 1 i KPRK – së. Kjo sepse sipas prokurorisë, më 30 nëntor 2017 në fshatin Banjë të Malishevës, në një aheng familjar, pa autorizim ka mbajtur armë e municione në kundërshtim me Ligjin për armë të Republikës së Kosovës dhe e cila armë me ligj kategorizohet si armë zjarri e ndaluar.

Sipas aktakuzës, i akuzuari Lushtaku, gjatë ahengut familjar, e hap dritaren e odës dhe me armë me gaz, të pranuar nga i akuzuari Behar Amerllahu shtien në ajër disa herë. Kjo armë dhe karikatori janë sekuestruar dhe gjenden në Stacionin Policor në Malishevë.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 1 mars 2019, e kishte shpallur fajtor Sami Lushtakun dhe të njëjtin e kishte dënuar me 1700 euro gjobë. Në seancën

fillestare të mbajtur më 27 shkurt 2019, Lushtaku e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej.⁸⁹

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në Gjykatën e Apelit kishte ushtruar prokuroria e cila kishte kërkuar rritjen e dënimit ndaj Lushtakut, mirëpo, ankesën e prokurorisë e kishte refuzuar shkalla e dytë, duke ia vërtetuar dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë, të akuzuarit Shala.⁹⁰

Aktakuza 2 - Ish-kryetari i Skenderajt, Sami Lushtaku, akuzohet për disa vepra penale “arratisje e personit të privuar nga liria”, “pengim të dëshmisë apo procedurës zyrtare si dhe frikësim gjatë procedurës zyrtare” si dhe “për pjesëmarrje në grup të organizuar kriminal”. Rasti ka të bëjë me pretendimet e prokurorisë se ish-kryetari i Skenderajt, ishte arratisur nga QKUK-ja në maj të vitit 2014, derisa Lushtaku po merrte trajtim shëndetësor, në kohën kur ai ndodhej në paraburgim në rastin “Drenica, e po ashtu pretendohet si ai ishte arratisur edhe nga Burgu i Dubravës më 21 gusht dhe 22 shtator 2015.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 prill të vitit 2018, kishte refuzuar kërkesat e mbrojtjes së Lushtakut dhe të akuzuarve tjerë për hudhjen e aktakuzës dhe kundërshtimin e provave, me arsyetimin se kishte vërtetuar se nuk ka parashkrim të veprës penale dhe se mbrojtja nuk ka paraqitur prova të mjaftueshme për t’i aprovuar ato.⁹¹ Gjykata e Apelit, në korrik 2018, kishte refuzuar si të pabazuara ankesat e mbrojtjes për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave dhe kishte lënë në fuqi aktvendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë.⁹² Pas konfirmimit të aktakuzës nga dy shkallët e gjyqësorit, Gjykatës Themelore në Prishtinë i ishte dashur plotë një vit kohë për të caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor për këtë rast, kur edhe e kishte caktuar seancën më 28 gusht 2019.⁹³

Ndërsa pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 14 prill 2020, e kishte liruar Lushtakun nga akuza për arratisje nga QKUK-ja, ndërsa ishte dënuar me 12 mijë euro për dy arratisjet nga Burgu i Dubravës⁹⁴.

⁸⁹ Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku e të tjerët dënohen me gjobë për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dardan-gashi-endrit-shala-sami-lushtaku-e-te-tjeret-denohen-me-gjobe-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹⁰ “Apeli vërteton dënimet me gjobë ndaj Dardan Gashit, Endrit Shalës, Sami Lushtakut e të tjerëve për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 30 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-me-gjobe-ndaj-dardan-gashit-endrit-shales-sami-lushtakut-e-te-tjereve-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹¹ “Refuzohen kërkesat për hudhje të aktakuzës në rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohen-kerkesat-per-hudhje-te-aktakuzes-ne-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹² “Apeli vërteton aktakuzën në rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja”. Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktakuzen-ne-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹³ “Pas më shumë se një viti që nga vërtetimi i aktakuzës, gjykata cakton seancën për rastin e arratisjes së Sami Lushtakut nga QKUK-ja”. Betimi për Drejtësi. 12 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-me-shume-se-nje-viti-qe-nga-vertetimi-i-aktakuzes-gjykata-cakton-seancen-per-rastin-e-arratisjes-se-sami-lushtakut-nga-qkuk-ja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹⁴ “Arsyetimi i gjykatës për lirimin e Sami Lushtakut për arratisjen nga QKUK dhe për dënimin e tij me 12 mijë euro për dy arratisjet e tjera” Betimi për Drejtësi. 27 maj 2020 (Shih linkun:

Aktakuza 3 – Sami Lushtaku bashkë me gjashtë të akuzuar tjerë akuzoheshin për ndërhyrje në një kontratë të lidhur mes kompanisë “Security Code” dhe KEK-ut për sigurimin e objekteve të kësaj të fundit. Në këtë proces gjyqësor të njohur si “KEK 2”, Sami Lushtaku ngarkohej me veprën penale “shtytje për keqpërdorim të pozitës zyrtare ose të autorizimit”. Prokuroria pretendonte se sjellja e paligjshme e Lushtakut dhe të akuzuarve tjerë, kishte rezultuar me dhënien e kontratës kompanisë së sigurimit “Security Code”, e cila ka ofertuar si pjesë e konsorciumit me kompaninë “EDG”. Kontrata në fjalë ishte për periudhën dy vjeçare, në shumë prej 6, 182, 609.76 euro, shumë kjo për të cilën pretendohet se është dëmtuar KEK-u.

Procesi 3 - Ish-Kryetari i Komunës së Skenderaj-it, Sami Lushtaku, më 20 maj 2019, pas më shumë se katër vjetësh gjykim, në mungesë të provave ishte liruar nga akuzat për korrupsion në rastin “KEK 2”.⁹⁵ Këtu edhe pse me aktakuzë ishte pretenduar se i është shkaktuar dëm buxhetit të shtetit mbi 6 milion Euro, nuk ka pasur kërkesë nga ana e Prokurorit të Shtetit që të konfiskohet pasuria e fituar me vepra penale. Ky rast fillimisht është trajtuar nga gjykatës të misionit të EULEX-it, por vendimi i shkallës së parë me të cilin u liruan të gjithë të akuzuarit u shqiptua pas më shumë se katër viteve gjykim nga gjykatës vendor. Për këtë rast, akoma nuk ka vendosur gjykata e Apelit.⁹⁶

Aktakuza 4 – Sami Lushtaku akuzohej për krime lufte në rastin “Drenica 1”, pasi që sipas aktakuzës së PSRK-së, duke vepruar në mënyrë brutale, qëllimisht ia kishte marrur jetën një mashkulli shqipfolës, të paidenfitikuar rreth 40 vjet, duke ia vënë pistoletën në kokë përderisa viktimi i kishte pasur dy duart e lidhura dhe pastaj duke e qëlluar atë.

Procesi 4 – Lidhur me këtë rast, Gjykata Themelore në Mitrovicë e kishte dënuar Sami Lushtakun me 12 vite burgim për vrasje gjatë kohës së luftës, ndërsa, Gjykata e Apelit e kishte ndryshuar këtë aktgjykim duke e dënuar Lushtakun me shtatë vjet burgim. Në korrik 2017, Gjykata Supreme e kishte liruar Lushtakun nga të gjitha akuzat.⁹⁷

<https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-gjykates-per-lirimin-e-sami-lushtakut-per-arratisjen-nga-qkuk-dhe-per-denimin-e-tij-me-12-mije-euro-per-dy-arratisjet-e-tjera/>. (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹⁵ “Sami Lushtaku dhe të tjerët lirohen nga akuzat në rastin e njohur “KEK 2”. Betimi për Drejtësi. 20 maj 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sami-lushtaku-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuzat-ne-rastin-e-njohur-kek-2/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹⁶ Shënim: Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. “Arratisja nga QKUK”, Apeli e lë në fuqi dënimin për Sami Lushtakun kurse e kthen në rigjykim rastin për dy të akuzuar”. Betimi për Drejtësi. 6 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/arratisja-nga-qkuk-apeli-e-le-ne-fuqi-denimin-per-sami-lushtakun-kurse-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-per-dy-te-akuzuar/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

⁹⁷ “Supremja e liron Sami Lushtakun nga të gjitha akuzat”. Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-e-liron-sami-lushtakun-nga-gjitha-akuzat/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Lirim

2. Lirim

3. Lirim

4. 3 vite burgim



NEXHAT DEMAKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Drenasit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 3. Keqpërdorim i pozitës apo autoriteti zyrtar”; 4. Krime lufte kundër popullatës civile

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë); 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 4. Tre vjet burgim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së ngritur më 27 shtator 2018, Nexhat Demaku akuzohet se duke shfrytëzuar detyrën zyrtare si kryetar i Komunës së Drenasit, i kishte tejkaluar kompetencat e tij me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër duke ia ka lëshuar akt emërimit punëtore MIMOZA Berisha në pozitën inspektore e tregut në Drejtorinë e Inspeksionit, në Komunën e Drenasit me kohëzgjatje prej 5 Mars 2015 deri më 5 mars 2016, si dhe me 20 janar 2016, në kohëzgjatje prej 5 mars 2015 deri më 5 qershor 2018, pa pasur konkurs publik të shpallur.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Prishtinë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më 28 janar 2020 kishte të shpallur të pafajshëm Demakun, me arsyetimin se nuk ishte provuar se kishte kryer veprën penale për të cilën akuzohej.^{98 99}

Aktakuza 2 – Demaku akuzohej nga prokuroria se në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Drenasit, nuk ka përmbushur detyrën zyrtare, në atë mënyrë që kishte refuzuar ta zbatojë një

⁹⁸ “Ish-kryetari i Drenasit dhe ish-drejtori i Arsimit lirohen nga akuza për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 28 janar 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-drenasit-dhe-ish-drejtori-i-arsimit-lirohen-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁹⁹ Shënim: Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. “Gjykimi për korrupsion, Apeli vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të Drenasit dhe ish-drejtorit të Arsimit në këtë komunë”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-korrupsion-apeli-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-drenasit-dhe-ish-drejtorit-te-arsimit-ne-kete-komune/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

aktvendim të Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me të cilin ishte obliguar Komuna e Drenasit që të bëjë regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluejtshme, duke ju shkaktuar dëm Jupë Hasit dhe Rexhep Hasit, duke siguruar kështu përfitim të kundërligjshëm për Komunën e Drenasit në vlerë prej 200 mijë euro.

Procesi 2 – Lidhur me këtë akuzë, Demaku ishte shpallur fajtor nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe ishte dënuar me një vit e gjashtë muaj burgim. Mirëpo, pas ankesave të ushtruara në Gjykatën e Apelit, kjo e fundit e kishte ndryshuar aktgjykimin e Themelores duke e liruar nga akuzat, Nexhat Demakun.

Aktakuza 3 - Prokuroria Themelore në Prishtinë kishte aktakuzë, në qershor 2016 sipas së cilës, Nexhat Demaku akuzohet se në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Drenasit ka tejkaluar kompetencat e tij, meqë si qiradhënës më 2009 ka lidhur qira me Fadil Shishanin, me qëllim që ky të përfitojë të drejtën e shfrytëzimit të banesës së Zejnepe Buzhalës e në këtë mënyrë Demaku ka ushtruar përgjegjësi përtej Ligjit për Qeverisje Lokale duke penguar të dëmtuarën Buzhala në gëzimin e të drejtës së saj banesore për shfrytëzim të përkohshëm të banesës të dhënë me një vendim të mëparshëm nga Qendra për edukim dhe arsim parashkollor “Ardhmëria”.


Procesi 3 - Gjykata Themelore në Prishtinë, me 28 qershor 2016 kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj Kryetarit të Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku me arsyetimin se nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprat penale të cekura në dispozitivin e aktakuzës.¹⁰⁰

Aktakuza 4 – Nexhat Demaku ishte i akuzuar për krime lufte kundër popullatës civile në rastin e njohur në publik si “Drenica 2”. Demaku akuzohej për vepra penale të krimeve të luftës kundër popullatës civile, përfshirë tortura, keqtrajtim të të burgosurve dhe vrasje, të cilat supozohen të jenë kryer në një qendër paraburgimi të UÇK-së në fshatin Likoc në vitin 1998.

Procesi 4 – Lidhur me këtë rast, Demaku ishte shpallur fajtor dhe dënuar nga Gjykata Themelore në Mitrovicë, në maj 2015 dhe ishte dënuar me tre vjet burgim.¹⁰¹ Ky dënim ishte vërtetuar pastaj edhe nga Gjykata e Apelit dhe ajo Supreme. Pas vërtetimit të aktgjykimit nga Apeli, Demaku ishte dorëhequr nga pozita e Kryetarit të Komunës së Drenasit.

¹⁰⁰ “Shpallet i pafajshëm Kryetari i Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-kryetari-i-komunes-se-drenasit-nexhat-demaku/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁰¹ “Drenica 2 verdict” Eulex-Kosova.eu. 27 maj 2015 (Shih linkun: <https://www.eulex-kosovo.eu/?page=2,10,229>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Refuzim2.
Lirim

SALIM JENUZI

Partia: PDK**Pozita shtetërore:** Kryetari i Komunës së Dragashit**Veprat penale:** 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** 1. Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Aktgjykim lirues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Salim Jenuzi akuzohej nga Prokuroria Themelore në Prizren, se duke qenë kryetar i Komunës së Dragashit, në periudhën 2009-2016, i ka mundësuar Nexhat Selajt, përvetësimin e pronës komunale, të cilën ky e kishte uzurpuar paraprakisht.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Prizren, më 21 janar 2017 e kishte dënuar ish-kryetarin Jenuzi me një vjet burgim, i cili nuk do të ekzekutohej nëse brenda dy viteve ai nuk kryen veprë të re penale.¹⁰²

Mirëpo, me 25 janar 2018, Gjykata e Apelit kishte vendosur që rasti të kthehet në rigjykim sa i përket Salim Jenuzi dhe një të akuzuari tjetër për shkak të shkeljeve të evidentuara në aktgjykimin e shkallës së parë.¹⁰³

Pas rigjykimit, Prokuroria Themelore në Prizren ishte tërhequr nga akuza ndaj Selimi për shkak se ishte arritur parashkrimi absolut i veprës penale për të cilën akuzohej Jenuzi, për çka edhe gjykata e shkallës së parë kishte nxjerr aktgjykim refuzues ndaj tij, më 9 tetor 2018.¹⁰⁴

Aktakuza 2 - Salim Jenuzi, akuzohej nga prokuroria se në cilësi të kryetarit të Komunës në Dragash, kishte urdhëruar drejtorin e Urbanizmit që të bartë pronën shoqërore, patundshmërinë

¹⁰² “Dënohet me kusht Kryetari i Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-kryetari-i-komunes-se-dragashit-salim-jenuzi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁰³ “Kthehet në rigjykim rasti kundër ish-kryetarit të Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-kunder-ish-kryetarit-te-komunes-se-dragashit-salim-jenuzi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁰⁴ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Dragashit, shpallet i pafajshëm i akuzuari për uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-dragashit-shpallet-i-pafajshem-i-akuzuari-per-uzurpim-prone/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

në sipërfaqe prej 29,7 hektarësh prej pronarit të ndërmarrjes shoqërore “Sharr Prodhim” në pronë të KK të Dragashit. Pastaj këtë patundshmëri, i akuzuari Jenuzi ua dha në shfrytëzim pa ndonjë bazë juridike, personave fizikë – blegtorëve.¹⁰⁵

Procesi 2 – Në janar 2015, Salim Jenuzi, në mungesë të provave ishte liruar nga akuzat nga Gjykata Themelore në Prizren., i cili vendim është bërë i formës së prerë.

¹⁰⁵ “Shpallet i pafajshëm Salim Jenuzi”. Gazetaexpress.com. 22 janar 2015. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/lajme-shpallet-i-pafajshem-salim-jenuzi-75261/?fbclid=IëAR2cëK1toqOX-MqRX3FeyXtGqyKbnQahJKH55tR-hTSpFHkeM1ëfoXY6sMs>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



SOKOL BASHOTA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Klinës

Veprat penale: 1. “Mos deklarim apo deklarim të rremë të pasurisë”; “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”; “Mashttrim në detyrë”; 2. “Ushtrim arbitrar i të drejtave”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Pejë; 2. Gjykata Themelore në Pejë, dega në Klinë

Faza procedurale: 1. Në proces për mos deklarim të pasurisë, Refuzim për keqpërdorim të pozitës zyrtare; Hudhje e aktakuzës për mashttrim në detyrë (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Hudhje (Aktgjykim i shkallës së parë)

1.
Në
proces

2.
Hudhje

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), e ngritur më 4 gusht 2016, Sokol Bashota, Enver Berisha, Esat Rraci dhe Fadil Gashi, akuzohen se kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas pretendimit të prokurorisë, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, të akuzuarit kanë bërë marrëveshje politike (Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiakë me banesa.

Bashota akuzohej edhe për veprën penale të mashtimit në detyrë, ashtu që sipas prokurorisë, i akuzuari kishte deklaruar rrejshëm se po jetonte me bashkëshorten dhe tre djemtë e tij në një vendbanim “ku mungonte hapësira dhe që nuk i plotësonte kushtet për jetesë”, ndërsa nuk kishte deklaruar disa prona të tjera që ishin në emër të tij dhe familjarëve të tij, në Prishtinë dhe Klinë.

Prokuroria, gjithashtu e ngarkon kryetarin e Klinës, Sokol Bashota, dhe Enver Berishën, edhe me veprën penale “mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”. Prokuroria i akuzon të pandehurit se në periudhën janar 2009 deri në qershor 2016, nuk kanë përfshirë të dhënat ose informacionet, kur kanë paraqitur deklaratimet e tyre pasurore në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Procesi 1 – Gjykata Themelore në Pejë, e kishte hudhur poshtë aktakuzën për mashtrim në detyrë ndaj Bashotës, ndërsa kishte shpallur aktgjykim refuzues për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi që prokurorja e rastit, Sahide Gashi kishte hequr dorë nga ndjekja penale.

Ndërsa me aktgjykimin e marrë më 29 maj 2019, Bashota ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë pasi që ishte shpallur fajtor për veprën penale “mos raportimi apo deklaram i rremë i pasurisë”¹⁰⁶ mirëpo këtë aktgjykim dënues e kishte kthyer më pas në rigjykim Gjykata e Apelit

Padi Private – Në tetor 2010, Koorporata Energjetike e Kosovës, distrikti Pejë, kishte ngritur një padi private ndaj Sokol Bashotës, për shkak të veprës penale, “ushtrim arbitrar i të drejtave” pasi pretendonte se i njëjti, pasi ishte ckyqur nga rrjeti elektrik, në mënyrë arbitrare, pa e paguar borxhin paraprak ishte kyçur sërish në rrjetin elektrik.

Procesi – Më 23 janar 2013, Gjykata Themelore në Pejë, dega në Klinë, kishte hudhur poshtë padinë private dhe kishte pushuar procedurën penale ndaj Bashotës, me arsyetimin se ishte arritur afati i parashkrimit të veprës penale.

¹⁰⁶ “Sokol Bashota dënohet me burgim me kusht për mos deklaram të pasurisë, aktgjykim refuzues për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-bashota-denohet-me-burgim-me-kusht-per-mos-deklaram-te-pasurise-aktgjykim-refuzues-per-keqperdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces

2. Në
proces

3. 4
muaj burg
me kusht dhe
2000 euro



SHUKRI BUJA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Lipjanit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 3. “Mos raportim apo raportim i rremë i pasurisë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces; 2. Në proces; 3. Dënim – 4 muaj burg me kusht dhe 200 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale, Shukri Buja akuzohet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Bashkë me Bujën, në këtë rast janë të akuzuar edhe Agim Ceku, Sadik Halitjaha, Nuredin Lushtaku, Qelë Gashi, Shkumbin Demaliaj, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Procesi 1 – Buja dhe të akuzuarit tjerë në këtë rast, ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur për këtë rast më 14 mars 2019. Të njëjtut, kishin kërkuar nga gjykatësja e rastit, Nushe Kuka-Mekaj, hudhjen e aktakuzës.¹⁰⁷ Megjithatë, aktakuza ndaj Bujës dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e gjykatës në qershor të këtij viti.¹⁰⁸

¹⁰⁷ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-cekut-rustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>)

¹⁰⁸ “Konfirmohet aktakuza ndaj Rustem Berishës, Agim Cekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Aktakuzën ndaj Bujës dhe të tjerëve, në gusht 2019, e ka konfirmuar edhe Gjykata e Apelit, ndërsa ky proces është akoma duke vazdhur.¹⁰⁹

Aktakuza 2 - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ngarkon ish-kryetarin e Lipjanit, Shukri Buja, se së bashku me disa zyrtarë të tjerë të kësaj komune, në kundërshtim me dispozitat ligjore, kanë ndërmarrë veprime për shpronësimin, eksproprijimin dhe më pas kanë tjetërsuar pronat shoqërore dhe komunale, në dobi të “Neë Co Ferronikel Complex L.LC”.¹¹⁰

Sipas aktakuzës së ngritur më 13 shkurt 2017, i pandehuri Shukri Buja, në kundërshtim me Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme ka caktuar komisionin për vlerësimin e paluajtshmërive, edhe pse ky vlerësim është në kompetencë të nivelit qendror. Lidhur me punën e këtij komisioni, i pandehuri Buja sipas aktakuzës iu ka drejtuar “Neë Co Ferronikel Complex L.LC”, nga i cili ka kërkuar pagesën për punën e komisionit në shumës prej 21.500 euro, dhe atë në llogarinë e cila ka rezultuar të jetë e të pandehurit, Nebih Zeqiri.

Tutje, Buja pretendohet se duke tejkaluar kompetencat zyrtare, në emër të Komunës së Lipjanit ka nënshkruar memorandum mirëkuptimi me “Neë Co Ferronikel Complex L.LC”. Në bazë të këtij memorandum siç thuhet në aktakuzë, Buja i ka dhënë me qira “Neë Co Ferronikel Complex L.LC” një objekt komunal në afat prej 10 vjet, me çmimin prej 1 euro, me të cilat veprime i ka shkaktuar dëm Komunës së Lipjanit.

Në një rast tjetër, Prokuroria pretendon se i pandehuri Shukri Buja, duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar, në kundërshtim me ligjin kanë nënshkruar marrëveshje për kompensimin e paligjshmërisë së eksproprijuar me “Neë Co Ferronikel Complex L.LC”, për parcelën me 0.94,75 ari. Me kërkesë të të pandehurve, mjetet nga kjo marrëveshje, në shumën prej 39.795 euro, janë paguar në llogarinë rrjedhëse të klubit futbollistik “Ulpiana”. Sipas prokurorisë, e njëjta procedurë dhe e njëjta mënyrë e eksproprijimit dhe shpronësimit të ngastrave tjera, është përdorur edhe në raste tjera, e të cilat mjete janë transferuar në llogarinë bankare të klubit futbollistik “Ulpiana”.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 nëntor 2019, e kishte shpallur fajtorë, për veprën penale, keqpërdorim i detyrës zyrtare në vazhdimësi dhe në bashkëkryerje, duke i shqiptuar një dënim në kohëzgjatje prej 3 vitesh burg efektiv.¹¹¹ Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në qershor 2019, e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim, me arsyetimin se shkalla e parë kishte ardhur në disa përfundime të ndryshme për të njëjtën gjendjen faktike si dhe nuk ishte vërtetuar dëmi apo

¹⁰⁹ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rrustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-ceku-rrustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹¹¹ “Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja dënohet me tre vjet burgim për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-lipjanit-shukri-buja-denohet-me-tre-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

përfitimi i të akuzuarve.¹¹² Ndryshe, ky rast kishte qenë i shënjestruar, si kusht për liberalizimin e vizave.¹¹³

Aktakuza 3 – Në një rast tjetër, Shukri Buja akuzohej nga prokuroria se në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Lipjanit, nuk e ka raportuar pasurinë brenda afatit ligjor, pasi e ka përfunduar mandatin e tij në këtë post, edhe pse ka qenë i obliguar ta bëjë këtë.

Procesi 3 – Më 30 dhjetor 2015, Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte shpallur fajtor dhe e kishte dënuar me katër muaj burgim me kusht dhe 2000 euro gjobë, Shukri Bujën. Ky dënim ndaj Bujës ishte konfirmuar gjatë vitit 2016 edhe nga Gjykata e Apelit.

¹¹²“Apeli e kthen në rigjykim rastin e Shukri Bujës, i dënuar me tre vjet burg për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-shukri-bujes-i-denuar-me-tre-vjet-burg-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹¹³ Shënim: Pas procesit së rigjykimit, Bujës përseri është dënuar nga gjykata e shkallës së parë. “Shukri Bujës i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet-denimi-denohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020).

8 muaj
burgim
me kusht**NEXHMEDIN ARIFI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Ish-kryetar i Komunës – Viti**Veprat penale:** “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjiilan**Faza procedurale:** Dënim – 8 muaj burgim me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - I pandehuri Nexhmedin Arifi akuzohej se duke qenë në pozitën e kryetarit të Vitisë më 22 gusht 2008, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veti apo tjetrin në kundërshtim me Ligjin mbi ndërmarrjet publike, ka marrë vendimin mbi ekzekutimin e vendimit të Kuvendit komunal për derajonalizimin e KRM “Higjiena”, njësia punuese në Viti e cila ishte pjesë integrale e “Higjienës” në Gjiilan.

Arifi gjithashtu akuzohej se nuk e kishte respektuar shkresën e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal e as vendimin e Qeverisë së Kosovës që të shfuqizojë atë vendim. Sipas aktakuzës, Arifi kishte dëmtuar buxhetin e Kosovës në vlerë prej 79 mijë eurove.

Procesi: Gjykata Themelore e Gjiilanit kishte shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Arifi, duke i shqiptuar burgim me kusht në kohëzgjatje prej 18 muajsh, i cili aktgjykim ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 20 janar 2015.¹¹⁴

¹¹⁴ Shënim: Përgjigje nga zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, 3 shtator 2019.



ESAT RRACI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Zëvendësministër në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal; Drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Klinës

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”; “Mashttrim në detyrë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Aktgjykim refuzues për keqpërdorim të pozitës zyrtare; Hudhje e aktakuzës për mashttrim në detyrë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Në rastin e dyshimeve për keqpërdorime me dhënjen e banesave me qera, bashkë me ish-kryetarin e Klinës Sokol Bashota, akuzohej edhe Esat Rraci, sipas pretendimit të prokurorisë, Rraci dhe tre të akuzuar të tjerë, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, kanë bërë marrëveshje politike (Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiakë me banesa.

Sipas prokurorisë, dy të pandehurit Esat Rraci dhe Fadil Gashi, duke shfrytëzuar dispozitat e Ligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore, kishin paraqitur kërkesa me shkrim për blerjen e banesave, të cilat u ishin ndarë atyre. Por, si rezultat i hetimeve, procesi i blerjes ishte pezulluar. Rraci akuzohej edhe për veprën penale të mashtimit në detyrë, pasi sipas prokurorisë, i njëjti e kishte mashtuar Komisionin për Banesa me Qira, këshilltarët e Kuvendit Komunal Klinë dhe personat tjerë të autorizuar, duke i nxitur ata që të vinin në përfundim të gabuar se Rraci i plotësonte kushtet për ndarjen e një banese që ishte pronë e Komunës së Klinës, me arsyetimin se nuk kishte pronë apo shtëpi në Kosovë dhe nuk e kishte të zgjidhur çështjen e banimit.

Procesi – Gjykata Themelore në Pejë, më 29 maj 2019, kishte nxjerr aktgjykim refuzues për Racin, për sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, pasi që, prokurorja e rastit, Sahide Gashi, ishte tërhequr nga akuzat ndaj tij, ndërsa për sa i përket veprës penale të mashtimit në detyrë, e njëjtë akuzë ishte hudhur poshtë nga ana e gjykatësit Sylë Lokaj.¹¹⁵

¹¹⁵ “Sokol Bashota dënohet me burgim me kusht për mos deklarim të pasurisë, aktgjykim refuzues për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-bashota-denohet-me-burgim-me-kusht-per-mos-deklarim-te-pasurise-aktgjykim-refuzues-per-keqperdorim-detyre/>) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



ENVER BERISHA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Nënkyetar i Komunës së Klinës/
Këshilltar i Komunës së Klinës

Veprat penale: “Mos deklarim apo deklarim të rremë të pasurisë”; “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”; “Mashttrim në detyrë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Në proces për “mos raportim të pasurisë”; Refuzim për keqpërdorim të pozitës zyrtare; Hudhje e aktakuzës për mashttrim në detyrë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), e ngritur më 4 gusht 2016, Enver Berisha, bashkë me Sokol Bashotën, Esat Racin dhe Fadil Gashin, akuzohen se kanë kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas pretendimit të prokurorisë, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, të akuzuarit kanë bërë marrëveshje politike (Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiakë me banesa. Prokuroria, gjithashtu e ngarkon Enver Berishën, edhe me veprën penale “mos-raportim ose raportim i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”. Prokuroria e akuzon të pandehurin se në periudhën janar 2009 deri në qershor 2016, nuk kanë përfshirë të dhënat ose informacionet, kur kanë paraqitur deklaratimet e tyre pasurore në Agjencinë Kundër Korrupsionit.

Berisha akuzohej edhe për veprën penale të mashtimit në detyrë, për shkak se sic pretendonte prokuroria, i njëjti kishte deklaruar se jeton me bashkëshorten dhe fëmijët e tij në një shtëpi të vëllezërve të tij, ndërsa nuk kishte deklaruar se e ka në pronësi një shtëpi tjetër prej 180 m2 dhe se kishte trashëguar tokë në hapësirë prej 10 hektarëve, duke i mashtuar kështu personat e autorizuar dhe duke i nxitur ata që të përfundonin gabimisht se Berisha I ka plotësuar kushtet për ndarjen e banesave në shfrytëzim me qira.

Procesi – Gjykata Themelore në Pejë, e kishte hudhur poshtë aktakuzën për mashtrim në detyrë ndaj Berishës, ndërsa kishte shpallur aktgjykim refuzues për veprën penale të keqpërdorimit të detyrës zyrtare, pasi që prokurorja e rastit, Sahide Gashi kishte hequr dorë nga ndjekja penale.

Me aktgjykimin e marrë më 29 maj 2019, Berisha ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë pasi që ishte shpallur fajtor për veprën penale “mos raportimi apo deklaram i rremë i pasurisë”. Dënimi me burgim ndaj tij nuk do të ekzekutohet, nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti, kurse dënimin me gjobë, detyrohet ta paguajë brenda 15 ditësh.¹¹⁶

Mirëpo. Gjykata e Apelit në tetorin e vitit 2019, kishte njoftuar se Berisha dhe Bashota do të duhet që përsëri nga gjykata e shkallës së parë për mos raportim të pasurisë.

¹¹⁶ “Sokol Bashota dënohet me burgim me kusht për mos deklaram të pasurisë, aktgjykim refuzues për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-bashota-denohet-me-burgim-me-kusht-per-mos-deklaram-te-pasurise-aktgjykim-refuzues-per-keqperdorim-detyre/>) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



EDMOND REXHEPI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor për Planifikim dhe Urbanizëm në Komunën e Lipjanit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Marrje ryshfeti”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Edmond Rexhepi akuzohet nga PSRK se në cilësinë e drejtorit për Planifikim dhe Urbanizëm në komunën e Lipjanit, ka kryer veprat penale ‘keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar’ dhe ‘marrje e ryshfeti’, për faktin se ka lëshuar leje ndërtimi për të pandehurin, Fahri Retkoceri. Rexhepi është pjesë e aktakuzë në rastin “Ferronikeli”, ku janë të akuzuar edhe ish-kryetari i Komunës së Lipjanit, Shukri Buja dhe tetë persona tjerë.

Procesi – Në nëntor 2018, Rexhepi ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë, me gjashtë muaj burg.¹¹⁷ Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në qershor 2019, e kishte anuluar aktgjykimin Themelores dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.^{118 119}

¹¹⁷ Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja dënohet me tre vjet burgim për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-lipjanit-shukri-buja-denohet-me-tre-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹¹⁸ Apeli e kthen në rigjykim rastin e Shukri Bujës, i dënuar me tre vjet burg për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-shukri-bujes-i-denuar-me-tre-vjet-burg-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹¹⁹ Shënim: Pas procesit të rigjyimit, Rexhepi përsëri është dënuar nga gjykata e shkallës së parë me gjashtë (6) muaj burgim. “Shukri Bujës i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet-denimi-denohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020).



ILHAMI GASHI

Partia: PDK

Pozitat shtetërore: Sekretar i përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme

Vepra penale: “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirues (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – Në rastin e njohur “Pronto”, po akuzohet edhe ish-sekretari i përgjithshëm i MPB-së Ilhami Gashi. Aktakuza ndaj tij dhe dhjetë personave të tjerë është ngritur me 6 prill 2018, me pretendimin se ata duke keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurrar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë, Me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar të pafajshëm¹²⁰. Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor në të cilin ishin caktuar nëntë (9) seanca gjyqësore,

Gashi dhe të tjerët më 3 janar 2020 janë liruar nga akuzat, ndërsa lënda po trajtohen në shkallën e dytë.¹²¹

¹²⁰ *Shënim:* Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

¹²¹ *Shënim:* Gjykata e Apelit, me 30 qershor 2020, kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë për rastin “Pronto” dhe i kishte shpallur fajtor Adem Grabovcin, Ilhami Gashin dhe Sedat Gashin, për veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, kurse për të akuzuarit tjerë ishte vërtetuar aktgjyrimi i lirues. Këtë vendim më 29 shtator 2020, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës. “Rasti “Pronto”: Gjykata Supreme vërteton vendimin dënues të Apelit ndaj Adem Grabovcit dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-gjykata-supreme-verteton-vendimin-denues-te-apelit-ndaj-adem-grabovcit-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Lirim

2. Në
proces



NIJAZI KRYEZIU

Partia: PDK

Pozitat shtetërore: Kryesues i Kuvendit në Komunën e Prizrenit/ Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor/ Këshilltar i Kryetarit të Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: 1. “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë), 2. Në proces

Aktakuza 1 – I bashkakuzuar tjetër në rastin “Pronto”, është edhe ish-kryesuesi i Kuvendit në Komunën e Prizrenit, Nijazi Kryeziu. Aktakuza e këtij rasti ishte ngritur me 6 prill 2018, me pretendimin se ata duke keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurruar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi 2 - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë, me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku edhe Pajaziti se bashku me dhjetë të akuzuarit tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë.¹²²

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Kryeziu ashtu sikurse edhe të akuzuarit tjerë, më 3 janar 2020, ishte liruar nga akuza¹²³, ndërsa lënda është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit.¹²⁴

¹²² Shënim: Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

¹²³ “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹²⁴ Shënim: Gjykata e Apelit, me 30 qershor 2020, kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë për rastin “Pronto” dhe i kishte shpallur fajtor Adem Grabovcin, Ilhami Gashin dhe Sedat Gashin, për veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, kurse për të akuzuarit tjerë ishte vërtetuar aktgjyrimi lirues. Këtë vendim më 29 shtator 2020, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e Kosovës. “Rasti “Pronto”: Gjykata Supreme vërteton vendimin dënues të Apelit ndaj Adem Grabovcit dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-gjykata->

¹²⁵ Iniciativa e kryetarit të partisë së cilës i përket Kryeziu, Kadri Veseli, për largimin e personave me aktakuza nga pozitat publike, kishte bërë që Kryeziu të shkarkohet nga pozita e këshilltarit të ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli.

Aktakuza 2 – Përpos në rastin “Pronto”, ndaj Kryeziut më 2 gusht të vitit 2019, është ngritur një tjetër aktakuzë për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, ai në periudhën janar-dhjetor 2015, në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, në Komunën e Prizrenit, kishte keqpërdorur pasurinë publike me qëllim që të përfitoj çfarëdo dobie për persona tjerë juridik TV Opinion, duke mos e përmbushur detyrën e përcaktuar me ligj. Ai po pretendohet se pa ndonjë procedurë të tenderimit kishte lidhur kontratë për emitimin e spoteve reklamuese në sensibilizimin e opinionit publik për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje, për nevojat e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Prizrenit, ashtu që me TV Opinion vlera totale e kontratës arrin shumën 7,200 euro.

Procesi 2 – Seanca fillestare e këtij rasti nga ana e gjykatës së Prizrenit, ishte mbajtur më 5 dhjetor 2020, ndërsa kjo gjykatë më 18 dhjetor 2019, ka vërtetuar aktakuzën e prokurorisë, për t’i hapur rrugë fillimit të shqyrtimit gjyqësor¹²⁶, i cili është duke vazhduar.

[supreme-verteton-vendimin-denues-te-apelit-ndaj-adem-grabovcit-dhe-dy-te-tjereve/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹²⁵ “Rasti “Pronto”, prokurorja flet për “shifat” e “jارات” e të akuzuarve, përmend edhe rastin e lirit të Salih Mekajt e Emin Beqirit”. Betimi për Drejtësi. 26 qershor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-prokurorja-flet-per-shifat-e-jارات-e-te-akuzuarve-permend-edhe-rastin-e-lirit-te-salih-mekajt-e-emin-beqirit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹²⁶ “Refuzohet kërkesa për hudhjen e aktakuzës ndaj ish-drejtorit të Urbanizmit në Prizren, Nijazi Kryeziu” Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/refuzohet-kerkesa-per-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizmit-ne-prizren-nijazi-kryeziu/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



BAJRAM RIZANI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor në Komunën e Lipjanit

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 13 shkurt 2017, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Bajram Rizani, akuzohet se, në cilësinë e drejtorit në Drejtorinë e Inspektionit në Komunën e Lipjanit, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare, duke qenë në dijeni se i pandehuri, Fahri Retkoceri, po ndërtonte objekt pa leje, nuk ka kërkuar nga vartësit e tij pezullimin e ndërtimit të objektit, me çka akuzohet për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”.

Procesi-- Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 nëntor 2019, e kishte shpallur fajtorë, për veprën penale, keqpërdorim i detyrës zyrtare, duke i shqiptuar një dënim në kohëzgjatje prej 6 muajsh burg efektiv, dënim i cili me pëlqimin e tij i është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 3.500 euro.¹²⁷ Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në qershor 2019 e kishte anuluar aktgjykimin e Themelores dhe rastin e kishte kthyer në rigjykim, me arsyetimin se nuk është vërtetuar dëmi e as përfitimi që kanë pasur të akuzuarit.¹²⁸ Ndryshe, ky rast kishte qenë i shënjestruar, si kusht për liberalizimin e vizave.¹²⁹

¹²⁷ “Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja dënohet me tre vjet burgim për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-lipjanit-shukri-buja-denohet-me-tre-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹²⁸ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e Shukri Bujës, i dënuar me tre vjet burg për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-shukri-bujes-i-denuar-me-tre-vjet-burg-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹²⁹ Shënim: Pas procesit së rigjykimit, Rexhepi përsëri është dënuar nga gjykata e shkallës së parë me gjashtë (6) muaj burgim. “Shukri Bujës i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet-denimi-denohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020).

1. Lirim

2.
Refuzim3. 1800
euro
gjobë**AJET DEMIRI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit/Urbanizmit/Asamblist në Komunën e Drenasit**Veprat penale:** 1“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 3. “Konflikt interesi”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** 1.Lirim (Aktgjykim i formës së prerë), 2. Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Dënim – 1800 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Ajet Demiri si drejtor i Drejtorisë për Planifikim Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit së bashku edhe ish-kryetarin e Komunës së Drenasit Nexhat Demaku dhe zyrtarin për çështje banesore në Komunën e Drenasit Gani Halilaj, në qershorin e vitit 2016 ishin akuzuar me pretendimin se të njëjtët kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare kur banesën e cila pretendohet se ishte e të dëmtuarës Zejnepe Buzhalës, ia kishin dhënë me qera Fadil Shishanit.

Vendimi 1 - Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Demiri së bashku me dy të bashkakuzuarit ishin shpallur të pafajshëm¹³⁰, i cili vendim më pas kishte marrë formën e prerë.

Aktakuza 2 - Demiri, për akuzat për korrupsion ishte i përfshirë edhe në një rast tjetër. Ai së bashku me tetë zyrtarë të tjerë të Komunës së Drenasit, shumica nga të cilët zyrtarë të drejtorisë së Urbanizimit të cilën ai e udhëhiqte, akuzoheshin lidhur me tenderin e kompanisë “Kalaja” për fasadimin e blloqeve në Drenas.

Vendimi 2 - Demiri në prill të vitit 2016 ishte gjetur fajtor dhe ishte dënuar me një vit e katër muaj burgim me kusht por Gjykata e Apelit, Demirin dhe pesë zyrtarë të tjerë i kishte liruar nga ndjekja penale pasi kishte konstatuar se kishte arritur parashkrimi i ndjekjes penale.

¹³⁰ “Shpallet i pafajshëm Kryetari i Komunës së Drenasit, Nexhat Demaku”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-kryetari-i-komunes-se-drenasit-nexhat-demaku/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Aktakuza 3 - Ajet Demiri, për vepra penale të kapitullit të korrupsionit, ishte akuzuar edhe më 27 mars 2017, me këtë aktakuzë mbi të rëndon akuza për konflikt të interesit pasi pretendohet se gjatë kohës sa ka ushtruar funksionin e këshilltarit komunal në komunën e Drenasit, ka rënë ndesh me ligjin pasi që për interesa private të drejtpërdrejta, personale pasurore, ka shfrytëzuar funksionin publik për të përfituar për vete.

Procesi 3 - Lidhur me këtë aktakuzë, Gjykata Themelore në Prishtinë më 29 gusht 2019, e kishte shpallur fajtor Demirin dhe të njëjtin e kishte gjykuar me 1800 euro gjobë.¹³¹

Ndaj këtij vendimi kishte paraqitur ankesë i akuzuari Demiri, duke kërkuar Apeli që aktgjykimi i shkallës së parë të ndryshohet dhe që ai të lirohet nga akuza apo që çështja të kthehet në rivendosje, mirëpo Apeli kishte refuzuar këtë ankesë dhe kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë¹³².

¹³¹ “*Ish-asamblisti i Komunës së Drenasit dënohet me 1800 euro gjobë për konflikt interesi*”. Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-asamblisti-i-komunes-se-drenasit-denohet-me-1800-euro-gjobe-per-konflikt-interesi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹³² “*Apeli vërteton dënimin me gjobë ndaj ish-asamblistit në Drenas, i akuzuar për konflikt interesi*”. Betimi për Drejtësi. 3 shkurt 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-gjobe-ndaj-ish-asamblistit-ne-drenas-i-akuzuar-per-konflikt-interesi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1 vit
burg me
kusht



Hajri Ramadani

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Dragashit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Dënim - Një vit burg me kusht dhe dënim plotësues për mos ushtrim të funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike në kohëzgjatje prej dy viteve (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ramadani, më 1 dhjetor 2014 ishte akuzuar për veprën penale të “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, pas pretendimit se ai gjatë vitit 2013, i ka tejkaluar kompetencat e tij duke zgjedhur në mënyrë të kundërligjshme në pozitën e drejtorit të gjimnazit “Ruzhdi Berisha”, një kandidat që nuk i plotësonte kushtet edhe pse këtë e kishte kërkuar Inspektorati i Arsimit.

Vendimi - Gjykata Themelore në Prizren në dhjetor të vitit 2016, kishte shpallur fajtor Ramadanin, duke e dënuar atë me një vit burgim me kusht i cili nuk do të ekzekutohej nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale. Përpos këtij dënimi kryesor ai ishte dënuar edhe me dënim plotësues me të cilin i ndalohej ushtrimi i funksioneve në administratën publike ose në shërbime publike në kohëzgjatje prej 2 viteve. Këtë vendim të shkallës së parë e kishte vërtetuar më pas edhe Gjykata e Apelit.

6 muaj
burg me
kusht



SADIK PAQARIZI

Partia: Drejtor komunal në qeverisjen e PDK-së

Pozita shtetërore: Drejtor i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Prizrenit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjiilan

Faza procedurale: Dënim - Gjashtë muaj burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza- Ish drejtori i Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor të Komunës së Prizrenit, gjatë kohës kur ish-kryetari i kësaj komune Ramadan Muja, që vjen nga radhët e PDK-së, ka bërë pjesë në aktakuzën e PSRK-ja më 26 shkurt të vitit 2013, në të cilën bënë pjesë edhe ish-kryetari i kësaj komune Ramadan Muja si dhe ish-drejtor e ish-zyrtar të kësaj komune. Ata akuzohen se kanë keqpërdorur pronat komunale të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, në mesin e pronave bëjnë pjesë edhe dy parcelat ku janë ndërtuar shkolla “Mehmet Akif” dhe fabrika e çokollatës “Kamila” në Prizren, të cilat sipas akuzës nuk kanë kaluar fare përmes Kuvendit Komunal por me vendim direkt të ish-kryetarit Muja.

Procesi - Edhe pas me shumë se gjashtë vjetëve që nga ngritja e aktakuzës, ende nuk kemi një aktgjykim të plotfuqishëm në këtë rast. Ky proces i nisur nga Gjykata Themelore në Prizren kishte prodhur një aktgjykim dënues që ishte anuluar nga Gjykata e Apelit, për të përfunduar më pas në një proces të rigjyimit në Gjykatën Themelore në Gjiilan. Kjo gjykatë rigjykimin ndaj Paqarizit dhe të tjerëve kishte filluar më 14 dhjetor 2017, ndërsa e kishte përfunduar me një aktgjykim dënues ndaj tij me gjashtë muaj burgim me kusht, më 19 dhjetor 2018.¹³³ Lënda aktualisht është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit.¹³⁴

¹³³ “Ish-kryetari i Prizrenit, Ramadan Muja dhe të tjerët dënohen me kusht pasi shpallen fajtorë për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2018. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-prizrenit-ramadan-muja-dhe-te-tjeret-denohen-me-kusht-pasi-shpallen-fajto-re-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹³⁴ Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. “Apeli ia vërteton dënimin për korrupsion ish-kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja”. Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-verteton-denimin-per-korrupsion-ish-kryetarit-te-prizrenit-ramadan-muja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

6 muaj
burg me
kusht**MINIR KRASNIQI****Partia:** Ish-kryetar i PDK-së në Prizren**Pozita shtetërore:** Drejtor i Administratës Publike të Komunës së Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjiilan**Faza procedurale:** Dënim - Gjashtë muaj burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Ish-drejtori i Administratës Publike të Komunës së Prizrenit ka bërë pjesë në aktakuzën e PSRK-ja më 26 shkurt të vitit 2013, në të cilën bënë pjesë edhe ish-kryetari i kësaj komune Ramadan Muja si dhe ish-drejtor e ish-zyrtar të kësaj komune. Ata akuzohen se kanë keqpërdorur pronat komunale të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, në mesin e pronave bëjnë pjesë edhe dy parcelat ku janë ndërtuar shkolla “Mehmet Akif” dhe fabrika e çokollatës “Kamila” në Prizren, të cilat sipas akuzës nuk kanë kaluar fare përmes Kuvendit Komunal por me vendim direkt të ish-kryetarit Muja.

Procesi - Edhe pas me shumë se gjashtë vjetëve që nga ngritja e aktakuzës, ende nuk kemi një aktgjykim të plotfuqishëm në këtë rast. Ky proces i nisur nga Gjykata Themelore në Prizren kishte prodhuar një aktgjykim dënues që ishte anuluar nga Gjykata e Apelit, për të përfunduar më pas në një proces të rigjyimit në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

Kjo gjykatë rigjykimin ndaj Krasniqit dhe të tjerëve kishte filluar më 14 dhjetor 2017, ndërsa e kishte përfunduar me një aktgjykim dënues ndaj tij me gjashtë muaj burgim me kusht, më 19 dhjetor 2018.¹³⁵ Lënda aktualisht është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit.¹³⁶

¹³⁵ “Ish-kryetari i Prizrenit, Ramadan Muja dhe të tjerët dënohen me kusht pasi shpallen fajtorë për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 19 dhjetor 2018. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-prizrenit-ramadan-muja-dhe-te-tjeret-denohen-me-kusht-pasi-shpallen-fajto-re-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹³⁶ Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. “Apeli ia vërteton dënimin për korrupsion ish-kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja”. Betimi për Drejtësi. 22 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-verteton-denimin-per-korrupsion-ish-kryetarit-te-prizrenit-ramadan-muja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

5 muaj
burg me
kusht**AVNI ADEMAJ****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjiilan**Faza procedurale:** Dënim - Pesë muaj burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Ish-drejtori i Gjeodezisë dhe Kadastrës të Komunës së Prizrenit ka bërë pjesë në aktakuzën e PSRK-ja më 26 shkurt të vitit 2013, në të cilën bënë pjesë edhe ish-kryetari i kësaj komune Ramadan Muja si dhe ish-drejtor e ish-zyrtar të kësaj komune. Ata akuzohen se kanë keqpërdorur pronat komunale të menaxhuara nga Agjencia Kosovare e Privatizimit. Po ashtu, në mesin e pronave bëjnë pjesë edhe dy parcelat ku janë ndërtuar shkolla “Mehmet Akif” dhe fabrika e çokollatës “Kamila” në Prizren, të cilat sipas akuzës nuk kanë kaluar fare përmes Kuvendit Komunal por me vendim direkt të ish-kryetarit Muja.

Procesi - Edhe pas me shumë se gjashtë vjetëve që nga ngritja e aktakuzës, ende nuk kemi një aktgjykim të plotfuqishëm në këtë rast. Ky proces i nisur nga Gjykata Themelore në Prizren kishte prodhuar një aktgjykim dënues që ishte anuluar nga Gjykata e Apelit, për të përfunduar më pas në një proces të rigjyimit në Gjykatën Themelore në Gjiilan.

Kjo gjykatë rigjykimin ndaj Ademajt dhe të tjerëve kishte filluar më 14 dhjetor 2017, ndërsa e kishte përfunduar me një aktgjykim dënues ndaj tij me pesë muaj burgim me kusht, më 19 dhjetor 2018.¹³⁷ Lënda aktualisht është duke u trajtuar në Gjykatën e Apelit.¹³⁸

¹³⁷ “Ish-kryetari i Prizrenit, Ramadan Muja dhe të tjerët dënohen me kusht pasi shpallen fajtorë për korrupsion” Betimi për Drejtësi, 19 dhjetor 2018. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-prizrenit-ramadan-muja-dhe-te-tjeret-denohen-me-kusht-pasi-shpallen-fajto-re-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹³⁸ Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. “Apeli ia vërteton dënimin për korrupsion ish-kryetarit të Prizrenit, Ramadan Muja”. Betimi për Drejtësi, 22 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-ia-verteton-denimin-per-korrupsion-ish-kryetarit-te-prizrenit-ramadan-muja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

Në
proces

	AVDI MJEKU Partia: PDK Pozita shtetërore: Drejtor i Inspeksionit të Komunës së Obiliqit Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë Faza procedurale: Në proces (Rigjykim)
---	---

Aktakuza- Me 18 korrik 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Avdi Mjekut, me pretendimin se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës zyrtare”. Mjeku thuhet se në cilësi të drejtorit të Inspeksionit në Komunën e Obiliqit duke shfrytëzuar detyrën e tij i kishte tejkaluar kompetencat e tij duke mos përmbushur detyrën e tij zyrtare me qëllim të përfitimit. Ai pretendohet se nga 1 janari 2014 e deri në muajin maj 2016 ka lejuar ndërtime të objekteve pa leje në zonën e cila ishte shpallur me vendim të Qeverisë si zonë e interesit të veçantë ekonomik “Fusha e Mihjes së Re” në Komunën e Obiliqit.

Procesi - Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, më 12 prill 2019 Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte liruar nga akuza Mjekun, me konstatimin se nuk është arritur të provohet se ai ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare.¹³⁹

Mirëpo pas ankesës në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë këtë rast e ka kthyer në rigjykim¹⁴⁰, i cili proces tashmë ka filluar.

¹³⁹ “Shpallet i pafajshëm ish-drejtori i Inspeksionit në Obiliq i akuzuar për keqpërdorim pozite” Betimi për Drejtësi. 12 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-drejtori-i-inspeksionit-ne-obiliq-i-akuzuar-per-keqpërdorim-pozite/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁴⁰ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit 02.06.2020

Refuzues



TEFIK MALOKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë dhe Resurse Natyrore në Komunën e Vushtrrisë

Vepra penale: “Lidhja e kontratës së dëmshme”

Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë - dega Vushtri

Faza procedurale: Refuzues/Parashkrim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës, së 20 janarit 2009 Tefik Maloku, me 15 maj 2006, në emër të Komunës së Vushtrrisë, kishte lidh kontratë mbi shfrytëzimin e shkëmbit gëlqeror në fshati Pasomë, te “Guri i Madh”, me kompaninë “Ndërtimi Kompani”, me seli në Prizren. Siç thuhet në aktakuzë, i pandehuri Maloku këtë kontratë dhe aneks kontratën së 1 qershorit 2006 për zgjatjen afatit për realizimin e saj, e kishte lidhur pa shpallur tender – njoftim publik dhe plotësuar kushtet tjera. Sipas pretendimeve të prokurorisë, me këtë kontratë komunës i është shkaktuar dëm në vlerën prej 200.000 euro.

Procesi. Duke marrë parasysh se ky rast nga fillimi i procesit gjyqësor është përcjellë me zvarritje e shtyrje të shumta të seancave gjyqësore, ka ndikuar që të kalojnë 10 vite nga ngritja e aktakuzës e më shumë se 13 vite, nga koha e pretenduar e kryerjes së veprës penale¹⁴¹, ka ndikuar që ky rast edhe ta arrij afatin e parashkrimit absolut.

Kjo kishte ndikuar që prokurori, për këtë arsye të tërhiqet nga ndjekja penale, pas të cilit veprim, Gjykata Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri, më 11 dhjetor 2019 kishte marrë aktgjykim me të cilin kishte refuzuar aktakuzën ndaj Malokut.¹⁴²

¹⁴¹ “Mungon prokurori, dështon seanca ndaj të akuzuarit për lidhje të dëmshme të kontratës”. Betimi për Drejtësi. 7 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-prokurori-deshton-seanca-ndaj-te-akuzuarit-per-lidhje-te-demshme-te-kontrates/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁴² Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Dega në Vushtri.

Lirim



MUSA LUSHTAKU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Skenderajt

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë - Dega Vushtrri

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ish-drejtori i drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Komunën e Skenderajt Musa Lushtaku, sipas aktakuzës, derisa ka ushtruar këtë pozitë, gjatë vitit 2011 dhe marsit të vitit 2012, i ka shpërndarë 163.16 m³ dru të konfiskuara Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe familjeve me asistencë sociale, në kundërshtim me udhëzimin administrativ nr.06/2010. Ndërsa sipas Ligjit të Prokurimit Publik të Kosovës, për këto dru është dashur të shpallet tender, ndërsa me këto veprime pretendohej se buxhetit të shtetit i është shkaktuar dëm në vlerë prej 4.079.99 euro.

Procesi - Trupi gjykues i Gjykatës Themelore në Mitrovicë, më 13 dhjetor 2016, kishte marrë aktgjykim me të cilin e kishte liruar Lushtakun nga akuza. Sipas vendimit të gjykatës nuk ishte vërtetuar se i akuzuar ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.¹⁴³ Ky vendim më pas është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

¹⁴³ “Lirohet nga akuza për korrupsion drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në Skenderaj, Musa Lushtaku” Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-drejtori-i-drejtorise-per-bujqesi-pylltari-dhe-zhvillim-rural-ne-skenderaj-musa-lushtaku/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**ZEQIR MORINA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Urbanizmit, Komuna Klinë**Veprat penale:** “Shpërdorim i detyrës zyrtare ose autorizimit”; “arkëtim dhe pagesa e paligjshme”; “falsifikim i dokumentit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Pejë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë).

Aktakuza – Prokuroria Themelore në Pejë, më 30 dhjetor 2013, kishte ngritur aktakuzë ndaj Zeqir Morinës, me pretendimet se i njëjti, si drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm në Komunën e Pejës dhe një zyrtar tjetër në këtë drejtori, gjatë periudhës kohore 2008-2012 kanë shpërdorë detyrën zyrtare. Këtë e kanë bërë duke mos përmbushur detyrat, ku pa bazë kanë lëshuar një vendim për lirim nga pagesa e qirasë për ndërmarrjen “Albulena”. Sipas aktit akuzues, të akuzuarit Zeqir Morina, Ali Gashi dhe Abaz Foniqi, si persona zyrtarë dhe atë Morina si drejtor i Drejtorisë për Urbanizëm, Gashi si zyrtar komunal dhe Foniqi si menaxher i prokurimit, kanë përpiluar dokumente të falsifikuara, të cilat i kanë nënshkruar dhe vulosur, në atë mënyrë që për ti ikur përgjegjësisë penale, pas fillimit të hetimeve kundër tyre i kanë falsifikuar dy faqet e para të kontratës, duke lënë të kuptohet se kontrata është e paafatshme. Më këtë, ata akuzoheshin se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “falsifikim i dokumentit zyrtar”.

Procesi – Gjykata Themelore në Pejë, më 27 dhjetor 2017, pas një procesi të rigjykit, kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj zyrtarëve të Komunës së Klinës, Zeqir Morina dhe Ali Gashi, të akuzuar për shpërdorim të detyrës zyrtare si dhe Abaz Foniqit, i akuzuar për falsifikim të dokumentit zyrtar.¹⁴⁴

Ky vendim është bërë i formës së prerë më 20 prill 2018.¹⁴⁵

¹⁴⁴ “Lirohen nga akuza për korrupsion zyrtarët e Komunës së Klinës”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuza-per-korrupsion-zyrtaret-e-komunes-se-klines/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁴⁵ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Pejë 01.06.2020

1.
Hudhje

2.
Lirim

3.
Hudhje



HYRIJE XHEMALJAJ - THAQI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtoreshë e Shërbimeve Publike; Drejtoreshë e Inspeksionit në Komunën e Glllogocit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 3. “Mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Prishtinë; 2. Gjykata Themelore në Prishtinë; 3. Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Glllogoc

Faza procedurale: 1. Hudhje e aktakuzës (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Hudhje e aktakuzës (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 – Hyrije Xhemalaj-Thaqi bashkë me Shyqri Bublatu dhe Vehbi Jashari, akuzoheshin nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, se në muajin shtator të vitit 2015, si persona zyrtar në Komunën e Drenasit, në bashkëkryerje kanë shkelur nenin 81.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik duke nënshkruar kontratë mes Komunës së Drenasit dhe kompanisë “Agribau”, drejtor i të cilës është i pandehuri tjetër në këtë rast Naim Berisha. Të pandehurit e lartpërmendur, pretendohet se kompanisë në fjalë ia kishin bërë pagesën prej 110.000 euro, për blerjen e një kamioni për fikjen e zjarrit, ndërsa mallin e kontraktuar nuk e kishin pranuar në kohë të duhur, duke qenë në dijeni se kamioni nuk i plotësonte kriteret sipas kontratës.

Procesi 1 – Ky rasti kishte dështuar qysh në fazën fillestare, duke mos shkuar fare në shqyrtim gjyqësor, pasi që, në gusht të vitit 2017, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të hudhë poshtë aktakuzën ndaj Xhemalajt si dhe të akuzurave tjerë në këtë rast, Shyqri Bublatu, Vehbi Jashari dhe Naim Berisha, me arsyetimin se nuk është arritur të vërtetohet cilësia e të akuzuarve, veprimet konkrete të tyre dhe faktin se kush është dëmtuar nga veprimet e të akuzuarve.¹⁴⁶

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Hyrije Xhemalji-Thaçi, akuzohet se duke qenë në pozitën e drejtoreshës së Inspeksionit Komunal në bashkëpunim me

¹⁴⁶ “Hudhet poshtë aktakuza ndaj ish-drejtoreshës së shërbimeve publike në Komunën e Drenasit”. Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-ish-drejtoreshes-se-sherbimeve-publike-ne-komunen-e-drenasit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Halil Vrellakun, shef i Inspektionit, i kanë sjellë fitim të kundërligjshëm organizatës “Elita A” me pronar Agron Kukaj, edhe pse të njëjtit kanë qenë në dijeni se janë bërë ndërtime pa leje.

Procesi 2 – Gjykata Themelore në Prishtinë, më 30 gusht 2017, e kishte dënuar me 10 muaj burg të akuzuarën Hyrije Xhemajlaj-Thaqi, pasi ajo ishte shpallur fajtores për veprën penale “keqpërdorim i detyrës zyrtare”, kurse, i akuzuari tjetër në këtë rast, Halil Vrellaku për të njëjtën vepër ishte dënuar me një vit burgim me kusht, mirëpo, dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohej, nëse në periudhën prej dy vjetësh, i njëjti nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

Mirëpo, ky rast ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit pas ankesave të të akuzurave¹⁴⁷ dhe pas rigjykimit, me 8 maj 2019, Gjykata Themelore në Prishtinë e kishte liruar Xhemajlajn nga akuzat kurse i akuzuari Vrellaku ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht.¹⁴⁸ Vendimin e Themelores për lirim të Xhemajlajt e kishte vërtetuar pastaj edhe Gjykata e Apelit.

Aktakuza 3 - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 22 nëntor 2018, kishte ngritur aktakuzë kundër Hyrije Xhemajlaj – Thaqi, të cilën e ngarkon se prej 14 janar 2014 e deri më 9 shtator 2014, si person përgjegjës në kuadër të Kuvendit Komunal në Drenas, nga pakujdesia nuk është përkujdesur në lidhje me mbikëqyrjen e gjendjes dhe mirëmbajtjes së rrugëve në territorin e Komunës së Drenasit, duke mos urdhëruar apo vendosur shenja sinjalizuese në rrugë për të cilën ka qenë e obliguar sipas përgjegjësisë që ka pasur.

Vendimi 3 – Sikurse edhe dy herët tjera kur ishte përballur me aktakuzat e ngritura nga prokuroria, Hyrije Xhemajlaj-Thaqi, kishte arritur të “triumfojë” edhe në përballjen e saj të fundit me organin e akuzës, nga i cili akuzohej për shkak të veprës penale “mbikëqyrja e pandërgjegjshme e trafikut publik”. Gjykata e Apelit, në maj 2019, e kishte aprovuar ankesat e mbrojtjes së Xhemajlajt, duke e ndryshuar vendimin e shkallës së parë e cila kishte konfirmuar aktakuzën e prokurorisë, duke e hudhur poshtë aktakuzën për sa i përket Xhemajlajt.

¹⁴⁷ “Gjykata e Apelit kthen në rigjykim rastin e ish-zyrtarëve të Komunës së Drenasit të dënuar për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 7 shkurt 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-zyrtareve-te-komunes-se-drenasit-te-denuar-per-keqperdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁴⁸ “Pas rigjykimit, lirohet nga akuza ish-drejtoresha në Komunën e Drenasit, ish-zyrtari tjetër dënohet me burgim me kusht”. Betimi për Drejtësi. 8 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-lirohet-nga-akuza-ish-drejtoresha-ne-komunen-e-drenasit-ish-zyrtari-tjeter-denohet-me-burgim-me-kusht/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**SHYQIRI BUBLAKU****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor për Buxhet dhe Financa – Komuna e Drenasit**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së përpiluar nga prokurorja Fikrije Fejzullahu, Shyqiri Bublatku, bashkë me Hyrije Xhemajlaj-Thaqi dhe Vehbi Jashari, akuzoheshin se në muajin shtator të vitit 2015, si persona zyrtar në Komunën e Drenasit, në bashkëkryerje pretendohesh se kanë shkelur nenin 81.2 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

Një gjë të tillë sipas Prokurorisë, të njëjtit e kishin bërë duke nënshkruar kontratë me Komunën e Drenasit dhe kompanisë “Agribau”, drejtor i të cilës është i pandehuri tjetër në këtë rast Naim Berisha. Të pandehurit e lartpërmendur, pretendohesh se kompanisë në fjalë ia kishin bërë pagesën prej 110.000 euro, për blerjen e një kamioni për fikjen e zjarrit, ndërsa mallin e kontraktuar nuk e kishin pranuar në kohë të duhur, duke qenë në dijeni se kamioni nuk i plotësonte kriteret sipas kontratës.

Në aktakuzë thuhej se pas ekzaminimit nga ekspertët, kamioni kishte qëndruar në pikën doganore, në Han të Elezit, për shkak të mos përmbushjes së kriterëve të parapara me kontratë.

Procesi – Lidhur me këtë rast, Bublatku dhe të akuzuarit tjerë ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 18 maj 2017 në Gjykatën Themelore në Prishtinë, me c’rast, kishin kërkuar nga gjykata hudhjen poshtë të aktakuzës.¹⁴⁹

¹⁴⁹ “Ish-zyrtarët e Komunës së Drenasit i mohojnë akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtar”. Betimi për Drejtësi. 18 maj 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zyrtaret-e-komunes-se-drenasit-i-mohojne-akuzat-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në gusht të vitit 2017, Gjykata e Apelit kishte vendosur që të hudhë poshtë aktakuzën ndaj Bublakut si dhe si dhe të akuzurave tjerë në këtë rast, Hyrije Xhemalaj – Thaqi, Vehbi Jashari dhe Naim Berisha.¹⁵⁰

Sipas vendimit të Apelit, aktakuzës i ka munguar fakti se në çfarë cilësie kanë qenë të gjithë të pandehurit dhe veprimi konkret i tyre ku nuk përshkruhen koha, vendi i kryerjes së veprës penale si dhe mënyra me të cilën është kryer kjo vepër penale. Si dhe ka munguar edhe dashja si element qenësor i kësaj vepre penale, përfitimi i çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, dhe se përfundimisht nuk është arritur të vërtetohet edhe fakti se kush është dëmtuar me veprimet e të pandehurve.

¹⁵⁰ *Hudhet poshtë aktakuza ndaj ish-drejtoreshës së shërbimeve publike në Komunën e Drenasit*. Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-ish-drejtoreshes-se-sherbimeve-publike-ne-komunen-e-drenasit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

3000
euro
gjobë**HASAN HASANI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** 3000 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së ngritur më 31 korrik 2019, nga Prokuroria Themelore në Prizren, i pandehuri Hasani akuzohet se gjatë periudhës kohore janar 2015 e deri në dhjetor 2016, në cilësinë e drejtorit të Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit, pa ndonjë procedurë të tenderimit në kundërshtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike, si dhe Rregulloren e Thesarit, kishte lidhur kontrata me TV “Besa” dhe TV “Opinion” për emetimin e spoteve reklamuese për nevojat e Drejtorisë së Shërbimeve Publike të Komunës Prizrenit. Sipas aktakuzës, Hasani, gjatë periudhës kohore 10 janar 2015, e deri më 31 dhjetor 2015, kishte lidhur kontratë me TV Opinionin, në vlerë prej 300 euro në muaj, dhe se për 12 muaj ka paguar 3600 euro, ndërsa në periudhën 01 maj 2016, deri me 31 dhjetor 2016, kishte lidhur kontratë prej 200 euro në muaj, që për 8 muaj arrin shumën 1600 euro, si dhe për në periudhën 01 prill 2016, e deri më 21 dhjetor 2016, kishte lidhur kontratë me TV Besa, në vlerë prej 200 euro në muaj, që për 9 muaj kap shifrën prej 1800 euro.

Procesi 1 - Gjykata Themelore e Prizrenit, më 9 tetor 2019, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Hasani, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 3,000 euro¹⁵¹, i cili vendim është bërë i formës së prerë më 4 nëntor 2019.

¹⁵¹ Dënohet ish-drejtori në Prizren që pranoi fajësinë për lidhjen e kontratave të kundërligjshme me televizionet lokale. Betimi për Drejtësi. 9 tetor 2019. (shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/denohet-ish-drejtori-ne-prizren-qe-pranoi-fajesine-per-lidhjen-e-kontratave-te-kunderligjshme-me-televizionet-lokale/?fbclid=IëAR2fDpKP_BZu12DHA5NIXrvp2ittOT5vj2ë963nkAdpJtF-Shoh35hx7Q4). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

	AHMET BAHTIJARI Partia: PDK Pozita shtetërore: Drejtor Financiar në Komunën e Dragashit në kohën e pushtetit të PDK-së Veprat penale: “Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”; “Konflikt interesi” Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren Faza procedurale: Në proces
---	---

Aktakuza - Sipas aktakuzës, Ahmet Bahtijari akuzohet se gjatë periudhës 2004, e deri më 2017, në cilësinë e Drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, nuk i ka përmbushur detyrat apo autoritetin zyrtar, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për servisin “Menti”, pronar i të cilit është djali i tij, Armend Bahtijari.

Bahtijari akuzohet po ashtu se në periudhën e njëjtë kohore, në cilësinë e drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit, personalisht merr pjesë në çështje zyrtare në të cilën anëtar i familjes-djali i tij, Armend Bahtijari ka interes financiar, në atë mënyrë që e nënshkruan urdhërpagesën e servisimit të automjeteve zyrtare në servisin “Menti” dhe, kështu i mundëson djali të tij, dobi pasurore si pronar i servisit “Menti”, për vitin 2015, shumën prej 3069 euro, për vitin 2016, shumën prej 712 euro dhe për vitin 2017, shumën prej 1532 euro.

Procesi – Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 19 korrik 2019, për këtë rast në Gjykatën Themelore në Prizren, Ahmet Bahtijari nuk e kishte pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat akuzohet, ndërsa gjykimi ndaj tij është akoma duke vazhduar.

Në
proces**AVNI NEBIU****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Administratës Publike në Komunën e Dragashit gjatë mandatit të PDK-së/ Zyrtar i pagesave në Komunën e Dragashit**Veprat penale:** “Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Avni Nebiu, akuzohet se gjatë periudhës nëntor 2014, e deri në kohë të pacaktuar, në cilësi të personave zyrtar të Komunës së Dragashit, Avni Nebiu, zyrtar autorizues i pagesave, duke mos i përmbushur detyrat zyrtare apo autoritetin zyrtar, kanë tejkaluar kompetencat me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për servisën “Menti”, pronar i të cilit është djali i drejtorit të Financave në Komunën e Dragashit.

Procesi - Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 19 korrik 2019, për këtë rast në Gjykatën Themelore në Prizren, Avni Nebiu nuk e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Seanca e shqyrtimit të dytë është caktuar të mbahet më 3 shtator 2019.¹⁵²

¹⁵² “Ish drejtori dhe dy zyrtarët tjerë të Komunës së Dragashit deklarohen të pafajshëm për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-dhe-dy-zyrtaret-tjere-te-komunes-se-dragashit-deklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

7 muaj
burgim me
kusht dhe
3600 euro
gjobë



NAZMI KRASNIQI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Lipjanit

Veprat penale: “Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim - Shtatë muaj burgim me kushte dhe 3600 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Nazmi Krasniqi akuzohet se ka keqpërdorur detyrën zyrtare në periudhën kohore 2010-2013, me qëllim të përfitimit për vete apo personin tjetër, ka nënshkruar marrëveshje me NTP “Nexhi” dhe “Taxi”, duke u mundësuar këtyre dy kompanive transportimin e fëmijëve pa kaluar procedurat e prokurimit. Po ashtu, Krasniqi akuzohet se ka lidhur kontrata me pesë arsimtarë të shkollave të ndryshme në Lipjan, duke u mundësuar disa prej tyre që pa mbajtur asnjë orë, tu figurohet si normë e plotë. Krasniqi, akuzohet edhe se u ka mundësuar personelit të çerdhes së fëmijëve në Lipjan që të paguhen më shumë se që është paraparë në kontratë, gjegjësisht duke ua rritur koeficientin e pagës.

Procesi – Me 29 gusht 2017, Gjykata Themelore në Prishtinë i kishte shqiptuar Krasniqit dënim prej shtatë muaj burgim me kusht dhe 3600 euro gjobë. Paraprakisht, ishte bërë edhe marrëveshja për pranimin e fajësisë ndërmjet të akuzuarit dhe prokurores Habibe Salihi.¹⁵³

¹⁵³ “Dënohet me shtatë muaj burgim me kusht dhe gjobë, ish-drejtori i Arsimit në Lipjan”. Betimi për Drejtësi. 29 gusht 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-shtate-muaj-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-ish-drejtori-i-arsimit-ne-lipjan/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



BEHAR RAMA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Rahovecit

Vepra penale: “Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”; “Konflikt i interesit”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Behar Rama akuzohej nga prokuroria se në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Rahovecit duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar i ka tejkaluar kompetencat duke shkelur të drejtat e profesorëve Vjosa Silka, Afrim Oruqi, Albana Isma, Eshref Haxhiu dhe Rasim Dula në atë mënyrë që ka shpallë konkursin për plotësimin e vendeve të lira të punës në shkollën ‘Xhelal Hajda – Toni’ dhe ka pranuar kandidatët – profesorët të cilat ishin edhe familjarë dhe të së njëjtës parti PDK.

Procesi – Gjykata Themelore në Gjakovë, në janar 2016, e kishte liruar nga akuzat Ramën, me arsyetimin se me provat e administruara nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprat penale për të cilat akuzohej, ndërsa këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit¹⁵⁴.

¹⁵⁴ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit Arbër Jashari.27.08.2019

Refuzim



MEHDI KURRUMELI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Drenasit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës, Mehdi Kurumeli akuzohet në cilësinë e drejtorit për Gjeodezi, Kadastër e Pronë në Komunën e Drenasit, se nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, në mënyrë që ka refuzuar ta zbatojë aktvendimin e Agjencisë Kadastrale të Kosovës, me të cilin është obliguar që Kadastrë të bëjë regjistrimin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme në sipërfaqe prej 4 hektarë e 6 ari e 82 metra.

Procesi – Gjykata Themelore në Prishtinë, pas përfundimit të rigjyimit, në dhjetor të vitit 2017 kishte marr aktgjykim refuzues ndaj Kurrumelit, pasi që paraprakisht, prokuroria ishte tërhequr nga akuza ndaj tij.

E njëjta gjykatë, në tetor 2015 e kishte shpallur fajtor Kurrumelin dhe të njëjtin e kishte gjykuar me një vit burgim, por pas ankesave në Apel, shkalla e dytë e kishte anuluar aktgjykimin për sa i përket Kurrumelit dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim, në të cilin gjykim prokurorja e rastit kishte hequr dorë nga gjykimi i këtij rasti¹⁵⁵.

¹⁵⁵“Prokuroria heq dorë nga aktakuza ndaj ish-drejtorit të Kadastrës në Komunën e Drenasit”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-heq-dore-nga-aktakuza-ndaj-ish-drejtorit-te-kadastres-ne-komunen-e-drenasit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 6
muaj
burg me
kusht

2.
Lirim

3.
Lirim



SADIK TAHIRAJ

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Drenasit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 3. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Dënim – 6 muaj burg me kusht (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Në proces; 3. Në proces

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së 22 qershorit 2018, Tahiraj, akuzohej se në vitin 2014 ka keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke mos respektuar procedurat e prokurimit publik lidhur me furnizimin me vaj (antifiriz) për ngrohjen qendrore të shkollës fillore të mesme të ulët “Rilindja” në fshatin Dobroshec të Komunës së Drenasit.

Procesi 1 – Gjykata Themelore në Prishtinë, më 21 qershor 2018, e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht ndaj ish-drejtorit të Arsimit në Komunën e Drenasit, Sadik Tahiraj, i cili akuzohej për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Por, ky dënim nuk do të ekzekutohet në afat verifikimi prej dy vjetësh nëse i akuzuari nuk do kryen vepër tjetër penale. Aktgjykimi ishte shpallur pasi paraprakisht gjykata e kishte aprovuar marrëveshjen për pranimin e fajësisë, që i akuzuari Tahiraj e kishte arritur me prokurorin e rastit, Arian Gashi.¹⁵⁶

Aktakuza 2 – Në një rast tjetër, bashkë me Tahiraj akuzohej edhe ish-kryetari i Drenasit Nexhat Demaku, në këtë rast Tahiraj akuzohet se më 3 nëntor 2014, ia ka lëshuar kontratën e punës për mësimdhënës Mimoza Berishës me titullin e vendit të punës, edukatore me parafillor në Shkollën Fillore të Mesme të Ulët “Ali Gashi” në Drenas, si dhe me 3 nëntor 2014 ia kishte lëshuar asaj vendimin, në pozitën edukatore në atë shkollë, pa pasur konkurs publik të shpallur, dhe e kishte punësuar pa përgatitje shkollore adekuate, duke mos iu nënshtruar procedurave të rekrutimit-punësimit. Gjithmonë sipas aktakuzës ai me 5 mars 2015, ia kishte lëshuar vendimin Berishës për transferimin e saj në Drejtorinë e Inspeksionit në Komunën e Drenasit në vendin

¹⁵⁶ “Ish-drejtori i Arsimit në Drenas dënohet me kusht lidhur me tenderin për ngrohjen e shkollës”. Betimi për Drejtësi. 21 shtator 2018. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-drenas-denohet-me-burgim-me-kusht-lidhur-me-tenderin-per-ngrohjen-e-shkolles/?fbclid=IëAR3eXDËxoËrzB2ldtiJ-sË_MëIIyqCHyPqIKjMZE1jCksbzcSbAhzaki-ec). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

e punës inspektor i tregut, e me ç’rast Berishës i kishte sjell përfitim të kundërligjshme në vlerë prej 756.18 euro, duke i shkaktuar dem edhe buxhetit të komunës në vlerë prej 756.18 euro.

Procesi 2 – Aktakuza ndaj Tahirajt dhe Demakut pasi është konfirmuar në dy instancat gjyqësore, pas përfundimit të procedimit të provave, kishte marrë epilog më 28 janar 2020, në të cilin Tahiraj dhe Demaku, ishin shpallur të pafajshëm.^{157 158}

Aktakuza 3 – Në rastin e tretë ndaj tij, Sadik Tahiraj akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, derisa ishte në pozitën e drejtorit të Drejtorisë Komunale të Arsimit në Drenas, ka shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar duke i tejkaluar kompetencat e tij. Në aktakuzë thuhet se këtë e ka bërë me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete ose për organizatën e biznesit “A&I Group” SH.P.K dhe “Al Trade” SH.P.K. Akti akuzues, thotë se me këtë rast është dëmtuar Komuna e Drenasit dhe është dashur të paguaj përmes përmbaruesit privat shumë prej 17.043.50 euro. Ndërsa, për projektin për ndërtimin e depos për dru dhe thëngjill në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët “Rasim Kiçina” në Drenas, thuhet se është dashur të paguaj shumë prej 8.454.31 euro.

Procesi 3 – Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 29 nëntor 2018 për këtë rast në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Tahiraj ishte deklaruar i pafajshëm për akuzat me të cilat ngarkohet.¹⁵⁹

Ndërsa pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë, trupi gjykues i udhëhequr nga gjykatësja Naime Krasniqi-Jashanica, vendosi që Tahiraj në mungesë të provave të lirohet nga akuza që e ngarkonte atë¹⁶⁰.

¹⁵⁷ “Ish-kryetari i Drenasit dhe ish-drejtori i Arsimit lirohen nga akuza për keqpërdorim detyre” Betimi për Drejtësi. 28 janar 2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-drenasit-dhe-ish-drejtori-i-arsimit-lirohen-nga-akuza-per-keqpërdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁵⁸ Shënim: Ky vendim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit. “Gjykimi për korrupsion, Apeli vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të Drenasit dhe ish-drejtorit të Arsimit në këtë komunë”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-korrupsion-apeli-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-drenasit-dhe-ish-drejtorit-te-arsimit-ne-kete-komune/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020.).

¹⁵⁹ “Ish-drejtori i Arsimit në Drenas deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim detyre”. Betimi për Drejtësi. 30 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-drenas-deklarohet-i-pafajshem-per-keqpërdorim-detyre/?fbclid=IëAR0ZX106RBrq0cmKAkëxucEë8EkeCIFNZg2kMUNtESblakACa6ëmcUBX86QI>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁶⁰ “Ish-drejtori i Arsimit në Drenas lirohet nga akuza lidhur me investimet në dy shkolla”. Betimi për Drejtësi. 30 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-drenas-lirohet-nga-akuza-lidhur-me-investimet-ne-dy-shkolla/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



HALIM GECAJ

1800 euro
gjobë

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajt

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë

Faza procedurale: 1800 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Mitrovicës, nga 17 nëntori 2010 e deri më 08 korrik 2013, Halim Gecaj akuzohet se në cilësinë e drejtorit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajt ka tejkalluar kompetencat e tij me qëllim që tjetrit t’i sjellë dobi pasurore. Këtë e kishte bërë në atë mënyrë që në kundërshtim me ligjet u kishte dhënë në shfrytëzim personave pronat e Komunës, pa miratimin e Kuvendit Komunal. I pandehuri në këtë mënyrë kishte dhënë në shfrytëzim plot 37 prona.

Procesi – Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 23 tetor 2017 e kishte shpallur fajtor Gecajn dhe të njëjtin e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim. Me pajtimin e të akuzuarit, dënimi me burg i ishte zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej 1800 euro.¹⁶¹ Dënimin ndaj Gecajt e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.¹⁶²

¹⁶¹ “Dy zyrtarë të Komunës së Skënderajt dënohen me burg, tre të tjerë lirohen nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dy-zyrtare-te-komunes-se-skenderajt-denohen-me-burg-tre-te-tjere-lirohen-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁶² “Kosneti pas raportimit të KTV-së: Emërimi i të dënuarit për korrupsion në postin e drejtorit ligjor në MIN, ofendim për qytetarët”. Koha.net. 15 qershor 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/168881/kosneti-pas-raportimit-te-ktv-se-emerimi-i-te-denuarit-per-korrupsion-ne-postin-e-drejtorit-ligjor-ne-min-ofendim-per-qytetaret/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1800 euro
gjobë



LULZIM KADRIU

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajt

Veprat penale: “Këqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë

Faza procedurale: 1800 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Lulzim Kadriu, akuzohej se në cilësinë e drejtorit për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajt, nga 31 marsi 2014 deri më 15 shkurt 2015, kishte dhënë me qira katër lokale pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Procesi – Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 23 tetor 2017 e kishte shpallur fajtor Kadriun dhe të njëjtin e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim. Me pajtimin e të akuzuarit, dënimi me burg i ishte zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej 1800 euro.¹⁶³ Dënimin ndaj Kadriut e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.¹⁶⁴

¹⁶³ “Dy zyrtarë të Komunës së Skënderajt dënohen me burg, tre të tjerë lirohen nga akuza”. Betimi për Drejtësi. 23 tetor 2017 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dy-zyrtare-te-komunes-se-skenderajt-denohen-me-burg-tre-te-tjere-lirohen-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁶⁴ “Kosnetti pas raportimit të KTV-së: Emërimi i të dënuarit për korrupsion në postin e drejtorit ligjor në MIN, ofendim për qytetarët”. Koha.net 15 qershor 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/168881/kosnetti-pas-raportimit-te-ktv-se-emerimi-i-te-denuarit-per-korrupsion-ne-postin-e-drejtorit-ligjor-ne-min-ofendim-per-qytetaret/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces

2.
Lirim



NEXHAT ÇOÇAJ

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Arsimit, Komuna e Prizrenit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Në proces; 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Nexhat Çoçaj, akuzohej se gjatë periudhës kohore maj-qershor të vitit 2008 në Prizren, si person zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij me qëllim të fitimit të kundërligjshëm pasuror për vete, në atë mënyrë që si kryetar i këshillit organizativ i manifestimit “Java e Remzi Ademajt” në xhirollogarinë e tij bankare alokohet shuma 12 mijë e 803 euro nga Komuna e Prizrenit. Nexhat Çoçaj, po ashtu akuzohej se duke qenë kryetar i këshillit organizativ, ka bërë furnizime nga firma “Bogdani” pronar i së cilës është vet ai dhe ka tërhequr para nga xhirollogaria e tij, pa iu ditur destinacioni, duke e tejkaluar buxhetin e lejuar në shumën prej mbi 4000 eurove, pa vendim përkatës të komunës.

Procesi 1 – Gjykata Themelore në Prizren, më 19 nëntor 2018, pas një procesi të rigjyimit, e kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare, ish-drejtorin e Arsimit në Komunën e Prizrenit, Nexhat Çoçaj i cili akuzohej se periudhën kohore prej 2008-2012, e ka keqpërdorur detyrën zyrtare gjatë realizimit të manifestimit tradicional “Remzi Ademaj”, në Prizren, Kurse, për pikën 1 të aktakuzës, me të cilan akuzohej se kishte tejkaluar buxhetin e lejuar në shumën prej mbi 4000 euro, pa vendim përkatës të komunës, ndaj Cocaj ishte marr aktgjykim refuzues, pasi prokurori Mehdi Sefa, kishte hequr dorë nga ndjekja penale, me arsyetimin se ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.¹⁶⁵

¹⁶⁵ “Pas rigjyimit, ish-drejtori i Arsimit në Prizren dhe dy të tjerët lirohen nga akuza se keqpërdoren mjetet për javën e dëshmorit”. Betimi për Drejtësi. 19 nëntor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjyimit-ish-drejtori-i-arsimit-ne-prizren-dhe-dy-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-se-keqperdoren-mjetet-per-javen-e-deshmorit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Mirëpo, pas ankesës së prokurorisë, Apeli e ka kthyer përsëri në rigjykim këtë rast, i cili është akoma duke vazdhur.

Ndryshe, në gjykimin e parë që kishte përfunduar në qershor të vitit 2016, Nexhat Çoçaj ishte dënuar me tre vjet burgim efektiv. Mirëpo, më 27 shtator 2016, Gjykata e Apelit, kishte aprovuar ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve dhe ka kthyer lëndën në shkallën e parë për ri-vendosje.

Aktakuza 2 - Nexhat Çoçaj akuzohej se kishte punësuar profesorin Besnik Krasniqi, në gjimnazin “Gjon Buzuku”, pa konkurs publik. Çoçaj akuzohej se ia ka lidhur Besnik Krasniqit, kontratën e punës në mënyrë të kundërligjshme, pasi që nuk kishte shpallur konkurs publik për atë vend të punës.

Procesi 2 - Ish-drejtori për Arsim në Komunën e Prizrenit, Nexhat Çoçaj, më 27 shkurt të vitit 2017, ishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare nga Gjykata Themelore në Prizren. Në dhjetor 2017, aktgjykimin e Themelores e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.¹⁶⁶

¹⁶⁶ “Apeli liron përfundimisht nga akuza për korrupsion ish-drejtorin e Arsimit në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 9 janar 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-liron-perfundimisht-nga-akuza-per-korrupsion-ish-drejtorin-e-arsimit-ne-prizren-nexhat-cocaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



XHEMALI HAXHIMUSTAFA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Kuvendit Komunal në Rahovec/Nënkryetar i Komunës së Rahovecit

Veprat penale: “Keqpërdorim i detyrës zyrtare apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Haxhimustafa akuzohet nga prokuroria se më 30 tetor 2012, si Kryetar i Kuvendit Komunal të Rahovecit, kishte tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, ashtu që pas diskutimit në Kuvendin Komunal është marrur vendim që tregu i gjelbër në Rahovec, Krushë e Madhe dhe në Ratkoc, tu jepen në shfrytëzim veteranëve të luftës në afat të caktuar prej 12 muajve, pa e proceduar procedurën e tenderimit siç e parasheh udhëzimi administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Me këtë rast, sipas prokurorisë, dëmi i shkaktuar Komunës së Rahovecit është 6.218,50 euro.

Procesi – Pasi Gjykata Themelore në Gjakovë, kishte përfunduar shqyrtimin gjyqësor, kjo gjykatë më 2 dhjetor 2015, kishte liruar nga aktakuza Haxhimustafën, i cili vendim edhe ishte bërë i plotfuqishëm¹⁶⁷.

¹⁶⁷ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjakovë Lekë Muçaj. 21.05.2020



BUJAR HASANI

1.
Lirim

2.
Hudhje

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Inspektoratit në Komunën e Prizrenit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar” 2. Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”

Gjykata: 1-2. Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Hudhje (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza 1. Prokuroria Themelore në Prizren, më 31 gusht 2017, ka ngritur aktakuzë ndaj të pandehurit Hasani, i cili akuzohet se si drejtor i inspektoratit, nuk ka vepruar për të larguar konstruksionin metalik të lokalit “Fellas”, të ndërtuar kundërligjshëm në Zonën Historike të Prizrenit, e pronar i të cilit lokal është vet ai.

Procesi 1. Në mungesë të provave, Gjykata Themelore e Prizrenit, më 26 shkurt 2018 kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit Hasani¹⁶⁸, i cili vendim është bërë i formës së prerë më 6 shtator 2018

Aktakuza 2. Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, i pandehuri Hasani, së bashku me dy persona të tjerë akuzoheshin se kishin zvarritur nxjerrjen e konkluzionit për largimin e objekteve të të akuzuarve B.B dhe A.O, të vendosura në mënyrë të paligjshme në pronë shoqërore.

Procesi 2. Gjykata e Apelit, më 28 maj 2018 kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore të Prizrenit, me të cilën ishte atakuar vendimi i Gjykatës Themelore në Prizren për hudhjen e aktakuzës ndaj të akuzuarit Hasani. Vendimin e shkallës së parë, më pas e ka konfirmuar edhe shkalla e dytë¹⁶⁹.

¹⁶⁸ Shpallet i pafajshëm ish-drejtori i Inspektoratit në Komunën e Prizrenit, Bujar Hasani, Betimi për Drejtësi, 26 shkurt 2018, (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-drejtori-i-inspektoratit-ne-komunen-e-prizrenit-bujar-hasani/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁶⁹ Apeli konfirmon hudhjen e aktakuzës për korrupsion ndaj ish-drejtorit të Inspektoratit në Prizren, Betimi për Drejtësi, 19 qershor 2018, (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-hudhjen-e-aktakuzes-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-te-inspektoratit-ne-prizren/?fbclid=IwAR1xgëë TRIHc Sv5A31yjh6DPo0zPDLËIro13VxdOF t5LuI NP7KSYDjU>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

600 euro
gjobë**RIZA ABDYLI****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Asamblist në Komunën e Gjilanit**Veprat penale:** “Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjilan**Faza procedurale:** Gjobë 600 euro (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjilan, më 22 gusht 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit Abdyl, me arsyetimin se ai në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, Këshilltar i Asamblesë Komunale në Gjilan, duke qenë i detyruar me ligj të bëjë deklarin e pasurisë për vitin 2018, dhe atë brenda periudhën kohore prej 1 deri më 31 mars 2019, edhe pse i akuzuari ka qenë i informuar për këtë obligim, ai nuk e ka bërë një gjë të tillë brenda afatit ligjor.

Procesi - Gjykata Themelore e Gjilanit, më 4 dhjetor 2019, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Abdyl, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600 euro.¹⁷⁰

¹⁷⁰ “Pranon fajësinë, asamblisti në Gjilan dënohet me 600 euro gjobë për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 4 dhjetor 2019. (Shih linkun https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-asamblisti-ne-gjilan-denohet-me-600-euro-gjobe-per-mos-deklarim-te-pasurise/?fbclid=IëAR152MkSsSULiId69i_Ëob3jHI1_kmi20cc0TvTëFgDtdotXjYNpLAzrQLc). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



IDRIZ HYSENAJ

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Infrastrukturës Publike në Komunën e Drenasit

Veprat penale: “Ndotja e ujit të pijshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Drenas

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 29 shtator 2019, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri Hysenaj, drejtori i Drejtorisë së Infrastrukturës Publike në Komunën e Drenasit, nuk ka ndërmarrë veprime konkrete për evitimin e rrjedhës së ujërave të zeza, të cilat rrjedhin në përroin në afërsi prej dy-tre metra afër pusit të ujit të pijshëm, në pronën e të dëmtuarit M.K. Sipas aktakuzës, ujërat e kanalizimit kanë vërshuar dhe kanë hyrë në pusin e të dëmtuarit, duke e ndotur ujin e pijshëm.

Procesi - Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 10 janar 2020, ish-drejtori i Infrastrukturës Publike në Komunën e Drenasit, Idriz Hysenaj, ka kërkuar që të hudhet poshtë aktakuza ndaj tij.¹⁷¹

¹⁷¹ “Ish-drejtori në Drenas akuzohet se gjatë implementimit të projektit të kanalizimit ishte ndotur uji i pijes për një familje”. Betimi për Drejtësi. 10 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-ne-drenas-akuzohet-se-gjate-implementimit-te-projektit-te-kanalizimit-ishte-ndotur-uji-i-pijes-per-nje-familje/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

	HASAN SHALA Partia: PDK Pozita shtetërore: Drejtor i Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Skenderajt Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë Faza procedurale: Në proces
---	---

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë, të ngritur më 15 korrik 2016, i pandehuri Shala, në cilësinë e drejtorit të Urbanizimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit në Komunën e Skenderajt, si dhe S.A si inxhinierë e arkitekturës në këtë drejtori, po akuzohen se duke shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar kanë tejkaluar kompetencat e tyre me qëllim që të përfitojë dobi pasurore personi tjetër dhe atë organizata e biznesit NNSH” ILEAA-GR”. Bazuar në aktakuzë, e akuzuara Sanije Ahmeti si mbikëqyrëse e punimeve të projektit për rregullimin e parkut “Te pishat” në Skenderaj më 28 shtator 2011, ka kërkuar nga zyra e prokurimit që të bëhet riformatimi – ndryshimi i pozicioneve të parapara me kontratën numër 643-11-033-521, të datës 21 korrik 2011. Sipas prokurorisë, kontrata ishte e nënshkruar në mes Komunës së Skenderajt dhe kompanisë NNSH” ILEAA-GR” në Skenderaj, për rregullimin e pishave të parkut në Skenderaj në vlerë prej 88.004,00 euro. Kurse, i akuzuari Shala, sipas aktakuzës, më 4 tetor 2011, ka marr vendim me anë të së cilit është aprovuar kërkesa, duke ndryshuar pozicionet e punës së rrethojës të parapara me kontratë me zëvendësimin e platosë më kubeja dhe murit mbrojtës për punime në terren edhe pse kompania NNSH” ILEAA-GR” kishte filluar realizimin e punëve sipas kontratës.

Procesi - I akuzuari Shala, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 14 janar 2019, është deklaruar i pafajshëm, ndërsa ky rast kishte filluar gjykimin rishtasi për shkak të ndërrimit të njërit nga anëtarët e trupit gjykues. Gjykimi në këtë rast është shtyrë në kohë të pacaktuar.¹⁷²

¹⁷² “Gjykata i drejtohet KGJK-së për verifikimin e ekspertit në gjykimin ndaj ish-drejtorit dhe zyrtares në Skenderaj”. Betimi për Drejtësi. 9 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-i-drejtohet-kgjk-se-per-verifikimin-e-ekspertit-te-ndertimtarise-ne-gjykimin-ndaj-ish-drejtorit-dhe-zyrtares-ne-skenderaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



LULZIM RIFAJ

1. 1
muaj
burg me
kusht

2.
Lirim

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Konsull në Ambasadën e Kosovës në Bullgari

Veprat penale: 1. “Mos raportim ose raportim i rreme i pasurisë ,i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Prishtinë; 2. Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: 1. Dënim – Një muaj burg me kusht (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza 1- Lulzim Rifaj akuzohet se në cilësinë e Konsullit në Ministri të Punëve të Jashtme në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Sofje, edhe pse ka qenë i njoftuar nga zyrtari kontaktues, që i njëjti brenda afatit prej 30 ditëve si afat ligjor ta bëjë deklarinimin e pasurisë për periudhën kohore nga 1 deri më 31 mars 2015 për vitin paraprak nga janari e deri më 31 dhjetor të vitit 2014, mirëpo i pandehuri një obligim të tillë nuk e ka përmbushur.¹⁷³

Procesi 1 - Me datë 22. Shkurt 2016 gjyqtarja Albina Rama Shabani kishte shpallur aktgjykimin dhe i kishte shqiptuar dënim me burg me kusht në kohëzgjatje prej një muaji, të cilin dënim nuk e mban në rast se në periudhën prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale, vendim që është bërë i plotfuqishëm me datë 13 janar 2017.¹⁷⁴

Aktakuza 2 - Lulzim Rifaj, akuzohej lidhur me bartjen e pronës shoqërore, patundshmërinë në sipërfaqe prej 29,7 hektarësh prej pronarit të ndërmarrjes shoqërore “Sharr Prodhim” në pronë të KK të Dragashit. që paraprakisht e kishte vënë në rend dite të Asamblesë Komunale, duke bindur deputetët që të marrin një vendim të tillë, edhe pse e kishte ditur se është në kundërshtim me ligjet pozitive në fuqi, pasi menaxhimi i pronës shoqërore me ligj i përket AKP-së.

Procesi 2 – Në janar 2015, në mungesë të provave, Lulzim Rifaj ishte shpallur i pafajshëm nga Gjykata Themelore në Prizren¹⁷⁵, i cili vendim u bë i formës së prerë.

¹⁷³ “Shtyhet gjykimi ndaj Lulzim Rifaj, i akuzuar për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2016. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-ndaj-lulzim-rifaj-i-akuzuar-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁷⁴ Shënim: Përgjigje e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi për IKD. 27 gusht 2019.

¹⁷⁵ “Shpallet i pafajshëm Salim Jenuzi”. Gazetaexpress.com. 22 janar 2015. (Shih linkun: <https://www.gazetaexpress.com/lajme-shpallet-i-pafajshem-salim-jenuzi-75261/?fbclid=IeAR2c6K1toqOX-MqRX3FeyXtGqyKbnQahJKH55tR-hTSpFHkeM1ëfoXY6sMs>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ILIR BEQIRI

Në
proces

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunen e Gjakovës

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, e ngritur më 16 mars 2018, Ilir Beqiri po akuzohet se nga 1 marsi e deri më 31 mars 2017, nuk e ka bërë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, dhuratave, të dobisë tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, edhe pse e ka ditur se si këshilltar në Asamblenë Komunale në Gjakovë, është i detyruar që konform ligjit, të dhënat e cekura t’i dërgojë në afatin ligjor në Agjencinë Kundër Korrupsion në Prishtinë, por i pandehuri duke mos respektuar ligjin, të dhënat e kërkuara në formular nuk i ka paraqitur saktë duke mos shënuar totalin e saktë e të hyrave vjetore për periudhën kohore nga 1 janari deri më 31 dhjetor të vitit 2016.

Procesi - Procesi gjyqësor ndaj ish-këshilltarit komunal të Gjakovës Ilir Beqiri kishte filluar me 26 shkurt 2019, ku ai në seancën fillestare ishte deklaruar i pafajshëm. Beqiri, në shqyrtimin e dytë të mbajtur më 2 prill 2019, kishte kërkuar që të hudhet aktakuza ndaj tij.¹⁷⁶ Pas kësaj seance ishte konfirmuar aktakuza ndërsa shqyrtimi gjyqësor është akoma duke vazhduar.

¹⁷⁶ “Ish-asamblisti i PDK-së në Komunën e Gjakovës kërkon hudhjen e aktakuzës për mos raportim të pasurisë” Betimi për Drejtësi. 2 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-asamblisti-i-pdk-se-ne-komunen-e-gjakoves-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes-per-mos-raportim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

750
euro
gjobë



FATMIR RUDARI

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Podujevës

Veprat penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 250 euro gjobë dhe tre muaj burgim të cilat i ka zëvendësuar me 500 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Këshilltari komunal i Podujevës Faim Rudari, sipas aktakuzës së 17 dhjetorit 2018, akuzohet se më 1 mars deri më 13 mars 2018, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, si asamblist i Kuvendit Komunal të Podujevës, edhe pse ka qenë i detyruar të bëjë deklarin e pasurisë, të të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare, i njëjti brenda afatit ligjor nuk e ka deklaruar pasurinë për periudhën kohore nga data 01-31 dhjetor 2017.

Procesi - Rudari, në seancën e 20 marsit 2019 e kishte pranuar fajësinë, ndërsa Gjykata Themelore në Prishtinë, dy ditë më pas e kishte shpallur aktgjykimin sipas të cilit Rudari, u dënua me tre muaj burgim të cilin ai e zëvendësoi në 500 euro gjobë dhe me dënim të dytë me gjobë prej 250 euro, në një vlerë të përgjithshme prej 750 euro.¹⁷⁷

¹⁷⁷ “Këshilltari komunal në Podujevë dënohet me burg dhe me gjobë për mos deklarim të pasurisë” Betimi për Drejtësi. 22 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/keshilltari-komunal-ne-podujeve-denohet-me-burg-dhe-me-gjobe-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

	ADEM ABAZI Partia: PDK Pozitat shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Novobërdës Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)
---	--

Aktakuza - Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Gjilan e ngarkonte Adem Abazin se në cilësi të drejtorit të Arsimit në Komunën e Novobërdës ka kryer veprën penale të keqpërdorim të detyrës apo autoritetit zyrtar. Sipas aktakuzës, Abazi duke shfrytëzuar pozitën e tij dhe me qëllim që vetit apo tjetrit t’i sjell dobi të kundërligjshme ligjore ka punësuar punëtorë të rinj në arsim duke mos respektuar procedurat ligjore. Në aktakuzë thuhet se edhe pse këta punëtorë kishin qenë fiktiv, të njëjtit kishin realizuar paga mujore, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Republikës së Kosovës në shumë prej 12.035 euro.

Procesi - Pjesë e kësaj aktakuze të prokurorisë ishte edhe kryetari i Komunës së Noveberdes Svetislav Ivanović dhe dy zyrtar të kësaj komune por ata në marsin e vitit 2017 kishin bërë marrëveshje për pranimin e fajësisë dhe ishin dënuar me gjobë, ndërsa Abazi nuk e kishte pranuar fajësinë dhe më 18 prill 2018, Gjykata atë në mungesë të provave e kishte liruar nga akuza.¹⁷⁸ Më 30 tetor 2018, ky aktgjykim i Themelores ishte vërtetuar edhe nga ana e Gjykatës së Apelit.¹⁷⁹

¹⁷⁸ “Lirohet nga akuza për korrupsion drejtori i Arsimit në Komunën e Novobërdës” Betimi për Drejtësi. 8 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-drejtori-i-arsimit-ne-komunen-e-novoberdes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁷⁹ Shënim: Përgjigja e zëdhënsit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Sabit Shkodra.

100
euro
gjobë



GRANIT RIFAJ

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Dragash

Veprat penale: “Mos raportim ose raportim i rreme i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren, dega në Dragash

Faza procedurale: Dënim - 100 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 7 shtator 2018, nga Prokuroria Themelore në Prizren, i pandehuri Granit Rifaj, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, asamblist në Komunën e Dragashit, nuk e ka përmbushur detyrimin ligjor për deklarimin e të ardhurave, dhuratave, dobisë pasurore ose detyrimeve financiare. Sipas aktakuzës, këtë deklaram është dashur ta bëjë në vitin 2016, në Agjencinë Kundër Korrupsionit në Prishtinë, në afatin e paraparë me ligj.

Procesi - Asamblisti i Komunës së Dragashit, Granit Rifaj, ishte dënuar me 100 euro gjobë, për mos deklaram të pasurisë. Aktgjykimi ndaj tij, ishte shpallur më 26 qershor 2019, në Gjykatën Themelore në Prizren, dega në Dragash, pasi që i akuzuari Rifaj, e kishte pranuar fajësinë.¹⁸⁰

¹⁸⁰ “Pranon fajësinë për mos deklaram të pasurisë, asamblisti në Dragash, dënohet me 100 euro gjobë”. Betimi për Drejtësi. 26 qershor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-fajesine-per-mos-deklaram-te-pasurise-asamblisti-ne-dragash-denohet-me-100-euro-gjobe/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

6 muaj
burgim me
kusht dhe
400 euro



IZET MORINA

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Kuvendin Komunal të Malishevës

Veprat penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë

Faza procedurale: Dënim - Gjashtë muaj burgim me kusht dhe 400 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 27 dhjetor 2017, Izet Morina, akuzohet se nga data 1 mars e deri më 31 mars 2017, në cilësinë e zyrtarit së lartë publike, respektivisht këshilltar në Asamblenë Komunale në Malishevë edhe pse ka qenë i detyruar ta bëjë deklarin e pasurisë, të ardhurave, dhuratave, dobisë tjetër materiale apo detyrimeve financiare, nuk ka deklaruar pasurinë për periudhën e vitit 2016, edhe pse këtë është dashur ta bëjë deri më datën 31.03.2017.

Procesi - Ish-asamblisti i Komunës së Malishevës, Izet Morina, i akuzuar për mos deklarim të pasurisë, të martën, me 21 maj 2019, ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, si dhe 400 euro gjobë nga Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, pasi që paraprakisht e kishte pranuar fajësinë. Mirëpo, dënimi me burg ndaj tij nuk do të ekzekutohet, nëse ai brenda periudhës verifikuese prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.¹⁸¹

¹⁸¹ “Ish asamblisti i Komunës së Malishevës dënohet me burgim me kusht dhe me gjobë për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 21 maj 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-asamblisti-i-komunes-se-malisheves-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

6 muaj
burgim**FLORIM SHKRETA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Këshilltar Komunal në Komunën e Hanit të Elezit**Veprat penale:** “*Mashtrim me votime*”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Ferizaj**Faza procedurale:** Dënim - Gjashtë muaj burgim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Ish-kandidati i PDK-së, për kryetar të Komunës së Hanit të Elezit, Florim Shkreta, akuzohej nga prokuroria për mashtrim në votime në zgjedhjet e vitit 2010. Sipas aktakuzës, Shkreta në një qendër votimi të fshatit Seqishtë të Hanit të Elezit kishte zvogëluar votat e tashmë presidentit Hashim Thaçi dhe kreut të Nismës Fatmir Limajt që atëherë ishte pjesë e PDK-së, ndërsa kishte shtuar votat e Azem Sylës dhe Hajredin Kuçit.

Procesi - Gjykata Themelore në Ferizaj, më 11 mars 2014, e kishte shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit në votime, Florim Shkretën dhe të njëjtin e kishte gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej gjashtë muaj.¹⁸², të cilin dënim edhe e kishte mbajtur.

¹⁸² “PDK kandidon në Han të Elezit të dënuarin për mashtrim me vota, Shkreta thotë se akuza ishte montim”. Telegrafi.com. 16 shtator 2017 (Shih linkun: <https://telegrafi.com/pdk-kandidon-ne-han-te-elezit-te-denuarin-per-mashtrim-vota-shkreta-thote-se-akuza-ishte-montim/>)

Refuzim



ARTAN LOSHAJ

Partia: PDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Dragashit

Veprat penale: “Kanosje”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren, dega Dragash

Faza procedurale: Refuzim (Aktgjykimi i formës së prerë)

Aktakuza -Artan Loshaj, ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren me 23 nëntor 2016, me pretendimin se ai në lokalet e Kuvendit Komunal në Dragash ishte fjalosur me këshilltarin komunal, nga radhët e LDK-së Samedin Xheladini, të cilin e kishte kanosur me fjalët “mbylle gojën se ti thej turitë”.

Procesi - Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash, më 11 dhjetor 2017, e kishte refuzuar aktakuzën ndaj tij, pasi i dëmtuari Xheladinin, kishte hequr dorë nga ndjekja penale, çka e kishte detyruar prokurorin që të edhe ai të tërhiqet nga aktakuza.¹⁸³

¹⁸³ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Dragash. 11.12.2017

Refuzim

**LULZIM BERISHA****Partia:** PDK**Pozita shtetërore:** Kryetar i Komisionit për Licencim të Firmave dhe Auditorëve Ligjor/Anëtar i Komisionit për Kontroll të Kualitetit**Veprat penale:** “Ndhmë në kryerjen e veprës penale keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Refuzim (Aktgjykimi i formës së prerë)

Aktakuza- Anëtari më i ri i PDK-së Lulzim Berisha, ishte pjesë e aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë më 28 dhjetor 2011. Ai pretendohet se si auditor i kompanisë “Imobiliare Friuli”, gjatë viteve 2007-2008 dhe 2009, i kishte ndihmuar pronarit të asaj kompanie Aziz Tafaj të i mashtroi tre shtetasit italian Gian Paolo Gortanit, Andrea Gortanit dhe Maia Teresa Tondato, të cilët ishin aksionar të kompanisë. Prokuroria ka pretenduar se Tafaj i kishte fryrë çmimet e paluettshmerive të blera nga kjo kompani, duke përvetësuar 2.270.524 euro.

Procesi - Edhe pse aktakuza ndaj Berishës dhe Tafajt ishte ngritur në fundin e vitit 2011, aktakuza e këtij rasti për Berishën, kishte marrë epilog vetëm për shkak të parashkrimit të veprës penale, në seancën e 7 majit 2019, për shkak të vjetërsimit të lëndës ishte pushuar procedura.¹⁸⁴

¹⁸⁴ “Gjykimi për korrupsion, shtetasi italian thotë se u dëmtua mbi dy milionë euro, për shkak të parashkrimit pushon procedura për njërin të akuzuar”. Betimi për Drejtësi. 7 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-korrupsion-shtetasi-italian-thote-se-u-demtua-mbi-dy-milione-euro-per-shkak-te-parashkrimit-pushon-procedura-per-njerin-te-akuzuar/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

II. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të LDK-së

Hudhje



LUTFI HAZIRI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Gjilanit; Zëvendëskryeministër/Ministër i Pushtetit Lokal

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza – Kryetari i Komunës së Gjilanit Lutfi Haziri, ishte akuzuar nga ana e PSRK-së. pasi pretendohet se duke ushtruar pozitën e Kryetarit të Komunës së Gjilanit, ai i kishte tejkaluar kompetencat e tij, me qëllim që për vete ose persona tjerë të përfitojnë çfarëdo dobie pasurore, duke shkelur të drejtat e pjesëmarrësve tjerë në një ankand publik, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Komunës së Gjilanit në vlerë prej 168,000.00 euro.

Procesi - Haziri, në seancën fillestare ndaj tij, të mbajtur më ishte deklaruar i pafajshëm për veprën penale me të cilën ngarkohej nga PSRK-ja¹⁸⁵, ndërsa Gjykata Themelore në Gjilan, më 28 tetor 2016, kishte marrë vendim që ta hudhte aktakuzën e PSRK-së me arsyetimin se nuk ka elemente të veprës penale me të cilën ngarkohej i akuzuari, duke bërë kështu që Haziri, të mos ketë nevojë fare që të ballafaqohet me provat e prokurorisë në një shqyrtim gjyqësorë.¹⁸⁶ Ky vendim më pas është bërë edhe i formës së prerë.

¹⁸⁵ “Kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-gjilanit-lutfi-haziri-deklarohet-i-pafajshem-per-keqpërdorim-te-pozites-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁸⁶ “Kryetari i Gjilanit Lutfi Haziri deklarohet i pafajshëm për keqpërdorim të pozitës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-gjilanit-lutfi-haziri-deklarohet-i-pafajshem-per-keqpërdorim-te-pozites-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



VALTON BEQIRI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit

Veprat penale: “Shpërdorim i pozitës apo autorizimit”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ish-ministri i MKRS-së Valton Beqiri ka qenë pjesë e aktakuzës së ngritur më 20 prill 2012 bashkë me ish-ministrin tjetër të MKRS-së Astrit Haraqija dhe dy producent filmik. Beqiri, që drejtoi këtë ministri në vitet 2008-2010 akuzohej se në shtator të vitit 2008 kishte lidhur një aneks-kontratë për të subvencionuar një projekt filmik, të kontraktuar më parë nga ish-ministri Haraqija që sipas prokurorisë ishte i kundërligjshëm. Ky subvencionim që nga prokuroria vlerësohej si dëm i buxhetit të ministrisë ishte në vlerë prej 100.000 euro.

Procesi - Në dhjetorin e vitit 2015, Beqiri, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me gjashtë muaj burgim me kusht, por rasti ishte kthyer për trajtim përsëri në këtë gjykatë pasi instanca e dytë gjyqësore më 2 qershor 2016, e kishte kthyer rastin në rigjykim. Por gjykata e Prishtinës më 15 dhjetor 2016, kishte vendosur që përsëri ta shpallë fajtor Beqirin, duke e dënuar atë me një vit burgim me kusht.¹⁸⁷

Pas ankesave ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit më 11 prill të vitit 2017, kishte aprovuar ankesën e Beqirit dhe e kishte liruar atë nga përgjegjësia penale me duke e konsideruar të pafajshëm për pretendimet e prokurorisë.¹⁸⁸

¹⁸⁷ “Dënohen me nga një vit burgim me kusht dy ish-Ministrat e Kulturës, Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri” ” Betimi për Drejtësi. 15 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-nga-nje-vit-burgim-me-kusht-dy-ish-ministrat-e-kultures-astrit-haraqija-dhe-valton-beqiri/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁸⁸ “Gjykata e Apelit e liron ish-ministrin e Kulturës, Valton Beqiri”. Betimi për Drejtësi. 2 qershor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-e-liron-ish-ministrin-e-kultures-valton-beqiri/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**SADRI FERATI****Partia:** Anëtar i LDK-së**Pozita shtetërore:** Deputet; Ministër i Administrimit të Pushtetit Lokal; Kryeshef ekzekutiv i Komunës së Mitrovicës**Vepra penale:** “Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Hudhje (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria e Qarkut e Mitrovicës, më 29 janar 2009 kishte akuzuar ish- ish-kryeshefin ekzekutiv të Komunës së Mitrovicës Sadri Feratin se gjatë kohës sa ka qenë duke ushtruar këtë funksion ka keqpërdorur detyrën e tij zyrtare, duke mos i dhënë banesë në objektin kolektiv të komunës të dëmtuarit Hasan Preteni, edhe pse ai plotësonte kushtet të merrte një banesë në këtë objekt.

Procesi - Pas ngritjes së aktakuzës, Gjykata e Qarkut në Mitrovicë, nuk i kishte dhënë prioritet zgjidhjes së këtij rasti, ndërsa në majin e vitit 2014 rasti kishte kaluar në kompetencë të misionit të Eulex-it, i cili mision kishte caktuar seancën gjyqësore më 7 gusht të vitit 2015.¹⁸⁹

Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 5 shkurt të vitit 2016, kishte hedhur poshtë aktakuzën ndaj Feratit dhe në këtë mënyrë edhe kishte pushuar procedurën.

¹⁸⁹ “Deputeti Sadri Ferati më 7 gusht del para Gjykatës së EULEX-it”. Telegrafi. 29 korrik 2015. (Shih linkun: <https://telegrafi.com/deputeti-sadri-ferati-me-7-gusht-del-para-gjykates-se-eulex-it/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**UKË RUGOVA**Në
proces**Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Deputet i Kuvendit të Kosovës**Vepra penale:** “Krim i organizuar”, “Kontrabandë me migrant”, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Ish-deputeti i Listës Rugova, Ukë Rugova tash e tre vite po përballlet në gjykatë me aktakuzën e përpiluar nga PSRK e Eulex-it më 18 maj 2016 për dyshime për dallavere me viza italiane. Në këtë rast ai akuzohet së bashku me ish-ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Astrit Haraqija dhe 18 persona tjerë se në bazë të një grupi kriminal kishin mundur që persona të ndryshëm të fitonin viza në zonën shengen. Në aktakuzë thuhet se Ukë Rugova nga të paktën muaji maj i vitit 2011 deri në muajin shkurt të vitit 2014 kishte krijuar, mbikëqyrur, menaxhuar dhe drejtuar aktivitete të një grupi të organizuar kriminal. Qëllimi kryesor i këtij grupi të organizuar kriminal pretendohet se kishte qenë përftimit material duke furnizuar individë me viza shengen të BE-së, nga Ambasada Italiane në Prishtinë, të cilat pretendohet se ishin marrë në mënyrë të kundërligjshme ose përmes shtrembërimit apo korrupsionit.

Procesi - Ky rast është përcjell me seanca të dështuara pasi që ka kaluar te gjykatësit vendor në vitin 2018.^{190 191} Në seancën e fundit të mbajtur më 3 korrik të viti 2019, gjykata ka marrë vendim që të veçoj procedurën për pesë të akuzuar në këtë rast duke përfshirë ish-deputetin Rugova, me qëllim të efikasitetit të procedurës, ky gjykim është akoma duke vazhduar

¹⁹⁰ “Rasti i Ukës Rugovës dorëzohet te vendorët, caktimi i seancave në pritje të përgjigjes nga Supremja”. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-ukes-rugoves-dorezohet-te-vendoret-caktimi-i-seancave-ne-pritje-te-pergjigjes-nga-supremja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁹¹ “Gjykata nuk e ka prioritet gjykimin e Ukë Rugovës dhe të tjerëve, për rreth tetë muaj nuk caktohet asnjë seancë”. Betimi për Drejtësi. 12 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-nuk-e-ka-prioritet-gjykimin-e-uke-rugoves-dhe-te-tjereve-per-rreth-tete-muaj-nuk-caktohet-asnje-seance/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



NASER OSMANI

Partia: Deputet i LDK-së

Pozita shtetërore Deputet, Nënkyetar i Bordit të Drejtorëve të AKP-së

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” 2. “Shpërdorimi”, “Shmangie nga tatimi”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces 2. Në proces

1. Në proces

2. Në proces

Aktakuza 1 - PSRK më 16 shkurt 2016, kishte ngritur aktakuzë kundër deputetit Naser Osmani si nënkryetari i Bordit të Drejtorëve të Agjencionit Kosovar të Privatizimit (AKP) dhe gjashtë zyrtarëve të tjerë të AKP-së si dhe një biznesmeni, nën dyshimin se ata i kanë kaluar kompetencat zyrtare me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë për vete ose për personin tjetër. Ata akuzohen se kanë shkelur të drejtat e punëtorëve të kësaj ndërmarrje, me çka njëkohësisht i kanë shkaktuar dëm Ndërmarrjes Shoqërore “FAN” e përfaqësuar nga AKP-ja si dhe buxhetit të shtetit, lidhur me çështjen e Ndërmarrjes së Re “FAN-Podujevë”, në vlerë prej 5,400,000.00 euro

Procesi 1- Pas 23 seancave gjyqësore, pesë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin dhe gati tre vjet pas ngritjes së aktakuzës, më 8 shkurt 2019, deputeti Naser Osmani dhe të akuzuarit tjerë zyrtarë të AKP-së për rastin e njohur si “FAN”, që ishte edhe rast i shënjestruar për liberalizimin e vizave, në mungesë të provave ishin shpallur të pafajshëm, ndërsa me një vit burgim ishte dënuar biznesmeni i cili ishte pjesë e kësaj aktakuze.¹⁹²

Mirëpo, pas ankesës së PSRK-së, Gjykata e Apelit më 4 mars 2020, me arsyetimin se vendimi i shkallës së parë ishte përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike¹⁹³. Procesi i rigjyimit nuk ka filluar akoma.

¹⁹² “Deputeti Naser Osmani dhe të tjerët shpallen të pafajshëm për keqpërdorim pozite, dënohet Agim Deshishku” Betimi për Drejtësi. 8 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-naser-osmani-dhe-te-tjeret-shpallen-te-pafajshem-per-keqpërdorim-pozite-dënohet-agim-deshishku/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁹³ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e Naser Osmanit dhe të tjerëve, vërteton dënimin ndaj biznesmenit, Agim Deshishku”. Betimi për Drejtësi. 4 mars 2020. (Shih linkun : <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne->

Aktakuza 2 - Përpos rastit “FAN”, Osmani është duke u akuzuar edhe në rasti e njohur si “fondi i 3%”, së bashku me ish-kryeministrin e Kosovës në ekzil Bujar Bukoshin dhe Atdhe Gashin. PSRK me aktakuzën e 28 prillit 2017, pretendon se Osmani dhe dy të tjerët, në periudhën 2006-2015, në bashkëkryerje me njëri-tjetrin kanë përvetësuar me pasurinë e qytetarëve të Kosovës që kanë punuar jashtë shtetit, i njohur ndryshe si fondi e 3%-shit. Me këto veprime dyshohet se i kanë shkaktuar dëm në shumën prej 154,132.47 euro.

Ai me këtë aktakuzë është akuzuar edhe me veprën penale “Shmangie nga tatimi”.¹⁹⁴

Procesi 2 - Edhe pse aktakuza ndaj tre të pandehurve ishte ngritur në prill të vitit 2017, publiku e kishte marrë vesh për këtë aktakuzë vetëm pas dy viteve kur ishte bërë publike në media në marsin e këtij viti.¹⁹⁵

Kjo lëndë fillimisht ishte ndarë në punë gjykatëse Albina Shabani–Rama, e cila më 23 maj 2018, kishte mbajtur shqyrtimin fillestar ndaj të akuzuarve në të cilin Osmani ishte deklaruar i pafajshëm. Po në këtë seancë, gjykatësja kishte marrë vendim për veçimin e procedurës penale ndaj Bujar Bukoshit, me arsyetimin se ai ishte i sëmurë dhe nuk kishte mundur të paraqitej në këtë shqyrtim fillestar.¹⁹⁶, ndërsa ky gjykim është akoma duke vazhduar.¹⁹⁷

[rigjykim-rastin-e-naser-osmanit-dhe-te-tjereve-verteton-denimin-ndaj-biznesmenit-agim-deshishku/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁹⁴ *Shënim*: Naser Osmani, akuzohet se në periudhën kohore prej vitit 2008-2013, në cilësinë e personit të punësuar në “UFORK”, me qëllim të shmangies pjesërisht apo tërësisht, pagesës së tatimit, tarifave apo kontributeve të tjera që kërkohen me ligj, nuk i ka përfshirë të dhënat lidhur me të ardhurat e tij të fituara përmes transaksioneve, në emër të pagave dhe të të hyrave të tjera, e të cilat ka qenë i obliguar që këto të ardhura ti deklaronte në ATK, si pasojë është dëmtuar buxheti i ATK-së – Republikës së Kosovës, me 3,150,00 euro.

¹⁹⁵ “Aktakuzë për keqpërdorim me Fondin e 3-përqindëshit kundër Bukoshit, Osmanit e Gashit” Koha.net. 30 mars 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/arberi/153679/aktakuze-per-keqpërdorim-me-fondin-e-3-perqindëshit-kunder-bukoshit-osmanit-e-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

¹⁹⁶ *Shënim*: Gjykatësja Shabani-Rama, më 3 dhjetor 2018, kishte marrë vendim që të refuzoheshin kërkesat për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Lidhur me këtë, të akuzuarit Osmani dhe Gashi, kishin ushtruar ankesë ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, e cila më 17 janar 2019, kishte refuzuar këto ankesa, duke konfirmuar aktakuzën në fjalë. Ndërsa, më 18 janar 2019, kjo lëndë i ishte ndarë në punë gjykatëse së Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Medie Bytyqi dhe më 13 mars të këtij viti, kjo lëndë nga Apeli, ishte kthyer në zyrën e kësaj gjykatëseje

¹⁹⁷ *Shënim*: Gjykata Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm, më 11 nëntor 2020, ka shpallur fajtor Osmanin, duke e dënua atë me tre (3) vite burgim. “Dënohen me 3 vite burgim për shpërdorim të akuzuarit në rastin e njohur si “Fondi 3%”. Betimi për Drejtësi. 11 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-3-vite-burgim-per-shpërdorim-te-akuzuarit-ne-rastin-e-njohur-si-fondi-3/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Refuzim2. Në
proces**ASTRIT HARAQIJA****Partia:** LDK**Pozita shtetërore** Deputet; Ministër; Zëvendësministër i Financave**Veprat penale:** 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”
2. “Krim i organizuar”, “Kontrabandë me migrant”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** 1. Refuzim/Parashkrim (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Në proces

Aktakuza 1- Astrit Haraqija ka qenë ministër i Kulturës, Rinisë dhe Sportit në mandatin qeverisës 2004-2007, por ai më 20 prill 2012 ishte akuzuar nga prokuroria për dyshimet se gjatë kësaj periudhe ai në cilësi të ministrit kishte subvencionuar dy projekte filmike, njeri nga të cilët nuk ishte punuar fare, pa shpallur fare konkurs për projekte filmike. Këto subvencione sipas prokurorisë i kanë kushtuar buxhetit të shtetit mbi 535,000 euro.

Procesi 1 - Pjesë e aktakuzës së bashku me Haraqijën kanë qenë edhe ish-ministri Valton Beqiri dhe dy producent filmik. Në dhjetorin e vitit 2015, Haraqija ishte gjetur fajtor dhe ishte dënuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë me gjashtë muaj burgim me kusht, por rasti ishte kthyer për trajtim përsëri në këtë gjykatë pasi instanca e dytë gjyqësore më 2 qershor 2016, e kishte kthyer rastin në rigjykim.

Themeloria më 15 dhjetor 2016, kishte vendosur që përsëri ta shpallë fajtor Haraqijën, duke e dënuar atë me një vit burgim me kusht.¹⁹⁸, por ky dënim në prill të vitit 2017 ra përsëri poshtë nga Apeli, pasi vepra ndaj tij kishte arritur afatin e parashkrimit absolut dhe në këtë mënyrë kishte pushuar procedura penale ndaj tij pa një vendim merit.

¹⁹⁸ “Dënohen me nga një vit burgim me kusht dy ish-Ministrat e Kulturës, Astrit Haraqija dhe Valton Beqiri” Betimi për Drejtësi. 15 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-nga-nje-vit-burgim-me-kusht-dy-ish-ministrat-e-kultures-astrit-haraqija-dhe-valton-beqiri/>) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në kohën kur ishte akuzuar, Haraqija ishte duke ushtruar funksionin e zëvendësministrit të Financave por pas kësaj aktakuze ai kishte dhënë dorëheqje nga kjo pozitë.¹⁹⁹

Aktakuza 2 - Haraqija, ka përfunduar një procedurë ndaj tij por ai aktualisht është duke i përballur me aktakuzën e ngritur nga misioni i Eulex-it, në të cilën bënë pjesë edhe ish-deputeti Ukë Rugova dhe 18 persona të tjerë, akuzohen për krim të organizuar dhe vepra të tjera penale duke pretenduar se ky grup, siç e cilëson kriminal, kishte për qëllim sigurimin e përfitimit material në atë mënyrë që qytetarët e Kosovës, të pajisen me viza shengen nga Ambasada Italiane në Prishtinë.


Procesi 2 - Ky rast është përcjell me seanca të dështuara pasi që ka kaluar te gjykatësit vendor në vitin 2018.^{200 201} Në seancën e fundit të mbajtur më 3 korrik të viti 2019, gjykata ka marrë vendim që të veçoj procedurën për pesë të akuzuar në këtë rast duke përfshirë Haraqijen dhe ish-deputetin Rugova, me qëllim të efikasitetit të procedurës, ndërsa seanca e radhës është caktuar për datën 14 shtator 2019.²⁰² Ky gjykim është akoma duke vazhduar.

¹⁹⁹ “Jep dorëheqje Bujar Bukoshi e Astrit Haraqija”. Rajonipress. 9 korrik 2012. (Shih linkun: <https://rajonipress.com/jep-doreheqje-bujar-bukoshi-e-astrit-haraqija/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰⁰ “Rasti i Ukës Rugovës dorëzohet te vendorët, caktimi i seancave në pritje të përgjigjes nga Supremja”. Betimi për Drejtësi. 30 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-i-ukes-rugoves-dorezohet-te-vendoret-caktimi-i-seancave-ne-pritje-te-pergjigjes-nga-supremja/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰¹ “Gjykata nuk e ka prioritet gjykimin e Ukë Rugovës dhe të tjerëve, për rreth tetë muaj nuk caktohet asnjë seancë”. Betimi për Drejtësi. 12 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-nuk-e-ka-prioritet-gjykimin-e-uke-rugoves-dhe-te-tjereve-per-rreth-tete-muaj-nuk-caktohet-asnje-seance/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰² Gjykimi për dallavere me viza italiane, veçohet procedura ndaj Ukë Rugovës, Astrit Haraqisë dhe tre të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 3 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykimi-per-dallavere-me-viza-italiane-vecohet-procedura-ndaj-uke-rugoves-astrit-haraqise-dhe-tre-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**GANI GECI****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Deputet**Veprat penale:** “Vrasje në tronditje të fortë mendore”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Mitrovicë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Ish-deputeti i Kuvendit të Kosovës, Gani Geci, akuzohet për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit që kishte ndodhur në gusht të 2014-tës. Sipas aktakuzës motivii i vrasjes së 4 gushtit ishte konflikti i vitit 2001 ku ishin vrarë Bekim Kastrati dhe Besim Dajaku dhe i plagosur kishte mbetur vetë Gani Geci. Po ashtu, sipas aktakuzës ditën kur ka kryer vrasjen, Gani Geci ka qenë në një “tronditje të fortë mendore”.

Procesi – Gjykata Themelore në Mitrovicë, në përbërje nga gjykatës të EULEX-it, më 3 qershor 2016, pasi e kishte shpallur fajtor për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit, Gani Geci i kishte shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej katër vjet e gjashtë muaj burgim. Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në tetor 2017 e kishte kthyer lëndën në rigjykim.²⁰³ Përkundër se kanë kaluar afër dy vjet që kur lënda është kthyer në rigjykim, në Gjykatën Themelore në Mitrovicë ende nuk ka filluar rigjykimi i Gecit.

²⁰³ “Kthehet në rigjykim rasti i Gani Gecit, i akuzuar për vrasjen e Ruzhdi Shaqirit”. Betimi për Drejtësi. 25 tetor 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kthehet-ne-rigjykim-rasti-i-gani-gecit-i-akuzuar-per-vrasjen-e-ruzhdi-shaqirit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



GAZMEND MUHAXHERI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Pejës

Veprat penale: “Mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Hudhje (Aktvendim i shkallës së parë)

Hudhje

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Pejë më 3 maj 2017, ka akuzuar Muhaxherin, për veprën penale të “mos ekzekutim të vendimeve gjyqësore”. Kjo aktakuzë është ngritur nën dyshimin se ai nuk ekzekutuar vendimin e formës së prerë, sipas të cilit Hysni Selmanaj, pas pezullimit nga Komuna, është dashur të kthehet në vendin e punës si drejtor i Auditorit të Brendshëm, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet, e duke i paguar 50% të pagës, nga dita e pezullimit e deri në zbatim të këtij vendimi.

Procesi- Edhe pse aktakuza ndaj Muhaxherit është ngritur më 3 maj 2017, procesi gjyqësor ndaj tij është vetëm në hapat e parë. Nga fillimi i këtij procesi gjyqësor, rasti është përcjellë me zvarritje e shtyrje të seancave.^{204 205 206}

Seanca fillestare kishte arritur të mbahej vetëm më 27 dhjetor 2018, në të cilën seancën Muhaxheri ishte deklaruar i pafajshëm.²⁰⁷ Në gusht të vitit 2019, Gjykata Themelore në Pejë e ka hudhur poshtë aktakuzën ndaj Muhaxherit, në mungesë të provave²⁰⁸, të cilin venim e ka konfirmuar edhe Gjykata e Apelit.

²⁰⁴ “Kryetari i Pejës, Gazmend Muhaxheri mungon në gjykatë, shtyhet seanca ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 24 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-pejes-gazmend-muhaxheri-mungon-ne-gjykate-shtyhet-seanca-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰⁵ “Prokurori dhe kryetari i Pejës nuk shkojnë në seancë, i dëmtuari kërkon që prokurori Bajraktari të mos e përfaqësojë aktakuzën”. Betimi për Drejtësi. 22 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-dhe-kryetari-i-pejes-nuk-shkojne-ne-seance-i-demtuar-kerkon-qe-prokurori-bajraktari-te-mos-e-perfaqesojte-aktakuzen/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰⁶ “Sërish mungon kryetari i Pejës, lëshohet urdhër për sjellje me detyrim për Gazmend Muhaxherin”. Betimi për Drejtësi. 25 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-mungon-kryetari-i-pejes-leshohet-urdher-per-sjellje-me-detyrim-per-gazmend-muhaxherin/>).

²⁰⁷ “Kryetari i Pejës deklarohet i pafajshëm për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore”. Betimi për Drejtësi. 27 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-pejes-deklarohet-i-pafajshem-per-mosekzekutim-te-vendimeve-gjyqesore/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁰⁸ “Hudhet poshtë aktakuza për mosekzekutim të vendimeve gjyqësore ndaj Kryetarit të Pejës Gazmend Muhaxheri”. Betimi për Drejtësi. 19 gusht 2019. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-per-mosekzekutim-te-vendimeve-gjyqesore-ndaj-kryetarit-te-pejes-gazmend-muhaxheri/?fbclid=IëAR0ZMn7d3RVJ-GQsTKNiX14dZEh4v0KXYËuYYAJahkB7Su3_uOsZ6NJGNvë). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



SALI ASLLANAJ

Lirim

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Suharekës

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prizren për veprimet e Asllanaj, gjatë kohës sa ka qenë në cilësi të kryetarit të komunës së Suharekës, e kishte akuzuar atë pasi kishte përfunduar këtë mandat. Ai u akuzua me aktakuzën e 22 tetorit 2018, pas dyshimeve se ai kishte nënshkruar një tender për transportin e nxënësve në fundin e vitit 2014. Për këto veprime, ai pretendohet se ai i ka shkaktuar dëm buxhetit të shtetit 10.556.00 euro.

Procesi – Asllanaj, në këtë aktakuzë është akuzuar edhe me ish-drejtorin e arsimit të Suharekës Sherif Berisha dhe një drejtor të shkollës, të cilët ishin deklaruar të pafajshëm në seancën fillestare të 19 nëntorit 2018.²⁰⁹ Shqyrtimi gjyqësor në këtë proces ka filluar 27 shkurt 2019 ndërsa kishte përfunduar më 9 dhjetor të po atij viti.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Asllanaj ishte shpallur i pafajshëm për akuzat që e rendonin, pasi sipas gjykatës nuk ishte vërtetuar se ai dhe dy të akuzuarit tjerë të këtij rasti ish-drejtori i Arsimit, Sherif Berisha dhe ish-drejtori i shkollës “Bajram Curri”, Milazim Hajdari, kanë kryer vepër penale²¹⁰.

Lënda aktualisht është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit.

²⁰⁹ “Ish-kryetari i Suharekës, Sali Asllanaj dhe dy të tjerët deklarohen të pafajshëm për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 19 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-suharekes-sali-asllanaj-dhe-dy-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²¹⁰ “Ish-kryetari i Suharekës dhe dy të tjerët lirohen nga akuza për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-suharekes-dhe-dy-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Refuzim

2.
Lirim

3.
Lirim



SHAIP SURDULLI

Partia: LDK

Pozitat shtetërore: Kryetar i Komunës së Kamenicës

Vepra penale: 1. “Shpërdorim i pozitës zyrtare ose autorizimit”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 3. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 1. Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë), 3. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1- Shaip Surdulli, ishte akuzuar nga prokuroria e Euelx-it, për dyshimet se më 10 janar 2011, në cilësinë e personit zyrtar, kryetari i Kamenicës në dëm të buxhetit të Kamenicës ka keqpërdorur pozitën zyrtare duke nxjerrë një vendim për kompensimin e shpenzimeve për udhëtim zyrtar jashtë Kosovës për bashkëshorten e tij, Hanife Surdulli, e cila me datën 17 janar 2011 ka udhëtuar së bashku me delegacionin nga Kamenica, për në Gjermani në një vizitë kompanisë “Fritz Schafer GmbH” që merret me riciklimin e mbeturinave edhe pse e njëjta nuk ka qenë pjesë e administratës komunale në Kamenicë, duke e dëmtuar kështu buxhetin e Komunës për shumën prej 384.11 euro.

Procesi 1 - Surdulli ishte liruar nga kjo akuzë pasi prokuroi në korrikun e vitit 2014 kishte hequr dorë nga aktakuza, me arsyetimin se lënda ndaj tij ka arritur afatin e parashkrimit.²¹¹

Aktakuza 2 - Prokuroria Themelore në Gjilan akuzon Surdullin se në tetor 2011 në cilësi të kryetarit të Komunës së Kamenicës ka shpërdoruar detyrën zyrtare. Ai pretendohet se si menaxher i projektit “Pastrimi i Lumit Krivareka” ka lejuar ngritjen e vëllimit të punëve, ashtu që kompania fituese “Besniku”, në vend se të marrë shumën prej 137,595,72 eurove ka marrë 145,000 euro.

²¹¹ “Shaip Surdulli lirohet nga akuza, shkak vjetërsia e lëndës”. Lajmi.net . 10 korrik 2014. (Shih linkun <https://lajmi.net/shaip-surdulli-lirohet-nga-akuza-shkak-vjetersia-e-lendes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 2 - Bashkë me Surdullin ishin akuzuar edhe dy zyrtarë të komunës së Vitisë dhe një biznesmen por ata më 2 nëntor 2015, në mungesë të provave ishin liruar nga aktakuza e prokurorisë.²¹²

Aktakuza 3 - Prokuroria Themelore në Gjilan më 9 dhjetor 2013 kishte ngritur aktakuzë kundër Surdullit për veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Në këtë aktakuzë ai dyshohej se ka nënshkruar një kontratë me IPKO në vlerë të 1.665 euro duke anashkaluar procedurat e prokurimit.

Procesi 3 - Ish-kryetari i Kamenicës, ishte i shpallur i pafajshëm edhe për aktakuzën e tretë që atë e ngarkuar për korrupsion. Gjykata Themelore në Gjilan, më 24 nëntor 2015 në mungesë të provave e kishte liruar Surdullin nga kjo akuzë.²¹³

²¹² “Shpallet i pafajshëm ish-kryetari i Kamenicës, Shaip Surdulli” ” Klankosova.tv. 2 nëntor 2015. (Shih linkun <https://klankosova.tv/shpallet-i-pafajshem-ish-kryetari-i-kamenices-shaip-surdulli/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²¹³ “Shaip Surdulli fiton edhe betejën e fundit gjyqësore” Rajonipress. 23 nëntor 2015 2015 (Shih linkun <https://rajonipress.com/shaip-surdulli-fiton-edhe-betejen-e-fundit-gjyqesore/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**MEHMET KRASNIQI****Lirim****Partia:** LDK**Pozitat shtetërore:** Kryetar i Komunës së Obiliqit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”,**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ish-kryetari i Obiliqit ishte akuzuar për keqpërdorim të pozitës së kryetarit të Obiliqit nga PSRK më 8 maj 2015, së bashku edhe me dhjetë zyrtar të kësaj komune dhe katër biznesmen për mashtrim. Kjo aktakuzë e PSRK-së pretendonte Krasniqi dhe të tjerët kishin bashkëpunuar kundërligjshëm në tenderët publik gjatë periudhës kohore 2012-2013, përkatësisht gjatë realizimit të projektit për asfaltimin e disa rrugëve në Komunën e Obiliqit.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 mars 2017, në mungesë të provave kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, ish-kryetarin Mehmet Krasniqi dhe tetë zyrtarët e tjerë të komunës.²¹⁴ Pas ankesës së PSRK-së, Gjykata e Apelit me vendimin e saj të 19 prillit 2018 kishte refuzuar ankesën e PSRK-së dhe kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë duke e liruar përfundimisht nga akuza Krasniqin.²¹⁵

Prokuroria e pakënaqur me këtë vendim i ishte drejtuar me kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë të cilën e kishte aprovuar pjesërisht Gjykata Supreme, e cila kishte konstatuar se instanca e parë dhe ajo e dytë nuk e kishte sqaruar tërësisht arsyet e lirimit të të akuzuarve. dhe me këtë kishin bërë shkelje të ligjit në favor të të akuzuarit.²¹⁶

²¹⁴ “Shpallet i pafajshëm ish-kryetari i Obiliqit, Mehmet Krasniqi” Betimi për Drejtësi. 19 maj 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-ish-kryetari-i-obiliqit-mehmet-krasniqi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²¹⁵ “Apeli vërteton pafajësinë e ish-kryetarit të Obiliqit, Mehmet Krasniqi” Betimi për Drejtësi. 3 maj 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-ish-kryetarit-te-obiliqit-mehmet-krasniqi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²¹⁶ “Supremja konstaton shkelje në rastin e ish-kryetarit të Obiliqit, Themeloria e Apeli e kishin liruar nga akuzat për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 11 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-ne-rastin-e-ish-kryetarit-te-obiliqit-themeloria-e-apeli-e-kishin-liruar-nga-akuzat-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



HAKI RUGOVA

Partia: Nënkyetar i LDK-së

Pozitat shtetërore: Kryetar i Komunës së Istogut

Vepra penale: “Konflikt i interesit”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën e 26 marsit të vitit 2018, ka akuzuar Haki Rugovën për veprën penale të konfliktit të interesit pasi pretendohet se duke vepruar si kryetar i Komunës së Istogut, më 1 gusht 2014, ka nënshkruar kontratë me kompaninë “Ma-Con” sh.p.k. për ndërtimin e kanalizimit për fshatrat Cercë dhe Lubozhdë, pronar i të cilës kompani ishte vëllau i tij Gani Rugova. Kjo kontratë sipas prokurorisë ka një çmim të kontratës prej 289.119.85 euro.

Procesi - Seanca fillestare ndaj Rugovës, në të cilën ai ishte deklaruar i pafajshëm²¹⁷ ishte mbajtur vetëm 10 muaj pas ngritjes së aktakuzës, konkretisht më 17 janar 2019 pasi gjykata kishte dështuar të mbaj shqyrtimin fillestar katër herë më radhë²¹⁸, ndërsa ky rast aktualisht është në fazën e shqyrtimit gjyqësorë.

²¹⁷ “Haki Rugova deklarohet i pafajshëm për konflikt interesi, Komuna e Istogut nuk i bashkëngjitet ndjekjes penale”. Betimi për Drejtësi. 17 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/haki-rugova-deklarohet-i-pafajshem-per-konflikt-interesi-komuna-e-istogut-nuk-i-bashkengjitet-ndjekjes-penale/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²¹⁸ Shënim: Tentimi i parë i Gjykatës Themelore në Pejë për të mbajtur shqyrtimin fillestar ishte bërë më 7 maj 2018 por për shkak të mungesës së Rugovës, kjo seancë kishte dështuar, ndërsa për arsye të njëjtë kishte dështuar edhe seanca e 21 majit 2018. Gjykata nuk kishte arritur të mbante seancën fillestare as më 10 shtator dhe 5 nëntor, pasi në seancën e shtatorit mbrojtja tha se nuk ishte e pajisur me shkresë, ndërsa më 5 nëntor Rugova, kishte thënë se është në udhëtim zyrtar.

**HALIM HALIMI****Partia:** LDK**Pozitat shtetërore:** Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Prishtinës; Kryetar i Kuvendit Komunal të Prishtinës; Këshilltar Komunal në Komunën e Prishtinës**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Halimi, është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë me pretendimin se ai si drejtor i Arsimit në Komunën e Prishtinës, ka keqpërdorur detyrën pasi më 20 shkurt 2013 kishte lidhur kontratë pune për mësimdhënie me Asllan Cenën në cilësinë e mësimdhënësit në Gjimnazin “Xhevdet Doda” në Prishtinë dhe me këtë pretendohet se me dashje ka pamundësuar kandidatët e tjerë që të jenë të barabartë me Cenën.

Procesi - Me 24 maj 2016, gjyqtari Arben Hoti lidhur me këtë rast, kishte marrë aktgjykim me të cilin e kishte refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykim i cili është bërë i plotfuqishëm me 18 korrik 2016.²¹⁹

²¹⁹ Shënim: Përgjigje e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi për IKD-në. 27 gusht 2019.

1. Në
proces

2. 1 vit
burgim me
kusht



AJMANE BARANI

Partia: Anëtare e LDK-së

Pozita shtetërore: Drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Mitrovicës

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”.

Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë

Faza procedurale: 1. Në proces; 2. Një (1) vit burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Mitrovicë, me aktakuzën e 21 nëntor 2017, ka akuzuar ish-drejtoreshën e arsimit të kësaj komune Ajmane Barani, me pretendimin se ajo nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare me qëllim që të përfitojë dobi pasurore personi tjetër dhe t’i shkaktojë dëm të dëmtuarës, Mirdona Istrefit. Bazuar në aktakuzë, Ajmane Barani, këtë veprë e ka kryer në atë mënyrë që edhe pse Istrefi, është vlerësuar me më shumë pikë, ajo në pozitën e mësimdhënëses e kishte pranuar një kandidat tjetër.

Procesi 1 - Pas përfundimi të shqyrtimit gjyqësor drejtoresha e arsimit në Komunën e Mitrovicës për periudhën 2014-2015, me vendimin e 13 dhjetorit 2018, në mungesë të provave ishte liruar nga akuza.²²⁰ Mirëpo, pas ankesave të palëve, ky rast ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit²²¹, ndërsa Gjykata Themelore në Mitrovicë, është akoma duke e zhvilluar këtë proces.

Aktakuza 2 - Barani, është akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, edhe me një aktakuzë tjetër të prokurorisë të ngritur më 10 dhjetor 2018. Edhe në këtë aktakuzë ajo është duke u akuzuar se ka bërë keqpërdorime duke shkelur statusin e barabartë të qytetarëve të cilët kanë aplikuar në punë për pozitën e mësimdhënësit.

²²⁰ “Ish-drejtoresha e Arsimit në Mitrovicë lirohet nga akuza se keqpërdori pozitën me rastin e punësimit të mësimdhënës”. Betimi për Drejtësi. 13 dhjetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtoresha-e-arsimit-ne-mitrovice-lirohet-nga-akuza-se-keqperdori-poziten-me-rastin-e-punesimit-te-mesimdheneses/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²²¹ “Apeli e kthen në rigjykim rastin e ish-drejtoreshës së Arsimit në Mitrovicë e cila ishte liruar nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-drejtoreshes-se-arsimit-ne-mitrovice-e-cila-ishte-liruar-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 2 - Pjesë e kësaj aktakuze së bashku me Baranin, për keqpërdorim të pozitës zyrtare është duke u akuzuar edhe ish-drejtori tjetër i arsimit në Komunën e Mitrovicës Pajazit Hajzeri.

Të dy të akuzuarit në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 12 shkurt 2019, ishin deklaruar të pafajshëm, ndërsa pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Barani ishte gjetur fajtor dhe për veprën penale, “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, ishte dënuar me një vit burgim me kusht.

Ndërsa ajo ishte shpallur e pafajshme, për veprën penale “shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”²²².

²²² “Shpallet aktgjykimi ndaj dy ish-drejtorëve në Mitrovicë, njëra dënohet me kusht, tjetri lirohet nga akuza” Betimi për Drejtësi. 28 janar 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykimi-ndaj-dy-ish-drejtoreve-ne-mitrovice-njera-denohet-me-kusht-tjetri-lirohet-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**PAJAZIT HAJZERI****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Arsimit në Komunën e Mitrovicës**Vepra penale:** “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Mitrovicë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Ish-drejtori i arsimit i Komunës së Mitrovicës Pajazit Hajzeri, me aktakuzën e prokurorisë të ngritur më 10 dhjetor 2018, është duke u akuzuar për “Falsifikimi i dokumentit zyrtar”.

Prokuroria pretendon se ai më 14 tetor 2015, në Kuvendin Komunal të Mitrovicës, saktësisht në zyrën e DKA-së, në cilësinë e drejtorit të Arsimit, me nënshkrimin e tij dhe vulën zyrtare ka vërtetuar dokumentin zyrtar dhe atë procesverbalin e “Gjimnazi- Frang Bardhi” në Mitrovicë, pikërisht vendimin për lëndën edukatës fizike dhe për lëndën gjuhë frënge, për kandidatët kinse janë poentuar dhe themeluar marrëdhënie pune, pasi që kanë marrë pikët kinse nga anëtarët e komisionit, e që thuhet se shihet se ky dokument është i pa datë dhe i pa nënshkruar nga anëtarët e komisionit, edhe pse e ka parë se i njëjti nuk ka qenë i nënshkruar nga anëtarët e komisionit, të cili e ka anuluar Inspektorati i Punës.

Procesi - Pjesë e kësaj aktakuze së bashku me Hajzerin, për keqpërdorim të pozitës zyrtare është duke u akuzuar edhe ish-drejtoresha tjetër e arsimit në Komunën e Mitrovicës Ajmane Barani. Të dy të akuzuarit në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 12 shkurt 2019, ishin deklaruar të pafajshëm, ndërsa ai pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, ishte liruar nga akuza²²³.

²²³ “Shpallet aktgjykimi ndaj dy ish-drejtorëve në Mitrovicë, njëra dënohet me kusht, tjetri lirohet nga akuza” Betimi për Drejtësi. 28 janar 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-aktgjykimi-ndaj-dy-ish-drejtoreve-ne-mitrovice-njera-denohet-me-kusht-tjetri-lirohet-nga-akuza/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Duhet theksuar, se kryetari i komunës së Mitrovicës Agim Bahtiri, e kishte shkarkuar nga pozita e drejtorit Hajzerin, për dyshimet për keqpërdorime, por këtë e kishte bërë në lidhje me një rast tjetër e jo për aktakuzën e ngritur nga prokuroria.²²⁴

	Refuzim FADIL GASHI Partia: LDK Pozita shtetërore: Kryesues i Kuvendit të Komunës së Klinës ; Zëvendësministër i Ministrisë së FSK-së (2015 – 2017); Këshilltar Komunal në Klinë (2013 dhe 2007-2009); Deputet i Kuvendit të Kosovës (2004 – 2007) Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”; “Mashttrim në detyrë” Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë Faza procedurale: Refuzim për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”; Hudhje e aktakuzës për “mashttrim në detyrë” (Aktgjykim i formës së prerë)
---	--

Aktakuza - Sipas pretendimit të prokurorisë, Fadil Gashi dhe tre të akuzuar të tjerë, gjatë procesit të ndarjes së banesave me qira, në pronësi të Komunës së Klinës, kanë bërë marrëveshje politike (Partia Demokratike e Kosovës, Lidhja Demokratike e Kosovës, Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës dhe Lidhja Demokratike e Dardanisë), për shpërndarjen e banesave. Pas kësaj marrëveshje, të pandehurit kanë ndikuar në procesin e vendimmarrjes, ku kanë anashkaluar aplikantët me gjendje të rëndë ekonomike dhe kanë shpërblyer shokët e tyre partiakë me banesa. Sipas prokurorisë, dy të pandehurit Fadil Gashit dhe Esat Rraci, duke shfrytëzuar dispozitat e Ligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore, kishin paraqitur kërkesa me shkrim për blerjen e banesave, të cilat u ishin ndarë atyre. Por, si rezultat i hetimeve, procesi i blerjes ishte pezulluar.

Gashi ngarkohej nga prokuroria edhe me veprën penale të mashtimit në detyrë, pasi sipas prokurorisë, i njëjti nuk kishte deklaruar disa prona të tij, dhe kishte mashtuar Komisionin për Banesa me Qira, këshilltarët e Kuvendit Komunal të Klinës dhe personat tjerë të autorizuar, duke i nxitur ata që të vinë në përfundim të gabuar se Gashi i plotësonte kushtet e parapara që t’i ndahej një banesë, pronë e Komunës së Klinës, me arsyetimin se nuk kishte pronë apo shtëpi në Kosovë dhe nuk e kishte të zgjidhur çështjen e banimit.

Procesi – Gjykata Themelore në Pejë, më 29 maj 2019, kishte nxjerr aktgjykim refuzues për Gashin, për sa i përket veprës penale të keqpërdorimit të pozitës apo autoritetit zyrtar, pasi që, prokurorja e rastit, Sahide Gashi, ishte tërhequr nga akuzat ndaj tij, ndërsa për sa i përket veprës

²²⁴ “Bahtiri shkarkon drejtorin e Arsimit, Pajazit Hajzeri (Dokument)”. Klan Kosova. 6 dhjetor 2016. (Shih linkun <https://klankosova.tv/bahtiri-shkarkon-drejtorin-e-arsimit-pajazit-hajzeri-dokument/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

penale të mashtrimit në detyrë, e njëjtë akuzë ishte hudhur poshtë nga ana e gjykatësit Sylë Lokaj.²²⁵

Në
proces



FAIK GRAINCA

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit dhe Mjedisit në Komunën e Ferizajt

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Ferizaj

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza- Grainca, në fund të muajit dhjetor të vitit 2018, ishte akuzuar me pretendimin se më 9 gusht 2017, në cilësi të drejtorit në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Mjedisit, në Komunën e Ferizajt, si dhe si person përgjegjës i komisionit për shqyrtim të planit zhvillimor komunal, nuk i ka verifikuar nënshkrimet në një peticion të qytetarëve, rreth një plani urbanistik.²²⁶

Sipas aktakuzës, Grainca, duke ushtruar detyrën zyrtare në këto cilësi, nuk i ka verifikuar nënshkrimet në një peticion të qytetarëve, i cili kishte të bënte me planin zhvillimor për zonën 8, të rrugës “Astrit Bytyqi”, në Ferizaj, e të cilat nënshkrime kishin rezultuar të jenë të falsifikuara. Tutje, në akuzë thuhet se tani i akuzuari Faik Grainca, ka qenë në dijeni se këto nënshkrime janë të falsifikuara ku si pasojë është lejuar që rruga “Astrit Bytyqi”, të mbetet banim kolektiv, edhe pse qytetarët e kësaj rruge kanë qenë për banim individual. Gjithnjë sipas aktakuzës, si rezultat i peticionit të falsifikuar, Kuvendi Komunal i Ferizajt kishte aprovuar planin urbanistik për rrugën në fjalë, duke i shkelur të drejtat e tani të dëmtuarve Imri e Bekim Haliti dhe Orhan Ibrahim.

²²⁵“Sokol Bashota dënohet me burgim me kusht për mos deklarim të pasurisë, aktgjykim refuzues për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 29 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/sokol-bashota-denohet-me-burgim-me-kusht-per-mos-deklarim-te-pasurise-aktgjykim-refuzues-per-keqperdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²²⁶ Shenim: Sipas aktakuzës, Grainca, duke ushtruar detyrën zyrtare në këto cilësi, nuk i ka verifikuar nënshkrimet në një peticion të qytetarëve, i cili kishte të bënte me planin zhvillimor për zonën 8, të rrugës “Astrit Bytyqi”, në Ferizaj, e të cilat nënshkrime kishin rezultuar të jenë të falsifikuara. Tutje, në akuzë thuhet se tani i akuzuari Faik Grainca, ka qenë në dijeni se këto nënshkrime janë të falsifikuara ku si pasojë është lejuar që rruga “Astrit Bytyqi”, të mbetet banim kolektiv, edhe pse qytetarët e kësaj rruge kanë qenë për banim individual. Gjithnjë sipas aktakuzës, si rezultat i peticionit të falsifikuar, Kuvendi Komunal i Ferizajt kishte aprovuar planin urbanistik për rrugën në fjalë, duke i shkelur të drejtat e tani të dëmtuarve Imri e Bekim Haliti dhe Orhan Ibrahim.

Procesi- Bashkë me Graincën në këtë proces janë duke u akuzuar edhe dy qytetarë për falsifikim të dokumenteve. Gjykata ka arritur që nga 28 seancat e caktuara të mbaj 24 seanca, ndërsa rasti është akoma në procedim e sipër²²⁷, seanca e fundit e mbajtur ishte ajo e 14 janarit 2020.

1.
Lirim

2.
Lirim

3.
Lirim



VALON SHEFKIU

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Gjilanit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 3. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë), 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë shkallës së parë) 3. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë),

Aktakuza 1 - Shefkiu, me një aktakuzë të 2 nëntorit 2016 akuzohej se duke qenë drejtor në Drejtorin për Urbanizëm, së bashku me tre inspektorë të kësaj komune me qëllim që vetit apo tjerëve tu sjellin dobi të kundërligjshme pasurore, kanë lejuar që në qytetin e Gjilanit të ndërtohen shumë objekte kolektive banesore, në kundërshtim me ligjin për ndërtim.

Bashkë me Shefkiun, në këtë proces akuzohen edhe ish-shefi të inspeksionit të ndërtimit, Milot Shkodra, inspektorëve Baki Azemi e Bahrije Beqiri, si dhe i akuzuari për heqje ose dëmtim të vulave zyrtare ose shenjave, Abdyl Brestovci.

²²⁷ “Dy dëshmitarë dëgjohen në gjykimin ndaj ish-drejtorit të Urbanizimit në Ferizaj, Faik Grainca dhe të tjerëve” Betimi për Drejtësi. 10 tetor 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-deshmitare-degjohen-ne-gjykimin-ndaj-ish-drejtorit-te-urbanizimit-ne-ferizaj-faik-grainca-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjilan, më 18 qershor 2018 kishte marrë aktgjykim me të cilin në mungesë të provave kishte liruar Shefkiun²²⁸, i cili vendim i bë i formës së prerë më 29 nëntor 2018.²²⁹

Mirëpo, pasi Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit, për këto vendime të shkallës së parë dhe asaj të dytë, përmes kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë, e kishte dërguar këtë lëndë në Gjykatën Supreme, e cila kishte ka konstatuar se shkalla e parë dhe e dytë, me rastin e vendosjes për këta të akuzuar, kishin shkelur ligjin në favor të të akuzuarve²³⁰

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë ndaj Shefkiut, të ngritur më 17 Prill 2018, pretendohet se ai, gjatë periudhës 21 nëntor 2016, e deri më tani, në cilësi të personit zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij ose nuk i ka përmbush detyrat e tij, duke mos zbatuar disa vendime për rrënimin e objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimore.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Gjilan, më 3 prill 2019, kishte marrë vendim me të cilin, në mungesë të provave e kishte liruar nga aktakuza Shefkiun, e kishte liruar nga akuza.²³¹ Më 22 gusht 2019, aktgjykimin e Themelores e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²³²

Aktakuza 3 - Në rastin tjetër, Shefkiu është duke u përballur me një aktakuzë për keqpërdorim të pozitës zyrtare gjatë periudhës 2013-2014, kur ka qenë në detyrën e inspektorit të ndërtimit në Komunën e Gjilanit, por kjo nuk ishte pengesë që ai të merrte pozitën e drejtorit të Urbanizmit në këtë komunë.

Valon Shefkiu, Baki Azemi, Merita Cana-Shabani dhe Shkëndije Mahmuti-Hajdini, akuzohen se në cilësi të inspektorëve ndërtimorë kanë keqpërdorur detyrën zyrtare që u ishte besuar me ligj.

Gjithnjë sipas aktakuzës, të akuzuarit në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me interesat dhe qëllimet e Komunës së Gjilanit, nuk kishin ekzekutuar masën për rrënimin e këtyre objekteve, duke iu mundësuar personave të ndryshëm përfitim pasuror.

Procesi 3 - Gjykata Themelore në Gjilan, edhe më 30 qershor 2017, në mungesë të provave, i kishte shpallur të pafajshëm katër të akuzuarit, mirëpo pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e

²²⁸ “Dy vjet burgim për njërin inspektor të Gjilanit, katër të tjerët lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-vjet-burgim-per-njerin-inspektor-te-gjilanit-kater-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²²⁹ “Apeli vërteton dënimin me dy vjet burg ndaj inspektorit të Gjilanit, liron përfundimisht nga akuzat katër të tjerët”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-me-dy-vjet-burg-ndaj-inspektorit-te-gjilanit-liron-perfundimisht-nga-akuzat-kater-te-tjeret/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²³⁰ “Supremja konstaton shkelje në rastin e ish-zyrtarëve të Komunës së Gjilanit që ishin liruar nga akuzat për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 6 dhjetor 2019. (<https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-ne-rastin-e-ish-zyrtareve-te-komunes-se-gjilanit-qe-ishin-liruar-nga-akuzat-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²³¹ “Drejtori dhe ish-drejtori në Komunën e Gjilanit lirohen nga akuza për korrupsion (Video)”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-dhe-ish-drejtori-ne-komunen-e-gjilanit-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²³² Shënim: Përgjigje e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari për IKD-në. 27 gusht 2019.

Apelit kishte vendosur që ta kthejë këtë rast në rigjykim. Gjykata Themelore në Gjilan edhe më 8 qershor 2018, ashtu si në gjykimin e parë, të akuzuarit i kishte shpallur të pafajshëm, por përsëri Apeli, këtë rast e kishte kthyer në rigjykim.

Përfundimisht, shkalla e parë në Gjilan, me vendimin e 4 dhjetorit 2019 e kishte liruar përsëri Shefkriu²³³, të cilin vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²³⁴

Lirim



NASER KORÇA

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike në Gjilan

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza-Sipas aktakuzës së ngritur më 17 Prill 2018, Korça, akuzohet gjatë periudhës 21 nëntor 2016, e deri më tani, në cilësi të personit zyrtar, i ka tejkaluar kompetencat e tij ose nuk i ka përmbush detyrat të tij, duke lejuar që të operojnë disa biznese hotelierie në mënyrë të kundërligjshme duke shfrytëzuar hapësirat publike, trotualet për zhvillimin e kësaj veprimtarie, të cilat gjenden para lokaleve hotelierie, edhe për kundër që t’iu lejohen këto hapësira për zhvillimin e veprimtarive hotelierie, ashtu që si person përgjegjës në rastin konkret ka refuzuar kërkesat e tyre përkundër faktit se të njëjta biznese kanë vazhduar punën apo veprimtarinë e tyre pa u pajisur me leje.

Procesi - Ashtu si i bashkakuzuari Shefkriu, edhe Korça, me vendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, të 3 prillit 2019, në mungesë të provave ishte shpallur i pafajshëm.²³⁵ Më 22 gusht 2019, aktgjykimin e Themelores e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²³⁶

²³³ “Ish-drejtori i Urbanizmit dhe inspektorët në Gjilan sërish lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 4 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-urbanizmit-dhe-inspektorët-ne-gjilan-serish-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²³⁴ Shënim: Përgjigje e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, 02.06.2020

²³⁵ “Drejtori dhe ish-drejtori në Komunën e Gjilanit lirohen nga akuza për korrupsion (Video)”. Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-dhe-ish-drejtori-ne-komunen-e-gjilanit-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²³⁶ Shënim: Përgjigje e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit, Arbër Jashari për IKD-në. 27 gusht 2019.

900
euro
gjobë



QAHIL SAHITI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i drejtorisë së Arsimit në Komunën e Vitisë

Veprat penale: “Cenim të të drejtave të punësimit dhe papunësisë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan-Dega Viti

Faza procedurale: 900 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Ndaj Sahitit, për dyshimet se i njëjti ka shkelur të drejtat e punësimit duke pranuar mësimdhënies në punë edhe për pozitat e lira të disa shkollave të Komunës së Vitisë, pa hapur fare konkurs, Prokuroria Themelore në Gjilan ndaj tij kishte ngritur aktakuzat më 16 nëntor 2015, 31 mars 2016 dhe 24 prill 2017.

Procesi - Gjykata Themelore në Gjilan, dega në Viti me një vendim të katër prillit 2019 ishte vendosur që të tri aktakuzat ndaj Salihitit, të bashkohen në një procedurë të vetme.

Sahiti, kishte vendosur që të hyj në marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë dhe me 5 prill 2019, ai ishte dënuar me një dënim unik prej 900 euro gjobë, ashtu siç edhe ishte përcaktuar në marrëveshjen me prokurorinë.²³⁷

²³⁷ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega Viti. 05.04.2019



AVNI MALOKU

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i drejtorisë së Arsimit në Komunën e Podujevës

Veprat penale: “Cenim të të drejtave të punësimit dhe papunësisë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega Podujevë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza- Më 10 janar 2019, Prokuroria Themelore në Prishtinë, me propozim për shqiptimin e urdhrit ndëshkimor, e ka akuzuar Malokun për veprën penale “cenim të të drejtave të punësimit dhe papunësisë”, pas pretendimit se i njëjti përkundër se Inspektorati i arsimit kishte gjetur shkelje, ai më 15 shtator 2015, ia kishte mohuar të drejtën për punësim Fatbardha Hotit, si mësimdhënëse e lëndës së historisë në shkollën fillore “Nuhi Gashi”, në Podujevë.

Vendimi- Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë, me 2 korrik 2019, ka marrë aktgjykim me urdhër ndëshkimor, me të cilin Maloku është gjetur fajtor dhe është dënuar me 400 euro.²³⁸

Mirëpo me këtë vendim nuk ishte pajtuar i akuzuari, i cili kishte bërë kundërshtim ndaj vendimit të gjykatës, çka ka bërë që për këtë rast të fillohet me procesin gjyqësor.²³⁹

²³⁸ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Podujevë. 02.07.2019

²³⁹ Shënim: Në seancën e 26 qershorit 2020, prokuroria kishte hequr dorë nga ndjekja penale ndaj Malokut, pas të cilit veprim. gjykata ka marrë aktgjykim refuzues dhe në këtë mënyrë është pushuar procedura ndaj Malokut. “Aktgjykim refuzues ndaj ish-drejtorit të Arsimit në Podujevë që akuzohet për cenim të drejtave të punësimit”. Betimi për Drejtësi. 6 korrik 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-drejtorit-te-arsimit-ne-podujeve-qe-akuzohet-per-cenim-te-drejtave-te-punesimit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 4000
euro
gjobë

2.
Lirim

3.
Lirim



SHERIF BERISHA

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Suharekës

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” 3. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: 1. 4.000 gjobë (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Aktgjykim lirues (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza 1 - Sherif Berisha, për veprimet e tij në cilësi të drejtorit të arsimit në komunën e Suharekës, është bërë pjesë e tri aktakuzave. Në aktakuzën e parë të 2 qershorit 2016, ai gjatë periudhës 2014-2016, ka punësuar në shkollat e Komunës së Suharekës, pa konkurs, nëntë mësimdhënës dhe një kontabilist.

Procesi 1 - Aktgjykimi i këtij rasti është shpallur nga Gjykata Themelore në Prizren me 26 prill 2017, sipas të cilit Berisha u dënua me 4.000 euro gjobë.²⁴⁰ Ky aktgjykim ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit më 16 gusht 2017.

Aktakuza 2 - Berisha, me aktakuzën e 6 dhjetorit 2016, është akuzuar se në cilësi të drejtorit të arsimit në komunën e Suharekës, nuk ka zbatuar një vendim të Inspeksionit për Arsim, për anulimin e konkursit për mësimdhënës.

Procesi 2 - Lidhur me këtë aktakuzë, Berisha me një vendim të 17 korrikut 2017, ishte shpallur i pafajshëm.²⁴¹ Lirimin e tij e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit më 29 shtator 2017.

²⁴⁰ “Drejtori për arsim në Suharekë dënohet me 4 mijë euro gjobë për punësime pa konkurs” Betimi për Drejtësi. 26 prill 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-per-arsim-ne-suhareke-denohet-me-4-mije-euro-gjobe-per-punesime-pa-konkurs/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁴¹ “Shpallet i pafajshëm drejtori i Arsimit në Suharekë (Video)” Betimi për Drejtësi. 17 korrik 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuzat-drejtori-i-arsimit-ne-suhareke/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Aktakuza 3- Në rastin e tretë ndaj tij, Berisha është duke u akuzuar së bashku me ish-kryetarin e komunës së Suharekës Sali Asllanaj dhe një drejtor të një shkolle fillore, lidhur me dyshimet për keqpërdorime në tenderin për transportin e nxënësve të fundit të vitit 2014.

Procesi 3- Në këtë proces gjyqësor Berisha dhe dy të tjerët ishin deklaruar të pafajshëm në seancën fillestare të 19 nëntorit 2018, ndërsa shqyrtimi gjyqësor në këtë proces ka filluar 27 shkurt 2019 ndërsa kishte përfunduar më 9 dhjetor të po atij viti.

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren, Berisha dhe të tjerët ishin shpallur të pafajshëm për akuzat që e rendonin, pasi sipas gjykatës nuk ishte vërtetuar se ai dhe dy të akuzuarit tjerë të këtij rasti kishin kryer vepër penale.²⁴²

Ky rast, akoma nuk është vendosur nga ana e Gjykatës së Apelit.

²⁴² “Ish-kryetari i Suharekës dhe dy të tjerët lirohen nga akuza për korrupsion” Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-suharekes-dhe-dy-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Vërejtje
gjqësore**SEDAT KUÇI****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Inspeksionit në Komunën e Suharekës**Veprat penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren - dega në Suharekë**Faza procedurale:** Vërejtje gjyqësore (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Kuçi, me aktakuzën e 28 shatorit 2017, ishte akuzuar se ai nuk e kishte bërë deklarinimin e pasurisë, të të ardhurave, të dobisë së tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare, duke mos i paraqitur brenda afatit për paraqitjen e deklaratës për periudhën e vitit 2016, që është dashur ta bëj deri më 31 mars 2017.

Vendimi - Pretendimet e prokurorisë i kishte pranuar Kuçi, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 25 tetor 2018, që kishte bërë që pas kësaj seance gjykata të nxjerr vendim me të cilin ndaj tij shqiptoi vërejtje gjyqësore, duke e obliguar të akuzuarin vetëm me shpenzimet e procedurës dhe paushallin gjyqësor prej 20 eurove si dhe në emër të kompensimit të viktimave në shumën prej 30 euro, i cili vendim është i formës së prerë.²⁴³

²⁴³ Shenim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Suharekë. 25.10.2019



RASIM HASANI

1.
Hudhje

2.
Lirim

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Lipjanit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 2. “Cenim të të drejtave të punësimit dhe papunësisë”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Prishtinë, 2. Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan

Faza procedurale: 1. Hudhje (Aktvendim i formës së prerë); 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1- Rasim Hasimi është akuzuar me aktakuzën e ngritur më 29 shtator 2016, me të cilën pretendohet se ka ndikuar në punësimin e kandidates Shefkije Grajqevci, edhe pse ajo nuk ishte përfshirë në listën e kandidatëve për intervistim, por që emri i saj ishte futur në listë dhe atë ishte shkruar me laps kimik, me të cilat veprime ka shkelur të drejtat e punësimit të kandidatëve tjerë që kishin konkurruar për atë pozitë të mësimdhënësit.

Procesi 1 - Hasimi në seancën fillestare të mbajtur më 27 shkurt 2017, ishte deklaruar i pafajshëm.²⁴⁴ Me 28 shkurt 2017 gjyqtari Elmaz Zenuni lidhur me rastin ndaj Hasanit kishte marrë aktvendim me të cilin e kishte refuzuar si të pabazuar kërkesën për kundërshtimin e provave si dhe për hudhjen e aktakuzës, kurse më 16 mars 2017 Gjykata e Apelit, kishte marrë aktvendim duke e hudhur aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë dhe duke e pushuar procedurën ndaj Hasanit.²⁴⁵

Aktakuza 2- Në aktakuzën e dytë, Hasani akuzohet për veprën penale të “Cenim të të drejtave të punësimit dhe papunësisë”, pasi pretendohet se në cilësi të drejtorit të arsimit ka shpallur konkurs për disa vende të reja të punës, ndërsa me vetëdije nuk ka shpallur vendet e punës për mësim zgjedhor, duke ia mohuar të drejtën e punësimit të dëmtuarit Fidan Hetemi.

Procesi 2 – Pas mbajtës së seancave gjyqësore, gjykata më 30 dhjetor 2019, në mungesë të provave e kishte liruar Hasanin nga aktakuza, të cilin vendim, më 15 maj 2020 e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²⁴⁶

²⁴⁴ “Deklarohet i pafajshëm Drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Komunën e Lipjanit, mbrojtja kërkon hudhjen e aktakuzës”. Betimi për Drejtësi. 27 shkurt 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohet-i-pafajshem-drejtori-i-drejtorise-se-arsimit-ne-komunen-e-lipjanit-mbrojtja-kerkon-hudhjen-e-aktakuzes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁴⁵ Shënim: Përgjigje e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi për IKD. 27 gusht 2019.

²⁴⁶ Shënim: Aktgjyrimi i Gjykatës së Apelit PA1.nr.252/2020

	FATMIR MEMAJ	1. Refuzim 2. 3 muaj burg me kusht
	Partia: LDK	
	Pozitat shtetërore: Drejtor në Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Prizren	
	Vepra penale: 1 “Kanosje” 2. “Pengim i personit zyrtar”	
	Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren	
Faza procedurale: 1. Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Dënim – Tre muaj burgim me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)		

Aktakuza 1 - Memaj akuzohet se me 7 tetor 2012, rreth orës 10:15, në zyrën e të dyshuarit e cila gjendet në rrugën “Jusuf Gërvalla”, në Prizren seriozisht e ka kanosur të dëmtuarin Ismet Budurin, se do ta privoj nga jeta, në atë mënyrë që pas një konflikti familjar në mes tyre, kishte nxjerrë një pistoletë duke e lënë mbi tavolinë dhe duke e kanosur me fjalët “kjo është për ju dhe familjen tuaj”, me c’rast tek i dëmtuari kishte shkaktuar ankth dhe pasiguri.

Procesi 1 – Me aktgjykimin e datës 8 nëntor 2013, gjykatësi Fatmir Krasniqi e ka refuzuar aktakuzën ndaj të akuzuarit Memaj me arsyetimin se i dëmtuari dhe prokurori Zenel Kodra në seancën e shqyrtimit kryesor janë tërhequr nga aktakuza.

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës, i pandehuri akuzohet se më 5 qershor 2015, në rrugën “Wesley Clarke” në Prizren, me kanosje serioze ka penguar personat zyrtarë policor Enver Sejfullahu dhe Nazmi Jahiri në kryerjen e detyruarve zyrtare . Siç thuhet në aktakuzë, pasi që zyrtarët policor gjatë patrullimit e kanë ndaluar automjetin “Opel Corsa”, të autoshkollës “Art”, për arsye se instruktorja Naxhije Memaj (bashkëshortja e te pandehurit), i kishte munguar licenca e instruktorit, të cilës iu ishte shqiptuar edhe tiketa kundërvajtëse. Bazuar në aktakuzë, pas kësaj në ndërkohë i pandehuri ishte paraqitur në vendin e ngjarjes i cili paraprakisht kishte filluar të marrë në telefon njerëz të ndryshëm, dhe vazhdimisht kishte kërkuar nga polici Enver Sejfullahu që të flas me ta duke i ofruar telefonin, por kur zyrtari policor Sejfullahu kishte refuzuar të flasë me të i pandehuri i’u kishte drejtuar me fjalët “mos të ishe në uniform do të ishim marrë vesh ndryshe, nuk ka me të zgjatë ty polic, ti nuk më njeh mua se kush jam, nuk ma ndien për ty, nuk do ta fali kurrë dhe do të shihemi”, me c’rast tek i dëmtuar kishte shkaktuar frikë dhe pasiguri.

Procesi 2 – Më 19 qershor të vitit 2017, Gjykata Themelore e Prizrenit e kishte dënuar me burgim me kusht në kohëzgjatje prej tre (3) muajsh, i cili nuk do të ekzekutohet brenda periudhës prej një (1) viti. Ndërsa, me aktgjykim i dëmtuari është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike.²⁴⁷

²⁴⁷ Aktgjykimi i datës 19 qershor 2017 i Gjykatës Themelore në Prizren.

Në
proces**FEJZË KABASHI****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Punës dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prizrenit**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Prizrenit të ngritur më 29 nëntor 2019, i pandehuri Kabashi, së bashku me disa persona të tjerë, duke qenë pjesë e komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prizrenit, në bashkëkryerje me dashje kanë shkelur kriterin e vetëm të Ankandit Publik. Sipas prokurorisë, duke vepruar në këtë mënyrë, të njëjtit kanë shkelur të drejtat e të dëmtuarit Albert Doqi, duke për zgjedhur si shfrytëzuese ofertuesen Fatmire Berisha, përkundër faktit se i dëmtuari Doqi, kishte kuotuar çmimin më të lartë, gjegjësisht shumën 25.20 euro për m2, për lokalin nr.29, i cili gjendet në sheshin “Shatërvan”, por i njëjti lokali i është dhënë në shfrytëzim ofertueses Berisha, me çmim pre 20.06 euro për m2. përkundër faktit se në bazë të dokumentacionit të prezantuar dëshmohej se përfituesja Fatmire Berisha, nuk ka pasur përvojë në menaxhim dhe zhvillim të biznesit, komisioni për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale në Prizren, të njëjtën e ka poentuar me pikë maksimale. Sipas aktakuzës, më pas komisioni për ankesa pranë Kuvendit Komunal në Prizren, e kishte aprovuar kërkesën e palës së dëmtuar, ku më 28 shkurt 2019, ka anuluar vendimin e këtij komisioni duke e dërguar çështjen në rishqyrtim, përkundër faktit të tillë, Komisioni përmes njoftimit të datës 1 prill 2019, ka potencuar se qëndrojnë pranë njoftimit të datës 17 janar 2019, ku janë shpallur fituesit e ankandit për shfrytëzimin me qira të lokaleve-pronë komunale.

Procesi - I akuzuari Kabashi, Drejtor i Punës dhe Mirëqenie Sociale në Komunën e Prizrenit, në seancën e mbajtur më 20 shkurt 2020 është deklaruar i pafajshëm²⁴⁸, ndërsa seanca e radhës mbetet e papërcaktuar.

²⁴⁸ “Drejtorët në Prizren dhe të tjerët mohojnë fajësinë se kundërligjshëm dhanë në shfrytëzim pronën komunale”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtores-ne-prizren-dhe-te-tjeres-mohojne-fajesine-se-kunderligjshem-dhane-ne-shfrytezim-pronen-komunale/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

3000
euro
gjobë



SHPRESA HAJDARI

Partia: Anëtare e LDK-së

Pozita shtetërore: Drejtoreshë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 3000 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjilan, më 28 gusht 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarës Hajdari, me arsyetimin se ajo në periudhën kohore 1 deri më 31 mars 2019, si zyrtare e lartë në pozitën e drejtoreshës në Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Gjilanit, nuk ka vepruar sipas nenit 3 të Ligjit mbi Raportimin- Lajmërimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e pasurisë të Zyrtarëve të Lartë Publik, dhe Lajmërimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Dhuratave për të gjithë Zyrtarët e Lartë 04/L-500 dhe brenda afatit ligjor të paraparë për raportim, nuk e ka raportuar pasurinë e saj në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Bazuar në aktakuzë, formularin për paraqitjen e pasurisë Agjencisë Kundër Korrupsionit ia ka dorëzuar pas skadimit të afatit, më 5 prill 2019, edhe pse nga ana e këtij agjencioni ka qenë e njoftuar brenda afatit ligjor, lidhur me fillimin e procesit për raportimin dhe afatin për paraqitjen e pasurisë.

Procesi - Gjykata Themelore e Gjilanit, më 11 dhjetor 2019, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarës Hajdari, duke i shqiptuar dënim në shumë prej 400 euro.²⁴⁹

²⁴⁹ “Drejtoresha e Kulturës në Gjilan dënohet me gjobë, pranon se nuk e raportoi me kohë pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 11 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtoresha-e-kultures-ne-gjilan-denohet-me-gjobe-pranon-se-nuk-e-raportoi-me-kohe-pasurine/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**JAKUP TËRNAVA****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë të Komunës së Fushë Kosovës**Vepra penale:** “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë të 30 shtatorit 2019, Mevlude Nishori akuzohet se më 18 mars 2016, si zyrtare ligjore për regjistrimin e hipotekave në Komunën e Fushë Kosovës, ka tejkualuar kompetencat e saja, ashtu që edhe pse nuk ka qenë detyrë dhe përgjegjësi e saj në bazë të vendit të punës, ka përpiluar aktvendimin me të cilin ka revokuar vendimin me nr.91/2008 të datës 19 qershor 2008, që kishte të bënte me bartjen në Operatin Kadastral për ngastrën me nr.00451/1, me sipërfaqe prej 1162 metër katror, e cila ishte bartur në emër të S.K, B.K, Z.K, DHE XH.K. Me vendimin e përpiluar nga ajo, prona ishte kthyer në emër të pronarit të mëparshëm Spiro Drashkoviç, edhe pse për këtë njësi kadastrale, më 25 gusht 2015 Gjykata Themelore Prishtinë kishte caktuar masë të përkohshme të sigurisë.

Ky vendim ishte nënshkruar nga ana e drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Jakup Ternava dhe sipas prokurorisë në këtë mënyrë ai ka tejkualuar pozitën e tij zyrtare, me qëllim të përfitimit për vete apo personin tjetër.

Procesi - Në seancën e mbajtur më 25 nëntor 2019, i akuzuari Tërnavë është deklaruar i pafajshëm, duke mohuar kryerjen e veprës penale me të cilën ngarkohet nga Prokuroria Themelore e Prishtinës.²⁵⁰

²⁵⁰ “Katër zyrtarët e drejtorisë së kadastrit në Fushë Kosovë mohojnë fajësinë për keqpërdorim të pozitës zyrtare”. . Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kater-zyrtaret-e-drejtorise-se-kadastrit-ne-fushe-kosove-mohojne-fajesine-per-keqpërdorim-te-pozites-zyrtare/?fbclid=IéAR1v5B9VxeRaj-1ëhgHn6KqhNGFTH-4-6qttYEonXrEAlOTPDx1VDX-qZ-c>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

2 vite
burgim
me kusht



BUDAK SHALA

Partia: Anëtar i LDK-së

Pozitat shtetërore: Shef i kabinetit të kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri

Vepra penale: “*Mashtrimi*”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Pejë është duke pretenduar se Shala, duke punuar në zyrën e kabinetit të Kryetarit të Pejës, Gazmend Muhaxheri ka përpiluar një vendim, kinse të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve të Komunës së Pejës, e pastaj ia ka dërguar kryetarit të Pejës, Gamend Muhaxheri, të cilin e ka vënë në lajthim dhe pa e kontrolluar i njëjti e ka nënshkruar së bashku me vendimet tjera, me ç ‘rast i është njohur e drejta kompanisë “Citroen”, pronar i së cilës ishte Enver Daci, për kompensim në shumë prej mbi 400 mijë euro.

Procesi - Në këtë proces gjyqësor bashkë me Shalën, është akuzuar edhe një biznesmen për të cilin gjatë shqyrtimit gjyqësor, prokuroria ka hequr dorë nga ndjekja penale dhe aktualisht procedura është duke u zhvilluar vetëm për Shalën. Ish-shefi i kabinetit të kryetarit Muhaxheri, fillimisht është akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, por nga 15 prilli 2019, prokuroria atë e ngarkon për veprën penale të mashtrimit.²⁵¹

Gjykata Themelore në Pejë më 19 tetor 2019, e kishte gjetur fajtor Shalën dhe e kishte dënuar atë me dy vite burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohej nëse i njëjti nuk kryen vepër tjetër penale, brenda një afati prej një viti. Këtë dënim më pas e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²⁵²

²⁵¹ “Prokuroria ndryshon aktakuzën ndaj ish-shefit të kabinetit të kryetarit të Pejës, aktgjykim refuzues ndaj të akuzuarit tjetër”. Betimi për Drejtësi. 15 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ndryshon-aktakuzen-ndaj-ish-shefit-te-kabinetit-te-kryetarit-te-pejes-aktgjykim-refuzues-ndaj-te-akuzuarit-tjetert/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁵² Apeli vërteton dënimin ndaj të akuzuarit se tentoi të mashtronte kryetarin e Pejës për ta kompensuar një kompani Betimi për Drejtësi. 5 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimin-ndaj-te-akuzuarit-se-tentoi-te-mashtronte-kryetarin-e-pejes-per-ta-kompensuar-nje-kompani/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**DURIM SHEREMETI****Partia:** Anëtar i LDK-së**Pozitat shtetërore:** Shef i kabinetit të kryetarit të Komunës së Pejës, Gazmend Muhaxheri**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Pejë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Më 30 maj 2019, Prokuroria Themelore në Pejë ka ngritur aktakuzë kundër shefit aktual të kabinetit të kryetarit të Pejës Gazmend Muhaxheri, Durim Sheremeti dhe katër zyrtarëve të komunës së Pejës. Sheremeti akuzohet se ka nënshkruar raportin për pranimin e mallit, lidhur me tender të prokurimit për blerjen e makinës për mirëmbajtjen e barit artificial për Qendrën Sportive në Brestovik në Pejë, në vlerë prej 11 mijë e 929.41 euro, pa pasur mandate dhe kompetencë për të nënshkruar.

Procesi - Seanca fillestare ndaj Sheremetit dhe të tjerëve ishte mbajtur më 1 tetor 2019, në të cilën seancë të gjithë të akuzuarit ishin deklaruar si të pafajshëm.

Pasi është konfirmuar aktakuza, ka filluar edhe shqyrtimi gjyqësor i këtij rasti, i cili ishte paraparë të përfundonte në seancat e caktuara për 2 dhe 3 prill 2020²⁵³, por për shkak të ndërprerjes së shqyrtimeve gjyqësore për shkak të pandemisë Covid-19, këto seanca kanë dështuar.

Sipas një deklarimi për media të kryetarit të komunës së Pejës Gazmend Muhaxheri, Sheremeti, ka dhënë dorëheqje nga pozita e shefit të kabinetit të kryetarit.²⁵⁴

²⁵³ “Kërkohet kohë për përgatitjen e mbrojtjes, shtyhet gjykimi ndaj zyrtarëve të Pejës”. Betimi për Drejtësi. 25 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kerkohet-kohe-per-pergatitjen-e-mbrojtjes-shtyhet-gjykimi-ndaj-zyrtareve-te-pejes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁵⁴ “Zyrtarët e Pejës në gusht dalin para gjykatës, Muhaxheri ende s’ka marr masa ndaj tyre, pasi thotë s’është njoftuar zyrtarisht” Betimi për Drejtësi. 15 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zyrtaret-e-pejes-ne-gusht-dalin-para-gjykares-muhaxheri-ende-ska-marr-masa-ndaj-tyre-pasi-thote-seshte-njoftuar-zyrtarisht/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1 vit me
kusht dhe
200 euro
gjobë



IMRIJE SADRIU

Partia: Anëtare e LDK-së

Pozita shtetërore: Këshilltare në Asamblenë Komunale në Shtime

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim me gjobë dhe me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Prokuroria Themelore në Prishtinë më 10 dhjetor 2015, ka ushtruar aktakuzë ndaj Imrie Sadriut, e cila akuzohej se nga data 1 – 31 mars 2015, nuk i kishte paraqitur të dhënat e kërkuara për pasurinë e saj për vitin 2014 në Agjencinë Kundër Korrupsionit, në atë mënyrë që nuk e kishte përmbushur formularin për deklarim të pasurisë së zyrtarit të lartë publik në bazë të ligjit.

Procesi – Ish-këshilltarja komunale nga radhët e LDD-së e aktualisht këtë pozitë e mbanë në krah të LDK-së, në seancën fillestare të mbajtur më 18 shkurt 2016, e kishte pranuar fajësinë dhe ishte dënuar me kusht dhe me gjobë.²⁵⁵ Sadriu ishte gjykuar nga gjykata me gjobë në lartësi prej 200 euro dhe burgim me kusht prej një viti i cili nuk do të ekzekutohet nëse në periudhën prej dy viteve nuk do të kryen vepër tjetër penale.

²⁵⁵ “E akuzuara për mosraportim të pasurisë e pranon fajësinë në shqyrtimin fillestar”. Betimi për Drejtësi. 18 shkurt 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/e-akuzuara-per-mosraportim-te-pasurise-e-pranon-fajesine-ne-shqyrtimin-fillestar/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Refuzim



REXHË FEKA

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Mitrovicës së Jugut

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Feka, ishte akuzuar me aktakuzën e 30 nëntorit 2015 për veprën penale “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, pasi pretendohet se ai pasi i kishte përfunduar mandati i këshilltarit komunal më 24 dhjetor 2013, nuk e kishte bërë deklarinimin e pasurisë, të të ardhurave, të dobisë së tjetër pasurore ose të detyrimeve financiare.

Procesi- Seanca fillestare ndaj Fekës, ishte mbajtur më 22 shkurt 2016, në të cilën seancë ai nuk e kishte pranuar fajësinë për veprën për të cilën është akuzuar.²⁵⁶ Me 31 maj 2016 gjyqtarja Albina Shabani Rama kishte marrë aktgjykim refuzues në këtë rast, aktgjykim i cili ishte bërë i plotfuqishëm me datë 07 korrik 2016.²⁵⁷

²⁵⁶ “Hapet shqyrtimi fillestar për ish-këshilltarin e asamblesë në mitrovicë për mos raportim të pasurisë” Betimi për Drejtësi. 22 shkurt 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hapet-shqyrtimi-fillestar-per-ish-keshilltarin-e-asamblese-ne-mitrovice-per-mos-raportim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁵⁷ Shënim: Përgjigje e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlindë Gashi për IKD. 27 gusht 2019.

Refuzim

	MERITA SLLAMNIKU Partia: Anëtare e LDK-së Pozita shtetërore: Këshilltare Komunale në Komunën e Fushë Kosovës Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë Faza procedurale: Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)
---	---

Aktakuza - Merita Sllamniku, ishte akuzuar më 2 dhjetor 2014, me pretendimin se ajo nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë pasi i kishte përfunduar mandati i këshilltarit komunal më 11 dhjetor 2013, edhe pse e ka ditur se është dashur ta bëjë.

Procesi - Me 15 prill 2016 gjyqtarja Naime Krasniqi në këtë kishte marrë aktgjykim dhe kishte refuzuar aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, aktgjykim i cili është bërë i plotfuqishëm me 25 qershor 2016.²⁵⁸

²⁵⁸ Shënim: Përgjigje e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlindë Gashi për IKD. 27 gusht 2019.

**DEMË GASHI****Partia:** LDK**Pozita shtetërore:** Drejtor i Inspeksionit në Pejë**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Pejë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Aktakuza ndaj Gashit ishte ngritur më 27 mars 2018. Sipas prokurorisë ai si drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Pejës, gjatë periudhës 7 maj 2014 deri 14 nëntor 2016, nuk i ka përmbushur detyrat zyrtare duke lejuar ndërtimin e mbi katërmëdhjetë objekteve shumë banesore në regjionin e Pejës, pa leje, duke i mundësuar përfitimin e personave të tjerë.

Procesi - Procesin ndaj Gashit, në të cilin janë caktuar 11 seanca gjyqësore, pesë nga të cilat kishin dështuar të mbaheshin, është në përfundim pasi në seancën e 5 gushtit 2019, ai ka dhënë mbrojtjen e tij në të cilën ka mohuar pretendimet e prokurorisë²⁵⁹, ndërsa ky gjykim akoma është duke vazhduar edhe pse më zvarritje të mëdha.

Seanca e 20 shkurtit 2020, ishte seanca e katërt rresht e cila ishte shtyrë, dy herë për për shkak të mungesës së prokurorit, një herë për shkak të mungesës së avokatit mbrojtës dhe një herë për shkak të mungesës së të akuzuarit²⁶⁰, në atë seancë ishte vendosur që vazhdimi i këtij gjykimi të vazhdojë më 23 dhe 24 mars 2020, por për shkak të ndërprerjes së shqyrtimeve gjyqësore për shkak të pandemisë Covid-19, këto seanca kanë dështuar.

²⁵⁹ “Ish-drejtori në Pejë mohon përgjegjësinë për mos rrënimin e objekteve pa leje, thotë se ishte kompetencë e inspektorëve të ndërtimit”. Betimi për Drejtësi. 5 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-ne-peje-mohon-pergjegjesine-per-mos-rrenimin-e-objekteve-pa-leje-thote-se-ishte-kompetence-e-inspektoreve-te-ndertimit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁶⁰ “Për herë të katërt radhazi dështon gjykimi për korrupsion ndaj ish-drejtorit në Pejë”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/per-here-te-katert-radhazi-deshton-gjykimi-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-ne-peje/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



BALTON DERGUTI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Ferizajt

Veprat penale: “*Dhënia ose marrja e ryshfetit lidhur me votimin*”

Gjykata: Gjykata Themelore në Ferizaj

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Balton Derguti në zgjedhjet komunale të vitit 2017 ishte zgjedhur si këshilltar komunal në Kuvendin Komunal në Ferizaj, por prokuroria e këtij qyteti me aktakuzën e 12 shtatorit 2018, kishte vlerësuar se për të arritur këtë qëllim ai para zgjedhjeve i kishte premtuar përfitime pasurore votuesit Lirim Kryeziu në këmbim të 12 votave.

Procesi - Për këtë aktakuzë të prokurorisë Gjykata Themelore në Ferizaj kishte vendosur më 26 nëntor 2018, sipas të cilit Derguti, në mungesë të provave ishte shpallur i pafajshëm dhe ishte liruar nga akuza që kishte rënduar mbi të, i cili vendim është bërë i formës së prerë.

3 muaj
burgim
me kusht



SAMEDIN XHELADINI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Dragashit

Veprat penale: “Lëndim i lehtë trupor”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren-Dega Dragash

Faza procedurale: 3 muaj burgim me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Këshilltari i Kuvendit Komunal në Dragash, Samedin Xheladini ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prizren me 23 nëntor 2016, me pretendimin se ai në lokalet e Kuvendit Komunal në Dragash ishte përleshur me këshilltarin komunal nga radhët e PDK-së Artan Loshaj, të cilin e kishte goditur me grushte duke i shkaktuar atij lëndime të lehta trupore.

Procesi - Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash, më 11 dhjetor 2017, e kishte shpallur fajtor Xheladinin, dhe e kishte dënuar atë me dënim prej tre muajve dënim me kusht i cili nuk do të ekzekutohej nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti.²⁶¹, i cili vendim është bërë i formës së prerë.

²⁶¹ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, dega në Dragash. 11.12.2017

60 ditë burg
me kusht
dhe 250 euro
gjobë



QAZIM AZEMI

Partia: LDK

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Vushtrrisë

Vepra penale: “Përvetësim në detyrë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 60 ditë burgim me kusht dhe 250 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza-Prokuroria Themelore në Mitrovicë, më 6 prill 2016 ka akuzuar Qazim Azemin, për veprën penale “Përvetësim në detyrë”, pasi pretendohet se ai në cilësi të asamblistit të Kuvendit Komunal të Komunës së Vushtrrisë, gjatë mandatit të tij ishte furnizuar me pajisje për punë, gjegjësisht Lap-Top dhe çantë për Lap-Top, po ai nuk i kishte kthyer këto pajisje pas përfundimit të mandatit të tij, ndonëse ishte ftuar zyrtarisht nga zyrtarët komunalë që ta bëjë këtë gjë.

Procesi- Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 1 shtator 2016, Azemi e kishte pranuar fajësinë për akuzat e prokurorisë, ndërsa komuna e Vushtrrisë kishte hequr dorë nga kompensimi i dëmit me arsyetimin se i pandehuri i kishte kthyer pajisjet e marra më parë nga komuna. Pas kësaj, ai u dënua me 60 ditë burgim i cili nuk do të ekzekutohet brenda afatit prej një viti dhe 250 euro gjobë.

III. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të LVV-së



ALBIN KURTI

Partia: Kryetar i LVV-së

Pozita shtetërore: Kryeministër/Deputet

Veprat penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: Dënim - Një vit e gjashtë muaj me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

1 vit e 6
muaj
burgim
me kusht

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 16 dhjetor 2015 ka akuzuar ish-kryeministrin dhe ish-deputetin Albin Kurti për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Kjo aktakuzë ishte ngritur nën dyshimin se ai pa autorizim, më 8 tetor 2015, kishte hedhur gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit të Kosovës, duke pamundësuar vazhdimin e kësaj seance²⁶². Ndryshe, për hedhje të gazit lotsjellës në Kuvendin e Republikës së Kosovës dhe pengim të personit zyrtar gjatë tetorit 2015 janë akuzuar edhe Albulena Haxhiu, Donika Kadaj-Bujupi dhe Faton Topalli.

Procesi - Pasi kishin kaluar më shumë se tri vjet nga ngritja e aktakuzës, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 3 janar 2018 kishte shpallur fajtor Kurtin për këto dy vepra. Ai ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm, kurse për veprën penale të pengimit të personit zyrtar është dënuar me gjashtë muaj burgim. Ndaj tij, ishte shqiptuar dënimi unik prej një vit e gjashtë muaj burgim me kusht.²⁶³ Ky dënim me kusht i shqiptuar në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 18 shtator 2018.²⁶⁴

²⁶² *Shënim:* Gjatë muajve tetor, nëntor e dhjetor të vitit 2015, dhe fillim të vitit 2016 shumë seanca të Kuvendit të Kosovës dështuan pasi partitë opozitare pengonin mbajtjen e seancave duke hedhur gaz lotsjellës, në disa raste deputet e shumicës shkonin në salla alternative të Kuvendit të Kosovës por ndodhte që edhe aty të përballeshin me tymin e gazit lotsjellës.

²⁶³ “Dënohen me burgim me kusht Albin Kurti dhe tre deputetët e tjerë të Vetëvendosjes për gazin lotsjellës”, Betimi për Drejtësi. 3 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-me-kusht-albin-kurti-dhe-tre-deputetet-e-tjere-te-vetevendosjes-per-gazin-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁶⁴ “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotsjellës”, Betimi për Drejtësi, 18 shtator 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 1 vit e 4 muaj burgim me kusht

2. Në proces



ALBULENA HAXHIU

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputete

Veprat penale: 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 2. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Dënim - Një vit e katër muaj me kusht (Aktgjykim i formës së prerë), 2. Në proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 16 dhjetor 2015 ka akuzuar Haxhiun për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Ajo akuzohet se pa autorizim, më 8 tetor 2015, kishte hedhur gaz lotsjellës në sallën e Kuvendit të Kosovës, duke pamundësuar vazhdimin e kësaj seance.

Procesi 1 - Pas shumë zvarritjeve të këtij procesi gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 3 janar 2018 kishte shpallur fajtor Haxhiun për këto dy vepra penale. Ajo ishte dënuar me një vit e tre muaj burgim për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm, kurse për pengim të personit zyrtar është dënuar me gjashtë muaj, kurse në fund asaj i është shqiptuar dënimi unik prej një vit e katër muaj burgim me kusht.²⁶⁵ Ky dënim me kusht i shqiptuar në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 18 shtator 2018.²⁶⁶

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë të 8 prillit 2016, prokuroria pretendon se Haxhiu më 19 shkurt 2016, ka poseduar armë, ashtu që në hollin e Kuvendit, gjatë kontrollit që i është bërë asaj nga punëtorët e sigurimit, i është gjetur dhe sekuestruar një bombolë e gazit, të cilën e mbante pa autorizim.

²⁶⁵ “Dënohen me burgim me kusht Albin Kurti dhe tre deputetët e tjerë të Vetëvendosjes për gazin lotsjellës”, Betimi për Drejtësi, 3 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-me-kusht-albin-kurti-dhe-tre-deputetet-e-tjere-te-vetevendosjes-per-gazin-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁶⁶ “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotsjellës”, Betimi për Drejtësi, 18 shtator 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 2 – Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohej.²⁶⁷

²⁶⁷ Përgjigja e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020



GLAUK KONJUFCA

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Kryetar i Kuvendit të Kosovës/Ministër i Punëve të Jashtme/ Deputet

Veprat penale: 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 2. “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepra penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”,

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces, 2. Refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

1. Në
proces

2.
Refuzim

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Konjufcën, për veprat penale të përdorimit të armës dhe pengim të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Pretendohet se ai në seancën e 14 dhjetorit 2015, në sallën e Kuvendit ka përdorur armën, konkretisht ka hedhur gaz lotsjellës dhe ka detyruar deputetet të largohen nga salla. Krahas Konjufcës, për hedhjen e gazit lotsjellës në seancën e 14 dhjetorit 2015 po akuzohen edhe Pal Lekaj, Aida Dërguti, Besa Baftiu, Teuta Haxhiu dhe Time Kadrijaj.

Procesi 1 - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohej.²⁶⁸

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë të ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Konjufca akuzohet se së bashku me 26 aktivistë dhe krerë të Vetëvendosjes, në parkingun e EULEX-it afër stadiumit të Prishtinës, kishin dëmtuar dhe kthyer përmbys makinat e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si shenjë të kundërshtimit të një marrëveshjeje protokolli ndërshtetëror, që misioni evropian e kishte nënshkruar me Serbinë, por jo edhe me Kosovën.²⁶⁹

Procesi 2 – Lidhur me këtë rast, për katër vjet, gjykata ka arritur të mbaj vetëm dy seanca gjyqësore gjë që ka bërë që kjo lëndë të jetë arrij afatin e parashkrimit më 25 gusht 2019.²⁷⁰

²⁶⁸ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

²⁶⁹ *Shënim:* Krahas Glauc Konjufcës, për këto dy vepra penale akuzohen edhe Xhelal Sveçla, Besfort Berisha, Zgjim Hyseni, Lirim Gashi, Salih Zyba, Rron Gjinovci, Salih Mehmeti, Naser Shatri, Bujar Voca, Kasim Uka, Arbër Nuredini, Fatmir Kurtaj, Asdren Peci, Fatmir Haziri, Ramadan Deliu, Faruk Dakaj, Frashër Krasniqi, Skënder Merturi, Pajtim Demaj, Flamur Arifaj, Kushtrim Zeqiri, Kujtim Kosumi, Dardan Molliqaj, Skender Blakaj, Blerim Maçastena dhe Lulzim Xhaka.

²⁷⁰ “Katër ditë deri në parashkrimin e lëndës gjyqësore në rastin e dëmtimit të veturave të Eulexit”. Koha.net. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/180019/kater-dite-deri-ne-parashkrimin-e-lendes->



REXHEP SELIMI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputet i Kuvendit të Kosovës

Vepra penale: “Lëndim i lehtë trupor”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Anëtari dhe deputeti i LVV-së Regjep Selimi, ishte pjesë e një përleshje fizike në oborrin e Kuvendit të Kosovës së ndodhur më 28 qershor të vitit 2012. Prokuroria pretendonte se atëkohë deputet e LVV-së Visar Ymeri, Regjep Selimi dhe Florin Krasniqi, së bashku edhe me një vozitës të kësaj partie atë ditë kishin sulmuar fizikisht deputetin e PDK-së Bekim Haxhiu, duke i shkaktuar atij lëndime të lehta trupore.

Procesi - Katër vite pas përleshjes, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 25 prill 2016 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin kishte liruar nga akuza deputetin Selimi²⁷¹ me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur që me prova bindëse se ai ka kryer veprën penale për të cilën ishte ngarkuar.²⁷²

Pasi këtij vendimi të Themelores, prokuroria e pakënaqur me këtë vendim i ishte drejtuar me ankesë Gjykatës së Apelit, por kjo gjykatë më 7 qershor 2016, kishte refuzuar ankesën e prokurorisë dhe kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë, duke e liruar përfundimisht Selimin, nga kjo akuzë.²⁷³

[gjuqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IëAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE](https://www.evropaelire.org/a/27695875.html)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁷¹ Shënim: Përpos Ymerit nga akuza ishte liruar edhe deputeti Regjep Selimi, ndërsa ishte dënua vozitësi Besart Bujupi ishte dënua me katër muaj burgim me kusht. Ndaj deputetit Florin Krasniqi ishte veçuar procedura pas i njëjti ndodhej jashtë Kosove.

²⁷² “Deputetët Ymeri e Selimi shpallen të pafajshëm”. Radio Evropa e Lirë. 25 prill 2016. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/27695875.html>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁷³ “Vërtetohet aktgjykimi në rastin e të akuzuarve Rexhep Selimi, Visar Ymeri dhe B.B.” Gjykata e Apelit. 21 qershor 2016. (shih linkun: <http://apeli.gjuqesori-rks.org/2016/06/21/vertetohet-aktgjykimi-ne-rastin-e-te-akuzuarve-rexhep-selimi-visar-ymeri-dhe-b-b/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Refuzim

2.
Refuzim

3. Në
proces



SALIH ZYBA

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputet i Kuvendit të Kosovës/ Drejtor Komunal në Komunën e Prishtinës

Vepra penale: 1. “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, 2. “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, 3. “Përdorim i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë e akuzon Zybën se ka kryer veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”. Sipas kësaj aktakuze, Zyba akuzohet se më 27 nëntor 2013, pasi kishte kaluar mesnate, kishte bërë largimin e flamurit shtetëror nga shtylla e tij te rrethi afër spitaleve në Prishtinë, Prokuroria bën me dije se Zyba atë natë e kishte zhvendosur flamurin shtetëror, duke e lënë në tokë me qëllimin që për 28 nëntorin e atij viti ta vë flamurin kuqezi.

Procesi 1 – Procesi gjyqësor ndaj Zybës për largimin e flamurit shtetëror është përmbyllur me një aktgjykim refuzues, pasi prokurori ishte tërhequr nga ndjekja penale.²⁷⁴

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë të ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Zyba akuzohet se së bashku me 26 aktivistë dhe krerë të Vetëvendosjes, më 25 gusht 2009, në parkingun e EULEX-it afër stadiumit të Prishtinës, kishin dëmtuar dhe kthyer përmbyks makinat e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si shenjë të kundërshtimit të një marrëveshjeje protokolli ndërshtetëror, që misioni evropian e kishte nënshkruar me Serbinë, por jo edhe me Kosovën.

Procesi 2 - Lidhur me këtë rast, për katër vjet, gjykata ka arritur të mbaj vetëm dy seanca gjyqësore gjë që ka bërë që kjo lëndë të jetë arrij afatin e parashkrimit më 25 gusht 2019²⁷⁵.

²⁷⁴ “Prokurori heq dorë nga ndjekja e Salih Zybës”. Arbresh.ifo. 22 mars 2016. (Shih linkun <http://time.ikub.al/Prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-e-Salih-Zybes230871/Prokurori-heq-dore-nga-ndjekja-e-Salih-Zybes.aspx>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁷⁵ “Katër ditë deri në parashkrimin e lëndës gjyqësore në rastin e dëmtimit të veturave të Eulexit”. Koha.net. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/180019/kater-dite-deri-ne-parashkrimin-e-lendes->

Aktakuza 3 - Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtit kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi 3 - Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁷⁶

[gjyqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IëAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE](https://www.gjyqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IëAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁷⁶ Shënim: Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, 23 qershor 2020.

1.
Refuzim

2. Në
proces



XHELAL SVEÇLA

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputet;/ Zv.Minister i Ministrisë së Punëve të Brendshme/Drejtor Komunal në Komunën e Prishtinës

Vepra penale:1. “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, 2. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale:1. Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Në proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj Sveçlës për shkak të veprave penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”. Sipas kësaj aktakuze, ai akuzohet se së bashku me 26 aktivistë dhe krerë të Vetëvendosjes, më 25 gusht 2009, në parkingun e EULEX-it afër stadiumit të Prishtinës, kishin dëmtuar dhe kthyer përmbys makinat e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si shenjë e kundërshtimit të një marrëveshjeje protokolli ndërshtetëror, që misioni evropian e kishte nënshkruar me Serbinë, por jo edhe me Kosovën.

Procesi 1 - Lidhur me këtë rast, për katër vjet, gjykata ka arritur të mbaj vetëm dy seanca gjyqësore gjë që ka bërë që kjo lëndë të jetë arrij afatin e parashkrimit më 25 gusht 2019²⁷⁷.

Aktakuza 2 - Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtit kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi 3 - Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁷⁸

²⁷⁷ “Katër ditë deri në parashkrimin e lëndës gjyqësore në rastin e dëmtimit të veturave të Eulexit”. Koha.net. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/180019/kater-dite-deri-ne-parashkrimin-e-lendes-gjyqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IwAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁷⁸ Shënim: Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, 23 qershor 2020.

1. Në
proces

2.
Refuzim



ISMAJL KURTESHI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputet

Vepra penale: 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare” 2. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1.Në proces, 2.Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 6 janar 2016 ka akuzuar Kurteshin se më 30 nëntor 2015, në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës, me qëllim të ndërprerjes së punimeve në seancë, kanë hedhur gaz lotsjellës, të cilin e posedonin pa autorizim. Po ashtu, Shala akuzohet se më 17 nëntor 2015 në cilësinë e deputetit nga radhët e Nismës për Kosovën, me disa deputetë të tjerë janë munduar që ta pamundësojnë shoqërimin e deputetit Albin Kurti nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Procesi 1 - Aktakuzën ndaj tij për herë të parë e kishte konfirmuar gjykatësi Faik Hoxha por pas ankesave në Gjykatën e Apelit, e njëjta e kishte kthyer në rivendosje këtë çështje. Më pas, kjo lëndë i ishte ndarë gjykatësit Vehbi Kashtanjeva, pasi gjykatësi Hoxha veç kishte dhënë dorëheqje. Pas tri dështimeve të mbajtjes së seancave, gjykatësi Kashtanjeva më 20 nëntor 2017 kishte refuzuar kërkesat e të akuzuarve për hudhjen e aktakuzës. Aktakuza në këtë rast kishte marrë formën e prerë më 22 dhjetor 2017 pasi Apeli kishte marrë vendim për refuzimin e kërkesave të mbrojtjes për hudhjen e aktakuzës. Ky rast, më 13 mars 2019 kishte kaluar Departamenti për Krime të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm ndërsa sipas zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi, kjo lëndë do të procedohet sipas radhës së arritjes së lëndëve në gjykatë.²⁷⁹

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë, Prokuroria Themelore në Prishtinë më 28 qershor 2017 ka akuzuar Kurteshin për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”. Prokuroria pretendon se ai më 26 shkurt 2016, ka përdorur armën apo mjetin e rrezikshëm duke hedhur gaz lotsjellës me qëllim të ndërprerjes së mbledhjes së kuvendit. Për hedhje të gazit në seancën e 26 shkurtit 2016 akuzohet edhe Bali Muharremaj.

²⁷⁹ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Procesi 2 - Ky proces gjyqësor ishte përcjellë me praktika jo të zakonshme gjyqësore pasi prokurorja Ferdane Sylejmani, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 2 maj 2019, ishte tërhequr nga ndjekja penale ndaj Muharremajt. Ajo ndër morri një veprim i tillë pasi gjykata shpalli si të papranueshme provat e prezantuara nga prokurorja Sylejmani, me arsyetimin se ato i referoheshin një rasti tjetër, e jo atij për të cilin po zhvillohej ky proces gjyqësor.

Kjo kishte për pasojë që Gjykata Themelore në Prishtinë, të nxjerrë aktgjykim refuzues po në seancën e 2 majit. Ndërsa, i akuzuari Kurteshi, në të gjitha fazat e procedurës ishte deklaruar i pafajshëm për këtë vepër penale, edhe pse i njeiti nuk kishte mohuar se ka hedhur gaz lotësjellës në sallën e kuvendit, me qëllim që sipas tij, të mbrohej sovraniteti dhe integriteti i vendit.²⁸⁰

²⁸⁰ “Konfirmohet aktakuza për hedhjen e gazit lotësjellës ndaj Bali Muharremajt dhe Ismajl Kurteshit”. Betimi për Drejtësi. 23 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ndaj-bali-muharremajt-dhe-ismajl-kurteshit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Hudhje



LIBURN ALIU

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputet/Drejtor i Urbanizmit në Komunën e Prishtinës

Veprat penale: “Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 26 korrik 2019, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i pandehuri Aliu akuzohet se më 21 mars 2018, si deputet në Kuvendin e Kosovës kishte penguar personat zyrtar-deputetët e Kuvendit në kryerjen e detyrave zyrtare, në atë mënyrë që derisa deputetët e Kuvendit të Republikës së Kosovës kanë qenë në pauzë, i akuzuari Aliu është futur në sallën e legjislativit dhe nga tavolinat e deputetëve ka marrë rreth 40 kartela zyrtare për votim, duke pamundësuar zhvillimin e suksesshëm të seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Me këtë, ai akuzohet për veprën penale “pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare”.

Procesi - Mirëpo, akoma pa filluar as seanca fillestare dhe pa u ftuar asnjëherë në sallën e gjyqimit për tu përballur me aktakuzën e cila e ngarkonte atë, prokuroria përmes një shkresë të 30 shtator 2019, prokurori Besart Mustafa, i ka dorëzuar gjykatës njoftimin për tërheqjen nga kjo aktakuzë.

Aty thuhet se organi i akuzës ka analizuar provat, foto dokumentacionin, video-incizimin dhe provat tjera që gjenden në shkresat e lëndës ka ardhur në përfundim se në rastin konkret nuk është përdorur forca, përkatësisht dhuna, e as kanosja serioze nga i akuzuari Aliu, kishte kryer veprën penal”.

Pas këtij vendimi, Gjykata Themelore e Prishtinës ka pushuar procedurën ndaj të pandehurit Aliu.²⁸¹

²⁸¹ “Prokuroria tërhiqet nga aktakuza, pushohet procedura penale ndaj ish-deputetit Liburn Aliu” Betimi për Drejtësi. 15 tetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pushohet-procedura-penale-ndaj-ish-deputetit-liburn-aliu/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



DRITA MILLAKU

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputete e Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza: Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtët kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi: Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁸²

²⁸² Përgjigja e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Në
proces



FITORE PACOLLI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputete e Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza: Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtët kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi: Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁸³

²⁸³ Përgjigja e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Në
proces



ARBËRIE NAGAVCI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputete e Kuvendit të Kosovës/Nënkryetare e Kuvendit të Kosovës
Veprat penale: “*Armëmbajtje pa leje*”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza: Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtit kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi: Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁸⁴

²⁸⁴ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Në
proces



VALON RAMADANI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Deputete e Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza: Prokuroria Themelore e Prishtinës ka ngritur aktakuzë kundër të pandehurve Salih Zyba, Xhelal Sveçla, Fitore Pacolli, Drita Millaku, Liburn Aliu, Valon Ramadani dhe Arbërie Nagavci, për shkak të dyshimit se të njëjtit kishin hedhur gaz lotsjellës gjatë seancës së Kuvendit të Kosovës, të mbajtur më 21 mars të vitit 2018.

Procesi: Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.²⁸⁵

²⁸⁵ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020



AGIM BAHTIRI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Mitrovicës

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: Hedhje aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Me 1 mars 2016, PSRK-ja kishte ngritur aktakuzë ndaj kryetarit të kësaj komune Agim Bahtiri që në atë kohë përfaqësonte partinë e AKR-së dhe dy personave të tjerë. Sipas prokurorisë, Bahtiri dhe të tjerët, në kundërshtim me dispozitat ligjore, për tenderin për “Furnizim, montim dhe mirëmbajtje e ndriçimit publik eficient në të gjitha rrugët e qytetit të Mitrovicës” i kanë sjellë fitim operatorit ekonomik ” HESALIGHT A/S. Me këto veprime Bahtiri llogaritej se i ka shkaktuar dëm komunës në vlerë prej 767.940.00 euro.

Procesi - Gjykata Themelore në Mitrovicë, në mesin e muajt korrik të vitit 2016 kishte hedhur poshtë aktakuzën ndaj Bahtirit, me arsyetimin se nuk është arritur dyshimi i bazuar mirë se të akuzuarit kanë kryer veprat penale, të cilin vendim më 27 shkurt 2017, e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.²⁸⁶

Prokuroria, e pakënaqur me këtë vendim i ishte drejtuar edhe Gjykatës Supreme, por edhe kjo gjykatë kishte refuzuar kërkesën e prokurorisë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke lënë në fuqi vendimet e dy instancave gjyqësore të cilat kishin hedhur aktakuzën ndaj Bahtirit.²⁸⁷

²⁸⁶ “Dështon edhe një aktakuzë e profilit të lartë të korrupsionit, Gjykata e Apelit e rrëzon aktakuzën kundër Agim Bahtirit”. Betimi për Drejtësi. 22 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktuza-ndaj-kryetarit-te-mitrovices-agim-bahtiri/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁸⁷ “Gjykata Supreme vërteton hudhjen e aktakuzës ndaj kryetarit të Mitrovicës, Agim Bahtiri”. Betimi për Drejtësi. 4 tetor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-supreme-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-kryetarit-te-mitrovices-agim-bahtiri/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**XHEVAT BISLIMI****Partia:** LVV**Pozita shtetërore:** Nënkyetar i Komunës së Vitisë**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjilan**Faza procedurale:** Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i shkallës së prerë)

Aktakuza – Xhevat Bislimi akuzohej se në cilësi të nënkryetarit të Komunës së Vitisë, ka shpërdorur pozitën zyrtare në atë mënyrë që pa i respektuar rregullat e tenderimit, me qëllim që zyrës projektuese “Geodezy & Projects” t’i sjell dobi të kundërligjshme, ka lidhur marrëveshje pune për hartimin e projektit për kanalizim për ujrë fekal për disa rrugë si dhe ka lejuar pagesën e punëve të pakryera duke i mundësuar përfitim të kundërligjshëm prej 3,028.20 euro.

Procesi – Në dhjetor 2015, prokurori i rastit kishte hequr dorë nga ndjekja penale ndaj Xhevat Bislimit. Fillimisht prokurori kishte kërkuar ndryshimin e dispozitivit të aktit akuzues, që do të thotë nga vepra penale keqpërdorim i detyrës zyrtare të bëhet në ricilësim të veprës penale shpërdorim i detyrës zyrtare. Gjykata kishte pranuar këtë ricilësim të veprës penale, ndërsa vepra e ri cilësuar ishte vjetërsuar për dy të akuzuarit.²⁸⁸

²⁸⁸ “Lirohet nga ndjekja penale Xhevat Bislimi e Avdulla Emini”. Rajonipress.com. 30 dhjetor 2015. (Shih linkun: <https://rajonipress.com/lirohet-nga-ndjekja-penale-xhevat-bislimi-e-avdulla-emini/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



XHEVXHET BERISHA

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunën e Klinës

Veprat penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: Tre muaj dënim me kusht në afat verifikimi prej një viti (Aktgjykim i formës së prerë).

3 muaj
me
kusht

Aktakuza - Xhevdet Berisha, akuzohej sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë, të ngritur më 9 tetor 2018, se në mes datave 01 deri më 31 mars 2018, si këshilltar Komunal në Komunën e Klinës, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, i kualifikuar sipas nenit 3 paragrafi 1, pika 1.1.8, të ligjit 04/L-050, nuk e ka deklaruar pasurinë për vitin paraprak të kërkuar nga Agjencia Kundër Korrupsionit. Në aktakuzë thuhet se edhe pse i njëjti ka qenë i informuar me shkrim, për të bërë deklarin e pasurisë, për periudhën kohore nga 01 janari e deri më 31 dhjetor të 2017, i akuzuari nuk e kishte bërë deklarin e pasurisë brenda afatit të kërkuar ligjor. Ai akuzohet se ka kryer veprën penale “mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare, nga nenin 437 paragrafi 1, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës”.

Procesi – Në seancën fillestare të mbajtur për këtë rast më 12 dhjetor 2018, Berisha e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej. Prokurorja e çështjes Sanije Gashi-Seferi, nuk e kishte kundërshtuar këtë pranim të fajësisë, pasi sipas saj sipas saj, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pa presion nga askush dhe që është në përputhje të plotë me shkresat e lëndës. Pas deklaramit të akuzuarit dhe prokurores, pranimin e fajësisë nga i akuzuari Berisha, e kishte aprovuar gjykatësja e rastit, Sabrije Rraci.²⁸⁹

Gjykata Themelore në Pejë, dega në Klinë, më 19 dhjetor 2018, e kishte shpall fajtor Berishën dhe të njëjtin e kishte gjykuar me dënim burgu në kohëzgjatje prej tre muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse li akuzuari në afat prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.

²⁸⁹“Këshilltari komunal në Klinë pranon fajësinë për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 12 dhjetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/keshilltari-komunal-ne-kline-pranon-fajesine-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ADEM SHABANAJ

Refuzim

Partia: Anëtar i LVV-së

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunën e Prizrenit

Vepra penale: “Ngacmimi”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë, dega në Drenas

Faza procedurale: Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 23 tetor 2018 e ka akuzuar Shabanajn se ka kryer veprën penale “Ngacmimi”. Prokuroria pretendon se ai më 26 korrik 2018, pas orës 01:00 të mesnatës kishte ngacmuar dhe shqetësuar përmes telefonit tani të dëmtuarën A.B.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, dega në Drenas me vendimin e nxjerrë më 26 qershor 2019, ka refuzuar aktakuzën e ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë për veprën penale të ngacmimit ndaj Adem Shabanaj. Ky vendim ishte nxjerrë nga gjykata pasi që prokurorja e rastit, Merita Shala-Muhaxhiri, gjatë prezantimit të fjalës së saj përfundimtare, ishte tërhequr nga ndjekja penale ndaj Shabanajt.²⁹⁰

²⁹⁰ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, dega në Drenas. 26.06.2019

**LEVENT KASEMI****Partia:** LVV**Pozita shtetërore:** Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Prizrenit të ngritur më 29 nëntor 2019, i pandehuri Kasemi, së bashku me disa persona të tjerë, duke qenë pjesë e komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prizrenit, në bashkëkryerje me dashje kanë shkelur kriterin e vetëm të Ankandit Publik, gjegjësisht nenin 5, paragrafi 3 të ligjit nr.04/L-144, ku theksohet se procedura për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale bëhet përmes Ankandit Publik, dhe akteve nënligjore, ku theksohet se përzgjedhja e fituesit bëhet në bazë të një kriteri dhe atë të çmimit më të lartë të ofruar.

Duke vepruar në këtë mënyrë, të njëjtit kanë shkelur të drejtat e të dëmtuarit Albert Doqi, duke përzgjedhur si shfrytëzuese ofertuesen Fatmire Berisha, përkundër faktit se i dëmtuari Doqi, kishte kuotuar çmimin më të lartë, gjegjësisht shumën 25.20 euro për m2, për lokalin nr.29, i cili gjendet në sheshin “Shatërvan”, por i njëjti lokali i është dhënë në shfrytëzim ofertueses Berisha, me çmim pre 20.06 euro për m2. përkundër faktit se në bazë të dokumentacionit të prezantuar dëshmohej se përfituesja Fatmire Berisha, nuk ka pasur përvojë në menaxhim dhe zhvillim të biznesit, komisioni për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale në Prizren, të njëjtën e ka poentuar me pikë maksimale. Sipas aktakuzës, më pas komisioni për ankesa pranë Kuvendit Komunal në Prizren, e kishte aprovuar kërkesën e palës së dëmtuar, ku më 28 shkurt 2019, ka anuluar vendimin e këtij komisioni duke e dërguar çështjen në rishqyrtim, përkundër faktit të tillë, Komisioni përmes njoftimit të datës 1 prill 2019, ka potencuar se qëndrojnë pranë njoftimit të datës 17 janar 2019, ku janë shpallur fituesit e ankandit për shfrytëzimin me qira të lokaleve-pronë komunale.

Procesi - I akuzuari Kasemi, Drejtori i Shërbimeve Publike në Komunën e Prizrenit, në seancën e mbajtur më 20 shkurt 2020 është deklaruar i pafajshëm, ndërsa seanca e radhës mbetet e papërcaktuar²⁹¹

²⁹¹ “Drejtorët në Prizren dhe të tjerët mohojnë fajësinë se kundërligjshëm dhanë në shfrytëzim pronën komunale” Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/drejtoreset-ne-prizren-dhe-te-tjeret->



VALON HOTI

Partia: LVV

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunën e Malishevës

Veprat penale: 1. “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”; 2. “pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore Gjakovë, dega në Malishevë

Faza procedurale: 1. Gashtë muaj burg me kusht dhe 400 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë), 2. Në proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Gjakovë më 1 shkurt 2018 ka akuzuar Hotin se nuk e ka deklaruar pasurinë për periudhën e vitit 2016, edhe këtë ka qenë i detyruar ta bëjë deri më 31 mars 2017.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 18 dhjetor 2019 pasi i akuzuari Hoti në shqyrtimin fillestar të 13 shtatorit 2019, e kishte pranuar fajësinë, e kishte dënuar Hotin me gjashtë muaj burgim me kusht, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari nuk kryen vepër tjetër penale, brenda periudhës kohore prej një viti dhe me dënim me 400 euro gjobë.²⁹²

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë, të ngritur më 7 gusht 2013, Prokuroria Themelore në Gjakovë po pretendon se Valon Hoti, më 24 qershor 2013 i ka penguar policët, duke i kapur për duar nga mbrapa, duke i penguar në ushtrimin e detyrës zyrtare, gjersa aktivistët e tjerë të “Vetëvendosjes”, kryenin aksionin e tyre, si shenjë sensibilizimi të sigurisë së përgjithshme të qytetarit kundër rriqrave.

Procesi 2 – Më 23 prill 2019 është mbajtur shqyrtimi fillestar për këtë rast, ku Hoti ishte deklaruar i pafajshëm për akuzat me të cilët ngarkohet, ndërsa ky proces gjyqësor, është duke vazhduar.

[mohojne-fajesine-se-kunderligishem-dhane-ne-shfrytezim-pronen-komunale/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁹² “Ish-asamblisti në Malishevë dënohet me burgim me kusht dhe me gjobë për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-asamblisti-ne-malisheve-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

5 vite
burgim



SADRI RAMABAJA

Partia: Anëtar LVV-së

Pozita shtetërore: Këshilltar komunal në Komunën e Prishtinës

Vepra penale: “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Pesë vite burgim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza- PSRK më 27 shkurt 2018, ka ngritur aktakuzë ndaj Sadri Ramabajës dhe nëntë personave të tjerë. Në këtë aktakuzë përfshihen vepra penale të “hakmarrjes”, “dhunimit” e veprave të tjera penale, ndërsa pjesë e kësaj aktakuzë është edhe Sadri Ramabaja, i cili është akuzuar për veprën penale “Përgatitja e veprave terroriste ose veprave penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Republikës së Kosovës”. Sipas aktakuzës, Ramabaja dhe të tjerët, pretendohet se më 15 maj 2017, si pjesëtarë të organizatës kriminale “Syri i Popullit”, me të ashtuquajturin ‘Avni Rustema’ diku në një shtet të Evropës kishin filluar aksionet e kundërligjshme me qëllim që të destabilizojnë ose shkatërrojnë strukturat themelore politike, ekonomike dhe kushtetuese të Republikës së Kosovës. Ata thuhet se kishin planifikuar sulme dhe vrasje ndaj personaliteteve të lartë shtetëror të konsideruar si ish funksionarë të viteve 1980-1991 si tradhtar të vendit. Këto sulme, sipas aktakuzës, ata kishin planifikuar t’i kryenin ndaj Presidentit të Kosovës Hashim Thaçi, kryetarit të Kuvendit Kadri Veseli, ish-kryeministrit Isa Mustafa, ish-ministrit Hajredin Kuçi, Xhavit Haliti, Fatmir Limaj duke vazhduar me komandantë të luftës së UÇK-së, drejtorin e ATK-së, klerikët fetarë etj.

Sipas prokurorisë, ky grup me qëllim të vrasjes së këtyre personave që i konsideronin si tradhtar kishin themeluar fondin “Liria e Atdheut” dhe si organizatë “Syri i Popullit” kishin një strukturë të ndarë në bazë të hierarkisë, kishin emra të koduar dhe detyra të ndara thuhet ndër tjera në aktakuzë.

Procesi - Ish-këshilltari komunal në Komunën e Prishtinës, ishte deklaruar i pafajshëm në seancën fillestare të mbajtur më 11 prill të vitit 2018 ²⁹³ dhe pas konfirmimit të aktakuzës,

²⁹³ “Deklarohen të pafajshëm të akuzuarit në rastin “Syri i Popullit”. Betimi për Drejtësi. 11 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deklarohen-te-pafajshem-te-akuzuarit-ne-rastin-syri-i-popullit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

shqyrtimi gjyqësor kishte filluar më 2 korrik 2018. Në këtë proces që akoma është duke vazhduar në cilësi të dëshmitarit janë dëgjuar Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, por në seancë të mbyllur për publikun²⁹⁴, Kryetari i Kuvendit të Kosovës Kadri Veseli²⁹⁵, zëvendëskryeministri i Kosovës Fatmir Limaj²⁹⁶ dhe deputetet Albulena Haxhiu, Xhavit Haliti, Faton Topalli, Elmi Reçica, ish-deputet Adem Grabovci, Shaip Muja, Nuredin Ibishi dhe ish-ministri i Drejtësisë Hajredin Kuci. Përpos deklaratës së tij të dhënë në cilësi të dëshmitarit, presidenti Thaçi, ishte paraqitur edhe në seancën e 11 korrikut 2019, në cilësi të të dëmtuarit ku i kishte parashtruar pyetje të akuzuarve. Edhe kjo seancë me kërkesë të presidentit ishte mbajtur e mbyllur për mediat dhe publikun.²⁹⁷

Pas kësaj seance mbrojtja kishte konsideruar se trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësja Naime Krasniqi-Jashanica dhe prokurori i PSRK-së Sylë Hoxha kanë lejuar që Thaçi të bëj pyetje edhe jashtë aktakuzës, çka sipas mbrojtjes e kishin bërë të padenjë këtë trup gjykues të udhëheq për këtë proces gjyqësor.²⁹⁸ Por kjo kërkesë e mbrojtjes ishte hedhur poshtë nga kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë Aferdita Bytyqi më 18 korrik 2019, avokatet e të akuzuarve nuk kishin paraqitur rrethana me të cilat do të arsyetohin përjashtimin e trupit gjykues nga vendosja e kësaj çështje penale.²⁹⁹ Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata më 22 janar 2020, kishte shpallur aktgjykimin me të cilin Sadri Ramabaja, Murat Jashari, Ragip Sallova, Avni Llumnica, Bexhet Luzha, Halim Halimi, Bajrush Konjusha dhe Rexhep Topllana, janë shpallur fajtorë për vepra penale kundër rendit kushtetues dhe vepra të tjera. Ramabaja për këto pretendime, është dënua me 5 vjet burg³⁰⁰, ndërsa ky rast aktualisht është në Gjykatën e Apelit.³⁰¹

²⁹⁴ “Rasti “Syri i Popullit”, Presidenti Thaçi kërkon të mbyllet seanca, aprovohet kërkesa e tij”. Betimi për Drejtësi. 18 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-syri-i-popullit-presidenti-thaci-kerkon-te-mbyllet-seanca-aprovohet-kerkesa-e-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁹⁵ “Rasti “Syri i Popullit”, përplasje mes Kadri Veselit dhe të akuzuarit Avni Llumnica (Video)”. Betimi për Drejtësi. 28 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-syri-i-popullit-perplasje-mes-kadri-veselit-dhe-te-akuzuarit-avni-llumnica/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁹⁶ “Rasti “Syri i Popullit”, Fatmir Limaj thotë se institucionet e sigurisë e njoftuan se ishte i kërcënuar me jetë” Betimi për Drejtësi. 25 janar 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-syri-i-popullit-fatmir-limaj-thote-se-institucionet-e-sigurise-e-njoftuan-se-ishte-i-kerccenuar-me-jete/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁹⁷ Hashim Thaçi në gjykimin ndaj të akuzuarve në rastin “Syri i Popullit”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hashim-thaci-ne-gjykimin-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-syri-i-popullit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).


²⁹⁸ “Pas dëshmisë së Hashim Thaçit, mbrojtja kërkon përjashtimin e trupit gjykues dhe prokurorit nga rasti “Syri i Popullit”. Betimi për Drejtësi. 11 korrik 2019. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-deshmise-se-hashim-thacit-mbrojtja-kerkon-perjashtimin-e-trupit-gjykues-dhe-prokurorit-nga-rasti-syri-i-popullit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

²⁹⁹ “Rasti “Syri i Popullit”, kryetarja e gjykatës refuzon kërkesën e avokatëve për përjashtimin e trupit gjykues nga ky rast”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-syri-i-popullit-kryetarja-e-gjykates-refuzon-kerkesen-e-avokateve-per-perjashtimin-e-trupit-gjykues-nga-ky-rast/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰⁰ Shpallen fajtorë dhe dënohen me burg të akuzuarit në rastin “Syri i Popullit”, tensione në sallë (Video) Betimi për Drejtësi 22 janar 2020 (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-fajtores-dhe-denohen-me-burg-te-akuzuarit-ne-rastin-syri-i-popullit-tensione-ne-salle-video/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰¹

IV. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të AAK-së



PAL LEKAJ

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Ministër i Infrastrukturës dhe Transportit,/Deputet/Kryetar i Komunës së Gjakovës

Veprat penale: 1.“Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 2. . “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”, 3.“Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 4. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: 1,2. Gjykata Themelore Prishtinë, 3,4. Gjykata Themelore Gjakovë

Faza procedurale: 1.Në proces, 2.Në proces, 3.Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë) 4.Në proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Lekajn, për veprat penale të përdorimit të armës dhe pengim të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Pretendohet se ai në seancën e 14 dhjetorit 2015, në sallën e Kuvendit ka përdorur armën, konkretisht ka hedhur gaz lotsjellës dhe ka detyruar deputetet të largohen nga sallat.

Procesi 1 - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohej.³⁰²

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë të 8 prillit 2016, prokuroria pretendon se Lekaj më 19 shkurt 2016, ka poseduar armë, ashtu që në hollin e Kuvendit, gjatë kontrollit që i është bërë asaj nga punëtorët e sigurimit, i është gjetur dhe sekuestruar një bombolë e gazit, të cilën e mbante pa autorizim.

³⁰² Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Procesi 2 - Edhe kjo lëndë, akoma nuk ka filluar që të gjykohej.³⁰³

Aktakuza 3 - Sipas aktakuzës së tretë të ngritur nga PSRK-ja në shkurt të vitit 2017, Lekaj akuzohet se në kohën sa ishte kryetar në komunën e Gjakovës, me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, kishte tejkaluar kompetencat e tij zyrtare, duke i shkaktuar dëm komunës së Gjakovës dhe banorëve të saj

Procesi 3 - Kjo aktakuzë e cila e ngarkonte Lekajn për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, ishte hedhur poshtë nga Gjykata Themelore në Gjakovë në maj të vitit 2017, me arsyetimin se nuk kishte prova që argumentonin se Lekaj kishte kryer këtë veprë penale.³⁰⁴ Ky vendim për hudhje të kësaj aktakuze, ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit në qershor të vitit 2017.³⁰⁵

Aktakuza 4 - Sipas aktakuzës së katërt të ngritur sërish nga PSRK-ja, Lekaj akuzohet se duke vepruar në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Gjakovës, gjatë viteve 2008-2014, ka shpërndarë subvencione në kundërshtim me ligjin, duke dëmtuar buxhetin e komunës në vlerën 250 mijë euro.

Procesi 4 - Kjo aktakuzë e ngritur nën dyshimet se Lekaj ka kryer veprën penale të korrupsionit është vërtetuar nga Gjykata Themelore në Gjakovë 10 janar 2019 dhe më pas, nga Gjykata e Apelit, në mars të këtij viti.³⁰⁶ Po kjo aktakuzë e ngarkonte Lekajn edhe për veprën penale “përvetësimi në detyrë”, mirëpo kjo pikë e aktakuzës hudhur poshtë nga shkalla e parë në mungesë provash.³⁰⁷ Aktualisht, procesi gjyqësor është duke vazhduar ndaj Lekajt për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar pranë Gjykatës Themelore në Gjakovë.

³⁰³ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, 23.06.2020

³⁰⁴ “Gjykata Themelore në Gjakovë hedhë poshtë aktakuzën ndaj ish-kryetarit të Gjakovës, Pal Lekaj”. Betimi për Drejtësi, 19 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-themelore-ne-gjakove-hedhe-poshte-aktakuzen-ndaj-ish-kryetarit-te-gjakoves-pal-lekaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰⁵ “Apeli vërteton hedhjen e aktakuzës ndaj ish-kryetarit të Gjakovës, Pal Lekaj”. Betimi për Drejtësi, 22 Qershor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hedhjen-e-aktakuzes-ndaj-ish-kryetarit-te-gjakoves-pal-lekaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰⁶ “Apeli vërteton aktakuzën për korrupsion ndaj Pal Lekajt dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi, 14 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktakuzen-per-korrupsion-ndaj-pal-lekajt-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰⁷ “Hudhet pjesërisht aktakuza ndaj ministrit Pal Lekaj”. Betimi për Drejtësi, 24 Korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-pjeserisht-aktakuza-ndaj-ministrit-pal-lekaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



RRUSTEM BERISHA

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Ministër i Mbrojtjes

Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale, Rustem Berisha akuzohet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës. Bashkë me Berishën, në këtë rast janë të akuzuar edhe Agim Ceku, Sadik Halitjaha, Nuredin Lushtaku, Qelë Gashi, Shkumbin Demaliaj, Ahmet Daku, Shukri Buja, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Procesi – Buja dhe të akuzuarit tjerë në këtë rast, ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur për këtë rast më 14 mars 2019. Të njëjtit, kishin kërkuar nga gjykatësja e rastit, Nushe Kuka-Mekaj, hudhjen e aktakuzës.³⁰⁸ Megjithatë, aktakuza ndaj Berisha dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e gjykatës në qershor të këtij viti.³⁰⁹ Në gusht 2019, aktakuzën ndaj Berishës dhe të tjerëve e ka konfirmuar edhe Gjykata e Apelit.³¹⁰

³⁰⁸ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-cekut-rustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁰⁹ “Konfirmohet aktakuza ndaj Rustem Berishës, Agim Cekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³¹⁰ Rasti “Veteranët”, Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Agim Çekut, Rustem Berishës e të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-agim-cekut-rustem-berishes-e-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi, ndaj Çekut dhe të tjerëve është akoma duke vazhduar, ndërsa deri më tani janë caktuar tetë (8) seanca gjyqësore, ndërsa njëra (1) nga to kishte dështuar të mbahej³¹¹. Gjatë këtij gjykimi deri më tani janë dëgjuar në cilësi të dëshmitarëve edhe politikanë tjerë e ish-komandant të UÇK-së, si ish-kryeministri Ramush Haradinaj, ish-kryetari i Komunës së Skenderajt Sami Lushtaku, kandidati i PDK-së për deputet Hisen Berisha, ndërsa ishin refuzuar që në cilësi të dëshmitarëve të dëgjohen edhe presidenti Hashim Thaçi dhe ish-kryeministri Isa Mustafa.

³¹¹ *Shënim:* Kryetarja e trupit gjykues Nushe Kuka-Mekaj, ka marrë vendim me të cilin ka ndaluar që të publikohen në media dëshmitë e dëshmitarëve e po ashtu që emrat e tyre të jepen vetëm me initiale derisa të përfundohet procedura e provave, duke lënë kështu publikun të painformuar për dëshmitë e dëshmitarëve të këtij procesi gjyqësorë. Kuka-Mekaj, këtë vendim e ka arsyetuar mbi bazën se me publikimin e dëshmimeve të dëshmitarëve dëmtohet procesi gjyqësorë, pasi sipas saj humb rëndësia që të largohen dëshmitarët nga salla e gjyqimit, derisa të merret në pyetje një dëshmitar tjetër. Mirëpo një formë e tillë e vendimit është aplikuar për herë të parë, pasi e njëjta situatë ndodh edhe në raste të tjera, por më parë nuk ka pasur vendime të ngjashme.



GANI DRESHAJ

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Deputet i Kuvendit të Kosovës

Veprat penale: “Kanosje”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 31 maj 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Gani Dreshaj, me të cilën pretendohet se më 18 maj 2018, në sallën e Kuvendit të Republikës së Kosovës, me dashje e kishte kanosur deputetin Gashi, me fjalët “Kom me ta prish fytyrën”. Me këtë fjalë, prokuroria pretendon se Gashit i është shkaktuar ndjenja e frikës dhe ankthit.³¹²

Prokuroria, bashkë me aktakuzë, ka bërë propozimin që ndaj tyre të shqiptohet urdhër ndëshkimor, në dënim me gjobë.

Procesi - Lidhur me këtë rast, zëdhënësja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi, në një përgjigje për “Betimi për Drejtësi”, më 16 korrik 2019, kishte thënë se kjo lëndë është e re prandaj gjykata nuk ka marr ende ndonjë veprim lidhur me këtë rast.³¹³ Vet Dreshaj, në deklaratën e dhënë në polici me 6 qershor 2018, kishte pranuar se e kishte kanosur deputetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Arben Gashin. Gjatë dhënies së deklaratës në polici, Dreshaj i kishte kërkuar falje të dëmtuarit Gashi dhe kishte premtuar se nuk do të ndodhë diçka e tillë në të ardhmen.³¹⁴

³¹² Ekskluzive, aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi”. 16 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halitit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³¹³ Ekskluzive, aktakuzë ndaj Xhavit Halitit dhe Gani Dreshajt për sulmin dhe kanosjen ndaj Arben Gashit”. Betimi për Drejtësi”. 16 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-aktakuze-ndaj-xhavit-halitit-dhe-gani-dreshajt-per-sulmin-dhe-kanosjen-ndaj-arben-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³¹⁴ “Deklarimi i Dreshajt para policisë: I kam thënë Arben Gashit ko me ta prishë fytyrën”. Betimi për Drejtësi. 16 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deklarimi-i-dreshajt-para-policise-i-kam-thene-arben-gashit-kam-me-ta-prishe-ftyren/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces2. Në
proces**SHKUMBIN DEMALIAJ****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Deputet i Kuvendit të Kosovës**Veprat penale:** 1. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” 2. Kanosje”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** 1. Në proces, 2. Në proces

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Speciale, Shkumbin Demaliaj akuzohet se prej vitit 2011 deri në vitin 2017, duke vepruar si anëtar i Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin e Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit dhe të Internuarit të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka shfrytëzuar detyrën dhe autoritetin zyrtar, duke tejkaluar kompetencat me dashje dhe duke mos i përmbushur detyrat zyrtare, me qëllim që të përfitojnë personat e tjerë në mënyrë të kundërligjshme, në vazhdimësi, në dëm të Buxhetit të Republikës së Kosovës.

Bashkë me Demaliajn, në këtë rast janë të akuzuar edhe Agim Ceku, Sadik Halitjaha, Nuredin Lushtaku, Qelë Gashi, Shukri Buja, Ahmet Daku, Rustem Berisha, Faik Fazliu, Smajl Elezaj dhe Xhavit Jashari.

Procesi 1– Demaliaj dhe të akuzuarit tjerë në këtë rast, ishin deklaruar të pafajshëm në shqyrtimin fillestar të mbajtur për këtë rast më 14 mars 2019. Të njëjtit, kishin kërkuar nga gjykatësja e rastit, Nushe Kuka-Mekaj, hudhjen e aktakuzës.³¹⁵ Megjithatë, aktakuza ndaj Demaliajt dhe të tjerëve, ishte konfirmuar nga ana e gjykatës në qershor të këtij viti.³¹⁶

Me aktakuzën e PSRK-së, po ashtu ishte kërkuar që Gjykata Themelore në Prishtinë, që të urdhërohet Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS), që të pezullonte pagesën e pensioneve për 19.500 veteranë, deri në përfundimin e procesit gjyqësor, por gjykata më 1 prill

³¹⁵ “Rasti “Veteranët”, Agim Ceku, Rustem Berisha, Shkumbin Demaliaj dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm”. Betimi për Drejtësi. 14 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-agim-ceku-rustem-berisha-shkumbin-demaliaj-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³¹⁶ “Konfirmohet aktakuza ndaj Rustem Berishës, Agim Cekut e të tjerëve në rastin “Veteranët”. Betimi për Drejtësi. 24 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-rustem-berishes-agim-cekut-e-te-tjereve-ne-rastin-veteranet/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

2019, e kishte refuzuar këtë kërkesë me arsyetimin se propozimi për masën e përkohshme nuk është ndaj të akuzuarve, por ndaj MPMS-së, si palë e tretë. Në gusht 2019, aktakuzën ndaj Demaliajt dhe të tjerëve e ka konfirmuar edhe Gjykata e Apelit.³¹⁷

Aktakuza 2 - Demalijaj, pas aktakuzës që prokurori Elez Blakaj kishte ngritur ndaj tij dhe 11 personave të tjerë në rastin “Veteranët”, në një emision televiziv ë emision në RTK, kishte thënë se “Unë do ta ndjek privatisht me familjen time në qoftë se shteti i Kosovës nuk i bënë asgjë”, ndërsa më 25 shtator 2018, në një intervistë në televizionin T7, kishte thënë se “jo unë nuk i bie pishman asnjëherë fjalët që i kam thënë, nëse shteti nuk merret me Blakaj, atëherë unë personalisht do të merrem me të”.

Këto deklarata të Demalijajt, ishin bërë pasi prokurori Blakaj kishte dorëzuar aktakuzën e rastit “Veteranët” dhe kishte dhënë dorëheqje, për shkak se siç kishte thënë ai, për kërcënimet e presionet, gjatë kohës sa po hetonte këtë rast, si nga brenda sistemit prokurorial, ashtu edhe jashtë tij.

Procesi 2 - Procesi lidhur me këtë rast, akoma nuk ka filluar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

³¹⁷ Rasti “Veteranët”, Apeli konfirmon aktakuzën ndaj Agim Çekut, Rustem Berishës e të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-veteranet-apeli-konfirmon-aktakuzen-ndaj-agim-cekut-rustem-berishes-e-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 1 vit
e 6 muaj
burg me
kusht

2. Në
proces

3. Në
proces



DONIKA KADAJ-BUJUPI

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Deputete e AAK-së

Veprat penale: 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 2. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve” 3. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Aktgjykim dënues, 1 vit e gjashtë muaj me kusht (Aktgjykim i formës së prerë) 2 dhe 3. Në proces

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 16 dhjetor 2015 ka akuzuar Kada-Bujupin për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Ajo akuzohet se pa autorizim, kishte hedhur gaz lotësjellës në sallën e Kuvendit të Kosovës, më 8 tetor 2015, duke pamundësuar vazhdimin e kësaj seance. Po ashtu, ajo akuzohet se më 17 nëntor 2015, ka tentuar që t’i pengoj pjesëtarët e policë që ta zbatojnë urdhrin e gjykatës për ta arrestuar Albin Kurtin në hapësirat e jashtme të Kuvendit.

Procesi 1 - Pas shumë zvarritjeve të këtij procesi gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 3 janar 2018 kishte shpallur fajtor Kada-Bujupin për këto dy vepra penale. Donika Kada-Bujupi për përdorim të armës apo mjetit të rrezikshëm është dënuar me një vit e tre muaj, kurse për pengim të personit zyrtar është dënuar me gjashtë muaj burgim. Ndaj saj, është shqiptuar dënimi unik prej një vit e gjashtë muaj burgim me kusht.³¹⁸ Ky dënim me kusht i shqiptuar në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 18 shtator 2018.³¹⁹

³¹⁸ ³¹⁸ “Dënohen me burgim me kusht Albin Kurti dhe tre deputetët e tjerë të Vetëvendosjes për gazin lotësjellës”, Betimi për Drejtësi. 3 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-me-kusht-albin-kurti-dhe-tre-deputetet-e-tjere-te-vetevendosjes-per-gazin-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³¹⁹ “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotësjellës”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë të 8 prillit 2016, prokuroria pretendon se Kadaj-Bujupi më 19 shkurt 2016, ka poseduar armë, ashtu që në hollin e Kuvendit, gjatë kontrollit që i është bërë asaj nga punëtorët e sigurimit, i është gjetur dhe sekuestruar një bombolë e gazit, të cilën e mbante pa autorizim.

Procesi 2 - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohej.³²⁰

Aktakuza 3 - Sipas aktakuzës së ngritur më 7 mars 2017, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Donika Kadaj-Bujupi dhe Aida Dërguti akuzohen se më 1 shtator 2016, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në hyrje tek holli i Kuvendit, gjatë kontrollit nga pjesëtarët e policisë, të akuzuarës Kadaj-Bujupi i është gjetur dhe konfiskuar një sprej me mbishkrimin “Nato”, ndërsa të akuzuarës Dërguti i është gjetur dhe konfiskuar një gaz lotsjellës, të cilat mjete i kishin vendosur në trup, e të cilat i kanë mbajtur në posedim, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Procesi 3 - Kjo lëndë është akoma në proces.³²¹

³²⁰ Përgjigja e zëdhënëses së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

³²¹ *Shënim:* Më 4 qershor 2020, pas pranimit të fajësisë nga të akuzuarat, gjykata ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarave Kadaj-Bujupi dhe Dërguti, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 200 euro. Betimi për Drejtësi 4 qershor 2020. (Shih linkun; https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IëAR0h82oËNJËT0_x4SoqVyiËqrdOXiBfkrËhB-uO2GqëëK-cfAs4yI9ugB9s). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020)

Në
proces



TEUTA HAXHIU

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Deputete

Vepra penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Haxhiun, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”. Kjo aktakuzë ishte ngritur nën dyshimin se Haxhiu pa autorizim ka poseduar armën, gazin, të cilin ia kanë dhënë deputetit Pal Lekaj, i cili të njëjtën e ka përdorur në seancën e 14 dhjetorit 2015 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Procesi - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohet.³²²

³²² Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Në
proces**TIME KADRIJAJ****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Deputete**Vepra penale:** “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”**Gjykata:** Gjykata Themelore Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Kadrijajn, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”. Kjo aktakuzë ishte ngritur nën dyshimin se Kadrijaj pa autorizim ka poseduar armën, gazin, të cilin i’a kanë dhënë deputetit Pal Lekaj, i cili të njëjtën e ka përdorur në seancën e 14 dhjetorit 2015 në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Procesi - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohet.³²³

³²³ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

Lirim



ELMAZE NURA

Partia: AAK**Pozita shtetërore:** Drejtoreshë e Teatrit Kombëtar të Kosovës**Veprat penale:** “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, e pandehura Elmaze Nura akuzohej se duke shfrytëzuar pozitën zyrtare-drejtoreshë e Teatrit Kombëtar, kishte shkelur seriozisht të drejtat e personave tjerë, ku duke mos i respektuar dispozitat e Ligjit të Prokurimit kishte lidhur kontratë për transportin e shfaqjes “Lisistrata”, nga Prishtina në Lubjanë dhe anasjelltas. Prokuroria pretendonte se lidhja e kontratës nga e akuzuara, në emër të Teatrit Kombëtar, me NSH “Alpina Reisen”, në shumën prej 5.000 euro, paraqiste vepër penale.

Procesi - Gjykata Themelore e Prishtinës, më 27 prill 2017 ka shpallur aktgjykim ndaj të akuzuarës Nura³²⁴, i cili aktgjykim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 22 nëntor 2017.

³²⁴ “Shpallet e pafajshme ish drejtoresha e Teatrit Kombëtar të Kosovës, Elmaze Nura”. Betimi për Drejtësi. 27 prill 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-e-pafajshme-ish-drejtoresha-e-teatrit-kombetar-te-kosoves-elmaze-nura/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Refuzim

**BALI MUHARREMAJ****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Kryetar i Komunës së Suharekës**Vepra penale:** “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”**Gjykata:** Gjykata Themelore Prishtinë**Faza procedurale:** Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 28 qershor 2017 ka akuzuar Muharremajn për veprën penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm”. Prokuroria pretendon se ai më 26 shkurt 2016, ka përdorur armën apo mjetin e rrezikshëm duke hedhur gaz lotësjellës me qëllim të ndërprerjes së mbledhjes së kuvendit.

Procesi- Ky proces gjyqësor ishte përcjellë me praktika jo të zakonshme gjyqësore pasi prokurorja e rastit Ferdane Sylejmani në seancën e shqyrtimit kryesor të mbajtur më 2 maj të vitit 2019 kishte hequr dorë nga ndjekja penale ndaj Muharremajt. Ajo kishte marrë një vendim të tillë pasi gjykata kishte shpallur si të papranueshme provat e prezantuara nga ajo në këtë seancë, me arsyetimin se ato i referoheshin një gjykimi tjetër, duke mos pasur relevancë me këtë rast.

Paraprakisht, para heqjes dorë nga ndjekja penale, i akuzuari Muharremaj, po në këtë seancë edhe kishte pranuar fajësinë për këtë vepër penale.³²⁵ Në këto rrethana, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte nxjerrë aktgjykim refuzues, pas vendimit të prokurores për heqje dorë nga ndjekja penale.³²⁶

³²⁵ “Ish-deputeti pranon fajësinë për gazin lotësjellës, gjykata zhvlerëson provat, më pas prokurorja tërhiqet nga aktakuza”. Betimi për Drejtësi. 2 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-deputeti-pranon-fajesine-per-gazin-lotsjelles-gjykata-zhvlereson-provat-me-pas-prokurorja-terhiqet-nga-aktakuza/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³²⁶ “Aktgjykim refuzues ndaj deputetit dhe ish-kolegut të tij që akuzoheshin për hedhje të gazit lotësjellës”. Betimi për Drejtësi. 2 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-deputetit-dhe-ish-kolegut-te-tij-qe-akuzoheshin-per-hedhje-te-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ZENUN ELEZAJ

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Klinës

Veprat penale: 1. “Shmangia nga tatimi”; 2. “konflikti i interesi”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Pejë-Dega në Klinë; 2. Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: 1. Hudhje e aktakuzës (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Në proces

1.
Hudhje

2. Në
proces

Aktakuza 1 – Prokuroria në Pejë, më 9 gusht 2010 kishte ngritur aktakuzë për Elezajn, me pretendimet se i njëjti, nga 1 janari 2002 e deri më 28 janar 2005, si drejtor i Kompanisë “Boksitet e Kosovës”, me qëllim t’i shmanget tërësisht pagimit të tatimit të përcaktuar me ligj, ka dhënë të dhëna të pavërteta lidhur me gjendjen ekonomike ashtu që ka paraqitur të dhëna të pavërteta në ATK lidhur me të hyrat e kësaj kompanie e duke e dëmtuar kështu buxhetin e Kosovës në vlerë prej 170.003, 91 euro.

Procesi 1– Gjykata Themelore në Pejë, dega në Klinë, më 15 qershor 2016, kishte marrë aktvendim me të cilin e kishte hudhur poshtë aktakuzën e prokurorisë ndaj Elezajt, me arsyetimin se për veprën penale për të cilën akuzohej Elezaj, ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së ngritur më 9 tetor të vitit 2019, nga Prokuroria Themelore në Pejë, Zenun Elezaj akuzohet se më 20 shkurt 2018, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Klinës, duke e ditur se vajza e tij ka për të aplikuar në pozitën “Mjeke e praksës së përgjithshme”, në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF), në Klinë, ka marrë pjesë personalisht në këtë çështje zyrtare, duke marrë vendim për formimin e komisionit për zhvillimin e procedurave për krijimin e marrëdhënies së punës. Ky komision e kishte përzgjedhur si punëtoreshë vajzën e kryetarit të Klinës, duke e punësuar atë në QKMF-në “Nëna Terezë”, në Klinë.

Procesi 2 - Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 29 janar 2020, i akuzuari Elezaj ka hequr dorë nga kundërshtimi i aktakuzës, ndërsa në seancën e mbajtur më 24 dhjetor 2019, ai kishte mohuar fajësinë për kryerjen e veprës për të cilën ngarkohet nga prokuroria.³²⁷

³²⁷ “Kryetari i Klinës heq dorë nga kundërshtimi i aktakuzës që e ngarkon atë se ndikoi në punësimin e vajzës në QKMF”. Betimi për Drejtësi. 29 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-klines-heq-dore-nga-kundershtimi-i-aktakuzes-qe-e-ngarkon-ate-se-ndikoi-ne-punesimin-e-vajzes-ne-qkmf/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



XHAFER GASHI

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Obiliqit

Vepra penale: “Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 4 prill 2019 ka akuzuar Gashin se ka kryer veprën penale “Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore”. Prokuroria pretendon se Gashi në pozitën e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, më 7 janar 2014, me dashje nuk e ka ekzekutuar Aktgjykimin e ish Gjykatës Komunale në Prishtinë të 16 janarit 2011, i cili ishte i plotfuqishëm edhe sipas vendimit të nxjerrë në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit. Prokurori pretendonte se ai kishte pasur njohuri se ekzekutimi i vendimeve të plotfuqishme gjyqësore, përbën vepër penale.

Procesi - Në seancën e 12 majit 2017, ku ishte planifikuar të mbahej shqyrtimi i dytë ndaj Gashit, prokurori Fejza dha njoftimin për tërheqjen nga ndjekja penale. Atë kohë, prokurori Fejza kishte arsyetuar heqjen dorë të tij nga kjo aktakuzë me pretekstin se mbrojtësi i kryetarit Gashi, avokati Nazim Mehmeti, pas ngritjes së aktit akuzues, i kishte ofruar prokurorisë prova materiale të cilat kishin vërtetuar se nuk kishte elemente të kësaj vepre penale.³²⁸

³²⁸ “Prokurori tërhiqet nga ndjekja penale kundër kryetarit të Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi”. Betimi për Drejtësi. 12 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-terhiqet-nga-ndjekja-penale-kunder-kryetarit-te-komunes-se-obiliqit-xhafer-gashi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Hudhje

**MUHARREM SHABANI****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Ish-kryetar Komunës i Vushtrisë**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore Mitrovicë**Faza procedurale:** Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Mitrovicë e ngarkon Shabanajn me veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Prokuroria pretendon se Shabanaj ka keqpërdorur pozitën e tij si Kryetar Komune i Vushtrisë, se i njëjti duke ditur parregullsitë dhe shkeljet e ligjit mbi prokurimin, nuk ka ndërmarrë veprime të parapara me ligj për të penguar lidhjen dhe zbatimin e kontratës për shfrytëzimin e gurit gëlqerorë tek vendi i quajtur “Guri i madh”, e cila është vlerësuar si e dëmshme për komunën e Vushtrisë.

Procesi – Gjykata Themelore në Mitrovicë, më 19 korrik 2017, kishte marr aktvendim për hedhjen e aktakuzës ndaj Muharrem Shabani për shkak se kishte vlerësuar se në këtë rast ka arritur parashkrimi relativ i veprës penale për të cilën akuzohej Shabani.

**FATMIR SHURDHAI****Lirim****Partia:** AAK**Pozitat shtetërore:** Zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale /Deputet**Vepra penale:** “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës në bashkëkryerje”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza– Në rastin e njohur “Pronto”, po akuzohet edhe ish-zëvendësministri i MPMS-së, i cili fillimisht kishte qenë PDK, ndërsa në qershor 2019 iu është bashkuar AAK-së. Aktakuza ndaj tij dhe dhjetë personave të tjerë është ngritur me 6 prill 2018, me pretendimin se ata duke keqpërdorur pozitat e tyre zyrtare, kishin bashkëpunuar me të tjerët për dhënien e privilegjeve dhe përparësive kundërligjshme personave të cilët kishin konkurruar në funksione të rëndësishme, duke mohuar dhe kufizuar liritë dhe të drejtat e kandidatëve të tjerë, të garantuara me ligj.

Procesi - Shqyrtimi fillestar në këtë rast ishte caktuar të mbahej më 1 tetor 2018, por kjo seancë ishte shtyrë, Me 15 nëntor 2018 ishte mbajtur seanca fillestare ku edhe Pajaziti se bashku me dhjetë të akuzuarit tjerë nuk e kishin pranuar fajësinë.³²⁹ Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë Beqaj dhe të tjerët më 3 janar 2020 janë liruar nga akuzat, ndërsa lënda po trajtohen në shkallën e dytë³³⁰.

Ndërsa, për këtë rast akoma nuk ka vendosur Gjykata e Apelit.³³¹

³²⁹ Shënim: Në këtë seancë fillestare, edhe pse është praktikë që gjithmonë të lexohet aktakuza, një gjë e tillë nuk ndodhi pasi këtë e kishin kërkuar të akuzuarit, të cilin propozim e kishte kundërshtuar prokurorja Drita Hajdari, por e kishte aprovuar gjykatësi Shashivar Hoti. Ndërsa në seancën e 21 dhjetorit 2018, ku ishte paraparë të mbahej shqyrtimi i dytë në këtë rast 2018, prokurorja speciale Drita Hajdari kishte bërë kërkesë tjetër në Zyrën e Prokurorit Disiplinor, me arsyetimin se Hoti ka shkelur etikën e gjykatësit, duke bërë që shqyrtimi i dytë në këtë rast të mos mbahet.

³³⁰ “Aktgjykim lirues ndaj të akuzuarve në rastin “Pronto”. Betimi për Drejtësi. 3 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-lirues-ndaj-te-akuzuarve-ne-rastin-pronto/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³³¹ Shënim: Gjykata e Apelit, me 30 qershor 2020, kishte ndryshuar pjesërisht aktgjykimin e shkallës së parë për rastin “Pronto” dhe i kishte shpallur fajtor Adem Grabovcin, Ilhami Gashin dhe Sedat Gashin, për veprën penale “Shkelja e statusit të barabartë të shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”, kurse për të akuzuarit tjerë ishte vërtetuar aktgjykimimi lirues. Këtë vendim më 29 shtator 2020, e kishte vërtetuar edhe Gjykata Supreme e

**NAIM BAZAJ****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Kryesues i Kuvendit Komunal në Drenas**Veprat penale:** “Lëndim i lehtë trupor”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Drenas**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza – Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 27 qershor 2017, ka ngritur aktakuzë ndaj Naim Bazaj dhe dy personave tjerë, sepse të njëjtit më 17 shkurt 2017, rreth orës 17:05, në lokalitetin të “Naimi”, e kishin sulmuar të dëmtuari Ragip Gjoka. Deri te konflikti mes tyre, sipas prokurorisë, ka ardhur si pasojë e një pakënaqësie që kishte pasur i dëmtuari lidhur me emërtimin e një rruge, për cka edhe i kishte dërguar një sms të akuzuarit Bazaj, e ku pastaj Bazaj me dy persona tjerë kishin shkuar te lokali në fjalë e ku pas një mosmarrëveshjeje, në bashkëkryerje nga ana e të pandehurve, i akuzuari Bazaj e ka kapur për rroba në gjoks të dëmtuarin duke e rrëzuar për tokë dhe më pas ata dy të pandehurit e kanë sulmuar fizikisht të dëmtuarin duke e goditur me grushte.

Sipas aktakuzës, në këtë rast i dëmtuari Ragip Gjoka ka pësuar lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Procesi – Lidhur me këtë rast, nga gjashtë seanca të caktuara, ka arritur të mbahet vetëm seanca e 9 marsit 2020, ndërsa rasti është akoma në proces.

Kosovës. “Rasti “Pronto”: Gjykata Supreme vërteton vendimin dënues të Apelit ndaj Adem Grabovcit dhe dy të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-pronto-gjykata-supreme-verteton-vendimin-denues-te-apelit-ndaj-adem-grabovcit-dhe-dy-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 6
muaj
burgim me
kusht

2.
Në
proces



ILIR BALDEDAJ

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Drejtor i Administratës në Komunën e Prizrenit; Këshilltar Komunal në Komunën e Prizrenit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”;

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: 1. Gjashtë muaj burgim me kusht (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Në proces

Aktakuza 1 - Ilir Baldedaj akuzohej nga Prokuroria Themelore në Prizren, se gjatë periudhës gusht 2015 – dhjetor 2016, duke vepruar në cilësinë e drejtorit të administratës komunale të Prizrenit, ka lidhur kontrata në mënyrë të paligjshme me tri televizione lokale për të reklamuar shërbimet komunale. Sipas aktakuzës, Baldedaj kontratat i ka lidhur me televizionet lokale pa procedura tenderuese, megjithëse kontratat parashohin pagesa mujore për një vit e që kalojnë shumë prej 1000 mijë euro, deri në të cilën shumë mund të lidhen kontrata pa kaluar në procedura tenderuese.

Procesi 1- Gjykata Themelore në Prizren, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më 25 maj 2018 pasi e kishte shpallur fajtorë Baldedajn për “keqpërdorim të pozitës zyrtare”, e kishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse brenda afatit prej një viti nuk kryen vepër tjetër penale.³³²

Aktakuza 2 - Prokuroria Themelore në Prizren, më 22 gusht 2019, ka ngritur aktakuzë kundër ish-drejtorit të Administratës në Komunën e Prizrenit, Ilir Baldedaj, për shkak të dyshimit të bazuar se ka kryer veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas prokurorisë, i akuzuari e ka kryer veprën penale gjatë periudhës 13-22 maj 2018, me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie për vete apo personin tjetër, duke mos i përmbushur detyrat zyrtare

³³² “Dënohet me burgim me kusht ish-drejtori i Administratës në Prizren, Ilir Baldedaj”. Betimi për Drejtësi. 25 maj 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-burgim-me-kusht-ish-drejtori-i-administrates-ne-prizren-ilir-baldedaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

të tij, të përcaktuara me ligj. Me këto veprime, sipas aktakuzës, Baldedaj i ka shkaktuar buxhetit të shtetit dëm në vlerë prej rreth 19,350.00 euro.³³³

Procesi 2 – Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast është duka vazhduar, por seanca e paraparë të mbahej më 10 prill 2020, kishte dështuar për shkak të ndërprerjes së shqyrtimeve gjyqësore për shkak të pandemisë Covid-19³³⁴.

³³³ “Ngritët edhe një aktakuzë për korrupsion ndaj ish-drejtorit të Administratës në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 22 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ngritet-edhe-nje-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-te-administrates-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³³⁴ “Shtyhet gjykimi për keqpërdorim detyre ndaj ish-drejtorit të Administratës në Prizren”. Betimi për Drejtësi. 6 mars 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-gjykimi-per-keqperdorim-detyre-ndaj-ish-drejtorit-te-administrates-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



BUJAR NERJOVAJ

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Drejtor i Inspektoratit në Komunën e Prizrenit; Zëvendësministër i Administratës Publike

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Gjashtë muaj burgim me kusht (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren, e ngritur më 30 tetor 2018, i pandehuri Bujar Nerjovaj, si drejtor i Inspektoratit në Komunën e Prizrenit, akuzohet se si person zyrtar me mosveprim duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, nuk e ka përmbushur detyrën zyrtare, me qëllim të përfitimit të dobisë për personin tjetër apo që t'i shkaktojë dëm personit tjetër.

Në aktakuzë thuhet se Nerjovaj, në cilësinë e ish-drejtorit të Drejtorisë Komunale të Inspektorateve në Prizren, gjatë periudhës 2011-2013, nuk i ka siguruar kushtet për t'i ekzekutuar konkluzionet e lëshuara nga inspektorët e ndërtimtarisë, për rrënimin e detyrueshëm të mbindërtimeve dhe ndërtimeve të katër objekteve hoteliere në afërsi të sheshit “Shatërvan” në Prizren. Nerjovaj akuzohet se ka vepruar për t’ua pamundësuar inspektorëve ekzekutimin e vendimeve për rrënim.

Procesi – Nerjovaj, që më pas në qeverinë Haradinaj, kishte marrë pozitën e zëvendësministrit të Administratës Publike, kishte shprehur gatishmërinë që të hyjë në marrëveshje për pranim të fajësisë, ashtu që në seancën e 6 shkurtit 2019, i kishte kërkuar kohë shtesë gjykatës për negociim të marrëveshjes me prokurorinë.³³⁵ Mirëpo, i akuzuari ishte tërhequr pastaj nga kjo kërkesë e tij për të cilën kishte thënë se ka qenë veprim i pamenduar mirë nga ana e tij.³³⁶ Më 3 qershor 2019 Nerjovaj është dënua me gjashtë muaj burgim me kusht, pasi është shpallur

³³⁵ “Zëvendësministri që akuzohet për korrupsion kërkon të hyjë në marrëveshje për pranim fajësie”. Betimi për Drejtësi. 6 shkurt 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zevendesministri-qe-akuzohet-per-korrupsion-kerkon-te-hyje-ne-marreveshje-per-pranim-fajesie/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³³⁶ “Zëvendësministri Nerjovaj mohon akuzat për korrupsion, prokuroria thotë se ka prova ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 20 mars 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/zevendesministri-nerjovaj-mohon-akuzat-per-korrupsion-prokuroria-thote-se-ka-prova-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

fajtor për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Mirëpo, dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohej nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda periudhës së verifikimit prej një viti³³⁷.

Kundër këtij aktgjykimi ishte bërë ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila gjykatë për shkak të shkeljeve të ligjit, e kishte kthyer këtë rast në rigjykim, proces i cili është akoma në procedim e sipër³³⁸.

Pas vendimit, me të cilin Nerjovaj ishte dënuar me burgim me kusht, ish-kryeministri Ramush Haradinaj, më 5 qershor 2019, e kishte liruar atë nga detyra, pasi siç kishte thënë ai këtë e kishte bërë me kërkesë të Nerjovajt³³⁹.

³³⁷ “Dënohet me burgim me kusht për korrupsion, ish-drejtori në Prizren, aktualisht zëvendësministër”. Betimi për Drejtësi. 3 qershor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-burgim-me-kusht-per-korrupsion-ish-drejtori-ne-prizren-aktualisht-zevendesminister/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³³⁸ “Dështon seanca e rigjykimit për korrupsion ndaj ish-drejtorit të Inspektoratit në Prizren” Betimi për Drejtësi. 20 janar 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/desh-ton-seanca-e-rigjykimit-per-korrupsion-ndaj-ish-drejtorit-te-inspektoratit-ne-prizren/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³³⁹ “Lirohet nga puna zëvendësministri, keqpërdori detyrën zyrtare” Reporteri.net. 5 qershor 2019. (Shih linkun <https://reporteri.net/lajme/lirohet-nga-puna-zevendesministri-bujar-nerjovajkeqperdori-detyren-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

5000 euro
gjobë**MUSA CENA****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Zëvendësministër i Zhvillimit Rajonal**Veprat penale:** “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Dënim – 5000 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza: Sipas aktakuzës së ngritur më 14 nëntor 2018, i pandehuri Cena, shefi i Drejtorisë së Bujqësisë në Rahovec, Nusret Shala, dhe Hazër Shehu, akuzoheshin për veprat penale “keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar” dhe “ndihmë në veprën penale, keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar”. Sipas aktakuzës më 12 tetor 2018, në Prishtinë i pandehuri Musa Cena, në pozitën e zëvendësministrit në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal, së bashku me të pandehurin tjetër, Nusret Shala, shef i Drejtorisë së Bujqësisë në Rahovec, në mënyrë të kundërligjshme, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar dhe me qëllim që vetës t’i sjellin dobi pasurore të kundërligjshme, kishin kërkuar nga i dëmtuari Afrim Berisha, fillimisht shumë prej 30.000 euro, shumë të cilën më pas e zbresin në 25.000 euro.

Sipas aktakuzës, Cena dhe Shala kishin marrë përmes Hazër Shehu, shumë prej 15.000 euro nga i dëmtuari Afrim Berisha. Siç pretendonte prokuroria, të njëjtit këto veprim i kishin ndërmarrë me qëllim që nga kompania “Bylmeti” të marrin shumë e cekur dhe të njëjtën ta shpallin fituese të grantit në vlerë prej 200,000 euro nga Ministria e Bujqësisë. Sipas prokurorisë, pas fitimit të grantit, do të jepej edhe shuma prej 10.000 euro.

Procesi: Gjykata Themelore e Prishtinës, më 22 nëntor 2018 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të pandehurit, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 5000 euro,³⁴⁰ i cili dënim është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

³⁴⁰ Ish-zëvendësministri i Zhvillimit Rajonal, Musa Cena dënohet me pesë mijë euro gjobë për korrupsion (Video), Betimi për Drejtësi. 22 nëntor 2018. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zevendesministri-i-zhvillimit-rajonal-musa-cena-denohet-me-pese-mije-euro-gjobe-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Lirim

2.
Refuzim



QAZIM MALOKU

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë për Arsim në Deçan

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Falsifikim i dokumentit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë

Faza procedurale: 1. Aktgjykim lirues (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Aktgjykim refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Pejë më 14 prill 2016 e ka akuzuar Malokun se se ka kryer veprën penale keqpërdorim i pozitës po autoritetit zyrtar. Ekziston dyshimi i bazuar se Maloku në cilësinë e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim në Deçan më 3 nëntor 2011, ka lëshuar rekomandim në kundërshtim me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, duke e caktuar në punën Koordinator Komunal për Qendrën Zhvillimore Profesionale në SHFMU “Lidhja e Prizrenit”, një person e cili nuk kishte përgatitje adekuate shkollore.

Procesi 1 - Maloku ishte shpallur i pafajshëm për këtë vepër penale së pari nga Gjykata Themelore në Pejë, më 7 qershor të këtij viti, me arsyetimin se nuk ishte provuar se ai kishte kryer veprën penale me të cilën ngarkohej.³⁴¹ Më pas, pafajësia e tij ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më vendimin e nxjerrë më 29 nëntor 2018.³⁴²

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë, Maloku akuzohet se ka kryer veprën penale “falsifikim të dokumenteve zyrtare”, ashtu që si Drejtor i Shkollës së Mesme në Gjimnazin “Sami Frashëri” në fshatin Irzniq, ka regjistruar në librin amë të vitit 1990/98, nxënësit të cilët kinse e kanë kryer shkollën fillore “Avni Rustemi” të fshatit Rezarë duke i regjistruar të njëjtit nxënës të atij gjimnazi, duke kryer kështu veprën penale “falsifikim të dokumenteve zyrtare.

Procesi 2 - Aktakuza që e ngarkonte Malokun për “falsifikim të dokumenteve zyrtare” ishte refuzuar nga Gjykata Themelore në Pejë në vitin me arsyetimin se kjo lëndë ka arritur parashkrimin absolut. Sipas kryetarit të trupit gjykues, vepra penale që pretendohet të jetë kryer

³⁴¹ “Lirohet nga akuza për korrupsion drejtori i Arsimit në Komunën e Deçanit”, Betimi për Drejtësi. 7 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-drejtori-i-arsimit-ne-komunen-e-decanit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁴² “Apeli vërteton pafajësinë e drejtorit të Arsimit në Deçan që akuzohej për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 10 Dhjetor 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-drejtorit-te-arsimit-ne-decan-qe-akuzohej-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

nga Maloku, kishte ndodhur në fund të vitit 2007, ndërsa deri tani në vitin 2016 kur po zhvillohej ky gjykim kishte kaluar më shumë se tetë vite.³⁴³

³⁴³ “Vjetërsohet lënda e korrupsionit për një të akuzuar, veçohet procedura për të dytin”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vjetersohet-lenda-e-korrupsionit-per-nje-te-akuzuar-vecohet-procedura-per-te-dytin/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



LEONARD SHABANAJ

1.
Lirim

2.
Lirim

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Shef i personelit në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Pejë

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, 2. “Shpërdorim të detyrës zyrtare ose autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore Pejë

Faza procedurale: 1. Aktgjykim lirues (Aktgjykim i fomës së prerë), 2. Aktgjykim lirues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Pejë e ngarkon Shabanajn se ka kryer veprën penale “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Sipas prokurorisë, ekzistonte dyshimi i bazuar se ai më 17 dhjetor 2012, në cilësinë e Shefit të personelit në Drejtorinë Komunale të Arsimit në Pejë, nuk i ka përmbush detyrat zyrtare me qëllim që të përfitojë personi tjetër, duke lëshuar rekomandim për pranimin si mësimdhënëse të një personi pa hapur konkursin publik.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Pejë, në nëntor të vitit 2017, e kishte liruar Shabanajn nga akuza për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar me arsyetimin se provat e paraqitura gjatë gjyimit nuk e dëshmonin se ai ka kryer këtë vepër penale.³⁴⁴ Ky vendim për shpalljen e pafajshëm të Shabanajt ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit, me vendimin e datës 15 shkurtit 2018.

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së dytë, Prokuroria Themelore në Pejë e akuzonte Shabanajn se ka kryer veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Prokuroria pretendonte se ka shpërdoruar detyrën zyrtare ose autorizimin, pasi si zyrtarë komunal në Drejtorinë e Arsimit, nuk ka pasur të drejtë ligjore të konkurrojë me kompaninë e tij në tenderin e vitit 2012 për sigurimin fizik të objekteve komunale.

Procesi 2 - Për këtë vepër penale, Shabanaj ishte liruar nga akuza në nëntor të vitit 2015 nga Gjykata Themelore në Pejë, me arsye se nuk ishte provuar se ai e kishte kryer këtë vepër penale që i ngarkohej.³⁴⁵ Pafajësia e Shabanaj për këtë vepër penale ishte vërtetuar edhe në shkallë të dytë nga Gjykata e Apelit, me vendimin e nxjerrë në Qershor të vitit 2016.³⁴⁶

³⁴⁴ “Lirohet nga akuza për korrupsion ish-zyrtari i Komunës së Pejës”. Betimi për Drejtësi. 13 Nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohet-nga-akuza-per-korrupsion-ish-zyrtari-i-komunes-se-pejes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁴⁵ “Gjykata i liron nga akuza gjashtë zyrtarë të komunës së Pejës”. Koha.net. 26 nëntor 2015. (Shih linkun <https://archive.koha.net/?id=1&l=86134>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁴⁶ “Shpallen të pafajshëm 6 zyrtarë të Pejës të përfshirë në një tender”. Sakt.net. (Shih linkun <https://www.sakte.net/shpallen-te-pafajshem-6-zyrtare-te-pejes-te-perfshire-ne-nje-tender/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

200 euro
gjobë dhe
60 ditë burg
me kusht



ISAH HODA

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Kamenicë

Veprat penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjiilan, dega në Kamenicë

Faza procedurale: 200 euro gjobë dhe 60 ditë me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjiilan, më 12 korrik 2018, e ka akuzuar Hodën, se nga 1 deri më 31 mars të vitit 2018, si Këshilltar Komunal në Kamenicë, nuk ka deklaruar pasurinë dhe të ardhurat tjera financiare në Agjencinë Kundër Korrupsion, për periudhën kohore nga 1 deri më 31 dhjetor 2017, edhe pse për këtë ka qenë i obliguar me ligj.

Procesi - Paraprakisht, Hoda kishte mohuar fajësinë për këtë vepër penale në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 7 shkurt të vitit 2019³⁴⁷ dhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 26 mars të këtij viti.³⁴⁸ Mirëpo, pas kësaj seance Hoda kishte ndryshuar mendim lidhur me fajësinë e tij, ashtu që më 23 prill 2019, ai dhe avokati i tij mbrojtës, Lulzim Canaj, kishin arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me Prokurorinë Themelore në Gjiilan, e cila edhe ishte aprovuar nga gjykata. Në këtë rrethana, Gjykata Themelore në Gjiilan, dega në Kamenicë, në maj të vitit 2019, për mos deklarim të pasurisë e ka dënua Hodën me dy muaj burgim me kusht dhe me 200 euro gjobë.³⁴⁹

³⁴⁷ “Asamblisti në Kamenicë mohon fajësinë, thotë se nuk e ka ditur që duhet ta deklaronte pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 7 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/asamblisti-ne-kamenice-mohon-fajesine-thote-se-nuk-e-ka-ditur-qe-duhet-ta-deklaronte-pasurine/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁴⁸ “Asamblisti në Kamenicë mohon fajësinë, thotë se njoftimi që duhet ta deklaronte pasurinë i kishte ardhur me vonesë”. Betimi për Drejtësi. 26 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/asamblisti-ne-kamenice-mohon-fajesine-thote-se-njoftimi-qe-duhet-ta-deklaronte-pasurine-i-kishte-ardhur-me-vonese/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁴⁹ “Asamblisti në Kamenicë dënohet me burgim me kusht dhe me gjobë për mos deklarim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi., 15 maj 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/asamblisti-ne-kamenice-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-per-mos-deklarim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

**MELIZA HARADINAJ STUBLLA****Partia:** AAK**Pozita shtetërore:** Këshilltare Politike e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj³⁵⁰**Vepra penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore Prishtinë**Faza procedurale:** Tetë (8) muaj burgim me kusht dhe 1000 euro gjobë (Aktgjykim i shkallës së parë)8 muaj burgim
me kusht dhe
1.000 euro
gjobë

Aktakuza- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 26 mars 2019 e ka akuzuar ministren aktuale të Ministrisë së Jashtme Meliza Haradinaj-Stubllën, për “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”. Ajo akuzohet se si këshilltare e ish-kryeministrit Ramush Haradinaj, nuk e ka deklaruar në Agjencinë Kundër Korrupsionit pronësinë e një biznesi të quajtur “IN MIDDLE LTD”, të regjistruar në Londër, edhe pse ka qenë e obliguar, edhe pse për këtë ka qenë e obliguar sipas ligjit. **Procesi-** Në seancën fillestare të 20 majit 2019, e akuzuara Haradinaj-Stublla ishte deklaruar e pafajshme për këtë vepër penale. Pas kësaj seance, palët kishin paraqitur kundërshtime për provat dhe kërkesë për hudhje të aktakuzës, të cilat Gjykata Themelore në Prishtinë, më vendimin e 27 qershorit i kishte refuzuar, duke konfirmuar kështu aktakuzën në fjalë.³⁵¹ Shqyrtimi gjyqësor ndaj Haradinaj-Stubllës kishte përfunduar më 1 tetor 2019, ndërsa aktgjykimi ndaj saj ishte shpallur më 4 tetor 2019, sipas të cilit ajo ishte gjetur fajtor dhe ishte dënuar me tetë muaj burgim me kusht, që nuk do të ekzekutohet nëse ajo nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti si dhe me 1.000 euro gjobë³⁵².

Këtë vendim e akuzuara e ka goditur me ankesë në Gjykatën e Apelit, e cila akoma nuk ka vendosur lidhur me këtë.³⁵³

³⁵⁰ Më 3 qershor 2020, Haradinaj-Stublla është emëruar ministre e Ministrisë së Jashtme, në Qeverinë e udhëhequr nga kryeministri Avdullah Hoti

³⁵¹ “Konfirmohet aktakuza ndaj këshilltares së kryeministrit Haradinaj për mos deklarimin e biznesit në Londër” Betimi për Drejtësi. 28 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmohet-aktakuza-ndaj-keshilltares-se-kryeministrit-haradinaj-per-mos-deklarimin-e-biznesit-ne-londer/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁵² “Shpallet fajtorë se nuk e deklaroi biznesin në Londër, dënohet me burgim me kusht dhe me gjobë këshilltarja e Ramush Haradinajt” Betimi për Drejtësi, 4 tetor 2020, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-fajtor-se-nuk-e-deklaroi-biznesin-ne-londer-denohet-me-burgim-me-kusht-dhe-me-gjobe-keshilltarja-e-ramush-haradinajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁵³ Shënim: Gjykata e Apelit, në shtatorin e vitit 2020, ka njoftuar se këtë rast e ka kthyer në rigjykim, i cili proces akoma nuk ka filluar. “Apeli e kthen në rigjykim rastin e ministres Haradinaj-Stublla, e akuzuar për korrupsion”.



MUHAMET HALILI

Lirim

Partia: AAK

Pozita shtetërore: Ish-drejtor i Arsimit në Komunën e Ferizajt

Veprat penale: “keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar”, “cenimi i të drejtave të punësimit dhe papunësisë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Ferizaj

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 12 dhjetor 2018, nga Prokuroria Themelore në Ferizaj, i pandehuri Halili akuzohet se si person zyrtar – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj, kishte keqpërdorur detyrën zyrtare, ku pa publikuar konkurs pune, më 6 janar 2018, kishte lidhur kontratë të punës me L.G, si mësimdhënëse e lëndëve ekonomike në Shkollën e Mesme Ekonomike “Faik Grainca” në Ferizaj, si dhe për pozitë dhe në vend të njëjtë, më 18 prill 2016, kishte lidhur kontratë për kohë të caktuar me Sh.S. Për shkak të lidhjes së këtyre kontratave, i njëjti kishte kufizuar dhe kishte vënë në pozitë të pabarabartë pjesëmarrësve të tjerë për të realizuar të drejtën e punësimit në kushte të njëjta.

Procesi - Gjykata Themelore në Ferizaj, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më 16 dhjetor 2019 ka shpallur aktgjykim lirues ndaj të akuzuarit Halili.³⁵⁴

Rasti aktualisht është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit.

Betimi për Drejtësi. 11 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ministres-haradinaj-stublla-e-akuzuar-per-korrupsion/>)

³⁵⁴ “Ish-drejtori i Arsimit në Ferizaj lirohet nga akuzat lidhur me punësimet pa konkurs”. Betimi për Drejtësi. 16 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-i-arsimit-ne-ferizaj-lirohet-nga-akuzat-lidhur-me-punesimet-pa-konkurs/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

V. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të PSD-së

	DARDAN MOLLIQAJ Partia: PSD Pozita shtetërore: Deputet Vepra penale: 1. “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”, 2. “Sulmi” Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë Faza procedurale: 1. Refuzues/Parashkrim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Në proces.
---	--

1.
Refuzues

2. Në
proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë ka ngritur aktakuzë ndaj Molliqajt për shkak të veprave penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”. Sipas kësaj aktakuze, Molliqaj akuzohet se së bashku me 26 aktivistë dhe krerë të Vetëvendosjes, më 25 gusht 2009, në parkingun e EULEX-it afër stadiumit të Prishtinës, kishin dëmtuar dhe kthyer përmbys makinat e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si shenjë e kundërshtimit të një marrëveshjeje protokolli ndërshtetëror, që misioni evropian e kishte nënshkruar me Serbinë, por jo edhe me Kosovën.

Procesi 1 - Lidhur me këtë rast, për katër vjet, gjykata ka arritur të mbaj vetëm dy seanca gjyqësore gjë që ka bërë që kjo lëndë të jetë arrij afatin e parashkrimit më 25 gusht 2019³⁵⁵.

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së ngritur më 14 shkurt 2020, nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, të pandehurit Dardan Molliqaj dhe Fatos Sahiti akuzohen se më 11 shtator 2019, pas një debati të zhvilluar në televizionin T7, që të dy kishin sulmuar fizikisht ish-zëvendëskryeministrin Haki Abazi.³⁵⁶

Procesi: Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.

³⁵⁵ “Katër ditë deri në parashkrimin e lëndës gjyqësore në rastin e dëmtimit të veturave të Eulexit”. Koha.net. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/180019/kater-dite-deri-ne-parashkrimin-e-lendes-gjyqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IwAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁵⁶ “Dardan Molliqaj dhe shoqëruesi i tij akuzohen për sulm ndaj ish-zëvendëskryeministrit Haki Abazi” Betimi për Drejtësi. 16 qershor 2020. (shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/dardan-molliqaj-dhe-shoqeruesi-i-tij-akuzohen-per-sulm-ndaj-ish-zevendeskryeministrit-haki-abazi/?fbclid=IwAR1ëSIH5nËE_yuDë0oyx-CJ1uhëEg-pfhAQTVXo0EUr6R8efvbNIZQZVhdI). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**VISAR YMERI****Partia:** PSD**Pozita shtetërore:** Deputet**Vepra penale:** “Lëndim i lehtë trupor”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- ish-kryetari i LVV-së e tash nënkryetari i PSD-së Visar Ymeri, ishte pjesë e një përleshje fizike në oborrin e Kuvendit të Kosovës së ndodhur më 28 qershor të vitit 2012. Prokuroria pretendonte se deputet e LVV-së Visar Ymeri, Regjep Selimi dhe Florin Krasniqi, së bashku edhe me një vozitës të kësaj partie atë ditë kishin sulmuar fizikisht deputetin e PDK-së Bekim Haxhiu, duke i shkaktuar atij lëndime të lehta trupore.

Procesi - Katër vite pas përleshjes, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 25 prill 2016 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin kishte liruar nga akuza deputetin Ymeri³⁵⁷ me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur që me prova bindëse se ai ka kryer veprën penale për të cilën ishte ngarkuar.³⁵⁸ Pasi këtij vendimi të themelores, prokuroria e pakënaqur me këtë vendim i ishte drejtuar me ankesë Gjykatës së Apelit, por kjo gjykatë më 7 qershor 2016, kishte refuzuar ankesën e prokurorisë dhe kishte vërtetuar vendimin e shkallës së parë, duke e liruar përfundimisht Ymerin, nga kjo akuzë.³⁵⁹

³⁵⁷ Shënim: Përpos Ymerit nga akuza ishte liruar edhe deputeti Regjep Selimi, ndërsa ishte dënuar vozitësi Besart Bujupi ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht. Ndaj deputetit Florin Krasniqi ishte veçuar procedura pas i njëjti ndodhej jashtë Kosove.

³⁵⁸ “Deputetët Ymeri e Selimi shpallen të pafajshëm”. Radio Evropa e Lirë. 25 prill 2016. (Shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/27695875.html>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁵⁹ “Vërtetohet aktgjykimi në rastin e të akuzuarve Rexhep Selimi, Visar Ymeri dhe B.B.” Gjykata e Apelit. 21 qershor 2016. (Shih linkun: <http://apeli.gjyqesori-rks.org/2016/06/21/vertetohet-aktgjykimi-ne-rastin-e-te-akuzuarve-rexhep-selimi-visar-ymeri-dhe-b-b/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1 vit e dy
muaj
burg me
kusht



FATON TOPALLI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputet

Veprat penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: Aktgjykim dënues, një vit e dy muaj me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 16 dhjetor 2015 ka akuzuar Topalli për veprat penale “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Ai akuzohet se pa autorizim, më 8 tetor 2015, kishte hedhur gaz lotësjellës në sallën e Kuvendit të Kosovës, duke pamundësuar vazhdimin e kësaj seance.


Procesi - Pas shumë zvarritjeve të këtij procesi gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë, më 3 janar 2018 kishte shpallur fajtor Topallin për këto dy vepra penale. Ai është dënuar me një vit burgim për përdorim të armës, për pengim të personit zyrtar tre muaj burgim, kurse më pas ndaj tij është shqiptuar dënimi unik prej një vit e dy muaj me kusht.³⁶⁰ Ky dënim me kusht i shqiptuar në shkallë të parë ishte vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit më 18 shtator 2018.³⁶¹

³⁶⁰ “Dënohen me burgim me kusht Albin Kurti dhe tre deputetët e tjerë të Vetëvendosjes për gazin lotësjellës”, Betimi për Drejtësi, 3 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-burgim-me-kusht-albin-kurti-dhe-tre-deputetet-e-tjere-te-vetevendosjes-per-gazin-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁶¹ “Apeli vërteton dënimet ndaj Albin Kurtit dhe deputetëve të tjerë për rastin e gazit lotësjellës”, Betimi për Drejtësi, 18 shtator 2018, (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-ndaj-albin-kurtit-dhe-deputeteve-te-tjere-per-rastin-e-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces

2. Në
proces



BESA BAFTIU

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputete

Veprat penale: 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 2. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces, 2. Në proces

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Baftiun, për veprat penale të përdorimit të armës dhe pengim të personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare. Pretendohet se ajo në seancën e 14 dhjetorit 2015, në sallën e Kuvendit ka përdorur armën, konkretisht ka hedhur gaz lotsjellës dhe ka detyruar deputetet të largohen nga salla.

Procesi 2 - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohet.³⁶²

Aktakuza 2- Sipas aktakuzës së dytë të 8 prillit 2016, prokuroria pretendon se Baftiu më 19 shkurt 2016, ka poseduar armë, ashtu që në hollin e Kuvendit, gjatë kontrollit që i është bërë asaj nga punëtorët e sigurimit, i është gjetur dhe sekuestruar një bombolë e gazit, të cilën e mbante pa autorizim.

Procesi 2 – Ngjashëm edhe për këtë lëndë, edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohet.³⁶³

³⁶² Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, 23.06.2020

³⁶³ Po aty

1. Në
proces

2. Në
proces



AIDA DËRGUTI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputete

Vepra penale: : 1. “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” 2 “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”

Gjykata: Gjykata Themelore Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces 2. Në proces

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 22 shkurt 2016 ka akuzuar Dërgutin, për veprat penale “përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm. Ajo akuzohet se më 14 dhjetor 2015 në sallën e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ka përdorur armën, konkretisht ka hedhur gaz lotsjellës dhe ka detyruar deputetët të largohen nga salla.

Procesi 1 - Edhe pse kanë kaluar më shumë se katër vite, ky rast akoma nuk ka filluar që të gjykohej.³⁶⁴

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së ngritur më 7 mars 2017, nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Aida Dërguti dhe Donika Kadaj-Bujupi akuzohen se më 1 shtator 2016, në Kuvendin e Republikës së Kosovës, në hyrje tek holli i Kuvendit, gjatë kontrollit nga pjesëtarët e policisë, të akuzuarës Kadaj-Bujupi i është gjetur dhe konfiskuar një sprej me mbishkrimin “Nato”, ndërsa të akuzuarës Dërguti i është gjetur dhe konfiskuar një gaz lotsjellës, të cilat mjete i kishin vendosur në trup, e të cilat i kanë mbajtur në posedim, në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët.

Procesi 2 - Edhe kjo lëndë po ashtu akoma është në proces gjyqësor.³⁶⁵

³⁶⁴ Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

³⁶⁵ Shënim: Më 4 qershor 2020, pas pranimit të fajësisë nga të akuzuarat, gjykata ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarave Kadaj-Bujupi dhe Dërguti, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 200 euro. Betimi për Drejtësi 4 qershor 2020. (Shih linkun; https://betimiperdrejtesi.com/donika-kadaj-bujupi-dhe-aida-derguti-denohen-me-nga-200-euro-gjobe-per-hedhjen-e-gazit-lotsjelles-ne-kuvend/?fbclid=IwAR0h82oEjNjE0_x4SoqVyiEgqrdOXiBfkrEhB-uO2GqëëK-cfAs4yI9ugB9s). (Qasur për here të fundit më 8 dhjetor 2020). (Qasur për here të fundit më 8 dhjetor 2020)

1.
Hudhje

2. Në
proces

3. Në
proces

4. Në
proces

5.
Refuzim



FRASHËR KRASNIQI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputet

Veprat penale: 1. “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi”, 2. “sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, 3. “lëndim i lehtë trupor”, 4. “Kryerja e veprës terroriste”, 5. “Pjesëmarrja në turmë që kryen veprë penale dhe huliganizmi” dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë) 2. Në proces, 3. Në proces, 4. Në proces, 5. Refuzim/Parashkrim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1- Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 20 korrik 2016, ka akuzuar Krasniqin se më 16 janar 2015, ka marrë pjesë në protestën e organizuar, si shenjë pakënaqësie për deklaratat e ministrit të atëhershëm Aleksandër Jabllanoviq, i cili i kishte quajtur nënat gjakovare “egërsira”.

Procesi 1 - Kjo aktakuzë e ngritur nga PTh në Prishtinë asnjëherë nuk pati fatin të shqyrtohej nga Gjykata Themelore në Prishtinë. Akoma pa arritur të mbahej seanca fillestare ndaj Krasniqit, prokurori Ali Hajdini më 18 prill 2019, ishte tërhequr nga ndjekja penale ndaj tij.³⁶⁶ Në këto rrethana, gjykatësi Alban Ajvazi, kishte marrë vendim për hudhjen e kësaj aktakuze më 23 prill të vitit 2019 dhe rrjedhimisht edhe pushimin e kësaj procedure penale.³⁶⁷

Aktakuza 2- Sipas aktakuzës së dytë të Prokurorisë Themelore në Prishtinë, të ngritur më 22 korrik 2016 Krasniqi akuzohet se ka kryer veprën penale “Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”. Prokuroria pretendon se ai ka përdorur mjete të forta si shufra, gurë, xhama, pjesë të karrigeve, shishe etj, duke i penguar Policinë e Kosovës, në kryerjen e detyrës zyrtare, gjatë operacionit për arrestimin e Albin Kurtit me urdhër të gjykatës.

³⁶⁶ Shënëim: Në parashtresën e dorëzuar në gjykatë nga prokurori Ali Hajdini me të cilën njoftohej heqja dorë nga ndjekja penale ndaj Krasniqit dhe të tjerëve thuhej: “Tërhiqet aktakuza sepse provat që gjenden në shkresat e lëndës janë thelbësisht të pambështetshme dhe thelbësisht të pabesueshme dhe si të tilla nuk vërtetojnë elementet qenësore të kësaj veprë penale”, Shih Kërkesën për tërheqje nga aktakuza PP/II.nr.351/2015 të dt 18.04.2019

³⁶⁷ “Pushon procedura penale ndaj deputetit Frashër Krasniqi dhe të tjerëve lidhur me protestën për shkarkimin e ish-ministrit Jabllanoviq”. Betimi për Drejtësi. 5 Qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pushon-procedura-penale-ndaj-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-te-tjereve-lidhur-me-protesten-per-shkarkimin-e-ish-ministrit-jabllanoviq/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Prishtinë ka bërë përpjekje të dyfishtë për mbajtjen e seancës fillestare ndaj Krasniqit për veprën penale “sulm ndaj persnit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”, por pa sukses. Pra, mos prania në gjykatë e të akuzuarit Krasniqi ka qenë shkas që të dështojë mbajtja e seancave të 20 Qershorit dhe 24 korrik të këtij viti. Ndërsa në seancën e 10 tetorit në sallën e gjykimit nuk kishte ardhur asnjë i akuzuar, por dështimi i seancave ka vazdhur edhe në vitin 2020, pasi për shkak të mungesës së të akuzuarit Faton Zekaj, kishte dështuar edhe seanca e 11 shkurtit 2020³⁶⁸

Aktakuza 3 - Sipas aktakuzës së tretë të ngritur më 26 tetor 2017, Prokuroria Themelore në Prishtinë e akuzon Krasniqin për veprën penale “lëndim i lehtë trupor”. Prokuroria pretendon se më 29 shtator 2017, Krasniqi ka sulmuar fizikisht Milaim Zekën duke e goditur me grusht, derisa të dy ishin të ftuar si mysafirë në një emision televiziv në Klan Kosova.

Procesi 3 - Kjo aktakuzë e ngritur ndaj Krasniqit për përleshjen e famshme në një emision televiziv kishte qëndruar e “fjetur” në sirtarët e Gjykatës Themelore në Prishtinë për më shumë se një vit e gjysmë që nga ngritja e saj. Më 23 korrik të këtij viti, Gjykata Themelore në Prishtinë kishte caktuar shqyrtimin fillestar ndaj Krasniqit,³⁶⁹ pasi tashmë aktakuza e ngritur ndaj këtij të fundit ishte bërë e njohur për publikun pas raportimit nga “Betimi për Drejtësi”.³⁷⁰ Kjo përpjekje e 23 korrikut për mbajtjen e shqyrtimit fillestar ishte treguar e pasuksesshme, pasi Krasniqi nuk ka prezantuar në gjykim. Edhe përpjekja e dytë, ajo e 7 gushtit nuk pati përfundimin e duhur, për shkak se këtë rradhë ka munguar gjykatësi i rastit, Hanefi Jashari, ndërsa Krasniqi këtë herë ka prezantuar në gjykatë.³⁷¹

Aktakuza 4 - Sipas aktakuzës së katërt të ngritur në dhjetor të vitit 2016 nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Krasniqi akuzohet se ka kryer veprën penale “kryerja e veprës terroriste”. PSRK-ja pretendon se Krasniqi së bashku me katër të tjerë, më 4 gusht 2016 kishin sulmuar objektin e Kuvendit të Kosovës me raketahedhës dore.

³⁶⁸ “Sërisht dështon gjykimi ndaj ish-deputetit Frashër Krasniqi dhe dy të tjerëve, akuzohen e sulmuan policët për të mos lejuar arrestimin e Albin Kurtit”. Betimi për Drejtësi. 11 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/serish-deshton-gjykimi-ndaj-ish-deputetit-frasher-krasniqi-dhe-dy-te-tjereve-akuzohen-e-sulmuan-policet-per-te-mos-lejuar-arrestimin-e-albin-kurtit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁶⁹ “Mungojnë deputetët Frashër Krasniqi dhe Milaim Zeka, dështon të nis gjykimi për përleshjen fizike në Klan Kosova.” Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungojne-deputetet-frasher-krasniqi-dhe-milaim-zeka-deshton-te-nis-gjykimi-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷⁰ “Ekskluzive: Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj Frashër Krasniqit dhe Milaim Zekës për përleshjen fizike në Klan Kosova”. Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-prokuroria-ngrite-aktakuze-ndaj-frasher-krasniqit-dhe-milaim-zekes-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷¹ “Mungon gjykatësi, dështon gjykimi ndaj Milaim Zekës dhe Frashër Krasniqit për përleshjen në studio televizive”. Betimi për Drejtësi. 7 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/mungon-gjykatesi-deshton-gjykimi-ndaj-milaim-zekes-dhe-frasher-krasniqit-per-perleshjen-ne-studio-televizive/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 4 - Për veprën penale të terrorizmit, Frashër Krasniqi ishte dënuar me 8 vjet burgim nga Gjykata Themelore në Prishtinë më 17 nëntor 2017.³⁷² Mirëpo, ky rast ishte kthyer në rigjykim nga Gjykata e Apelit, më 22 shkurt të vitit 2018.³⁷³ Por edhe pse nga kthimi në rigjykim, kishte kaluar shumë kohë, gjykatësi i çështjes Beqir Kalludra, fillimin e rigjykimit e kishte caktuar më 4 mars 2020, por që kishte dështuar për shkak të kërkesës së mbrojtësit të Krasniqit, që të përjashtohet gjyqtari Beqir Kalludra, nga gjykimi i kësaj çështje³⁷⁴, të cilën kërkesë më pas e kishte refuzuar kryetarja e Gjykatës Themelore në Prishtinë, Afërdita Bytyqi. Seanca e radhës, akoma nuk është caktuar.

Aktakuza 5 - Sipas aktakuzës së pestë të ngritur nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, Krasniqi akuzohet se ka kryer veprat penale “Pjesëmarrja në turmë që kryen vepër penale dhe huliganizmi”, dhe “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë”. Sipas kësaj aktakuze, Krasniqi akuzohet se së bashku me 26 aktivistë dhe krerë të Vetëvendosjes, më 25 gusht 2009, në parkingun e EULEX-it afër stadiumit të Prishtinës, kishin dëmtuar dhe kthyer përmbys makinat e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit (EULEX), si shenjë e kundërshtimit të një marrëveshjeje protokolli ndërshtetëror, që misioni evropian e kishte nënshkruar me Serbinë, por jo edhe me Kosovën.

Procesi 5 - Lidhur me këtë rast, për katër vjet, gjykata ka arritur të mbaj vetëm dy seanca gjyqësore gjë që ka bërë që kjo lëndë të jetë arrij afatin e parashkrimit më 25 gusht 2019³⁷⁵.

³⁷² “Shpallen fajtorë për terrorizëm, mbi 21 vjet burgim për katër aktivistët e VV-së (Video)” Betimi për Drejtësi, 17 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallen-fajto-re-per-terrorizem-mbi-21-vjet-burgim-per-kater-aktivistet-e-vv-se/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷³ “Konfirmon Apeli, kthehet në rigjykim rasti ndaj aktivistëve të VV-së të dënuar për terrorizëm”. Betimi për Drejtësi. 26 shkurt 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/konfirmon-apeli-kthehet-ne-rigjykim-rasti-ndaj-aktivisteve-te-vv-se-te-denuar-per-terrorizem/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷⁴ “Avokati i Frashër Krasniqit kërkon përjashtimin e Beqir Kalludrës nga rigjykimi i rastit për sulmin në Kuvend”. Betimi për Drejtësi. 4 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/avokati-i-frasher-krasniqit-kerkon-perjashtimin-e-beqir-kalludres-nga-rigjykimi-i-rastit-per-sulmin-ne-kuvend/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷⁵ “Katër ditë deri në parashkrimin e lëndës gjyqësore në rastin e dëmtimit të veturave të Eulexit”. Koha.net. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/180019/kater-dite-deri-ne-parashkrimin-e-lendes-gjyqesore-ne-rastin-e-demtimit-te-veturave-te-eulex-it/?fbclid=IwAR3dzuxoE1XOiQ5SQ3pm8k1bCL4ëtëk-BmeL74K6KnJO19BiMQrENDHC3UE>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



FISNIK ISMAILI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputet

Veprat penale: “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”, “Pengim të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Gjashtë muaj burgim me kusht për mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”. Refuzim për “Pengim të personit zyrtar në kryerje të detyrave zyrtare (Aktgjykim i shkallës së parë)

6 muaj
burgim
me kusht

Aktakuza - Sipas aktakuzës së 5 janarit 2016, Ismaili dyshohet se më 30 nëntor 2015 në hollin e Kuvendit të Republikës së Kosovës, te ai ishin gjetur dy bombola me gaz lotsjellës, të cilët i kishte fshehur në këpucët e tij. ndërsa për piken tjetër të aktakuzës, ai dyshohej se më 17 nëntor 2015, në dalje të Kuvendit të Kosovës, i kishte penguar pjesëtarët e Policisë së Kosovës, kur ata kishin tentuar që ta ndalin dhe ta shoqërojnë në polici deputetin e Vetëvendosjes, Albin Kurti. Para se të përfundoi shqyrtimi gjyqësorë i procesit ndaj Ismailit, prokurori Ilaz Beqiri kishte konsideruar se nuk ishte provuar se Ismaili, ka penguar personat zyrtar dhe ishte tërhequr nga ndjekja penale për këtë vepër.³⁷⁶

Procesi - Ndërsa 18 mars 2019, trupi gjykues i kryesuar nga gjykatësi Vesel Ismaili, kishte shpallur aktgjykimin me të cilin e kishte gjetur fajtor deputetin e PSD-së, duke e dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht, për veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim i paautorizuar i armëve”. Mirëpo, dënimi ndaj tij nuk do të ekzekutohet nëse ai nuk kryen vepër tjetër penale brenda një viti.³⁷⁷

Gjykata e Apelit, më 25 nëntor 2019 këtë rast e ka kthyer në rigjykim³⁷⁸, ndërsa gjykimi në shkallë të parë akoma nuk ka filluar.³⁷⁹

³⁷⁶ “Prokurori tërhiqet nga njëra pikë e aktakuzës ndaj deputetit Fisnik Ismaili, ky i fundit thotë se ka pasur vetëm dy “shkrepsa”. Betimi për Drejtësi. 12 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokurori-terhiqet-nga-njera-pike-e-aktakuzes-ndaj-deputetit-fisnik-ismaili-ky-i-fundit-thote-se-ka-pasur-vetem-dy-shkrepsa/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷⁷ “Deputeti Fisnik Ismaili dënohet me kusht, pasi shpallet fajtor se i ishin gjetur dy bombola të gazit lotsjellës (Video)” Betimi për Drejtësi. 18 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-fisnik-ismaili-denohet-me-kusht-pasi-shpallet-fajtor-se-i-ishin-gjetur-dy-bombola-te-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁷⁸ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020

³⁷⁹ Shënim: Më 11 qershor 2020, gjykata pas rigjykimit e ka liruar nga akuza Fisnik Ismailin. Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2020 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-deputeti-fisnik-ismaili-lirohet-nga-akuza-per-posedim-te-gazit-lotsjelles/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



FLORIN KRASNIQI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Deputet

Vepra penale: “Lëndim i lehtë trupor”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Refuzim/Parashkrim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Anëtari i PSD-së dhe ish-deputeti i LVV-së Florin Krasniqi, ishte pjesë e një përleshje fizike në oborrin e Kuvendit të Kosovës së ndodhur më 28 qershor të vitit 2012. Prokuroria pretendonte se atëkohë deputet e LVV-së Visar Ymeri, Regjep Selimi dhe Florin Krasniqi, së bashku edhe me një vozitës të kësaj partie atë ditë kishin sulmuar fizikisht deputetin e PDK-së Bekim Haxhiu, duke i shkaktuar atij lëndime të lehta trupore.

Vendimi- Përpos politikës Krasniqi ishte pjesë edhe e botës biznesore të cilën e ushtronte në SHBA dhe në këtë mënyrë procedura ndaj tij ishte veçuar ndërsa gjykata, më 25 prill 2016 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin kishte liruar nga akuza deputetet Ymeri e Selimi³⁸⁰ me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është arritur që me prova bindëse se ai ka kryer veprën penale për të cilën ishte ngarkuar.³⁸¹

Pasi vepra me të cilin akuzohej Krasniqi, dënohej me vetëm një vit burgim, parashkrimi absolut i ndjekjes penale sipas dispozitave të Kodit Penal të Kosovës ndaj Krasniqit, kishte arritur më 28 qershor 2016, pasi kishin kaluar katër vite nga koha e kryerjes së pretenduar të veprës penale (28.06.2012)e cila parashihte një dënim prej së paku një vit burgim dhe në këtë mënyrë kishte pushuar edhe procedura ndaj tij.³⁸²

³⁸⁰ *Shënim:* Përpos Ymerit nga akuza ishte liruar edhe deputeti Regjep Selimi, ndërsa ishte dënuar vozitësi Besart Bujupi ishte dënuar me katër muaj burgim me kusht, të cilin vendim më 7 qershor 2016 e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.

³⁸¹ “*Deputetët Ymeri e Selimi shpallen të pafajshëm*”. Radio Evropa e Lirë. 25 prill 2016. (shih linkun <https://www.evropaelire.org/a/27695875.html>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸² “*Pushon ndjekja penale ndaj ish-deputetit të VV-së, Florin Krasniqi*”. Koha.net. 7 korrik 2016.(Shih linkun <https://archive.koha.net///?id=&l=122312>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

600
euro
gjobë



ADRIAN BERISHA

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunën e Prishtinës

Vepra penale: “Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim – 600 euro gjobë

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 8 korrik 2019, kishte ngritur aktakuzë ndaj Adrian Berisha, për veprën penale “mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”, nga neni 430 par. 1 të KPRK-së.

Sipas aktakuzës, ai akuzohet në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, Këshilltar i Asamblesë Komunale në Prishtinë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 par.1, të Ligjit 04/L-50, për deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë të zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtarë, ku ka qenë i detyruar që ta deklarojë pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsionit, përmes formularit për deklarimin e pasurisë, nga data 1 deri 31 mars të vitit 2019, për periudhën 1 janar deri 31 dhjetor 2018, mirëpo të njëjtën nuk e ka bërë në afatin e paraparë ligjor.³⁸³

Procesi – Në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 20 gusht 2019, Berisha e kishte pranuar fajësinë lidhur me veprën penale për të cilën akuzohej.³⁸⁴ Një ditë më vonë, më 21 gusht, Berisha ishte dënuar nga gjykata me 600 euro gjobë.³⁸⁵

³⁸³ “Isha në Milano për një ndeshje futbollit”, asamblisti i PSD-së në Prishtinë pranon se nuk e deklaroi pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 21 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/isha-ne-milano-per-nje-ndeshje-futbolli-asamblisti-i-psd-se-ne-prishtine-pranon-se-nuk-e-deklaroi-pasurine/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸⁴ “Isha në Milano për një ndeshje futbollit”, asamblisti i PSD-së në Prishtinë pranon se nuk e deklaroi pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 21 gusht 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/isha-ne-milano-per-nje-ndeshje-futbolli-asamblisti-i-psd-se-ne-prishtine-pranon-se-nuk-e-deklaroi-pasurine/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸⁵ “Dënohet me 600 euro gjobë, asamblisti i PSD-së në Prishtinë që pranoi se nuk e kishte deklaruar pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 21 gusht 2019 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-600-euro-gjobe-asamblisti-i-psd-se-ne-prishtine-qe-pranoi-se-nuk-e-kishte-deklaruar-pasurine/>).

Dënim 300
euro gjobë



ARTA GASHI

Partia: PSD

Pozita shtetërore: Drejtoreshë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Kamenicës

Veprat penale: “Mos raportimi apo raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë

Faza procedurale: Gjobë 300 euro (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjilan, më 21 qershor 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Arta Gashit, me arsyetimin se ajo pas kalimit të afatit ligjor për deklarimin e pasurisë e deri në lirimin nga funksioni me vendim të 1 marsit 2019, e vërtetuar më 4 mars 2019, në cilësinë e zyrtares së lartë publike, drejtoreshë e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor në Komunën e Kamenicës, duke qenë e detyruar me ligj të bëjë deklarimin e pasurisë për vitin 2018 e deri në lirimin nga funksioni, e njëjta edhe pse ka qenë e informuar për këtë obligim, nuk e ka bërë një gjë të tillë në afatin ligjor, ndërkaq deklarimin e pasurisë e bënë më 10 prill 2019, pas kalimit të afatit.

Procesi 1. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Kamenicë, më 3 mars 2020 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarës Gashi, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 300 euro.³⁸⁶

pasurine/?fbclid=IeAR04T9NLY781eKZLpouxQ6fE_xcZLBmftsmR_SGbFLS0VoS2G3hJVpsDMCY). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸⁶ “Pranon se nuk e raportoi me kohë pasurinë, ish-drejtoresha në Kamenicë dënohet me gjobë”. Betimi për Drejtësi. 3 mars 2020.(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pranon-se-nuk-e-raportoi-me-kohe-pasurine-ish-drejtoresha-ne-kamenice-denohet-me-gjobe/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

VI. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të NISMËS

1.
Lirim

2.
Lirim

3.
Lirim



FATMIR LIMAJ

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Zëvendëskryeministër, Ministër i Transportit dhe Post-Telekomunikacionit, Deputet

Veprat penale: 1. “Krim i organizuar” “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” “Marrje ryshfeti” “ Mos deklarim i parave për fushatë” 2. “Krime lufte” 3. “Krime lufte”

Gjykata: 1 dhe 2 Gjykata Themelore në Prishtinë 3.Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: 1.Lirim (Aktgjykim formës së prerë) 2. Lirim (Aktgjykim formës së prerë) 3. Lirim (Aktgjykim formës së prerë)

Aktakuza 1 – PSRK e Euelx-it, në dhjetorin e vitit 2012 kishte ngritur aktakuzë ndaj ish-ministrit të MTPT-së Fatmir Limajt dhe disa të tjerëve të dyshuar për keqpërdorime me tender në këtë ministri. Ndërsa në shkurtin e vitit 2014, për këtë rast ishte ngritur edhe një aktakuzë por më 28 shtator 2015, u krijua një aktakuzë e quajtur si e “konsoliduar” me anë të së cilës janë bashkuar dy aktakuza të mëparshme të rasteve MTPT 1 dhe MTPT 2.³⁸⁷

Përveç këtyre veprave penale, Fatmir Limaj, akuzohet po ashtu edhe për veprën mos deklarim i parave për fushatë.

Procesi 1 – Shqyrtimi gjyqësor nda Limajt dhe katër të akuzuarve të tjerë, kishte filluar më 18 nëntor 2015, po kishte përfunduar pas dy viteve, përkatësisht më 24 nëntor 2017. Shkalla e

³⁸⁷ Shënim: Aktakuza e parë ishte ngritur me datë 05 dhjetor 2012, ndërkaq aktakuza e dytë më 19 shkurt 2014 dhe për të dyja janë mbajtur dy shqyrtime fillestare. Mirëpo me vendimin e 30 majit 2014 të kryetares së atëhershme të trupit gjykues këto dy raste janë bashkuar në një, duke ngritur një aktakuzë të cilën e kanë quajtur aktakuzë e konsoliduar. Pas këtij vendimi, të dyja palët kishin dërguar ankesat e tyre dhe në bazë të ankesave Gjykata e Apelit më 23 dhjetor 2014 kishte vendosur që ai vendim nuk mund të ankimohet sepse është vendim i prerë.

Aktakuza e konsoliduar i ngarkon të akuzuarit Fatmir Limaj, Endrit Shala, Nexhat Krasniqi për veprat penale krim i organizuar, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar, marrje ryshfeti, Shpëtim Telakun për veprat penale krim i organizuar dhe keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe të akuzuarin e fundit Florim Zukën për veprat penale dhënie ryshfeti dhe keqpërdorim i autorizimeve ekonomike.

parë, kishte vendosur që të lirojë të gjithë të akuzuarit nga akuzat që i viheshin në barrë, ndërsa disa vepra penale kishin arritur afatin e parashkrimit.³⁸⁸

Ndërsa, pas afër dy vitesh nga verdikti i themelores, instanca e dytë gjyqësore, më 30 maj të vitit 2019, ka vendosur që të vërtetojë aktgjykimin e Themelores dhe të refuzojë ankesën e paraqitur nga ana e PSRK-së.³⁸⁹

Aktakuza 2 - Në verën e 2012-ës, Fatmir Limaj dhe nëntë pjesëtarë të tjerë të UÇK-së u akuzuan për krime lufte kundër popullatës civile dhe krime lufte kundër të burgosurve të luftës, që siç supozohej të jenë kryer nga fillimi i vitit 1999, deri në mesin e qershorit të atij viti, në një qendër të improvizuar paraburgimi nga UÇK-ja, e që ndodhej në fshatin, Kleçkë.

Procesi 2 - Lidhur me këtë rast të njohur si rasti “Kleçka”, më 17 shtator 2013 trupi gjykues në përbërje të gjykatësve të Eulex-it dhe atyre vendor i Gjykatës Themelore në Prishtinë, kishte liruar nga akuzat për krime lufte Limajn dhe nëntë bashkëluftëtarët e tij.³⁹⁰ Ky vendim i themelores më 26 janar të vitit 2016 u vërtetua edhe nga Gjykata e Apelit, ndërsa rasti ishte dërguar edhe në Gjykatën Supreme, e cila gjykatë më 12 maj të vitit 2017, kishte refuzuar kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë të zyrës së Prokurorit të Shtetit.³⁹¹

Aktakuza 3 - PSRK-ja më 28 tetor 2016, kishte ngritur aktakuzë ndaj Fatmir Limajt, lidhur me vrasjen e dy civilëve shqiptarë gjatë luftës në Kosovë 1998-1999. Sipas PSRK-së, Limaj dyshohet se në cilësinë e komandantit ushtarak të Brigadës 121, të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), nuk ka ndërmarrë masa të arsyeshme dhe të nevojshme brenda kompetencave të tij, për të parandaluar apo ndaluar vrasjen e Ramiz Hoxhës nga fshati Bellanicë dhe Selman Binishit, nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, të cilët me arsyetimin se janë bashkëpunëtorë të okupatorit serb, janë marrë peng nga disa persona me maska, më 2 tetor 1998, dhe më pas janë ekzekutuar.

Procesi 3 - Gjykata Themelore në Gjakovë, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, më 8 mars 2018, te kishte liruar nga akuza, Limajn, me arsyetimin se gjykata nuk kishte gjetur elemente të veprës penale.³⁹²

³⁸⁸ “Fatmir Limaj dhe të tjerët lirohen nga të gjitha pikat e aktakuzës në rastin e MTPT-së (Video)”. Betimi për Drejtësi. 24 nëntor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fatmir-limaj-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-tegjitha-pikat-e-aktakuzes-ne-rastin-e-mtpt-se/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁸⁹ “Arsyetimi i Apelit që i liroi përfundimisht nga akuzat për korrupsion Fatmir Limajn dhe të tjerët në rastin “MTPT””. Betimi për Drejtësi 2 korrik 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-apelit-qe-i-lroi-perfundimisht-nga-akuzat-per-korrupsion-fatmir-limajn-dhe-te-tjeret-ne-rastin-mtpt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁹⁰ “Rasti Kleçka: Të pafajshëm”. Radio Evropa e Lirë. 17 shtator 2013. (Shih linkun: <https://www.evropaelire.org/a/25108794.html>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁹¹ “Përfundon rasti “Kleçka”, refuzohet kërkesa e Prokurorisë”. Betimi për Drejtësi. 24 maj 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/perfundon-rasti-klecka-refuzohet-kerkesa-e-prokuroris/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁹² “Fatmir Limaj lirohet nga akuza për krime lufte në rastin “Bellanica”. Betimi për Drejtësi. 9 mars 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fatmir-limaj-lirohet-nga-akuza-per-krime-lufte-ne-rastin-bellanica/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

E pakënaqur me vendimin e gjykatës së shkallës së parë, PSRK kishte ushtruar ankesë në Gjykatën e Apelit, duke kërkuar dënimin e Limajt por edhe shkalla e dytë më vendimin e 30 tetorit 2018, kishte marr aktgjykim me të cilin e kishte vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë, me të cilin Limaj ishte liruar nga akuza, me arsyetimin se gjykata e shkallës së parë kishte dhënë arsye të qarta dhe të plota rreth argumentit se i akuzuari Limaj, nuk është kryerës i veprës penale krim i luftës kundër popullsisë civile.³⁹³

³⁹³ “*Apeli vërteton pafajësinë e Fatmir Limajt për rastin “Bellanica”*”. Betimi për Drejtësi. 11 nëntor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-fatmir-limajt-per-rastin-bellanica/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
1700
euro

2. Në
proces



DARDAN GASHI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Zëvendëskryeministër/
Ministër i Diasporës i Qeverisë së Kosovës

Veprat penale: 1. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” 2. “keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë; 2. Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. 1700 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë). 2. Në proces

Aktakuza 1- Sipas aktakuzës, Dardan Gashi akuzohet se deri më 30 nëntor 2017 në fshatin Banjë të Malishevës, në një aheng familjar, pa autorizim ka mbajtur armë e municione në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1,2 dhe 1,3 e lidhur me nenin 17 par.1 të ligjit për armë të Republikës së Kosovës dhe të cilat armë me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara.

Gjithnjë sipas aktakuzës, i akuzuari Gashi gjatë ahengut kishte hapur dritaren e odës dhe me armë me gaz të llojit “GAP” kal. 9 mm dhe një karikator, të pranuar nga i akuzuari Fadil Demiri, kishte shtënë në ajër disa herë dhe një armë e tillë ishte sekuestruar dhe e njëjta gjendet në Stacionin Policor në Malishevë. Për këto veprime, prokuroria e ngarkon të akuzuarin Gashi se ka kryer veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374 par.1 të KPRK-së.

Procesi 1– Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 1 mars 2019, e kishte shpallur fajtor Dardan Gashin dhe të njëjtin e kishte dënuar me 1700 euro gjobë. Në seancën fillestare të mbajtur më 27 shkurt 2019, Gashi e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej.³⁹⁴

Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në Gjykatën e Apelit kishte ushtruar prokuroria e cila kishte kërkuar rritjen e dënimit ndaj Gashit, mirëpo, ankesën e prokurorisë e kishte refuzuar shkalla e dytë, duke ia vërtetuar dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë, të akuzuarit Gashi.**Aktakuza**

³⁹⁴ “Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku e të tjerët dënohen me gjobë për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/dardan-gashi-endrit-shala-sami-lushtaku-e-te-tjeret-denohen-me-gjobe-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

2. Sipas aktakuzës së ngritur më 10 prill 2020, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Gashi akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, anëtar i Komitetit Qeveritar të Privatizimit, kishte tejkaluar kompetencat e veta, pasi së bashku me disa të akuzuar të tjerë në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, më 08.05.2013, njëzëri kishin votuar që hidrocentrali i Lumbardhit, hidrocentrali në Burim, Hidrocentrali i Radavcit dhe hidrocentrali “Dikance”, të transferohen tek KKDFE dhe më pas të privatizohen nga kompania “Limak-Calik”.

Në aktakuzë thuhet se po të njëjtën ditë është nënshkruar marrëveshja për importe, për transferim, për furnizim, për implementim dhe për borxhe, e se me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve është përmbyllur procesi i privatizimit të KKDFE-së, veprim i cili shkel Ligji për rregullatorin e energjisë elektrike nr.05/L-084, neni 35, paragrafi 4. Me këto veprime, të njëjtit, kanë dëmtuar interesat e kompanisë KEK si dhe aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,054,000.00 euro.

Sipas prokurorisë, dëmi tjetër i shkaktuar direkt është vlera e investuar (shtuar) në hidrocentrale prej 12,628,166.41 euro, që nuk përfshinë vlerën e aseteve para koncesionit.³⁹⁵

Procesi 2. Procesi në këtë rast nuk ka filluar akoma.

³⁹⁵ “PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 10 prill 2020. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 2400
euro
gjobë

2.
Lirim

3. Në
proces



ENDRIT SHALA

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e Kosovës

Veprat penale: 1. “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”; 2. “Krim i organizuar” “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” “Marrje ryshfeti” 3. “sulmi”

Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë
2. Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Dënim - 2400 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Në proces

Aktakuza 1- Endrit Shalën, prokuroria e ngarkonte se deri më 30 nëntor 2017 në fshatin Banjë të Malishevës, në një aheng familjar, pa autorizim ka mbajtur armë e municion në kundërshtim me nenin 4 par.1 nën par. 1,2 dhe 1,3 e lidhur me nenin 17 par.1 të ligjit për armë të Republikës së Kosovës, e të cilat armë me ligj kategorizohen si armë zjarri të ndaluara.

Gjithnjë sipas prokurorisë, i akuzuari Shala akuzohet se gjatë ahengut familjar, pasi i ishte hapur dritarja e odës nga Durim Limaj, me armë gjysmë automatike të pranuar nga i akuzuari Sherif Kastrati, ka shtënë në ajër disa herë. Kjo armë pastaj ishte sekuestruar dhe e njëjta gjendet në Stacionin Policor në Malishevë. Me këtë rast, sipas aktakuzës, Endrit Shala ka kryer veprën penale “mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, në vazhdimësi, nga neni 374, par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK – së.

Procesi 1- Gjykata Themelore në Gjakovë, dega në Malishevë, më 1 mars 2019, e kishte shpallur fajtor Endrit Shalën dhe të njëjtin e kishte dënuar me 2400 euro gjobë. Në seancën fillestare të mbajtur më 27 shkurt 2019, Shala e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohej.³⁹⁶ Kundër këtij aktgjykimi, ankesë në Gjykatën e Apelit kishte ushtruar prokuroria e cila kishte kërkuar rritjen e dënimit ndaj Shalës, mirëpo, ankesën e prokurorisë e

³⁹⁶ Dardan Gashi, Endrit Shala, Sami Lushtaku e të tjerët dënohen me gjobë për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 1 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dardan-gashi-endrit-shala-sami-lushtaku-e-te-tjeret-denohen-me-gjobe-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

kishte refuzuar shkalla e dytë, duke ia vërtetuar dënimin e shqiptuar nga shkalla e parë, të akuzuarit Shala.³⁹⁷

Aktakuza 2- Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK), kishte ngritur aktakuzën e konsoliduar më 28 shtator 2015, me anë të së cilës janë bashkuar dy aktakuza të mëparshme të rasteve MTPT 1 dhe MTPT 2. Aktakuza e parë ishte ngritur me datë 5 dhjetor 2012, ndërkaq aktakuza e dytë më 19 shkurt 2014 dhe për të dyja janë mbajtur dy shqyrtime fillestare. Mirëpo me vendimin e 30 majit 2014 të kryetares së atëhershme të trupit gjykues këto dy raste janë bashkuar në një, duke ngritur një aktakuzë të cilën e kanë quajtur aktakuzë e konsoliduar.

Aktakuza e konsoliduar e ngarkonte Endrit Shalën për veprat penale krim i organizuar, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar dhe marrje ryshfeti.

Procesi 2 – Gjykata Themelore në Prishtinë, më 24 nëntor 2017, Endrit Shalën dhe të akuzuarit e tjerë i kishte liruar nga të gjitha pikat e aktakuzës në rastin e njohur si MTPT.³⁹⁸

Ndërsa gjykata e shkallës së dytë, më 30 maj të vitit 2019, ka vendosur që të vërtetojë aktgjykimin e Themelores dhe të refuzojë ankesën e paraqitur nga ana e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK)³⁹⁹

Aktakuza 3. Sipas aktakuzës së ngritur më 10 shkurt 2020, nga Prokuroria Themelore e Prishtinës i pandehuri Shala akuzohet se më 17 dhjetor 2019, kishte sulmuar një gazetar të portalit “Indeksonline”, i cili kishte shkrepur disa fotografi gjatë kohës sa i akuzuari Shala kishte qenë në Klinikën Emergjente të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), pas plagosjes së një bashkë partiaku të tij nga Nisma Socialdemokrate.⁴⁰⁰

Procesi 3. Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar ende.

³⁹⁷“Apeli vërteton dënimet me gjobë ndaj Dardan Gashit, Endrit Shalës, Sami Lushtakut e të tjerëve për gjuajtjen me armë në odën e Fatmir Limajt”. Betimi për Drejtësi. 30 korrik 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-denimet-me-gjobe-ndaj-dardan-gashit-endrit-shales-sami-lushtakut-e-te-tjereve-per-gjuajtjen-me-arme-ne-oden-e-fatmir-limajt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁹⁸ “Fatmir Limaj dhe të tjerët lirohen nga të gjitha pikat e aktakuzës në rastin e MTPT-së (Video)” Betimi për Drejtësi. 25 nëntor 2017 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/fatmir-limaj-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-te-gjitha-pikat-e-aktakuzes-ne-rastin-e-mtpt-se/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

³⁹⁹ “Arsyetimi i Apelit që i liroi përfundimisht nga akuzat për korrupsion Fatmir Limajn dhe të tjerët në rastin “MTPT”. Betimi për Drejtësi. 2 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/arsyetimi-i-apelit-qe-i-liroi-perfundimisht-nga-akuzat-per-korrupsion-fatmir-limajn-dhe-te-tjeret-ne-rastin-mtpt/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁰⁰ Prokuroria ngrit aktakuzë ndaj deputetit Endrit Shala për sulmin ndaj gazetarit të “Indeksonline”. Betimi për Drejtësi. 15 qershor 2020. (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-ngrit-aktakuze-ndaj-deputetit-endrit-shala-per-sulmin-ndaj-gazetarit-te-indeksonline/?fbclid=IwAR0LëHëkYMEFYronmIDL6eRëSRsCTEZQYdOëx7enfxMë1ëPuafihë5GSuIE>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**HAXHI SHALA****Partia:** NISMA⁴⁰¹**Pozita shtetërore:** Deputet**Vepra penale:** “Përdorimi i armës apo mjetit të rrezikshëm” dhe “Pengim i personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare”**Gjykata:** Gjykata Themelore Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 6 janar 2016 ka akuzuar Shalën se më 30 nëntor 2015, në sallën e seancave plenare të Kuvendit të Kosovës, me qëllim të ndërprerjes së punimeve në seancë, kanë hedhur gaz lotsjellës, të cilin e posedonin pa autorizim. Po ashtu, Shala akuzohet se më 17 nëntor 2015 në cilësinë e deputetit nga radhët e Nismës për Kosovën, me disa deputetë të tjerë janë munduar që ta pamundësojnë shoqërimin e deputetit Albin Kurti nga pjesëtarët e Policisë së Kosovës.

Procesi - Aktakuzën ndaj tij për herë të parë e kishte konfirmuar gjykatësi Faik Hoxha por pas ankesave në Gjykatën e Apelit, e njëjta e kishte kthyer në rivendosje këtë çështje.

Më pas, kjo lëndë i ishte ndarë gjykatësit Vehbi Kashtanjeva pasi gjykatësi Hoxha veç kishte dhënë dorëheqje. Pas tri dështimeve të mbajtjes së seancave, gjykatësi Kashtanjeva më 20 nëntor 2017 kishte refuzuar kërkesat e të akuzuarve për hudhjen e aktakuzës.

Aktakuza në këtë rast kishte marrë formën e prerë më 22 dhjetor 2017 pasi Apeli kishte marrë vendim për refuzimin e kërkesave të mbrojtjes për hudhjen e aktakuzës. Ky rast, më 13 mars 2019 kishte kaluar Departamenti për Krime të Rënda në Departamentin e Përgjithshëm ndërsa sipas zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë, Mirlinda Gashi, kjo lëndë do të procedohet sipas radhës së arritjes së lëndëve në gjykatë.⁴⁰²

⁴⁰¹ Shënim: Më 6 korrik 2020, deputeti Haxhi Shala, ka aderuar në AAK, mirëpo për shkak se raporti përfshinë të dhënat deri më 31.05.2020, ai është përfshirë te aktakuzat e Nismës.

⁴⁰² Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 23.06.2020

140
euro
gjobë



ZAFIR BERISHA

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Deputet

Vepra penale: “Lidhja e paautorizuar në shërbime”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: 140 euro gjobë (Aktgjykimi i formës së prerë)

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 27 mars 2014, Prokuroria Themelore në Prizren, të akuzuarin Zafir Berisha, e ngarkonte me veprën penale “lidhja e paautorizuar në shërbime” Kjo pasi që sipas prokurorisë, Berisha dyshohej se nga periudha e pavërtetuar e deri më 31 janar 2014, në fshatin Vlashnje, Komuna e Prizrenit, në lokalit të tij afarist, restorant “Kështjella” ishte lidhur apo rilidhet në përçuesin e rrymës elektrike, në atë mënyrë që edhe pse ishte ç’kyqur nga njehsori për shkak të borxhit, kishte bërë kyçje ilegale në shtyllë pa autorizim.

Procesi - Gjykata Themelore në Prizren, më 20 gusht 2015, kishte marr aktgjykim me të cilin, Berishën e kishte shpallur fajtorë, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 140 euro. Kjo pas seancës fillestare, gjatë të cilës ishte bërë ri cilësimi i veprës penale në “heqja apo dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave” ku i akuzuari edhe kishte pranuar fajësinë.⁴⁰³

⁴⁰³ Shënim: Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, 20 gusht 2015.

1.
Lirim

2.
Hudhje



RAGIP BEGAJ

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Malishevës

Veprat penale: 1. “Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit”, 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. Hedhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza 1- PSRK kishte akuzuar Ragip Begajn, se në periudhën qershor-gusht 2014, kishte shpërdorur pozitën zyrtare pasi edhe përkundër faktit se i dëmtuari Shemsi Morina, kishte kontratë për punët dhe detyrat e punës si Drejtor në SHFMU “Ganimete Tërbeshi”, e vlefshme deri më 1 tetor 2015, i pandehuri me dashje dhe me dijeni kishte shkelur dispozitat e Ligjit të Punës, duke shpallur konkursin për drejtor të shkollës, kurse të dëmtuarit iu kishte ndërprerë marrëdhënia e punës.

Procesi 1 -Vendimi- Gjykata Themelore në Gjakovë, kishte filluar procesin gjyqësor ndaj Begajt, në janarin e vitit 2016, ndërsa kishte përfunduar atë pas gjashtë muajsh. Më 14 korrik 2016, kjo gjykatë kishte shpallur aktgjykimin me të cilin, Begaj në mungesë të provave u lirua nga akuza.⁴⁰⁴ Vendimi i shkallës së parë pas ankesës së PSRK-së është vërtetuar edhe nga Gjykata e Apelit.

Aktakuza 2 – PSRK , më 29 dhjetor 2017, kishte ngritur aktakuzë ndaj Ragip Begaj, i cili akuzohej se duke qenë kryetar i Komunës së Malishevës, ka angazhuar Labinot Mazrekun, në cilësinë e menaxherit të prokurimit për rreth shtatë muaj, megjithëse komuna kishte të punësuar një menaxher të tillë të prokurimit. Begaj edhe pse ka kuptuar se në zyrën e menaxherit të prokurimit, Haxhi Krasniqit, ka pas keqpërdorime, respektivisht ka humbur dosja e operatorit ekonomik “SHPK Albakos & NNSH Korben”, Pejë-Gjakovë, i cili operator kishte parashtruar ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), si palë e pakënaqur dhe ankesa i ishte

⁴⁰⁴ “Kryetari i malishevës ragip begaj lirohet nga akuza për shpërdorim të detyrës” Betimi për Drejtësi. 14 korrik 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-malisheves-ragip-begaj-lirohet-nga-akuza-per-shperdorim-te-detyres/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

aprovuar nga ky organ. Sipas vendimit të OSHP-së, të datës 11 gusht 2014, vendimi i autoritetit kontraktues është anuluar si i pabazë dhe është urdhëruar ky autoritet ta kthej lëndën në ritenderim, si dhe ka obliguar Komunën e Malishevës që të merr në përgjegjësi personat përgjegjës për humbjen e ofertës.

Në aktakuzë shkruan se i pandehuri pas pranimi të vendimit, në procedurë të shpejtuar ka pezulluar të gjithë zyrtarët e prokurimit nga puna me 50 % të pagës prej 14 gushtit 2014 edhe pse dosja ishte zbuluar në zyrën e menaxherit të prokurimit, vetëm dy ditë pas pranimi të vendimit nga OSHP.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Gjakovë, pa u futur fare në shqyrtim gjyqësor, në prill të vitit 2018, kishte hudhur poshtë aktakuzën e PSRK-së, me arsyetimin se aktakuza nuk kishte prova që mbështesin dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale me të cilën ngarkohet. Tutje, në aktvendim të gjykatës thuhej se veprimet e të akuzuarit në suspendimin e zyrtarëve të prokurimit në Komunën e Malishevës dhe lidhjen e kontratës së përkohshme me Labinot Mazrekun, nuk përbëjnë vepër penale sepse nuk ka dashje, përfitim apo dëm të shkaktuar.⁴⁰⁵ Hedhjen e aktakuzës, në qershor të vitit të kaluar e vërtetoi edhe Gjykata e Apelit.⁴⁰⁶

⁴⁰⁵ “Hudhet poshtë aktakuza për korrupsion kundër kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj”. Betimi për Drejtësi. 2 maj 2018. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-per-korrupsion-kunder-kryetarit-te-malisheves-ragip-begaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁰⁶ “Apeli konfirmon hudhjen e aktakuzës ndaj kryetarit të Malishevës, Ragip Begaj”. Betimi për Drejtësi. 3 qershor 2018. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-konfirmon-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-kryetarit-te-malisheves-ragip-begaj/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



DAUT XHEMAJLI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Ish-zëvendësministri i Drejtësisë dhe ish-shëfi i Administratës dhe Personelit në Komunën e Vitisë

Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza: Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore e Gjilanit, i pandehuri Xhemajli akuzohej se në kohën kur ishte shëf i Administratës dhe Personelit në vitin 2009, pa përfillur Zyrën e Prokurimit kishte lidhur kontratë me vlerë prej 7,900 eurove për implementimin e punëve të projektit “Rregullimi i trotuarëve dhe drunjve dekorativë në Viti” me kompaninë NNP “Kristal”.

Procesi: Gjykata e Apelit, më 27 dhjetor 2016 e kishte liruar të pandehurin Xhemajli nga aktakuza.⁴⁰⁷

⁴⁰⁷ Shënim: Përgjigje nga zëdhënësi i Gjykatës së Apelit, 3 shtator 2019.

6 muaj
burgim
me kusht



BESNIK BERISHA

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Zëvendësministër në Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Zbulim i fshehtësisë zyrtare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim - Gjashtë muaj burgim me kusht për zbulim të fshehtësisë zyrtare; Lirim për keqpërdorim të pozitës zyrtare (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës, Besnik Berisha, udhëheqës i Divizionit të Prodhimit në MPB, më 4 shkurt 2015, në një intervistë për KTV-në, kishte zbuluar të dhëna sekrete që kanë të bëjnë me prodhimin e pasaportave. Ai akuzohej se kishte zbuluar publikisht të dhëna në lidhje me sigurinë e pasaportave si: vendosjen e çipit, mënyrën e lansimit, qepjen dhe të dhëna të tjera, të klasifikuara si sekret zyrtar.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, në mars të vitit 2018, Besnik Berishën e kishte shpallur fajtor për veprën penale “zbulim të fshehtësisë zyrtare” dhe të njëjtit i kishte shqiptuar dënim me burgim me kusht në kohëzgjatje prej gjashtë muaj. Mirëpo, ky dënim ndaj Berishës nuk do të ekzekutohet nëse brenda periudhës dy vjeçare nuk kryen vepër tjetër penale. Ndërsa, Berisha, ishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, pasi sipas gjykatës së shkallës së parë, nuk ishte vërtetuar kryerja e kësaj vepre penale.⁴⁰⁸ Vendimin e Themelores e kishte vërtetuar në qershor 2018, edhe Gjykata e Apelit.⁴⁰⁹

⁴⁰⁸“Dënohet me kusht ish-zyrtari i MPB-së i akuzuar për zbulim të fshehtësisë zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 9 mars 2018. (Shih linku: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-ish-zyrtari-i-mpb-se-i-akuzuar-per-zbulim-te-fshehtesisë-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁰⁹ “Apeli vërteton aktgjykimin ndaj ish-zyrtarit të MPB-së, i dënuar me kusht për zbulim të fshehtësisë zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-ndaj-ish-zyrtarit-te-mpb-se-i-denuar-me-kusht-per-zbulim-te-fshehtesisë-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**VESEL KRASNIQI****Partia:** NISMA**Pozita shtetërore:** Zëvendësministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural⁴¹⁰**Veprat penale:** “Vetëgjyqësi”, “Asgjësim apo dëmtim i pasurisë”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjakovë - dega Malishevë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, më 12 aj 2019, Krasniqi akuzohej për veprat penale “ Vetëgjyqësi” dhe “Asgjësim apo dëmtim i pasurisë”

Kjo pasi që më datën 14 janar 2015, në fshatin Banjë, Komuna e Malishevës të dëmtuarit Feim dhe Nazmi Telaku, teksa i kane par duke punuar në tokën e tyre, të blerë para një viti⁴¹¹, me forcë i kanë larguar nga aty dhe i kanë futur me dhunë në automjet.

Po ashtu në ditën dhe kohën e njëjtë, me rastin e largimit me forcë të të dëmtuarve, u kanë dëmtuar pasurinë.

Procesi - Lidhur me këtë rast, në janar të vitit 2019 është mbajtur shqyrtimi i dytë, ku është kërkuar hüdhe e aktakuzës⁴¹² por kjo kërkesë është refuzuar. Ndërsa, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, më 2 mars 2020, Krasniqi është liruar nga akuza që e ngarkonte atë⁴¹³, mirëpo ky vendim akoma nuk e ka fituar formën e prerë.

⁴¹⁰ Më 3 qershor 2020, Krasniqi është emëruar ministër i Tregtisë dhe Industrisë në Qeverinë e udhëhequr nga Avdullah Hoti

⁴¹¹ *Shënim:* Kjo pronë është kontestuese, pasi që lidhur me pronësinë mbi të është duke u zhvilluar procedurë kontestimore në Gjykatën Themelore në Gjakovë.

⁴¹² “Zëvendësministri dhe të tjerët kundërshtojnë aktakuzën për vetëgjyqësi, dëmtim të pasurisë dhe uzurpim prone”. Betimi për Drejtësi. 8 janar 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/zevendesministri-dhe-te-tjeret-kundershtojne-aktakuzen-per-vetegjyqesi-demtimit-te-pasurise-dhe-uzurpim-prone/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴¹³ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjakovë Lekë Muçaj. 21.05.2020

8 muaj
burgim
efektiv



NYSRET DURMISHI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Inspektorateve në Komunën e Prizrenit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Dënim - Tetë muaj burgim efektiv (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Nysret Durmishi akuzohej se si drejtor i Inspektorateve gjatë viteve 2009-2010 në Komunën e Prizrenit, nuk i ka përmbushur detyrat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitojë personi tjetër dobi pasurore dhe të shkelen të drejtat e personit tjetër, pasi që nuk i ka ushtruar autorizimet e tij rreth ndalimit të kryerjes së punëve ndërtimore pa leje ndërtimi, në një kompleks banesor në rrugën “Jeronim de Rada”, ashtu që investitori ndërton katin e tetë dhe të nëntë në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga DUPH-ja.

Procesi – Gjykata Themelore në Prizren, në nëntor 2016 e kishte shpallur fajtor dhe e kishte gjykuar me tetë muaj burgim efektiv Durmishin për shkak të veprës penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Këtë aktgjykim të Themelores e kishte aprovuar pastaj edhe Gjykata e Apelit.⁴¹⁴

⁴¹⁴ “Apeli vërteton dënimin me 8 muaj burgim për ish-drejtorin komunal të Prizrenit”.. Koha.net. 7 dhjetor 2016. (Shih linkun: <https://archive.koha.net/?id=1&l=146086>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1 vit e
gjashtë
muaj burg
me kusht



EHAT ORESHKA

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Prizrenit

Veprat penale: “Falsifikim i dokumentit”, “Legalizim i përmbajtjes së rreme”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Dënim - Një vit e gjashtë muaj me kusht (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Prokuroria Themelore në Prizren me datën 24 shkurt të vitit 2017 kishte ngritur aktakuzë ndaj Drejtorit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ehat Oreshkës, i cili nga Prokuroria akuzohet se ka kryer dy vepra penale.

Sipas Prokurorisë, Ehat Oreshka ka kryer veprat penale, falsifikim i dokumentit dhe legalizim i përmbajtjes së rreme. Oreshka sipas prokurorisë ka falsifikuar dhe përdorur dokumentin e automjetit, i cili ka qenë në pronësi të babait të tij të ndjerë, A. Oreshka.

Procesi – Ehat Oreshka, ishte shpallur fajtor për veprat penale më 30 tetor 2018, për të cilat akuzohej dhe ndaj tij, gjykata kishte shqiptuar dënim unik prej një vit e gjashtë muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari në afat të verifikimit prej dy viteve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nuk kryen vepër të re penale.

**GANIMETE BABUNA****Partia:** NISMA**Pozita shtetërore:** Asambleiste në Kuvendin Komunal të Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Prizrenit të ngritur më 29 nëntor 2019, e pandehura Babuna, së bashku me disa persona të tjerë, duke qenë pjesë e komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prizrenit, në bashkëkryerje me dashje kanë shkelur kriterin e vetëm të Ankandit Publik. Duke vepruar në këtë mënyrë, të njëjtit kanë shkelur të drejtat e të dëmtuarit Albert Doqi, duke përzgjedhur si shfrytëzuese ofertuesen Fatmire Berisha, përkundër faktit se i dëmtuari Doqi, kishte kuotuar çmimin më të lartë, gjegjësisht shumën 25.20 euro për m², për lokalin nr.29, i cili gjendet në sheshin “Shatërvan”, por i njëjti lokal i është dhënë në shfrytëzim ofertueses Berisha, me çmim prej 20.06 euro për m². Përkundër faktit se në bazë të dokumentacionit të prezantuar dëshmohej se përfituesja Fatmire Berisha, nuk ka pasur përvojë në menaxhim dhe zhvillim të biznesit, komisioni për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale në Prizren, të njëjtën e ka poentuar me pikë maksimale.

Sipas aktakuzës, më pas komisioni për ankesa pranë Kuvendit Komunal në Prizren, e kishte aprovuar kërkesën e palës së dëmtuar, ku më 28 shkurt 2019, ka anuluar vendimin e këtij komisioni duke e dërguar çështjen në rishqyrtim, përkundër faktit të tillë, Komisioni përmes njoftimit të datës 1 prill 2019, ka potencuar se qëndrojnë pranë njoftimit të datës 17 janar 2019, ku janë shpallur fituesit e ankandit për shfrytëzimin me qira të lokaleve-pronë komunale.

Procesi - E pandehura Babuna, asambleiste në Kuvendin Komunal të Prizrenit, në seancën e mbajtur më 20 shkurt 2020 është deklaruar e pafajshme⁴¹⁵, ndërsa seanca e radhës mbetet e papërcaktuar.

⁴¹⁵ “Drejtorët në Prizren dhe të tjerët mohojnë fajësinë se kundërligjshëm dhanë në shfrytëzim pronën komunale”. Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtorët-ne-prizren-dhe-te-tjerët-mohojnë-fajësinë-se-kundërligjshëm-dhanë-ne-shfrytëzim-pronën-komunale/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**MURAT HOXHA****Partia:** NISMA**Pozita shtetërore:** Drejtor komunal në Malishevë**Vepra penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjakovë - dega Malishevë**Faza procedurale:** Gjashtë (6) muaj burgim me kusht dhe 600 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 9 gusht 2018, Murat Hoxha akuzohej nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, në cilësinë Drejtorit të Drejtorisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe zhvillimit Rural në Komunën e Malishevës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për deklarim, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave, për periudhën kohore prej 1 mars deri 31 mars 2017, nuk e kishte deklaruar pasurinë në Agjencinë Kundër Korrupsion.

Procesi – Hoxha, në seancën fillestare të 13 shtatorit 2019, e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ndërsa pas kësaj, ai më 18 shtator 2019, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me gjashtë muaj burgim me kusht i cili nuk do të ekzekutohet brenda periudhës prej një vit dhe 600 euro gjobë⁴¹⁶.

⁴¹⁶ “E pranoi fajësinë për mos deklarim të pasurisë, dënohet drejtori për Bujqësi në Komunën e Malishevës” Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/e-pranoi-fajesine-per-mos-deklarim-te-pasurise-denohet-drejtori-per-bujqesi-ne-komunen-e-malisheves/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



BLERIM THAQI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Malishevë

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” 2. Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë

Faza procedurale: 1 Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)
2 Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

1.
Lirim

2.
Lirim

Aktakuza 1– Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 9 dhjetor 2014, kishte ngritur aktakuzë ndaj Drejtorit të Arsimit në komunën e Malishevës, Blerim Thaqi. Kjo me pretendimin se Thaqi, në cilësinë e personit zyrtarë, i shkakton dëm të dëmtuarit Agim Samadraxha, ashtu që me një njoftim hap konkursin për Drejtor në Gjimnazin e Malishevës, të cilën pozitë e kishte i dëmtuari, ku më pas të njëjtit i ndërprente kontratën e punës.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Gjakovë, të akuzuarin Thaqi e ka liruar nga akuza, vendim ky i cili është vërtetuar nga Gjykata e Apelit.

Aktakuza 2- Prokuroria Themelore në Gjakovë, e kishte ngritur edhe një aktakuzë për korrupsion ndaj Thaqit më 29 shtator 2016. Sipas kësaj aktakuze Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, në ueb faqen e tij ka publikuar dhënien e kontratës së punës për punimin e rrethojës së gjimnazit “Hamdi Berisha” në Malisheve, ku tenderin e ka fituar operatori ekonomik NPZ “ Arbëri” në Malishevë. Ky publikim është bërë pasi janë kryer punimet nga ana e operatorit në fjalë, e të cilat punime nga ana e të pandehurit janë urdhëruar që të kryhen në mars 2014. Ndërkaq fituesi i tenderit është shpallur më 10 prill 2014 në ueb faqen e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik pranë Komunës të Malishevës.

Procesi 2 - Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Gjakovë, më 21 mars 2017, kishte shpallur aktgjykimin me të cilin, në mungesë të provave e kishte liruar nga përgjegjësia penale Thaqin.⁴¹⁷. Ky vendim më pas kishte marr formën e prerë.

⁴¹⁷ “Shpallet i pafajshëm drejtori i Drejtorisë për Arsim në Malishevë”. Betimi për Drejtësi. 21 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shpallet-i-pafajshem-drejtori-i-drejtorise-per-arsim-ne-malisheves/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

4 muaj burg
me kusht
dhe 300 euro
gjobë



GAZMEND KRASNIQI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Këshilltar në Asamblenë Komunale në Malishevë

Vepra penale “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë - Dega Malishevë

Faza procedurale: Katër (4) muaj burgim me kusht dhe 300 euro gjobë (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 25 maj 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë, e ngarkonte të akuzuarin Gazmend Krasniqi, me veprën penale “mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”

Kjo pasi që sipas prokurorisë, i akuzuari nga data 1 mars deri më 31 mars 2017, nuk e ka bërë deklarimin e pasurisë, edhe pse e ka ditur se si këshilltar i asamblesë komunale në Malishevë, është i detyruar konform ligjit të dhënat e kërkuara ti dërgoj në Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Procesi – Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë, me vendimin e 9 marsit 2020, e kishte shpallur fajtor Krasniqin dhe të njëjtin e kishte dënuar me Katër (4) muaj burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet brenda periudhës prej një viti dhe me 300 euro gjobë ⁴¹⁸, mirëpo ky vendim akoma nuk e ka fituar formën e prerë.

⁴¹⁸ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjakovë Lekë Muçaj. 21.05.2020

6 muaj burg
me kusht
dhe 400
euro gjobë



FILLORETA BYTYQI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Këshilltare e Asamblesë Komunale në Malishevë

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë

Faza procedurale: Gjashtë (6) muaj burgim me kusht, si dhe 400 euro gjobë (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza- Sipas aktakuzës së ngritur më 25 shtator 2018, Prokuroria Themelore në Gjakovë, e ngarkonte të akuzuarën Filloreta Bytyqi, me veprën penale “mos raportim ose raportim i rremë i pasurisë të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare”

Kjo pasi që sipas prokurorisë, e akuzuara nga data 1 mars deri më 31 mars 2018, nuk e ka bërë deklarinimin e pasurisë, të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose detyrimeve financiare, edhe pse e ka ditur se si këshilltare e asamblesë komunale në Malishevë, është e detyruar konform ligjit të dhënat e kërkuara ti dërgoj në Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Procesi- Pasi Bytyqi, në seancën fillestare të 2 gushtit 2019, e kishte pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar, ajo më 7 gusht 2019 nga Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë u dënua me gjashtë muaj burgim me kusht i cili nuk do të ekzekutohet brenda periudhës prej një vit dhe me 600 euro gjobë.⁴¹⁹

Këtë vendim më 13 nëntor 2019, e ka vërtetuar Gjykata e Apelit.⁴²⁰

⁴¹⁹ “Gjashtë muaj burg me kusht dhe 400 euro gjobë për asamblisten në Malishevë që pranoi se për një ditë ishte vonuar ta deklaronte pasurinë”. Betimi për Drejtësi. 7 gusht 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjashte-muaj-burg-me-kusht-dhe-400-euro-gjobe-per-asamblisten-ne-malisheve-ge-pranoi-se-per-nje-dite-ishte-vonuara-deklaronte-pasurine/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴²⁰ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020.

6 muaj burg
me kusht
dhe 600
euro gjobë

	AZIZ THAQI Partia: NISMA Pozita shtetërore: Kryesues në Kuvendit Komunal në Malishevë Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare” Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë Faza procedurale: Gjashtë (6) muaj me kusht dhe 600 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)
---	--

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 16 mars 2018, Aziz Thaqi akuzohet më 23 mars 2017, në cilësinë e zyrtarit së lartë publike, respektivisht si kryesues i Kuvendit Komunal në Malishevë, ka vepruar në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për deklarim, prejardhjen dhe kontrollimin e pasurisë së zyrtarëve të lartë publik dhe deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave, për periudhën kohore prej 1 janar 2015 e deri më 31 dhjetor 2015, në atë mënyrë që në rastin e deklarimit të pasurisë nuk ka deklaruar pasurinë- subjektin afarist O.S “As.dent”, edhe pse sipas ligjit ka qenë i detyruar ta bëjë.

Procesi – Lidhur me këtë në seancën e mbajtur në Gjykatën Themelore në Gjakovë, Thaqi, është deklaruar i pafajshëm për mos deklarim të pasurisë⁴²¹, mirëpo në shqyrtimin e dytë, i cili ishte mbajtur më 13 shtator 2019, ai e kishte pranuar veprën penale për të cilën ishte akuzuar dhe për këtë, ai ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me gjashtë (6) muaj burgim me kusht, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën prej një viti dhe me 600 euro gjobë⁴²²

⁴²¹ “Ish-asamblisti i Komunës së Malishevës deklarohet i pafajshëm për mos raportim të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 2 gusht 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-asamblisti-i-komunes-se-malisheves-deklarohet-i-pafajshem-per-mos-raportim-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴²² “Dënohet ish-kryesuesi i Kuvendit Komunal në Malishevë, pranoi se nuk e kishte deklaruar ordinancën e tij private”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-ish-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-ne-malisheve-pranoi-se-nuk-e-kishte-deklaruar-ordinancen-e-tij-private/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ISLAM VRENEZI

Partia: NISMA

Pozita shtetërore: Drejtor i Urbanizmit në Komunën e Malishevës

Vepra penale: “falsifikim i dokumentit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjakovë- Dega në Malishevë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore në Gjakovë, më 9 nëntor 2018 në Malishevë, i akuzuari Vranezi në cilësinë e Drejtorit të Urbanizmit në Komunën e Malishevës, dhe e akuzuara Valdete Morina, në cilësinë e menaxheres së projektit të kanalizimit në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj”, në dokumentin zyrtar-Raportin e Kryerjes së Punimeve, kanë shënuar të dhëna të rreme duke vërtetuar se pas daljes në terren në fshatin Balincë dhe lagjen “Veselaj” janë realizuar punimet në bazë të projektit të kontratës dhe planit dinamik nga operatori ekonomik N.T “Flamuri”, duke rekomanduar që operatori ekonomik në fjalë t’i bëhet pagesa për realizimin e këtyre punimeve në shumën prej 9,870.18, edhe pse e pandehura Morina ishte në pushim vjetor nuk kishte dalë në vend punishte edhe pse punët në terren nga operatori ekonomik nuk ishin kyçur.

Procesi - Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 25 shkurt 2020, i akuzuari Vranezi është deklaruar i pafajshëm lidhur me akuzën me të cilën ngarkohet⁴²³, ndërsa gjykimi është akoma duke vazhduar.

⁴²³ “Drejtori i Urbanizmit në Malishevë dhe zyrtarët e tjerë komunalë mohojnë akuzat për korrupsion”. Betimi për Drejtësi., 25 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-i-urbanizmit-ne-malisheve-dhe-zyrtaret-e-tjere-komunale-mohojne-akuzat-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**AGIM KRASNIQI****Partia:** NISMA**Pozita shtetërore:** Pa pozitë (Mjek në QKUK)**Veprat penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”; “Marrje ryshfeti”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Aktakuza e PSKR-së e ngarkon Agim Krasniqin dhe 45 mjekë të tjerë që janë të përfshirë në rastin “Stenta 2”, se kanë keqpërdorur pozitën zyrtare dhe kanë marrë ryshfet, ashtu që, në vend se pacientët që kanë shkuar për kontroll në institucione publike shëndetësore, t’i referonin në njësinë kompetente invazive në Klinikën Kardiologjisë në SHSKUK në Prishtinë, të njëjtit pacientët i kanë referuar në spitale private dhe për këto veprimet kanë marrë ryshfet.

Procesi – Shqyrtimi gjyqësor në këtë rast kishte filluar në tetor të vitit 2018, pasi që paraprakisht, aktakuza ishte konfirmuar nga dy instancat gjyqësore. Krasniqi, ashtu si edhe të akuzuarit tjerë ishin deklaruar të pafajshëm lidhur me akuzat për të cilat ngarkohen⁴²⁴, ndërsa ky proces është akoma duke vazhduar me dëgjimin e dëshmitarëve.

⁴²⁴ “Polemika ndërmjet gjykatës dhe avokatit në gjykimin ndaj mjekëve të akuzuar në rastin Stenta 2”. Betimi për Drejtësi. 29 tetor 2018. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/polemika-ndermjet-gjykateses-dhe-avokatit-ne-gjykimin-ndaj-mjekeve-te-akuzuar-ne-rastin-stenta-2/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

VII. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të AKR-së


 Lirim


VALDRIN LLUKA

Partia: AKR

Pozita shtetërore: Ministër në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, zyrtar i lartë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë

Vepra penale: “Konflikt interesi”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Ministri i Zhvillimit Ekonomik akuzohej se në cilësinë e zyrtarit të lartë në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), njëkohësisht edhe Kryeshef i Agjencisë për Promovim të Investimeve, më 23 mars 2014, kishte filluar procedurat për zotimin e mjeteve në vlerë prej 20 mijë euro për Organizatën Jo-Qeveritare (OJQ) “Jakov Innovation Center”, në të cilën OJQ kishte qenë themelues.

Procesi - Bashkë me Llukën është akuzuar edhe një ish-sekretarën e MTI-së Eljana Naka. Pas shqyrtimit gjyqësor, Gjykata Themelore në Prishtinë më 23 korrik 2018, në mungesë të provave kishte liruar Llukën, ndërsa kishte dënuar Nakën me shtatë mijë euro gjobë.⁴²⁵

Pas ankesave, vendimin e shkallës së parë për Llukën e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, duke e liruar përfundimisht ka akuza atë.⁴²⁶

⁴²⁵ “Valdrin Lluka lirohet nga akuza për konflikt interesi”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/valdrin-lluka-lirohet-nga-akuza-per-konflikt-interesi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴²⁶ “Apeli e liron përfundimisht nga akuza për konflikt interesi ministrin Valdrin Lluka, e kthen në rigjykim rastin e ish-sekretares së MTI-së” Betimi për Drejtësi. 20 dhjetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-liron-perfundimisht-nga-akuza-per-konflikt-interesi-ministrin-valdrin-lluka-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-ish-sekretares-se-mti-se/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**EKREM MUSTAFA****Partia:** AKR**Pozita shtetërore:** Ministër i Ministrisë së Punëve të Brendshme**Vepra penale:** “Rrezikim i trafikut publik”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Ministri aktual i brendshëm, Ekrem Mustafa, është duke u përballur me një aktakuzë të ngritur para se ai të emërohet ministër, për rrezikim të trafikut publik, për një aksident të ndodhur më 13 prill 2014, në magjistralen Prishtinë-Ferizaj. Sipas aktakuzës së 21 marsit 2017 Mustafa nga pakujdesia ka rrezikuar trafikun publik dhe jetën e njerëzve, pasi veprimet e tij në kundërshtim me rregullat e trafikut kanë ndikuar që përpos dëmeve materiale të ketë edhe dëme trupore pasi dy persona kanë pësuar lëndime të rënda ndërsa një tjetër lëndime më të lehta.

Procesi - Edhe pse aktakuza ndaj Mustafës është ngritur në marsin e vitit 2017, Gjykata Themelore në Ferizaj, nuk e kishte mbajtur shqyrtimin fillestar deri më 14 gusht 2019, duke shkelur kështu dispozitat e Kodit të procedurës penale të cilat parashohin mbajtjen e seancës fillestare 30 ditë pas ngritjes së aktakuzës. Në shqyrtimin fillestar të 14 gushtit, Mustafa ishte deklaruar i pafajshëm lidhur me veprën penale për të cilën akuzohet⁴²⁷, ndërsa ky proces akoma nuk ka përfunduar.

⁴²⁷ “Ministri i MPB-së mohon fajësinë për aksidentin ku ishin lënduar tre persona”. Betimi për Drejtësi. 14 gusht 2019. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/ministri-i-mpb-se-mohon-fajesine-per-aksidentin-ku-ishin-lenduar-tre-persona/?fbclid=IëAR3xIoFgrfmfeU0dtxZ5AëBtevm4fqG5um3h9_J6nMsXëjLNvOrvpVëeYVs). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Tre muaj
burgim
me kusht



FAUZ XHEMJALI

Partia: AKR

Pozita shtetërore: Nënkyetar i Komunës së Lipjanit
Drejtor i Administratës në Komunën e Lipjanit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dënim - 3 muaj burgim me kusht
(Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Nënkyetari aktual i Lipjanit Fauz Xhemjali, ishte akuzuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 28 qershor 2017. Ai ngarkohej se si drejtor i Administratës në Komunën e Lipjanit, gjatë vitit 2014, me qëllim të përfitimit pasuror për tjetrin nuk i kishte përmbushur detyrat e tij zyrtare, duke i shkaktuar dëm buxhetit të Komunës së Lipjanit. Sipas prokurorisë, Xhemjali nuk e kishte zbatuar vendimin për pushim pa pagesë të datës 2 mars 2014 të Afrim Pacollit, dhe të njëjtit në periudhën kohore 25 shtator 2014 e deri më 31 dhjetor 2014, i kishte dhënë paga mujore, edhe pse gjatë asaj periudhe Pacolli, kishte qenë në pushim pa pagesë.

Procesi - Xhemjali, i kishte pranuar këto pretendime të prokurorisë dhe kishte lidhur marrëveshje për pranimin e fajësisë, e cila ishte aprovuar nga ana e gjykatës, sipas së cilës ai u dënua me tre muaj burgim me kusht, që brenda një viti të mos kryej vepër tjetër penale. Ai po ashtu edhe kishte hequr dorë nga e drejta e ankesës.⁴²⁸

⁴²⁸ “Dënohet me tre muaj burg me kusht drejtori i Administratës në Komunën e Lipjanit”. Betimi për Drejtësi. 12 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-tre-muaj-burg-me-kusht-drejtori-i-administrates-ne-komunen-e-lipjanit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

VIII. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve dhe ish-zyrtarëve të partive tjera

	1. Në proces 2. Në proces BUJAR BUKOSHI Partia: Anëtar i “Lista Rugova” Pozita shtetërore: Deputet/ Zëvendëskryeministër/Ministër i Shëndetësisë Vepra penale: 1. “Shpërdorim i pozitës zyrtare apo autorizimit” 2. “Shpërdorimi”, “Shmangie nga tatimi” Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë Faza procedurale: 1.Në proces 2.Në proces
---	--

Aktakuza 1- PSRK e Eulex-it, më 4 qershor 2011² kishte ngritur aktakuzë ndaj ish-ministrit të Shëndetësisë Bujar Bukoshit, ish-sekretarit të përhershëm të Ministrisë së Shëndetësisë Ilir Tolaj dhe tetë zyrtarëve të tjerë të kësaj ministrie Sipas pretendimeve të prokurorisë, të akuzuarit kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare në lidhje me lidhjen e kontratave me kompani te ndryshme tenderuese me të cilat ministria ka qenë pjesë e marrëveshjeve dhe të cilat janë bërë në kundërshtim me rregullat e përcaktuara të prokurimit publik. Me këto veprime, ata dyshohet se i kanë shkaktuar buxhetit të shtetit humbje prej më shumë se dy milion euro.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 19 korrik 2013 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin kishte liruar nga akuza Bukoshin, ndërsa më 13 shtator 2016, Gjykata e kishte kthyer në rigjykim rastin ndaj tij. Pas kthimit në rigjykim, kjo lëndë ishte transferuar te gjykatësit vendor, ndërsa disa seanca kishin dështuar në mungesë të të akuzuarit Bukoshi për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore të tij. Gjykata Themelore në Prishtinë, përfundimisht më 11 qershor 2019, kishte veçuar procedurën ndaj Bukoshit, ndërsa gjykimi kishte vazhduar për të akuzuarit Ilir Tolaj, Arbenita Pajaziti, Hajrullah Fejza, Zenel Kuqi dhe Bekim Fusha.⁴²⁹

⁴²⁹ “Veçohet procedura ndaj Bujar Bukoshit, derisa Ilir Tolaj e të tjerët e kundërshtojnë edhe aktakuzën e ndryshuar, prokuroria thotë se ka prova”. Betimi për Drejtësi. 11 qershor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/vecohet-procedura-ndaj-bujar-bukoshit-derisa-ilir-tolaj-e-te-tjeret-e-kundershtojne-edhe-aktakuzen-e-ndryshuar-prokuroria-thote-se-ka-prova/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Pas kësaj aktakuze Bujar Bukoshi kishte dhënë dorëheqje nga posti i zëvendëskryeministrit.⁴³⁰

Aktakuza 2 - PSRK, ka ngritur edhe një aktkuzë ndaj Bukoshit. Ai së bashku me deputetin e LDK-së Naser Osmani dhe Atdhe Gashin janë akuzuar më 28 prill 2017 lidhur me dyshimet se të njëjtit në bashkëkryerje me njëri-tjetrin gjatë periudhës 2008-2013 kanë përvetësuar me pasurinë e qytetarëve të Kosovës që kanë punuar jashtë shtetit, i njohur ndryshe si fondi e 3%-shit. Me këto veprime dyshohet se Bukoshi, i ka shkaktuar dëm “Fondit 3%” në shumën prej mbi 248,462 euro. Ai me këtë aktakuzë akuzohet për veprat penale “shpërdorim” dhe “shmangie nga tatimi”

Procesi 2 - Edhe pse aktakuza ndaj tre të pandehurve ishte ngritur në prill të vitit 2017, publiku e kishte marrë vesh për këtë aktakuzë vetëm pas dy viteve kur ishte bërë publike në media në marsin e këtij viti.⁴³¹

Kjo lëndë fillimisht ishte ndarë në punë gjykatëse Albina Shabani–Rama, e cila më 23 maj 2018, kishte mbajtur shqyrtimin fillestar ndaj të akuzuarve në të cilin Osmani ishte deklaruar i pafajshëm. Po në këtë seancë, gjykatësja kishte marrë vendim për veçimin e procedurës penale ndaj Bujar Bukoshit, me arsyetimin se ai ishte i sëmurë dhe nuk kishte mundur të paraqitej në këtë shqyrtim fillestar.⁴³²

Shqyrtimi gjyqësor ndaj Bukoshit ishte caktuar më 12 korrik 2019, por kjo seancë kishte dështuar për shkak se aty nuk u paraqitë i akuzuari Bujar Bukoshi, e arsyetimin se i akuzuari Bukoshi, për shkaqe shëndetësore nuk mund të marr pjesë në këtë seancë, ndërsa seanca është shtyrë për afat të pacaktuar.⁴³³

⁴³⁰ “Jep dorëheqje Bujar Bukoshi e Astrit Haraqija”. Rajonipress. 9 korrik 2012. (Shih linkun: <https://rajonipress.com/jep-doreheqje-bujar-bukoshi-e-astrit-haraqija/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴³¹ “Aktakuzë për keqpërdorim me Fondin e 3-përqindëshit kundër Bukoshit, Osmanit e Gashit”. Koha.net. 30 mars 2019. (Shih linkun: <https://www.koha.net/arberi/153679/aktakuze-per-keqperdorim-me-fondin-e-3-perqindeshit-kunder-bukoshit-osmanit-e-gashit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴³² Shënim: Gjykatësja Shabani-Rama, më 3 dhjetor 2018, kishte marrë vendim që të refuzoheshin kërkesat për hudhje të aktakuzës dhe kundërshtim të provave. Lidhur me këtë, të akuzuarit Osmani dhe Gashi, kishin ushtruar ankesë ndaj këtij vendimi në Gjykatën e Apelit, e cila më 17 janar 2019, kishte refuzuar këto ankesa, duke konfirmuar aktakuzën në fjalë. Ndërsa, më 18 janar 2019, kjo lëndë i ishte ndarë në punë gjykatëse së Departamentit të Përgjithshëm në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Medie Bytyqi dhe më 13 mars të këtij viti, kjo lëndë nga Apeli, ishte kthyer në zyrën e kësaj gjykatëseje

⁴³³ “Rasti “Fondi 3%”, mungon Bujar Bukoshi, shtyhet në kohë të pacaktuar seanca ndaj tij”. Betimi për Drejtësi. 12 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-fondi-3-mungon-bujar-bukoshi-shtyhet-ne-kohe-te-pacaktuar-seanca-ndaj-tij/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



FERID AGANI

Partia: Partia e Drejtësisë

Pozita shtetërore: Ministër i Shëndetësisë, Ministër i Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor 2010-2016

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Agani së bashku me 63 persona të tjerë ishte pjesë e një aktakuze të ngritur nga prokurori i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, në kundërshtim me ligjin dhe praktikën gjyqësore në Kosovë, më 15 qershor 2016, gjetje kjo të cilën e ka ngritur IKD në raportet paraprake.⁴³⁴ Kjo aktakuzë në brendi të saj përfshinte veprat penale “keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “marrje e ryshfetit”, “trajtimi i pandërgjegjshëm mjekësor”, “ushtrimi i kundërligjshëm i veprimtarisë mjekësore dhe farmaceutike” dhe vepra tjera penale. Rasti ndaj Aganit dhe të tjerëve i njohur si “Stenta”, për shkak të numrit të madh të të akuzuarve ishte ndarë në tri procese gjyqësore, ndërsa ai dhe Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së, Gani Shabani u gjykuan në rastin e njohur si “Stenta 1”, ndryshe rast i shenjesruar për liberalizim të vizave por nga ngritja e aktakuzës deri në shpalljen e aktgjykimit në shkallë të parë kanë kaluar 1165 ditë.

Procesi - Më 24 prill 2019, gjykata e shkallës së parë i ka shpallur fajtorë Aganin dhe Shabanin, për keqpërdorim të pozitës zyrtare. Agani është dënuar me dy vite e gjashtë muaj burgim efektiv, ndërsa i akuzuari tjetër, Gani Shabani është dënuar dy vite burgim efektiv. Ata gjithashtu janë obliguar edhe në shpenzimet procedurale si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 400 euro⁴³⁵.

⁴³⁴ “Luftë, persekutim apo amnisti në emër të luftës kundër korrupsionit?”. Instituti i Kosovës për Drejtësi. Dhjetor 2017. (Shih linkun <http://kli-ks.org/luftë-persekutim-apo-amnisti-ne-emer-te-luftes-kunder-korrupsionit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴³⁵ “Rasti “Stenta 1”, ish-ministri Ferid Agani dhe ish-sekretari Gani Shabani dënohen me mbi 4 vjet burg efektiv (Video)”. Betimi për Drejtësi. 24 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/rasti-stenta-1-ish-ministri-ferid-agani-dhe-ish-sekretari-gani-shabani-denohen-me-mbi-4-vjet-burg-efektiv/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Mirëpo, pasi lënda kishte shkuar në Departamentin Special të Gjykatës së Apelit, kjo gjykatë kishte vendosur që për shkak se sipas tyre aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e po ashtu edhe gjendja faktike është vërtetuar mënyrë jo të plotë dhe të gabuar⁴³⁶.

Ndërsa procesi i rigjyimit në këtë rast akoma nuk ka filluar nga Gjykata Themelore në Prishtinë.

Ndryshe, Ferid Agani, ishte ndër të vetmit politikan që kishte liruar detyrën e tij pas ngritjes së një aktakuze.⁴³⁷

⁴³⁶ “Apeli e kthen në rigjykim dhe rivendosje rastin ndaj ish-ministrit, Ferid Agani dhe ish-sekretarit”. Gani Shabani”. Betimi për Drejtësi. 24 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-dhe-rivendosje-rastin-ndaj-ish-ministrit-ferid-agani-dhe-ish-sekretarit-gani-shabani/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴³⁷ “Ferid Agani jep dorëheqje”. Lajmi.net. 17 qershor 2016. (Shih linkun <https://lajmi.net/lajmi-fundit-ferid-agani-jep-doreheqje/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**MIMOZA KUSARI-LILA****Partia:** Alternativa**Pozita shtetërore:** Kryetare e partisë Alternativa**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special**Faza procedurale:** 1. Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 10 prill 2020, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Kusari-Lila akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, anëtare e Komitetit Qeveritar të Privatizimit, kishte tejkaluar kompetencat e veta, pasi së bashku me disa të akuzuar të tjerë në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, më 08.05.2013, njëzëri kishin votuar që hidrocentrali i Lumbardhit, hidrocentrali në Burim, Hidrocentrali i Radavcit dhe hidrocentrali “Dikance”, të transferohen tek KKDFE dhe më pas të privatizohen nga kompania “Limak-Calik”.

Në aktakuzë thuhet se po të njëjtën ditë është nënshkruar marrëveshja për importe, për transferim, për furnizim, për implementim dhe për borxhe, e se me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve është përmbyllur procesi i privatizimit të KKDFE-së, veprim i cili shkel Ligji për rregullatorin e energjisë elektrike nr.05/L-084, neni 35, paragrafi 4.

Së bashku me Kusari-Lilën, në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, po akuzohet edhe ish-ministrat Nesim Beqaj, Nenad Rashiq Dardan Gashi si dhe 15 persona të tjerë.⁴³⁸

Me këto veprime, të njëjtit, kanë dëmtuar interesat e kompanisë KEK si dhe aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,054,000.00 euro.

⁴³⁸ “PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë”, Betimi për Drejtësi. 10 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Sipas prokurorisë, dëmi tjetër i shkaktuar direkt është vlera e investuar (shtuar) në hidrocentrale prej 12,628,166.41 euro, që nuk përfshinë vlerën e aseteve para koncesionit⁴³⁹ Së bashku me të pandehurin Beqaj, në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, po akuzohet edhe ish-ministrja dhe deputetja aktuale Mimoza Kusari-Lila, si dhe ish-ministrat Nenad Rashiq Dardan Gashi si dhe 15 persona të tjerë⁴⁴⁰.

Procesi - Procesi në këtë rast nuk ka filluar akoma.

⁴³⁹ “PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 10 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴⁰ “PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 10 prill 2020. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. Në
proces

2. Në
proces

3. Në
proces



MILAIM ZEKA

Partia: Kryetar i Partisë Euroatlantike

Pozita shtetërore: Deputet

Veprat penale: 1. “*Mashtrim*” dhe “*Shmangie nga tatimi*” 2. “*Kanosje*”, 3. “*Kanosje*”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 1. Në proces 2. Në proces

Aktakuza 1 – PSRK-ja më 28 gusht 2018, ka ngritur aktakuzë, me pretendimin se i pandehuri Milaim Zeka ka kryer veprën penale të mashtrimit dhe shmangie nga tatimi. Zeka akuzohet se prej vitit 2016 deri në mars të vitit 2017 me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror më 2 qershor 2016, së bashku me të akuzuarin tjetër në këtë rast Ilir Krasniqi,² kishin krijuar biznesin “Ilir Krasniqi & Milaim Zeka Op”, si agjenci punësimi.

Sipas aktakuzës, të pandehurit thuhet se kishin paraqitur fakte të rreme kinse për punësimin e qytetarëve të Kosovës në Gjermani përmes emisionit “Pa rrotlla” duke joshur qytetarët që të aplikojnë në zyrat tyre në lagjen “Pejton”, të Prishtinës. Krasniqi dhe Zeka, akuzohen se kishin mashtruar 900 aplikues për viza pune e që me qëllim iu kishin marrë shuma prej 500 deri në 3050 euro duke i ndarë proporcionalisht mes vete. Kurse, thuhet se pas fillimit të hetimeve 354 personave iu janë kthyer mjetet në vlerë prej 83,850 euro, kurse 546 personave të tjerë nuk u janë kthyer mjetet në shumë prej 261,850.00 euro.

Ndërsa, gjatë periudhës kohore prej 2 qershorit 2016 e deri më 31 dhjetor 2017, sipas aktakuzës, si bashkëpronarë të biznesit të përmendur me dashje direkte u janë shmangur obligimeve tatimore ndaj Administratës Tatimore të Kosovës me ç ‘rast akuzohen se kanë kryer veprën penale “shmangia nga tatimi”.⁴⁴¹

⁴⁴¹ “Dëshmitari: Për vizë pune në Gjermani pagova mbi një mijë euro, Milaim Zeka më tha ta paraqes rastin në polici” Betimi për Drejtësi 27 mars 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deshmitari-per-vize-pune-ne->

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 28 tetor 2018 ka mbajtur seancën fillestare në këtë rast, ku i akuzuari Zeka është deklaruar i pafajshëm.⁴⁴² Pas paraqitjes së kundërshtimeve dhe kërkesës për hudhjen e aktakuzës, Gjykata Themelore në Prishtinë, kishte konfirmuar aktakuzën, e edhe ajo e Apelit kishte refuzuar ankesat e të akuzuarve, duke e lënë në fuqi aktvendimin e shkallës së parë.⁴⁴³ Ndërsa seanca e radhës e shqyrtimit gjyqësor është caktuar për 9 shtator 2019.

Aktakuza 2 - Prokuroria Themelore në Prishtinë, ka ngritur aktakuzë ndaj Zekës edhe për përleshjen që kishte ndodhur në mes tij dhe deputetit të PSD-së Frashër Krasniqi, më 29 shtator 2017, në lokalet e objektit të “Klan Kosova”, në studion e emisionit “Info Lokale”, gjatë transmetimit të drejtpërdrejtë. Prokuroria pretendon se të akuzuarit nuk i janë përmbajtur temës së emisionit për të cilën ishin të ftuar dhe gjatë debatit kanë filluar ta fyejnë njëri-tjetrin ku më pas i akuzuari Zeka, pasi që ishte sulmuar fizikisht nga Frashër Krasniqi, i ishte drejtuar me fjalët “me ty do të merrem pas emisionit”.⁴⁴⁴

Procesi 2 – Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 5 nëntor 2019, është vendosur që rasti ndaj të akuzuarit Zeka dhe Krasniqi, të dërgohet në procedurë të ndërmjetësimit.⁴⁴⁵

Aktakuza 3 – Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, i pandehuri Zeka auzohet se gjatë një emisioni televiziv, më 24 shtator 2018, kishte kanosur prokurorin special, Afrim Shefkriu, i cili kishte ngritur aktakuzë ndaj tij në rastin e njohur si “Vizat”.

“Ma përpara ia kisha falë nëse ma kish vra njërin prej fëmijëve në afekt sesa kështu me ia shkatërru njerëzve ëndrrat. Mua më kanë poshtëruar. Unë do ta ndjek këtë prokurorin tem me gjyq, me kanun e edhe privatisht. Nuk ia fali kurrë poshtërimin. Se njerëzit tash thonë për mua: Kqyre ky hajni i vizave”, kishte deklaruar ish-deputeti Zeka në emisionin “DPT te Fidani”.

Procesi 3 – Pas ngritjes së aktakuzës, shqyrtimi gjyqësor lidhur me këtë rast ende nuk ka filluar.⁴⁴⁶

[gjermani-pagova-mbi-nje-mije-euro-milaim-zeka-me-tha-ta-paraqes-rastin-ne-polici/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴² “Milaim Zeka dhe të tjerët deklarohen të pafajshëm për mashtrim, shmangie nga tatimi e pastrim parash” Betimi për Drejtësi. 29 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/milaim-zeka-dhe-te-tjeret-deklarohen-te-pafajshem-per-mashtrim-shmangie-nga-tatimi-e-pastrim-parash/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴³ “Gjykata e Apelit konfirmon aktakuzën ndaj deputetit Milaim Zeka dhe të tjerëve” Betimmi për Drejtësi. 11 shkurt 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/gjykata-e-apelit-konfirmon-aktakuzen-ndaj-deputetit-milaim-zeka-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴⁴ “Ekskluzive: Prokuroria ngritë aktakuzë ndaj Frashër Krasniqit dhe Milaim Zekës për përleshjen fizike në Klan Kosova” Betimi për Drejtësi. 19 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ekskluzive-prokuroria-ngrite-aktakuze-ndaj-frasher-krasniqit-dhe-milaim-zekes-per-perleshjen-fizike-ne-klan-kosova/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴⁵ “Milaim Zeka nuk e pranon fajin, kurse Frashër Krasniqi po, ish-deputetët pajtohen që rastin ta zgjidhin me ndërmjetësim”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/milaim-zeka-nuk-e-pranon-fajin-kurse-frasher-krasniqi-po-ish-deputetet-pajtohen-qe-rastin-ta-zgjidhin-me-ndermjetesim/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴⁶ “Aktakuzë ndaj ish-deputetëve Shkumbin Demalijaj e Milaim Zeka, akuzohen për kanosjen e prokurorëve”. Betimi për Drejtësi. 5 shtator 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuze-ndaj-ish-deputeteve->

Në
proces**NENAD RASHIQ****Partia:** Sloboda**Pozita shtetërore:** Ish-këshilltar politik i Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurti, ish-drejtor të Zyrës për Çështje të Komuniteteve dhe Ish-ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti Special**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 10 prill 2020, nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, Rashiq akuzohet se në cilësinë e personit zyrtar, anëtar i Komitetit Qeveritar të Privatizimit, kishte tejkaluar kompetencat e veta, pasi së bashku me disa të akuzuar të tjerë në këtë rast, të njohur si “falja e hidrocentralit”, më 08.05.2013, njëzëri kishin votuar që hidrocentrali i Lumbardhit, hidrocentrali në Burim, Hidrocentrali i Radavcit dhe hidrocentrali “Dikance”, të transferohen tek KKDFE dhe më pas të privatizohen nga kompania “Limak-Calik”.

Në aktakuzë thuhet se po të njëjtën ditë është nënshkruar marrëveshja për importe, për transferim, për furnizim, për implementim dhe për borxhe, e se me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve është përmbyllur procesi i privatizimit të KKDFE-së, veprim i cili shkel Ligji për rregullatorin e energjisë elektrike nr.05/L-084, neni 35, paragrafi 4. Me këto veprime, të njëjtë, kanë dëmtuar interesat e kompanisë KEK si dhe aksionarit Qeveria e Republikës së Kosovës, në shumën prej 1,054,000.00 euro. Dëmi tjetër i shkaktuar direkt është vlera e investuar (shtuar) në hidrocentrale prej 12,628,166.41 euro, që nuk përfshinë vlerën e aseteve para koncesionit.⁴⁴⁷ Pas ngritjes së aktakuzës, kryeministri në detyrë, Albin Kurti, në një

[shkumbin-demalijaj-e-milaim-zeka-akuzohen-per-kanosjen-e-prokuroreve/](#)). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁴⁷ “PSRK ngritë aktakuzë për korrupsion ndaj Mimoza Kuasri-Lilës, Besim Beqajt, Dardan Gashit e 16 zyrtarëve tjerë”. Betimi për Drejtësi. 10 prill 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/psrk-ngrite-aktakuze-per-korrupsion-ndaj-mimoza-kuasri-liles-besim-beqajt-dardan-gashit-e-16-zyrtareve-tjere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

konferencë për media kishte njoftuar se këshilltari i tij politik, Nenad Rashiq, njëkohësisht drejtor i të Zyrës për Çështje të Komuniteteve, ka dhënë dorëheqje.⁴⁴⁸

Procesi - Procesi ndaj të akuzuarit Rashiqit, nuk ka filluar ende.



NENAD RIKALO

Partia: Lista Serbe

Pozita shtetërore: Ministër në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural/Anëtarë i KQZ-së

Vepra penale: “keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Në
proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së përpiluar nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) me 26 dhjetor 2019, ish-ministri Nenad Rikalo, në bashkëveprim me zyrtar të tjerë të kësaj ministrie, me qëllim që tu mundësojnë përfitim në mënyrë të kundërligjshëm kompanive të ndyshme, të cilët më pas kanë fituar grande nga ana e Minisrisë së Bujqësisë, kanë vepruar në kundërshtim me Ligjin 04/L-090 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 03/L-098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural neni 5.1, neni 8, neni 13 paragrafi 1.2, neni 4, neni 14.2 Ligji 03/L098 për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, neni 8 dhe 9, rregullores (QRK) nr. 37/2013, neni 7.1, paragrafi 1.1, Udhëzuesi dhe Doracaku për hartimin e konceptit të dokumenteve nga Zyra e Kryeministrit.

Sipas prokurorisë, i pandehuri Rikalo, në cilësinë e Ministrit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ka tejkaluar kompetencat e tij, duke hartuar një “Program të veçantë”, pa buxhet të veçantë të ndarë për këtë projekt, ka vendosur mbi kriteret, ka përcaktuar regjionet për financim, shumën e grandit, duke i anashkaluar edhe procedurat e rregullta të hartimit të programit të veçantë, që ishte kompetencë e Departamentit të Politikave të Zhvillimit Rural në MBPZHR duke mbivendosur në mes të masave me programin e rregullt, me datë 26 mars 2018, në mënyrë të kundërligjshme ka lëshuar vendimin me nr. ref. KM 91/18 për hartimin e politikave të reja për zhvillim të mëtutjeshme të infrastrukturës rurale dhe ngritjes së konkurrencës në zonat rurale më pak të zhvilluara, me ç ‘rast edhe programin ua dorëzon vet të përfunduar, ndërsa komisionin e kishin formuar vetëm formalisht.

⁴⁴⁸ “Jep dorëheqje Nenad Rashiq”. Gazeta Blic. (Shih linkun: <https://gazetablic.com/jep-doreheqje-nenad-rashiq22/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi – Në seancën fillestare të 12 marsit 2020, Rikallo dhe të tjerët ishin deklaruar të pafajshëm ndërsa shqyrtimi i dytë i caktuar më 21 prill 2010, mirëpo ka dështuar për shkak të paraqitjes së pandemisë Covid-19.⁴⁴⁹

Hudhje



DALIBOR JEVTIQ

Partia: Lista Serbe

Pozitat shtetërore: Ministër i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Hudhje (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza - Ish-ministri i Ministrisë për Komunitete dhe Kthim, Dalibor Jevtiq, akuzohej nga PSRK, me pretendimin se ai, në cilësinë e ministrit të MKK-së, i ka tejkaluar kompetencat dhe autorizimet e tij duke i shkaktar dëm MKK-së. Në aktakuzë thuhej se me 11 shkurt 2014, i pandehuri Dalibor Jevtiq, në kundërshtim me nenin 16 të Udhëzimit Administrativ nr.03/2008 për përdorimin e automjeteve të Qeverisë së Kosovës, ka nxjerrë vendim, me të cilin veturën që ishte pronë e MKK-së ia ka dhënë për shfrytëzim të përhershëm kompanisë private “Radio KIM- TV Centar”, me seli në Çagllavicë.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 4 shtator 2017, në mungesë të provave e kishte hudhur poshtë aktakuzën e ngritur nga PSRK, ndaj Jevtiqit.⁴⁵⁰ E këtë vendim e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila më 16 tetor 2017 e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e PSRK-së.⁴⁵¹

Ndërsa Gjykata Supreme ka konstatuar se në aktvendimet për hudhje të aktakuzës të Gjykatës Themelore në Prishtinë dhe asaj të Apelit, ka pas shkelje të dispozitave të procedurës penale,

⁴⁴⁹ “Shqyrtimi i dytë ndaj ish-ministrit Nenad Rikalo dhe të tjerëve pritet të mbahet me 21 prill”. Betimi për Drejtësi. 17 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shqyrtimi-i-dyte-ndaj-ish-ministrit-nenad-rikalo-dhe-te-tjereve-pritet-te-mbahet-me-21-prill/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵⁰ “Hudhet poshtë aktakuza ndaj ministrit në detyrë Dalibor Jevtiq (Video)”. Betimi për Drejtësi 4 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/hudhet-poshte-aktakuza-ndaj-ministrit-ne-detyre-dalibor-jevtiq/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵¹ “Apeli vërteton hudhjen e aktakuzës ndaj ministrit Dalibor Jevtiq dhe të tjerëve”. Betimi për Drejtësi. 16 tetor 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-ministrit-dalibor-jevtiq-dhe-te-tjereve/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

në favor të të pandehurit, mirëpo duke mos prekur në vendimin e formës së prerë në raport me të.⁴⁵²

1 vit e dy
muaj
burgim



IVAN TODOSIJEVIQ

Partia: Lista Serbe

Pozitat shtetërore: Ministër i Ministrisë së Administratës dhe Pushtetit Lokal

Vepra penale: “Nxitja e urrejtjes, përçarjes ose mos durimit kombëtar, racor, fetar apo etnik”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Dy vite burgim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza – Një deklaratë e 24 marsit 2019 rreth masakrës së Reçakut i ka kushtuar me aktakuzë ministrit të atëhershëm Ivan Todosijević. Sipas aktakuzës së PSRK-së, së ngritur më 28 qershor 2019, i pandehuri në cilësinë e Ministrit të Administratës dhe Pushtetit Lokal, duke keqpërdorur pozitën apo autorizimin e tij, me dashje, ka nxituar dhe përhapur publikisht urrejtje, përçarja dhe mos durim midis grupeve kombëtare, racore dhe etnike që jetojnë në Republikës e Kosovës.


Sipas akuzës, me datë 24 mars 2019, në rrugën “Kralj Milutin” në Zvečan, në cilësinë e pjesëmarrësit dhe folësit në tubimin qytetar kundër intervenimit të NATO-s, në vitin 1999 në Kosovë, të ashtuquajtur “në kujtim të viktimave të bombardimeve të NATO-s”, shprehet se “Arsyeja për agresionin në shtetin tonë ka qenë e ashtuquajtura katastrofë humanitare në Kosovë e Metohi... Masakra e Reçakut ishte trillim... Janë terroristët shqiptarë që e trilluan gjithë këtë dhe bënë krimet më të mëdha në Kosovë e Metohi... Për këtë, sot e kësaj dite askush nuk ka dhënë përgjegjësi... Kanë bërë krime para agresionit të NATO-s, kanë vrarë shtëpiak të mirë serb dhe policë në vendin e tyre të punës... gjak pirjen e tyre e kanë vazhduar edhe gjatë agresionit edhe pas ardhjes të së ashtuquajturës mision paqësor në Kosovë e Metohi”.

Procesi – Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 dhjetor 2019 ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Todosijević, duke i shqiptuar dënim me burg efektiv në kohëzgjatje prej dy

⁴⁵² “Supremja konstaton shkelje në vendimet e Themelores dhe të Apelit për hudhjen e aktakuzës ndaj Dalibor Jevtiq” Betimi për drejtësi 18 prill 2019 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/supremja-konstaton-shkelje-ne-vendimet-e-themelores-dhe-te-apelit-per-hudhjen-e-aktakuzes-ndaj-dalibor-jevtiq/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

vite.⁴⁵³ Për këtë rast, ende nuk ka vendim nga Gjykata e Apelit. Kryeministri Ramush Haradinaj, në prill të vitit 2019, e kishte shkarkuar atë nga kjo pozitë, pas deklaratës që kishte dhënë lidhur me masakrën e Reçakut.

Lirim



DUDA BALJE

Partia: Koalicioni Vakut

Pozita shtetërore: Deputete

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza- Sipas aktakuzës së prokurorisë, deputetja Duda Balja, më 28 mars 2013 në Agjencinë Kundër Korrupsion në Prishtinë në cilësinë e zyrtares së lartë publike në formularin për deklarin e pasurisë nuk ka paraqitur të dhënat e kërkuara. Prokuroria pretendonte se ajo kishte paraqitur vetëm pagën bazë si deputete në shumën prej 17.856.000 euro, ndërsa të dhëna të tjera ishin gjetur në Kuvendin e Kosovës, sipas të cilave të hyrat vjetore nga Kuvendi për këtë deputete janë 24.327.00 euro.

Procesi - Gjykata Themelore në Prizren, më 29 prill 2015, kishte shpallur aktgjykimin sipas të cilit deputetja Balje, ishte shpallur e pafajshme. Sipas arsyetimit të kësaj gjykate mos deklarimi i pasurisë nga e akuzuara ishte vetëm një gabim dhe se nuk ka ekzistuar dashja për ta kryer këtë vepër.⁴⁵⁴

⁴⁵³ “Ish-ministri i MAPL-së dënohet me dy vjet burg për deklaratat e tij fyese për masakrën e Reçakut” Betimi për Drejtësi. 5 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ministri-i-mapl-se-denohet-me-dy-vjet-burg-per-deklaratat-e-tij-fyese-per-masakren-e-recakut/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵⁴ “Duda Balje shpallet e pafajshme” Klan Kosova. 29 prill 2019. (Shih linkun: <https://klankosova.tv/duda-balje-shpallet-e-pafajshme/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1 vit e tre muaj burgim

**ETEM ARIFI****Partia:** Partia e Ashkalinjëve për Integrim**Pozitat shtetërore:** Deputet**Veprat penale:** 1. “*Mashtrim me subvencione*”; “*Ushtrim ndikimi*”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prishtinë**Faza procedurale:** Dënim – 1 vit e tre muaj burgim efektiv (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës, Etem Arifi ka shfrytëzuar pozitën e tij të deputetit për të ndikuar për dhënien e subvencioneve për OJQ-në “Zëri i Ashkalinjëve për Integrim”, duke siguruar në këtë mënyrë shumën prej 25.646.00 euro. Këto para, sipas prokurorisë, nuk janë përdorur për qëllime për të cilat janë dhënë, por janë përvetësuar nga Arifi dhe Gashi për persona të tjerë.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 20 prill 2018 e ka dënuar me dy vjet burgim me kusht, deputetin e Kuvendit të Kosovës nga radhët e Partisë së Ashkalinjëve për Integrim, Etem Arifi, pasi ai është shpallur fajtor për veprën penale të mashtrimit me subvencione, duke u dënuar me dy vite burgim me kusht, ndërsa ishte liruar për veprën penale të “ushtrimit të ndikimit”.⁴⁵⁵

Por pas ankesës së PSRK-së, në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë kishte ndryshuar vendimin e shkallës së parë, duke marrë vendim që Arifin, ta dënoi me një vit e tre muaj burgim efektiv. Arifi, po ashtu është detyruar që së bashku me të akuzuarin tjetër Bajram Gashi, të ia kthejnë mbi 25.646.00 euro buxhetit të shtetit. Ndërsa për veprën penale ushtrim ndikimi, Apeli çështjen e ka kthyer në rigjykim.⁴⁵⁶ Mirëpo, Gjykata Supreme e kishte anuluar aktgjykimin e Apelit dhe e kishte kthyer lëndën në rivendosje, pasi kishte konstatuar, se gjykatësja e njëjtë që

⁴⁵⁵ “Deputeti Etem Arifi, dënohet me dy vjet burgim me kusht për mashtrim me subvencione, lirohet nga akuza për ushtrim ndikimi (Video)”. Betimi për Drejtësi. 20 prill 2018 (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-etem-arifi-denohet-me-dy-vjet-burgim-me-kusht-per-mashtrim-me-subvencione-lirohet-nga-akuza-per-ushtrim-ndikimi/>) (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵⁶ “Apeli konfirmon dënimin prej 1 vit e 3 muaj burg për deputetin Etem Arifi”. Reporter. 18 maj 2019. (Shih linkun <https://reporteri.net/lajme/apeli-konfirmon-denimin-prej-1-vit-e-3-muaj-burg-per-deputetin-e-nisma-s/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

kishte vendosur për konfirmim të aktakuzës kishte vendosur edhe në lidhje me aktgjykimi. Pas, kësaj, Apelit më 20 gusht kishte shqyrtuar sërish ankesat në këtë lëndë.⁴⁵⁷

Dënimi me një vit e tre muaj burgim efektiv për mashtrim me subvencione ndaj Etem Arifit, deputet nga radhët e Partisë së Ashkalinjëve për Integrim (PAI), u konfirmua edhe nga Gjykata Supreme, duke e lënë në fuqi dënimin e shqiptuar nga Gjykata e Apelit.

I dënuari Arifi, më 2 mars 2020 kishte bërë kërkesë për shtyrje të ekzekutimit të dënimit, e cila kërkesë i është aprovuar nga ana e Gjykatës Themelore në Prishtinë.

Pas këtij vendimi, Arifi është paraqitur në qendrën e paraburgimit në Prishtinë për ta vuajtur dënimin në shtatorin e vitit 2020.⁴⁵⁸

⁴⁵⁷ “Pas kthimit në rivendosje nga Supremja, Apei sërish shqyrton ankesat në rastin e deputetit që ishte dënuar për mashtrim me subvencione”. Betimi për Drejtësi. 20 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/pas-kthimit-ne-rivendosje-nga-supremja-apeli-serish-shqyrton-ankesat-ne-rastin-e-deputetit-qe-ishte-denuar-per-mashtrim-me-subvencione/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁵⁸ “Deputeti Etem Arifi paraqitet në Qendrën e Paraburgimit për vuajtje të dënimit”. Betimi për Drejtësi. 29 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-etem-arifi-paraqitet-ne-qendren-e-paraburgimit-per-vuajtje-te-denimit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**ADEM HOXHA****Partia:** Partia e Bashkuar Gorane**Pozitat shtetërore:** Deputet**Veprat penale:** “Sulm”, “Kanosja”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren-Dega në Dragash**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 20 shkurt 2018, Hoxha akuzohej se kishte kryer veprën penale të sulmit dhe kanosjes. Kjo pasi që më 26 nëntor 2017, në selinë partiake të JPG në Dragash, ka përdorur forcën ndaj personit pa pëlqimin e tyre, ashtu që i ka sulmuar të dëmtuarit B.B dhe F.B, ku më pas edhe i ka kanosur me fjalë të ndryshme.

Procesi – Lidhur me këtë rast në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Dragash është duke vazhduar mbajtja e shqyrtimit gjyqësor, seanca e fundit është mbajtur është më 30 korrik 2019, ndërsa seanca e radhës është caktuar të mbahet më 20 gusht 2019.^{459 460}

⁴⁵⁹ “I dëmtuari arsyeton ngritjen e kallëzimit penal ndaj deputetit Adem Hoxha 10 ditë pas ndodhisë, thotë se policia nuk i ka marrë deklaratat e tyre në ditën kritike”. Betimi për Drejtësi, 30 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/i-demtuar-arsyeton-ngritjen-e-kallezimit-penal-ndaj-deputetit-adem-hoxha-10-dite-pas-ndodhise-thote-se-policia-nuk-i-ka-marre-deklaratat-e-tyre-ne-diten-kritike/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁶⁰ Shënim: Deputeti Hoxha, më 20 nëntor 2020, është liruar nga Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Dragash. “Deputeti Adem Hoxha lirohet nga akuzat për sulm dhe kanosje”. Betimi për Drejtësi, 20 nëntor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-adem-hoxha-lirohet-nga-akuzat-per-sulm-dhe-kanosje/>)

Refuzim

	DRAGAN DIMIQ Partia: LSDM Pozitat shtetërore: Deputet Vepra penale: “<i>Mashtrim me votime</i>” Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë, Dega në Vushtri Faza procedurale: Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)
---	--

Aktakuza - Sipas aktakuzës, Dragan Dimiq gjatë zgjedhjeve të vitit 2007, në qendrën e votimit në fshatin Grac të komunës së Vushtrisë, në mënyrë të rreme ka paraqitur veten si kryetarë i njësisë zgjedhore. Ai ishte paraqitur edhe si menaxher i njësisë zgjedhore në momentin kur i kishte dorëzuar materialet zgjedhore komisionit komunal në Vushtri. I njëjti, në mënyrë të rreme ka nënshkruar në emër të djalit të tij, Stojan Dimiq, edhe raportin nga qendra e votimit.

Gjatë mbajtjes së zgjedhjeve, i akuzuari kishte qenë në qendrën e votimit në fshatin Grac të Vushtrisë, ku nuk kishte të drejtë të ishte i pranishëm, pasi ishte në listë për deputet në Kuvendin e Kosovës. Duke e prezantuar veten si kryetar i këshillit të votimit, ai për vetvete dhe disa njerëz të tjerë kishte hedhur fletëvotimet në kuti. I njëjti gjithashtu, kishte votuar për persona që jetojnë në Serbi, për persona të vdekur dhe për personat që nuk kishin ardhur të votojnë në fshatin Grac të Vushtrisë.

Vendimi - Gjykata Themelore e Mitrovicës më 15 nëntor 2016, ka nxjerrë aktgjykim refuzues ndaj Dragan Dimiq, i akuzuar për “mashttrim në votime”, pasi që Prokurori i Shtetit Njazi Rexha ka hequr dorë nga ndjekja penale. Kjo për shkak se sipas prokurorit, vepra penale për të cilën akuzohej Dimiq kishte arritur parashkrimin absolut.⁴⁶¹

⁴⁶¹ “Kodi i ri penal është më i favorshëm, parashkruhet lënda ndaj të akuzuarit për mashttrim në votime” Betimi për Drejtësi. 15 nëntor 2016. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kodi-i-ri-penal-eshte-me-i-favorshem-parashkruhet-lenda-ndaj-te-akuzuarit-per-mashttrim-ne-votime/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1. 10
muaj burg
me kusht

2.
Lirim

3.
Hudhje



SREĆKO SPASIĆ

Partia: Lista Serbe

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës Klllokotit

Veprat penale: 1. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës” dhe “mosekzekutimi i vendimit gjyqësor” 2. “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Konflikt interesi”, 3. “Konflikt interesi”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 10 muaj burg me kusht për keqpërdorim të detyrës, ndërsa për veprat penale cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës dhe mosekzekutimi i vendimit gjyqësor është liruar nga akuza. 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 3. Hudhje e aktakuzës (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Gjilan, ka ngritur aktakuzë ndaj Srećko Spasić, pasi që ai duke qenë në pozitën e kryetarit të Komunës së Klllokotit, duke i shkaktuar dëm material tani të dëmtuarit Trajan Stojanovic, të cilin pa ndonjë arsyeje ligjore e ka larguar nga vendi i punës përkatësisht nga pozita e drejtorit të shkollës fillore “Marko Rajkovic” në fshatin Verbovac. Poashtu duke ke qenë në pozitën e njëjte e ka larguar nga puna edhe Bozhidar Dejanovic i cili kishte qenë drejtor në shkollën ekonomike teknike në fshatin Verbovc.

Srećko Spasić akuzohet edhe për mos ekzekutimin e aktvendimit të Gjykatës Themelore në Gjilan dega në Viti departamenti për çështje civile me të cilin është obliguar që të dëmtuarit Bozhidar Dejanovic dhe Trajan Stojanovic ti kthej në vendet e punës përkatësisht në pozitë sipas akt emërimit dhe t’ia kompensoj të ardhurat personale.

Procesi 1 – Gjykata Themelore në Gjilan më 26 tetor 2016 e kishte shpallur fajtorë Srećko Spasić, duke i shqiptuar dënim me kusht në kohëzgjatje prej 10 muajsh.⁴⁶² Ndërkaq për veprat penale “cenimi i të drejtave në marrëdhënien e punës” dhe “mosekzekutimi i vendimit

⁴⁶² “Kryetari i Klllokotit Srećko Spasić dënohet me 10 muaj burg me kusht për keqpërdorim të detyrës zyrtare” Betimi për Drejtësi. 26 tetor 2016. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-klllokotit-srecko-spasic-denohet-me-10-muaj-burg-me-kusht-per-keqpërdorim-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

gjyqësor “ është liruar nga akuza, të cilin vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit në prill të vitit 2017.

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së ngritur më 2 dhjetor të vitit 2015, Srećko Spasić duke vepruar si kryetar i Komunës së Klllokotit, më 6 janar 2014, kishte keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar, në atë mënyrë që nuk ka përfillur procedurat e përcaktuara me Ligjin mbi Vetëqeverisjen Lokale, duke emëruar Hasan Rushitin si zëvendëskryetar, i cili kishte marrë katër muaj pagë për këtë funksion, duke i kanë shkaktuar kështu dëm buxhetit komunal në vlerë prej 3200 euro.

Gjithashtu, ai akuzohej se më 10 shkurt 2014 duke keqpërdorur pozitën ka bërë ndërprerjen e marrëdhënies së punës së punëtorëve të arsimit në shkollën fillore “Marko Rajković”, në shkollën e mesme teknike në fshatin Verbovc, si dhe dy punëtorëve ndihmës në shkollën fillore “Sveti Sava”, në Klllokot, me ç’rast ka krijuar suficit për buxhetin e komunës në vlerë prej 36,000.00 euro dhe njëkohësisht u ka shkaktuar dëm disa personave. Srećko Spasić, akuzohej gjithashtu për keqpërdorimin e 31,000.00 eurove në dëm të buxhetit komunal të Klllokotit, me rastin e blerjes së kamionit për pastrimin e borës, i cili ishte blerë 29,000 euro, ndërsa për blerjen e këtij mjeti nga buxheti komunal është participuar me 20,000.00 euro dhe 40,000 nga IOM që rezulton të jenë keqpërdorur mjetet në vlerë 31.000 euro.

Procesi 2 – Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e 29 dhjetor 2017,⁴⁶³ e kishte liruar nga akuza të akuzuarin Spasić, vendim ky i cili ishte vërtetuar nga Gjykata e Apelit, më 2 gusht 2018.⁴⁶⁴

Aktakuza 3 - Sipas aktakuzës të ngritur më 21 tetor 2015 nga Prokuroria Themelore në Gjilan pretendohet se Srećko Spasić, në cilësinë e Kryetarit të Komunës së Klllokotit kishte kryer veprën penale “konflikt interesi”. Këtë thuhej se e kishte bërë duke shfrytëzuar autoritetin zyrtar dhe duke bërë tejkalimin e kompetencave të tij zyrtare në atë mënyrë që kishte nxjerrë vendim me të cilin kishte emëruar nipin e tij Aleksander Spasić, ushtrues detyre të Drejtorit të shkollës fillore “Sveti Sava” në Klllokot, edhe pse emërimi i drejtorëve të shkollave është në kompetencë të Drejtorisë Komunale të Arsimit të Komunës. Me këtë rast, thuhej se i ka shkelur të drejtat e personave të tjerë pretendent për ushtrues detyre të kësaj shkolle, edhe pse në këtë rast i pandehuri është dashur të përjashtohet nga kjo procedurë vendimmarrëse, sepse kjo procedurë ka pasur të bëjë me çështje në të cilën është emëruar ushtrues i detyrës së drejtorit nipi tij.

Procesi 3 – Gjykata Themelore në Gjilan, më 12 janar 2016, e kishte hudhur aktakuzën ndaj të akuzuarit Srećko Spasić⁴⁶⁵, e që Gjykata e Apelit, më 12 shkurt e kishte kthyer në rivendosje.

⁴⁶⁶ Por Gjykata Themelore në Gjilan, më 21 mars 2016, sërish e kishte hudhur aktakuzën.

⁴⁶³ Shënim: Vendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan 29 dhjetor 2017.

⁴⁶⁴ Shënim: Vendimi i Gjykatës së Apelit 2 gusht 2018.

⁴⁶⁵ Shënim: Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, 13 janar 2016

⁴⁶⁶ Shënim: Aktvendim i Gjykatës së Apelit 12 shkurt 2016.

1.
Lirim

2.
Lirim

3. Në
proces

4.
Lirim

5.
Lirim

6.
Refuzim

7.
Refuzim



SASHA MIRKOVIQ

Partia: Iniciativa qytetare Kllkot-Verbovac

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës Kllkotit, Nënkyetar i Komunës së Kllkotit.

Veprat penale: 1 dhe 4. “Mashttrim në detyrë”, 2, 3, 5, 6 dhe 7 “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”,

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 2 (Aktgjykim i formës së prerë), 3 (Në proces) 4; 5; Lirim (Aktgjykim i formës së prerë), 6; 7 Refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 – Sasha Mirković, më 26 tetor 2016 është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Gjilan me pretendimin se ai më 30 gusht 2010 si kryetar i Komunës së Kllkotit, me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete, apo personin tjetër, ka kryer mashttrim në detyrë. Prokuroria Themelore në Gjilan, pretendonte se ai pa shpalljen e tenderit për sigurimin e projektit kryesor për asfaltimin e rrugës Verboc-Mogillë-Ura e Dilit dhe pa pasur kontratë të nënshkruar me firmën “Roni-Ing” në Viti, me pronar Florim Ramaj, ka urdhëruar shërbimin e pagesave të komunës që të paguaj për “Zuka Commerce”, duke i shkaktuar dëm komunës së Kllkotit në shumën prej 22,781.11 euro.

Procesi 1 - Mirković, në seancën fillestare të mbajtur më 11 prill 2017 ishte deklaruar i pafajshëm, ndërsa Gjykata Themelore në Gjilan, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor më 26 prill 2018, në mungesë të provave kishte shpallur Mirkovićin të pafajshëm.⁴⁶⁷ Vendimin e Themelores më pas e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.⁴⁶⁸

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës, së ngritur më 20 dhjetor 2016, Sasha Mirković në cilësi të kryetarit të Komunës së Kllkotit dhe Zharko Dejanović, në cilësi të kryetarit të Kuvendit Komunal, akuzohen se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete

⁴⁶⁷ “Ish-kryetari i Kllkotit lirohet nga akuza për mashttrim në detyrë (Video)”. Betimi për Drejtësi. 26 prill 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-kllkotit-lirohet-nga-akuza-per-mashttrim-ne-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁶⁸ “Asnjë aktgjykim dënues i plotfuqishëm ndaj profilit të lartë më 2018, mbi 20% të lëndëve të korrupsionit u kthyen në rigjykim”. Betimi për Drejtësi. 2 janar 2019. (shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/asnje-aktgjykim-denues-i-plotfuqishem-ndaj-profilit-te-larte-me-2018-mbi-20-te-lendeve-te-korrupsionit-u-kthyen-ne-rigjykim/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

dhe Dardan Novosellën, kanë tejkaluar kompetencat e tyre. Në aktin akuzues, thuhet se 22 shkurt 2012, pa i përfillur procedurat ligjore, kanë nxjerrë vendimin dhe kanë dhënë në shfrytëzim më qira një ngastër kadastrale për periudhë 10 vjeçare, konkretisht Qendrës për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim, “Nëna Naile”, me pronar Dardan Novosella, në shumën prej 550 euro për muaj.

Procesi 2 – Lidhur me këtë aktakuzë, Gjykata Themelore në Gjilan, më 19 nëntor 2018, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare Mirkoviqin dhe Dejanoviqin.⁴⁶⁹ Por pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit këtë rast e ka kthyer në rigjykim mirëpo edhe pas procesit të rigjykimit, shkalla e parë, më 23 korrik 2019, ka konsideruar se në mungesë të provave të akuzuarit duhet të lirohen nga akuza për korrupsion.⁴⁷⁰

Vendimin e shkallës së parë, më 8 nëntor 2019, e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.⁴⁷¹

Aktakuza 3 - Mirkoviq, ka dalë i pafajshëm edhe një akuzë tjetër për korrupsion me të cilën e ka ngarkuar Prokuroria Themelore në Gjilan. Me aktakuzën e 22 dhjetorit 2015, Mirkoviq dhe tre zyrtarë të kësaj komune akuzohen se kanë keqpërdorur pozitën e tyre zyrtare pasi në dhjetorin e vitit 2012, kanë pranuar një kontratë me të cilën kompania “Metali”, ka pasur obligim të sjellë në komunë inventar në vlerë prej 29,330.00 euro, por që i njëjti nuk kishte arritur asnjëherë në komunë..

Procesi 3 - Gjykata Themelore në Gjilan, pas përfundimit të gjykimit, më 15 prill 2019 kishte shpallur aktgjykimin me të cilin ish-kryetari i Klllokotit Sasha Mirkoviq, tre zyrtarët e kësaj komune dhe pronari i kompanisë “Metali”, në mungesë të provave u shpallën të pafajshëm.⁴⁷²

Mirëpo pas ankesës së prokurorisë në Gjykatën e Apelit, kjo gjykatë këtë lëndë e ka kthyer në rigjykim⁴⁷³, i cili proces është duke vazhduar.⁴⁷⁴

Aktakuza 4 - Më 10 mars 2017, Sasha Mirkoviq është akuzuar me një aktakuzë tjetër me të cilën Prokuroria Themelore në Gjilan, pretendon se ai në cilësi të kryetarit të komunës së Klllokotit ka keqpërdorur me derivatet e naftës që është dashur të shfrytëzohen për nevoja të komunës. Sipas aktakuzës, ai ka nënshkruar faturat të furnizimit me derivate të naftës për

⁴⁶⁹ “Ish-kryetari i Klllokotit dhe ish-kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për korrupsion (Video)” Betimi për Drejtësi. 19 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-ish-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁷⁰ “Pas rigjykimit, ish-kryetari i Klllokotit dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-keqperdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁷¹ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020.

⁴⁷² “Ish-kryetari i Klllokotit dhe të tjerët lirohen nga akuza për kontratën me kompaninë “Metali” (Video)” Betimi për Drejtësi. 15 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-te-tjeret-lirohen-nga-akuza-per-kontraten-me-kompanine-metali/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁷³ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020.

⁴⁷⁴ Shënim: Pas procesit të rigjykimit, Gjykata Themelore në Gjilan, më 1 dhjetor 2020, kishte marrë vendim me të cilin Mirkoviqin e kishte shpallur fajtor dhe e kishte dënuar me 180 ditë burgim. “Ish-kryetari i Klllokotit dhe të tjerët, shpallen fajtorë për keqpërdorim të detyrës zyrtare”. Betimi për Drejtësi. 1 dhjetor 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-te-tjeret-shpallen-fajto-re-per-keqperdorim-te-detyres-zyrtare/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020)

Komunën e Klllokotit dhe kompaninë “Euro Tafa” pa qenë faturat e kompletuara, me çka i ka shkaktuar dëm komunës prej 20,940.86 euro, paso sipas prokurorisë ato derivate janë keqpërdorur nga zyrtarët e komunës edhe për nevoja private.

Procesi 4 - Mirkoviq, edhe lidhur me këtë aktakuzë kishte dalë nga procesi gjyqësor si i pafajshëm, pasi Gjykata Themelore në Gjilan, më 28 maj 2018, në mungesë të provave ishte liruar nga kjo aktakuzë.⁴⁷⁵

Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.⁴⁷⁶

Aktakuza 5 - Prokurorisë Themelore në Gjilan, me aktakuzën e 12 dhjetorit 2016, Sasha Mirkoviq, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Klllokotit, dhe Marko Svilanoviq, në cilësinë e nënkryetarit të Komunës së Klllokotit, nga dhjetori i vitit 2010 e deri në marsin e vitit 2012, në bashkëveprim kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke blerë mallra, derivate të naftës dhe shërbime të servisimit të veturave në mënyrë të kundërligjshme. Me këto veprime të akuzuarve prokuroria pretendon se i kanë shkaktuar dëm komunës së Klllokotit 6.890.04 euro.

Procesi 5 - Gjykata Themelore në Gjilan, më 27 mars 2019 edhe për këtë aktakuzë kishte marrë vendim me të cilin ish-kryetari Mirkoviq, ishte shpallur i pafajshëm. Gjykata, me vendimin e saj kishte konsideruar se prokuroria nuk kishte ofruar prova për të vërtetuar se Mirkoviq dhe Svillanoviq, kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare.⁴⁷⁷

Edhe këtë vendim me të cilin Mirkoviq, është liruar nga akuzat për korrupsion e ka konfirmuar Gjykata e Apelit.⁴⁷⁸

Aktakuza 6 - Sipas aktakuzës së 23 nëntorit 2016, Sasha Mirkoviq, në cilësi të kryetarit të Komunës së Klllokotit dhe Dejana Stojanoviq, Sasha Totiq e Daniejl Stojkoviç, anëtarë të komisionit për pranimin e mallrave, akuzoheshin se më 20 nëntor 2011, në cilësi të personave zyrtarë, kanë keqpërdorur detyrën zyrtare. Sipas aktakuzës, rasti ka ndodhur në atë mënyrë që i akuzuari i parë Sasha Mirkoviq, ka lejuar ndërsa të pandehurit e tjerë kanë nënshkruar raportin se kinse kanë pranuar mallra – pajisje sportive për aktivitete sportive në Komunën e Klllokotit, me ç’rast me aprovimin e kryetarit Sasha Mirkoviq, kompanisë NTSH “Sporti” në Viti i ishte bërë pagesa në shumën prej 4898 euro, duke i shkaktuar dëm buxhetit të kësaj komune.

Procesi 6 - Edhe pse Prokuroria Themelore në Gjilan kishte pretenduar se ish-kryetari i komunës së Klllokotit Sasha Mirkoviq dhe pesë zyrtarëve të kësaj komune kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, kjo prokurori por në seancën e 31 gushtit kur ishte paraparë që të mbahej fjala përfundimtare, kjo prokurori me anë të një shkrese dërguar ishte tërhequr nga ndjekja penale ndaj të gjithë të akuzuarve me arsyetimin se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ishte provuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë ngarkuar. Në këtë mënyrë Gjykata

⁴⁷⁵ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës Themelore në Gjilan Sabit Shkodra për IKD. 30.05.2019

⁴⁷⁶ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020.

⁴⁷⁷ “Ish-kryetari i Klllokotit dhe ish-zëvendësi i tij lirohen nga akuzat për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 27 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-ish-zevendesi-i-tij-lirohen-nga-akuzat-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁷⁸ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020

Themelore në Gjilan, atë ditë mori aktgjykim refuzues, duke e liruar edhe nga një akuzë ish-kryetarin Mirkoviq.⁴⁷⁹

Aktakuza 7 - Prokuroria Themelore në Gjilan, me aktakuzën e ngritur më 29 dhjetor të vitit 2016, kishte akuzuar ish-kryetarin e Klllokotit Sasha Mirkoviq dhe ish-nënkryetarin e kësaj komune Marko Svilanoviq, me pretendimin se kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare në lidhje me faturat e artikujve shpenzues të komunës së Klllokotit, duke i shkaktuar dëm kësaj komune rreth 9 mijë euro.

Procesi 7 - Edhe për këtë aktakuzë, si në atë paraprake, ish-kryetari Mirkoviq nuk e patë të nevojshme të pret një vendim të gjykatës pasi ishte organi i akuzues ai që edhe në një rast tjetër vendosi që në përfundim të gjykimit të tërhiqet nga ndjeka penale. Në këtë rast ndodhi një praktikë e rrallë pasi prokuroria vendosi që të tërhiqej pasi vetëm atëherë e kuptoi se për këto dyshime për keqpërdorime ishte zhvilluar një proces gjyqësor ndaj një zyrtari të Komunës së Klllokotit i cili edhe ishte liruar me vendim përfundimtar. Në këtë mënyrë Gjykata Themelore në Gjilan më 20 prill 2018, mori edhe një tjetër aktgjykim refuzues ndaj Mirkoviqit.⁴⁸⁰

⁴⁷⁹ “Aktgjykim refuzues ndaj ish-kryetarit të Klllokotit dhe pesë zyrtarëve të tjerë që akuzoheshin për korrupsion (Video)”. Betimi për Drejtësi. 31 gusht 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktgjykim-refuzues-ndaj-ish-kryetarit-te-klllokotit-dhe-pese-zyrtareve-te-tjere-qe-akuzoheshin-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁸⁰ “Prokuroria tërhiqet nga aktakuza pasi kupton që për të njëjtën çështje tash ka një vendim të formës së prerë”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pasi-kupton-qe-per-te-njejten-ceshtje-tash-ka-nje-vendim-te-formes-se-prere/>).

1. 4500
euro gjobë

2. 3000
euro
gjobë



SVETISLLAV IVANOVIQ

Partia: Lista Serbe

Pozita shtetërore: Kryetar i Komunës së Novobërdës

Veprat penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”, “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë

Faza procedurale: 1. Dënim 4.500 euro gjobë (Aktgjykim formës së prerë) 2. Dënim 3000 euro gjobë (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza 1 – Sipas prokurorisë Themelore në Gjilan, Svetislav Ivanović, në cilësinë e kryetarit të Komunës së Novobërdës, në bashkëpunim me shefin e personelit Sylejman Avdyli, e kanë punësuar Vesna Ivanovicin në pozitë të përkohshme të menaxheres për kulturë në Sektorin e Arsimit dhe Kulturës në Komunën e Novobërdës. Një punësim i tillë ishte bërë pa konkurs, me ç’ rast buxheti i Republikës së Kosovës është dëmtuar për shumën prej 5,757,25 euro për vitin 2014, dhe 7,349,46 euro për vitin 2015.

Procesi 1 – Gjykata Themelore në Gjilan, më 17 mars 2017, kishte dënuar me 4,500 euro gjobë kryetarin e Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanović. Kjo pasi që i njëjti kishte arritur marrëveshje për pranimin e fajësisë me prokurorinë.⁴⁸¹

Aktakuza 2 – Prokuroria Themelore në Gjilan më 2 dhjetor 2018, kishte ngritur aktakuzë ndaj Svetislav Ivanović, të cilin e ngarkonte me veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtare. Sipas kësaj aktakuze, pretendohet se më 15 nëntor 2017, në Novobërdë, i pandehuri me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm pasuror për personin tjetër juridik – Shoqatën e Gjuetarëve “Kalaja” ka tejkaluar kompetencat e tij zyrtare dhe ka shkelur të drejtat e personit tjetër juridik – Shoqatës së Gjuetarëve “Ujku”, në atë mënyrë që Shoqatës së Gjuetarëve “Kalaja”, i ka dhënë në shfrytëzim dhe menaxhim tërë territorin e komunës së Novobërdës dhe një zyre në objekt të kësaj komune.

⁴⁸¹ “Dënohet me gjobë kryetari i Komunës së Novobërdës, Svetislav Ivanović” Betimi për Drejtësi. 17 mars 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-gjobe-kryetari-i-komunes-se-novoberdes-svetislava-ivanovic/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Procesi 2 - Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 19 shkurt 2020, Gjykata Themelore e Gjilanit ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Ivanoviq, duke i shqiptuar gjobë në shumë prej 3000 euro.⁴⁸², ky rast akoma nuk e ka marrë vendimin e formës së prerë

⁴⁸²“ Kryetari i Novobërdës dënohet me tremijë euro gjobë për keqpërdorim pozite”. Betimi për Drejtësi. 19 shkurt 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/kryetari-i-novoberdes-denohet-me-tremije-euro-gjobe-per-keqperdorim-pozite/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**BOZHIDAR DEJANOVIQ****Partia:** Iniciativa qytetare**Pozita shtetërore:** Kryetar Komune - Kllkot**Vepra penale:** “Shkelja e statusit të barabartë e shtetasve dhe banorëve të Republikës së Kosovës”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjilan**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza: Sipas aktakuzës, i pandehuri Dejanović, së bashku me Goran Marinković, nga data 01 shkurt deri më 15 mars 2018 dhe në maj të vitit 2018, në komunën e Kllkotit, me dashje, për shkak të bindjeve politike u kanë mohuar të dëmtuarve të drejtat e përcaktuara me Kushtetutë dhe ligjin e punës, ashtu që për shkak se të dëmtuarit nuk kanë pasur bindje të njëjta politike me të pandehurit, sapo i pandehuri Dejanović merr postin e kryetarit të komunës së Kllkotit, emëron të pandehurin tjetër Marinković drejtor të arsimit, me ç ‘rast në bashkëveprim ushtrojnë presion tek të dëmtuarit që të japin dorëheqje. Në këtë mënyrë të njëjtit, pa respektuar procedurat e parapara me kontratën kolektive dhe ligjin e punës, në mënyrë selektive u kanë ndërprerë 40 punëtorëve arsimor dhe dhjetë (10) punëtorëve shëndetësor marrëdhënien e punës, në komunën e Kllkotit, kinse për shkak të kontratave të kundërligjshme, mospërmbushjes së detyrave, shkurtimit buxhetor etj, pa asnjë procedurë disiplinore dhe pa paralajmërim, përkundër asaj që të njëjtit kishin kontrata valide. Në aktakuzë thuhet se të njëjtit pa eliminuar shkeljet, më 14 mars 2018, kanë shpallur konkurs, duke pranuar punëtorë sipas bindjeve të tyre politike, duke iu shkelur, mohuar dhe kufizuar të dëmtuarve të drejtat e parapara me ligjin e punës.⁴⁸³

Procesi – Procesi ndaj Dejanovićit do të gjykohet nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, mirëpo i njëjti akoma nuk ka filluar.

⁴⁸³ “Aktakuzë ndaj dy zyrtarëve të komunës së Kllkotit”. Koha.net. 30 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/kronike/201497/aktakuze-ndaj-dy-zyrtareve-te-komunes-se-kllkotit/?fbclid=IëAR2z2KËtPSLUn48VFes-0kv3XsXiVEa254-OoNX-4utObz7Ze6CB6ËtRFB8>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

6 muaj burg
me kusht dhe
3000 mijë
euro gjobë



QAZIM RRAHMANI

Partia: Partia e Ashkalive për Integrim

Pozitat shtetërore: Zëvendësministër i Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, Zëvendësministër i Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Deputet

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: 6 muaj burg me kusht dhe 3 mijë euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza – Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, i pandehuri Rrahmani akuzohet se ka keqpërdorur kartelën zyrtare bankare, gjatë kohës sa ka qenë zëvendësministër i MPMS-së, duke dëmtuar këtë ministri me rreth 12 mijë euro.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 1 tetor 2018, kishte marrë aktgjykim me të cilin e kishte shpallur fajtor zëvendësministrin e Ministrisë për Kthim dhe Komunitete, Qazim Rrahmani. Ai ishte dënuar me 6 muaj burg me kusht, por me pajtimin e tij, ky dënim i është zëvendësuar me dënim me gjobë prej tre mijë eurosh, të cilin ai mund ta paguaj me këste, i cili vendim është bërë i formës së prerë.⁴⁸⁴

⁴⁸⁴ “Ish-zëvendësministri dënohet më tre mijë euro për korrupsion, ndërsa rreth pesë mijë euro obligohet t’ia kthejë MPMS-së (Video)”. Betimi për Drejtësi. 1 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-zevendesministri-denohet-me-tre-mije-euro-per-korrupsion-ndersa-rreth-pese-mije-euro-obligohet-tia-ktheje-mpms-se/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**NUMAN BALIQ****Partia:** VAKAT**Pozitat shtetërore:** Ministër i Shëndetësisë
Zëvendësministër/Zëvendësministër i Administratës
Publike/Deputet**Vepra penale:** “Ngacmim”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Pejë**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Ish-ministri i Shëndetësisë Numan Baliq është akuzuar nga Prokuroria Themelore në Pejë, më 31 janar 2019, për veprën penale “ngacmimi”. Sipas aktakuzës Baliq nga muaji gusht i vitit 2018 ishte përfshirë në vëmendje të vazhdueshme dhe të padëshirueshme me qëllim të ngacmimit dhe të frikësimit të dëmtuarës S.M. Prokuroria pretendon se, kur e dëmtuara S.M kishte filluar kryerjen e praktikës në Spitalin Regjional në Pejë, edhe pse e njëjta e kishte refuzuar në vazhdimësi, i pandehuri i shkruante në numrin e saj në “Viber” me përmbajtje ngacmuese.

Procesi – Me një procedurë të shpejtë, më 25 korrik 2019, Gjykata Themelore në Pejë, në mungesë të provave e kishte liruar nga akuza për ngacmim ish-ministrin e Shëndetësisë dhe ish-zëvendësministër i Administratës Publike në Qeverinë Haradinaj, Numan Baliq.⁴⁸⁵

Ky rast akoma nuk ka marrë epilog nga ana e Gjykatës së Apelit.⁴⁸⁶

⁴⁸⁵ “Ish-ministri i Shëndetësisë lirohet nga akuza për ngacmim” Betimi për Drejtësi. 25 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-ministri-i-shendetesise-lirohet-nga-akuza-per-ngacmim/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁸⁶ Shënim: Këtë vendim e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit. “Apeli vërteton aktgjykimin lirues ndaj ish-ministrit të Shëndetësisë, Numan Baliq”. Betimi për Drejtësi. 25 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-aktgjykimin-lirues-ndaj-ish-ministrit-te-shendetesise-numan-baliq/>)

Lirim

	ZHARKO DEJANOVIQ Partia: Iniciativa qytetare Klllokot Verbovac Pozita shtetërore: Kryetar i Kuvendit Komunal në Klllokot Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)
---	---

Aktakuza – Sipas aktakuzës së ngritur më 20 dhjetor 2016, Sasha Mirkoviq në cilësi të kryetarit të Komunës së Klllokotit dhe Zharko Dejanoviq, në cilësi të kryetarit të Kuvendit Komunal, akuzohen se me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për vete dhe Dardan Novosellën, kanë tejkaluar kompetencat e tyre. Në aktin akuzues, thuhet se më 22 shkurt 2012, pa i përfillur procedurat ligjore, kanë nxjerrë vendimin dhe kanë dhënë në shfrytëzim më qira një ngastër kadastrale për periudhë 10 vjeçare, konkretisht Qendrës për Mjekësi Fizikale dhe Rehabilitim, “Nëna Naile”, me pronar Dardan Novosella, në shumën prej 550 euro për muaj.

Procesi – Lidhur me këtë aktakuzë, Gjykata Themelore në Gjilan, më 19 nëntor 2018, në mungesë të provave i kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të detyrës zyrtare Mirkoviqin dhe Dejanoviqin.⁴⁸⁷ Por pas ankesës së prokurorisë, Gjykata e Apelit këtë rast e ka kthyer në rigjykim mirëpo edhe pas procesit të rigjykimit, shkalla e parë, më 23 korrik 2019, ka konsideruar se në mungesë të provave të akuzuarit duhet të lirohen nga akuza për korrupsion.⁴⁸⁸

Vendimin e shkallës së parë, më 8 nëntor 2019, e ka vërtetuar edhe Gjykata e Apelit.⁴⁸⁹

⁴⁸⁷ “Ish-kryetari i Klllokotit dhe ish-kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për korrupsion (Video)” Betimi për Drejtësi. 19 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-ish-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁸⁸ “Pas rigjykimit, ish-kryetari i Klllokotit dhe kryesuesi i Kuvendit Komunal lirohen nga akuza për keqpërdorim detyrë”. Betimi për Drejtësi. 23 korrik 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/pas-rigjykimit-ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-kryesuesi-i-kuvendit-komunal-lirohen-nga-akuza-per-keqpërdorim-detyre/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁸⁹ Përgjigja e zëdhënësit të Gjykatës së Apelit. 02.06.2020

1.
Lirim2.
Lirim3.
Refuzim**MARKO SVILANOVIQ****Partia:** Samostalna Liberalna Stranka**Pozitat shtetërore:** Nënkyetar i Komunës së Klllokotit**Vepra penale:** 1, 2 dhe 3 “Keqpërdorim i pozitës zyrtare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjilan**Faza procedurale:** 1. 2. Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë) 3. Refuzim (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, i pandehuri Marko Svilanoviq akuzohet se në cilësinë nënkryetarit të Komunës së Klllokotit ka keqpërdorur detyrën, ashtu që me qëllim që vetes apo tjetrit t’i sjell dobi të kundërligjshme pasurore, me rastin e furnizimit me mallra për nevojat e komunës në fjalë, ka plotësuar dokumente fiktive në vlerë të përgjithshme prej 6,042,5 euro për dy kompani private NTP “Arti G” dhe NTP “Ermali”, nga Vitia.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjilan më 11 prill 2018, e kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, pasi që sipas gjykatës pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe dëgjimit të dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale me të cilën e ngarkonte Prokuroria Themelore në Gjilan.⁴⁹⁰ Me 20 prill 2018, ky aktgjykim i formës së prerë.⁴⁹¹

Aktakuza 2 - Mirkoviq si i akuzuar në cilësi të nënkryetarit të Komunës së Klllokotit, ka qenë pjesë edhe të aktakuzës së ngritur më 12 dhjetor 2016, së bashku me ish-kryetarin Sasha Mirkoviq. Me këtë aktakuzë pretendohet se ata nga dhjetori i vitit 2010 e deri në marsin e vitit 2012, në bashkëveprim kanë keqpërdorur detyrën e tyre zyrtare, duke blerë mallra, derivate të naftës dhe shërbime të servisimit të veturave në mënyrë të kundërligjshme. Me këto veprime të akuzuarve prokuroria pretendon se i kanë shkaktuar dëm komunës së Klllokotit 6.890.04 euro.

⁴⁹⁰ “Lirohen nga akuza për korrupsion ish-nënkryetari dhe ish-drejtori në Komunën e Klllokotit”. Betimi për Drejtësi. 11 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuza-per-korrupsion-ish-nenkryetari-dhe-ish-drejtori-ne-komunen-e-klllokotit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁹¹ Shënim: Përgjigja e zëdhënësit të gjykatës, Sabit Shkodra. 14 gusht 2019.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Gjilan, më 27 mars 2019 edhe për këtë aktakuzë kishte marrë vendim me të cilin ish-kryetari Mirković, ishte shpallur i pafajshëm. Gjykata, me vendimin e saj kishte konsideruar se prokuroria nuk kishte ofruar prova për të vërtetuar se Mirković dhe Svillanović, kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare.⁴⁹²

Aktakuza 3 - Svillanović, për pozitën e nënkryetarit akuzohej për korrupsion edhe në aktakuzën tjetër të Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ngritur më 29 dhjetor të vitit 2016 me pretendimin se ata kanë keqpërdorur detyrat e tyre zyrtare në lidhje me faturat e artikujve shpenzues të komunës së Klllokotit, duke i shkaktuar dëm kësaj komune rreth 9 mijë euro.

Procesi 3 - Edhe për këtë aktakuzë, si në atë paraprake, ish-kryetari Mirković nuk e patë të nevojshme të pret një vendim të gjykatës pasi ishte organi i akuzues ai që edhe në një rast tjetër vendosi që në përfundim të gjykimit të tërhiqet nga ndjeka penale. Në këtë rast ndodhi një praktikë e rrallë pasi prokuroria vendosi që të tërhiqej pasi vetëm atëherë e kuptoi se për këto dyshime për keqpërdorime ishte zhvilluar një proces gjyqësor ndaj një zyrtari të Komunës së Klllokotit i cili edhe ishte liruar me vendim përfundimtar.⁴⁹³

⁴⁹² “Ish-kryetari i Klllokotit dhe ish-zëvendësi i tij lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 27 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-klllokotit-dhe-ish-zevendesi-i-tij-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁹³ “Prokuroria tërhiqet nga aktakuza pasi kupton që për të njëjtën çështje tash ka një vendim të formës së prerë”. Betimi për Drejtësi. 21 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-terhiqet-nga-aktakuza-pasi-kupton-qe-per-te-njejten-ceshtje-tash-ka-nje-vendim-te-formes-se-prere/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**VESNA JOVANOVIQ****Partia:** Iniciativa për Partesh**Pozita shtetërore:** Drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Parteshit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjiilan**Faza procedurale:** Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)


Aktakuza -Prokuroria Themelore në Gjiilan, në dhjetor të vitit 2015, ka ngritur aktakuzë ndaj Vesna Jovanović, drejtoreshë e Arsimit në Komunën e Parteshit, pasi që sipas aktakuzës, Jovanović, me dashje ka shkelur ligjin si dhe ka penguar tjetrin në gëzimin e të drejtës në pagë të plotë.⁴⁹⁴

Procesi – Gjykata Themelore në Gjiilan, më 09 tetor 2017, të akuzuarën Vesna Jovanović, e kishte liruar nga akuza për veprën penale “keqpërdorimi i pozitës apo i autorizimit zyrtar”, me arsyetim se me provat e procedura në shqyrtimin gjyqësor nuk është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarës përmbushen elementet e kësaj vepre penale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë në Apel kishte paraqitur Prokuroria Themelore në Gjiilan, me pretendimet për shkelje ligjore por këto pretendime, Gjykata e Apelit i ka vlerësuar si të pabazuara, duke e vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë dhe duke e liruar përfundimisht nga akuza Jovanović.⁴⁹⁵

⁴⁹⁴ Shënim: Ashtu që pas nënshkrimit të kontratave me arsimtarët e shkollave fillore dhe të mesme në Komunën e Parteshit, për vitin 2014\2015, e akuzuara i kishte urdhëruar të dëmtuarit Blagoje Stojković, Bozhidar Simiq, Predarag Simiq, Aleksandra Stajoneviq, Srebra Maksimović, Goran Keriq, Aleksandra Maksimović, Zoran Simiq, Slobodan Simiq dhe Dragan Simiq, që të veprojnë në dëm të pasurisë së tyre, ashtu që për çdo pagë mujore të pranuar nga buxheti i Republikës së Kosovës, të njëjtë ishin detyruar ta ndajnë me nga dy persona tjerë sipas rekomandimit të saj. Këta persona nuk kanë qenë të angazhuar në punë si mësimdhënës, e as që kanë nënshkruar ndonjë kontratë pune me Drejtorinë për Arsim. Mirëpo, të njëjtëve ua kishte dhënë nga 100 euro në muaj, duke iu shkaktuar të dëmtuarve dëm material me vlerë të përgjithshme prej 18,488.00 euro

⁴⁹⁵ “Apeli vërteton pafajësinë e drejtoreshës së Arsimit në Komunën e Parteshit”. Betimi për Drejtësi. 15 janar 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-e-drejtoreshes-se-arsimit-ne-komunen-e-parteshit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces**ERTAN SIMITQI****Partia:** Kosova Demokratik Turk Partisi**Pozita shtetërore:** Drejtor për Ekonomi dhe Financa në Komunën e Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Me datë 31.07.2019 Prokuroria Themelore në Prizren, Departamenti i Krimeve të Rënda, ka ngritur aktakuzë kundër E. S., në cilësinë e Drejtorit në Drejtorinë për Ekonomi dhe Financa, në Komunën e Prizrenit, për veprën penale “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Ai akuzohet se në periudhën janar - dhjetor të vitit 2016 në Prizren, në cilësinë e Drejtorit për Drejtorinë në Ekonomi dhe Financa, ka shfrytëzuar autoritetin zyrtar duke u dhënë disa medieve lokale në këtë qytet para në vlerë prej 11 mijë e 800 euro, pa kaluar fare në procedura të tenderimit, të cilat janë të parapara me ligj.

Procesi – Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur më 21 tetor 2019, i akuzuari Simitqi ka kërkuar që të hudhet aktakuza ndaj tij. Ndërsa, pas seancës së mbajtur më 28 shkurt 2020, shqyrtimi i radhës ishte caktuar më 2 mars 2020.⁴⁹⁶

⁴⁹⁶ Përfaqësuesit e televizioneve lokale tregojnë për kontratat e tyre me Komunën e Prizrenit. Betimi për Drejtësi. 28 shkurt 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/perfaqesuesit-e-televizioneve-lokale-tregojne-per-kontratat-e-tyre-me-komunen-e-prizrenit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim

**BEAN HAXHIHASANI****Partia:** Koalicioni Vakat**Pozita shtetërore:** Drejtor për Urbanizëm dhe Kadastër – Komuna e Dragashit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Aktgjykim lirues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Bean Haxhihasani, akuzohet se në cilësinë e drejtorit të urbanizmit në Komunën e Dragashit, ka lëshuar vendim me të cilin i është lejuar Nexhat Selajt, që të ndërtojë objektin afarist në pronë komunale.

Procesi – Gjykata Themelore në Prizren, më 21 janar 2017, e kishte liruar Bean Haxhihasanin nga akuzat për keqpërdorim të pozitës zyrtare pasi që sipas gjykatës, nuk ishte arritur të provohet se të njëjtit kishin kryer veprat për të cilat akuzoheshin.⁴⁹⁷

⁴⁹⁷ Dënohet me kusht Kryetari i Komunës së Dragashit, Salim Jenuzi”. Betimi për Drejtësi. 21 nëntor 2017. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/denohet-me-kusht-kryetari-i-komunes-se-dragashit-salim-jenuzi/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



HALIT GASHI

Partia: LDD

Pozita shtetërore: Drejtor në Komunën e Lipjanit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë, më 13 shkurt 2017, kishte ngritur aktakuzë ndaj drejtorit të Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Lipjan, Halit Gashi, me pretendimin se, në cilësinë e drejtorit komunal në kundërshtim me dispozitat ligjore kanë nxjerrë urdhëresë për regjistrimin dhe bartjen e pronës në mënyrë të kundërligjshme, në emër të “Neë Co Ferronikel Complex L.LC”. Ai akuzohet se në cilësinë e personit zyrtarë, kishte dhe në bashkëkryerje me persona të tjerë kishin kryer veprën penale të keqpërdorimit të pozitës zyrtar apo autoritetit zyrtar.

Procesi - Gjykata Themelore në Prishtinë, më 5 nëntor 2018, e kishte shpallur fajtorë, për veprën penale, keqpërdorim i detyrës zyrtare, duke i shqiptuar një dënim në kohëzgjatje prej 6 muajsh burg efektiv, dënim i cili me pëlqimin e tij i është zëvendësuar me gjobë në lartësi prej 3.500 euro.⁴⁹⁸ Mirëpo, pas ankesave të palëve, Gjykata e Apelit, në qershor 2019, e kishte anuluar aktgjykimin Themelores dhe lëndën e kishte kthyer në rigjykim.⁴⁹⁹ Ndryshe, ky rast kishte qenë i shënjestruar, si kusht për liberalizimin e vizave.⁵⁰⁰

⁴⁹⁸ “Ish-kryetari i Lipjanit, Shukri Buja dënohet me tre vjet burgim për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 5 nëntor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-kryetari-i-lipjanit-shukri-buja-denohet-me-tre-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁴⁹⁹ Apeli e kthen në rigjykim rastin e Shukri Bujës, i dënuar me tre vjet burg për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 26 gusht 2019. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-e-kthen-ne-rigjykim-rastin-e-shukri-bujes-i-denuar-me-tre-vjet-burg-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵⁰⁰ Shënim: Pas procesit së rigjykimit, Gashi përseri është dënuar nga gjykata e shkallës së pare me gjashtë (6) muaj burgim. “Shukri Bujës i ulet dënimi, dënohet me dy vjet burgim për korrupsion (VIDEO)”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/shukri-bujes-i-ulet-denimi-denohet-me-dy-vjet-burgim-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 08.12.2020).

500
euro
gjobë**MILAN ARITONVIÇ****Partia:** Iniciativa Qytetare të Komunës së Ranillugut**Pozita shtetërore:** Këshilltar në Asamblenë Komunale në Ranillugë**Vepra penale:** “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë**Faza procedurale:** Dënim 500 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur, më 21 shtator 2018, ka ngritur aktakuzë ndaj tashmë të akuzuarit Milan Aritonoviç, me arsyetimin se ai nga 1 marsi 2018 deri më 31 mars 2018, në cilësinë e Këshilltarit Komunal në Kuvendin Komunal në Ranillug, edhe pse ka qenë i detyruar ta bëjë deklarin e pasurisë nuk e ka përmbushur obligimin e tij, si zyrtar publik konform ligjit të dhënat e kërkuara ti dërgoj në Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Procesi- 25 prill 2019, Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, e kishte shpallur fajtorë të akuzuarin Aritovic, dhe ndaj tij kishte shqiptuar dënimin në kohëzgjatje prej 30 ditësh, dënim ky i cili i është zëvendësuar me gjobë në shumë prej 500 euro. Paraprakisht, i akuzuari më 16 prill 2019, kishin arritur marrëveshje me Prokurorinë Themelore në Gjilan për pranimin e fajësisë, të cilën marrëveshje, te kishte aprovuar gjykatësi i çështjes.⁵⁰¹

⁵⁰¹ “Asamblisti në Komunën e Ranillugut dënohet me 500 euro gjobë për mos deklarin të pasurisë”. Betimi për Drejtësi. 25 prill 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/asamblisti-ne-komunen-e-ranillugut-denohet-me-500-euro-gjobe-per-mos-deklarin-te-pasurise/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

3 muaj
burgim me
kusht dhe
200 euro
gjobe



MRIKA MARKU GASHI

Partia: Iniciativa për Progres

Pozita shtetërore: Këshilltare komunale në Komunën e Klinës

Vepra penale: “Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë

Faza procedurale: Në proces


Aktakuza - Prokuroria Themelore në Prishtinë më 17 nëntor 2014 e ka akuzuar Marku Gashin se ka kryer veprën penale mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, të ardhurave, dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare. Prokuroria pretendon se ajo në cilësinë e këshilltares komunale në Klinë, gjatë periudhës kohore 24 dhjetor 2013 deri më 24 janar 2014, nuk e ka deklaruar fare pasurinë edhe pse për këtë ka qenë e obliguar sipas ligjit.⁵⁰²

Procesi – Për këtë rast, Gashi nga Gjykata Themelore në Prishtinë, më 17 dhjetor 2015, ishte dënuar me 3 muaj burgim me kusht dhe 200 euro gjobë, ndërsa i njëjti vendim është bërë i formës së prerë më 22 mars 2016.⁵⁰³

⁵⁰² Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë e ngritur më 17 janar 2014 në Departamentin e Përgjithshëm të Gjykatës Themelore në Prishtinë

⁵⁰³ Shënim: Përgjigja e zëdhënësës së Gjykatës Themelore në Prishtinë. 06.09.2019.

2 muaj
burg me
kusht dhe
200 euro



TUSH DEDAJ

Partia: PSHDK

Pozita shtetërore: Këshilltar Komunal në Komunën e Klinës

Vepra penale: *“Mos raportimi ose raportimi i rremë i pasurisë, i të ardhurave, i dhuratave, i dobisë tjetër materiale ose i detyrimeve financiare”*

Gjykata: Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë

Faza procedurale: 2 muaj burg me kusht dhe 200 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur, më 17 shtator 2018, ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit Tush Deda, me arsyetimin se ai nga 1 marsi 2018 deri më 31 mars 2018, në cilësinë e Këshilltarit Komunal në Kuvendin Komunal në Klinë, edhe pse ka qenë i detyruar ta bëjë deklarin e pasurisë nuk e ka përmbushur obligimin e tij, si zyrtar publik konform ligjit të dhënat e kërkuara ti dërgoj në Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Procesi - Gjykata Themelore në Pejë, Dega në Klinë, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, kishte marr aktgjykim në vitin 2018, me të cilin të akuzuarin Deda e kishte shpallur fajtorë, duke i shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje prej 2 muaj me kusht dhe dënim me gjobë në lartësi prej 200 euro.

Në
proces**REFIK SHAQIRI****Partia:** NDS**Pozita shtetërore:** Ish-drejtor i Kadastrit dhe Gjeodezisë në Komunën e Prizrenit**Vepra penale:** “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar”**Gjykata:** Gjykata Themelore në Prizren**Faza procedurale:** Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore të Prizrenit të ngritur më 29 nëntor 2019, i pandehuri Shaqiri, së bashku me disa persona të tjerë, duke qenë pjesë e komisionit për dhënie në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të Komunës së Prizrenit, në bashkëkryerje me dashje kanë shkelur kriterin e vetëm të Ankandit Publik. Duke vepruar në këtë mënyrë, të njëjtit kanë shkelur të drejtat e të dëmtuarit Albert Doqi, duke përzgjedhur si shfrytëzuese ofertuesen Fatmire Berisha, përkundër faktit se i dëmtuari Doqi, kishte kuotuar çmimin më të lartë, gjegjësisht shumën 25.20 euro për m2, për lokalin nr.29, i cili gjendet në sheshin “Shatërvan”, por i njëjti lokal i është dhënë në shfrytëzim ofertueses Berisha, me çmim pre 20.06 euro për m2. përkundër faktit se në bazë të dokumentacionit të prezantuar dëshmohej se përfituesja Fatmire Berisha, nuk ka pasur përvojë në menaxhim dhe zhvillim të biznesit, komisioni për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale në Prizren, të njëjtën e ka poentuar me pikë maksimale. Sipas aktakuzës, më pas komisioni për ankesa pranë Kuvendit Komunal në Prizren, e kishte aprovuar kërkesën e palës së dëmtuar, ku më 28 shkurt 2019, ka anuluar vendimin e këtij komisioni duke e dërguar çështjen në rishqyrtim, përkundër faktit të tillë, Komisioni përmes njoftimit të datës 1 prill 2019, ka potencuar se qëndrojnë pranë njoftimit të datës 17 janar 2019, ku janë shpallur fituesit e ankandit për shfrytëzimin me qira të lokaleve-pronë komunale. Pas ngritjes së aktakuzës, i pandehuri Shaqiri kishte dhënë dorëheqje nga pozita e drejtorit të Kadastrit dhe Gjeodezisë në Komunën e Prizrenit.

Procesi - I akuzuari Shaqiri, ish-drejtor i Kadastrit dhe Gjeodezisë në Komunën e Prizrenit, në seancën e mbajtur më 20 shkurt 2020 është deklaruar i pafajshëm⁵⁰⁴, ndërsa seanca e radhës mbetet e papërcaktuar.

⁵⁰⁴ “Drejtorët në Prizren dhe të tjerët mohojnë fajësinë se kundërligjshëm dhanë në shfrytëzim pronën komunale” Betimi për Drejtësi. 20 shkurt 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/drejtores-ne-prizren-dhe-te-tjeret-mohojne-fajesine-se-kunderligjshem-dhane-ne-shfrytezim-pronen-komunale/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces

	GORAN MAKSIMOVIC Partia: Lista Serbe Pozita shtetërore: Ish-drejtor për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Novobërdës Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritet zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan Faza procedurale: Në proces
---	--

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjilan, më 17 qershor 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj të akuzuarit Maksimović, sipas së cilës, ai në cilësinë e drejtorit në Drejtorinë për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Novobërdës, më qëllim të shkakutimit të dëmit për personin tjetër ose për organizatën e biznesit, shpërdoron pozitën e tij zyrtare, duke tejkaluar detyrat zyrtare, duke lëshuar pëlqimin në emër të Dushan Maksimović për ndërtim të objektit “Fermë e Derrave”, në fshatin Zebincë, në parcelën 934, në pronën që nuk ka qenë në emër të tij, por pronë e gjyshit të tij, Trajan Maksimović, në kundërshtim të ligjit për ndërtim Nr.04/L110, neni 4, paragrafi 3, pika 3.1 dhe neni 20, paragrafi 3, 3.1, me çka në mënyrë të kundërligjshme ia ka mundësuar Dushan Maksimovićit përfitim në vlerë prej 66,360 euro.

Procesi - Në seancën fillestare të mbajtur më 14 tetor 2019, i akuzuari Maksimović është deklaruar i pafajshëm, ndërsa seanca e radhës ishte caktuar më 17 prill 2020⁵⁰⁵ mirëpo për shkak të pezullimit të punës të sistemit gjyqësor për shkak të situatës së krijuar me pandeminë Covid-19, kjo seancë është anuluar.

⁵⁰⁵ “Prokuroria pretendon se ka prova ndaj ish-drejtorit dhe shefit të Urbanizmit në Novobërdë, mbrojtja e thotë të kundërtën”. Betimi për Drejtësi. 2 mars 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/prokuroria-pretendon-se-ka-prova-ndaj-ish-drejtorit-dhe-shefit-te-urbanizmit-ne-novoberde-mbrojtja-e-thote-te-kunderten/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Hudhje2. Në
proces


GORAN MARINKOVIQ

Partia: Lista Serbe
Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Kllokot
Veprat penale: 1. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar” 2. “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar”
Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan
Faza procedurale: Hudhje (Aktvendim i formës së prerë)

Aktakuza 1 - Prokuroria Themelore në Gjilan, më 23 gusht 2019, ka ngritur aktakuzë ndaj Goran Marinkoviq, me arsyetimin se ai në cilësinë e drejtorit për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë dhe Sport në Komunën e Kllokotit, derisa kaishte qenë i obliguar t’i zbatojë dispozitat ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës, nuk iu ka përmbajtur të njëjtave, dhe gjatë punësimit të personelit arsimor dhe jo arsimor në Komunën e Kllokotit, gjatë konkursit të shpallur më 14 mars 2018, ka ardhur deri të parregullsitë me rastin e pranimit-punësimit të stafit arsimor dhe jo arsimor, e të cilat parregullsi janë të evidentuara edhe nga Inspektorati i Punës dhe Inspektorati i Arsimit, në Shkollën Ekonomike – Teknike në Vërboc, shkollën fillore “Marko Rajkoviq”, dhe në shkollën fillore “Sveti Slava” në Kllokot, ku të punësuarit në mënyrë të kundërligjshme nga ky konkurs i kanë marrë pagat, me çka Komunës së Kllokotit i ka shkaktuar dëm të konsiderueshëm material, ndërsa konkursi i lartpërmendur është anuluar nga Inspektorati i Punës.

Procesi 1 - Gjykata e Apelit, më 25 tetor 2019, me aktvendim e ka refuzuar si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, duke e vërtetuar kështu aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, e cila e kishte hudhur aktakuzën ndaj drejtorit të Arsimit në Kllokot, Goran Marinkoviq.⁵⁰⁶

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës, i pandehuri Dejanoviq, së bashku me Goran Marinkoviq, nga data 01 shkurt deri më 15 mars 2018 dhe në maj të vitit 2018, në komunën e Kllokotit, me dashje, për shkak të bindjeve politike u kanë mohuar të dëmtuarve të drejtat e përcaktuara me

⁵⁰⁶“Apeli vërteton hudhjen e aktakuzës për korrupsion ndaj drejtorit të Arsimit në Kllokot”. Betimi për Drejtësi. 9 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-hudhjen-e-aktakuzes-per-korrupsion-ndaj-drejtorit-te-arsimit-ne-kllokot/?fbclid=IëAR33rn-ZN0cjYMLQgaudllUf1UPEibdy-ZOMëLmPbcPt9A-hDKmS6rN6ThI>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Kushtetutë dhe ligjin e punës, ashtu që për shkak se të dëmtuarit nuk kanë pasur bindje të njëjta politike me të pandehurit, sapo i pandehuri Dejanoviq merr postin e kryetarit të komunës së Klllokotit, emëron të pandehurin tjetër Marinkoviq drejtor të arsimit, me ç ‘rast në bashkëveprim ushtrojnë presion tek të dëmtuarit që të japin dorëheqje.

Në këtë mënyrë të njëjtit, pa respektuar procedurat e parapara me kontratën kolektive dhe ligjin e punës, në mënyrë selektive u kanë ndërprerë 40 punëtorëve arsimor dhe dhjetë (10) punëtorëve shëndetësor marrëdhënien e punës, në komunën e Klllokotit, kinse për shkak të kontratave të kundërligjshme, mospërmbushjes së detyrave, shkurtimit buxhetor etj, pa asnjë procedurë disiplinore dhe pa paralajmërim, përkundër asaj që të njëjtit kishin kontrata valide. Në aktakuzë thuhet se të njëjtit pa eliminuar shkeljet, më 14 mars 2018, kanë shpallur konkurs, duke pranuar punëtorë sipas bindjeve të tyre politike, duke iu shkelur, mohuar dhe kufizuar të dëmtuarve të drejtat e parapara me ligjin e punës.⁵⁰⁷

Procesi 2 – Procesi ndaj Dejanoviqit do të gjykohet nga Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, mirëpo i njëjti akoma nuk ka filluar.

⁵⁰⁷ “Aktakuzë ndaj dy zyrtarëve të komunës së Klllokotit”. Koha.net. 30 dhjetor 2019. (Shih linkun <https://www.koha.net/kronike/201497/aktakuze-ndaj-dy-zyrtareve-te-komunes-se-klllokotit/?fbclid=IëAR2z2KËtPSLUn48VFes-0kv3XsXiVEa254-OoNX-4utObz7Ze6CB6ËtRFB8>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces


BRANISLAV KLAJIQ

Partia: Lista Serbe
Pozita shtetërore: Ish-drejtor për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Mitrovicës Veriore
Vepra penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritet zyrtar”
Gjykata: Gjykata Themelore në Mitrovicë
Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur më 12 dhjetor 2018, nga Prokuroria Themelore në Mitrovicë, i pandehuri Klajiq akuzohet se prej vitit 2013 e tutje, në cilësinë e drejtorit të Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi në Komunën e Mitrovicës-Veri, nuk i kishte përmbush detyrat zyrtare me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër. Siç thuhet në aktakuzë, pasi i dëmtuari I.M kishte blerë një lokal afarist “Teuta Bare”, në rrugën “Ivo Lola Ribar”, e cila gjendet në pjesën veriore të Mitrovicës, nga Agjencia Kosovare e Privatizimit në vitin 2012, kishte bërë kërkesë në zyrën kadastrale të Komunës në Veri për të regjistruar pronën dhe pasi nuk kishte marrë përgjigje i ishte drejtuar Agjencisë Kadastrale të Kosovës (AKK) për regjistrimin e pronës. AKK-ja kishte sjellë konkluzion se Drejtoria për Kadastër KK-Mitrovica Veriore, kishte bërë heshtje administrative në kundërshtim me Ligjin për Themelimin e regjistrimit të drejtave të pronësisë së paluajtshme. Sipas aktakuzës, i pandehuri Branislav Klajiq, nuk e kishte zbatuar vendimin e AKK, dhe të dëmtuarit Izet Maxhera i kishte shkaktuar dëm në vlerë prej 67.061,22 euro.

Procesi - I akuzuari Klajiq, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më 6 dhjetor 2019, është deklaruar i pafajshëm, ndërsa seanca e radhës ka mbetur e papërcaktuar.⁵⁰⁸

⁵⁰⁸ “Ish-drejtori në Komunën e Mitrovicës Veriore mohon fajësinë për keqpërdorim detyre” Betimi për Drejtësi.6 dhjetor 2019.(Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/ish-drejtori-ne-komunen-e-mitrovices-veriore-mohon-fajesine-per-keqperdorim-detyre/?fbclid=IéAR1v5B9VxeRaj-1ëhgHn6KqhNGFTH-4-6qttYEonXrEAIOTPDx1VDX-qZ-c>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Në
proces



RASIM DEMIRI

Partia: VAKAT

Pozita shtetërore: Ministër i Zhvillimit Rajonal/
Deputet

Vepra penale: “Përdorimi i armës apo mjetit të
rrezikshëm”

Gjykata: Gjykata Themelore në Prizren

Faza procedurale: Në proces

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur nga Prokuroria Themelore e Prizrenit, i pandehuri Demiri më 30 mars 2020 rreth orës 16:00 në fshatin Pouskë – Komuna e Prizrenit, kishte përdorë armë zjarri pushkën gjysmë – automatike në një shenjëtore të improvizuar.⁵⁰⁹

Procesi - Gjykimi për këtë rast nuk ka filluar akoma.⁵¹⁰

⁵⁰⁹ Aktakuzë ndaj deputetit Rasim Demiri dhe një personi tjetër për armëmbajtje pa leje dhe përdorim të armës, Betimi për Drejtësi. 22 maj 2020. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/aktakuze-ndaj-deputetit-rasim-demiri-dhe-nje-personi-tjeter-per-armembajtje-pa-leje-dhe-perdorim-te-armes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵¹⁰ Shënim: Demiri, më 10 qershor 2020, është dënuar 500 euro gjobë dhe me katër (4) muaj burgim, të cilin me pelqimin e tij, mund ta zëvendësoj me 600 euro gjobë. Betimi për Drejtësi. 10.06.2020 (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/deputeti-rasim-demiri-dhe-i-akuzuari-tjeter-denohen-per-perdorim-te-armes/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

IX. Shtojca e albumit me aktakuza të zyrtarëve të partive të paidentifikuara nga IKD

Në
proces

	AFRIM KRASNIQI Partia: ? Pozita shtetërore: Drejtori i Inspektoratit në Komunën e Fushë Kosovës Veprat penale: “Keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Prishtinë Faza procedurale: Në proces
---	--

Aktakuza - Sipas aktakuzës së ngritur me 14 dhjetor 2016, nga Prokuroria Themelore e Prishtinës, Krasniqi akuzohet së bashku me tri inspektore të ndërtimit të Komunës së Fushë Kosovës, nuk e kanë përmbushur detyrën e tyre zyrtare që kanë qenë të obliguara ta kryejnë në bazë të detyrave të tyre zyrtare.

Sipas prokurorisë, Afrim Krasniqi në cilësinë e drejtorit të departamentit të ndërtimit, gjatë periudhës kohore 2015-2016, nuk i kishte ndërprerë punimet kundërligjore dhe nuk kanë nxjerrë vendim për rrënim, duke i mundësuar në këtë mënyrë kompanisë, “Princesha Construction”, të përfitojë nga ndërtimet kundërligjore në dy objekte banesore tetë katëshe, i cili ka pasur tejkalimit të lejes ndërtimore.

Procesi - Në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur 22 tetor 2019, i akuzuari Afrim Krasniqi është deklaruar i pafajshëm, ndërsa ky proces ende nuk ka përfunduar.⁵¹¹

⁵¹¹ “Drejtori dhe inspektorët në Fushë Kosovë mohojnë se keqpërdorën detyrën, prokuroria thotë se ka prova ndaj tyre”. Betimi për Drejtësi. 22 tetor 2019. (Shih linkun: https://betimiperdrejtesi.com/drejtori-dhe-inspektorët-ne-fushe-kosove-mohojne-se-keqperdoren-detyren-prokuroria-thote-se-ka-prova-ndaj-tyre/?fbclid=IwAR35pE8o_4lbl2HSSaqM-v8our5keP72oQ7IDTz47NGsT3ëBbQFUPj2_7E). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



ZORAN MIRKOVIQ

Partia: ?

Pozita shtetërore: Drejtor në Departamentit për Administratë dhe Personel

Vepra penale: 1 dhe 2 “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan

Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë); 2. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)

1.
Lirim

2.
Lirim

Aktakuza 1 - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të pandehurit Zoran Mirkoviq, në cilësinë e drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Personel dhe Goran Maksimoviq, në cilësinë e drejtorit të Arsimit në këtë komunë, akuzohen se kanë keqpërdorur pozitën zyrtare, me qëllim që vetes apo kompanisë sh.p.k. “Euro Tafa”, t’i sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror. Sipas prokurorisë, të akuzuarit nga prilli deri në dhjetor të vitit 2013, me rastin e furnizimit me derivate të naftës, kanë plotësuar dokumente fiktive, duke lejuar pagesën për kompaninë në fjalë, më ç’rast Komunes së Kllokotit i kanë shkaktuar dëm material në shumë prej 15.488,00 euro.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjilan, në qershor të vitit 2018, kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-drejtorit për Administratë dhe Personel në Komunën e Kllokotit, Zoran Mirkoviq, i cili akuzohej se me rastin e furnizimit me derivate të naftës, kishte plotësuar dokumente fiktive, me ç’rast sipas prokurorisë, kishin keqpërdorur detyrën zyrtare.⁵¹² Këtë vendim e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan kundër aktgjykimit lirues që gjykata e shkallës së parë, duke e liruar atë përfundimisht nga akuza.⁵¹³

⁵¹² “Dy ish-drejtorët e Komunes së Kllokotit lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi .18 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-ish-drejtorët-e-komunes-se-kllokotit-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵¹³ “Apeli vërteton pafajësinë për dy ish-drejtorët e Komunes së Kllokotit, të akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 2 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-per-dy-ish-drejtorët-e-komunes-se-kllokotit-te-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Aktakuza 2 - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, i pandehuri Zoran Mirkoviq, po akuzohen se në cilësinë Drejtor në Departamentit për Administratë dhe Personel, ka keqpërdorur detyrën, ashtu që me qëllim që vetes apo tjetrit t'i sjell dobi të kundërligjshme pasurore, me rastin e furnizimit me mallra për nevojat e komunës në fjalë, ka plotësuar dokumente fiktive në vlerë të përgjithshme prej 6,042,5 euro për dy kompani private NTP “Arti G” dhe NTP “Ermali”, nga Vitia.

Procesi 2 - Gjykata Themelore në Gjilan më 11 prill 2018, e kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës zyrtare, pasi që sipas gjykatës pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe dëgjimit të dëshmitarëve nuk është vërtetuar se i akuzuari është kryerës i veprës penale me të cilën e ngarkonte Prokuroria Themelore në Gjilan.⁵¹⁴ Me 20 prill 2018, ky aktgjykimi i formës së prerë.⁵¹⁵

⁵¹⁴ “Lirohen nga akuza për korrupsion ish-nënkryetari dhe ish-drejtori në Komunën e Klllokotit” Betimi për Drejtësi. 11 prill 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/lirohen-nga-akuza-per-korrupsion-ish-nenkryetari-dhe-ish-drejtori-ne-komunen-e-klllokotit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵¹⁵ Shënim: Përgjigja e zëdhënësit të gjykatës, Sabit Shkodra. 14 gusht 2019.

	GORAN MAKSIMOVIC Partia: ? Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Klllokotit Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i formës së prerë)
---	---

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të pandehurit Zoran Mirković, në cilësinë e drejtorit të Departamentit për Administratë dhe Personel dhe Goran Maksimović, në cilësinë e drejtorit të Arsimit në këtë komunë, akuzohen se kanë keqpërdorur pozitën zyrtare, me qëllim që vetes apo kompanisë sh.p.k. “Euro Tafa”, t’i sjellin përfitim të kundërligjshëm pasuror. Sipas prokurorisë, të akuzuarit nga prilli deri në dhjetor të vitit 2013, me rastin e furnizimit me derivate të naftës, kanë plotësuar dokumente fiktive, duke lejuar pagesën për kompaninë në fjalë, më ç’rast Komunes së Klllokotit i kanë shkaktuar dëm material në shumë prej 15.488,00 euro.

Procesi - Gjykata Themelore në Gjilan, në qershor të vitit 2018, kishte shpallur aktgjykim lirues ndaj ish-drejtorit për Administratë dhe Personel në Komunën e Klllokotit, Zoran Mirković, i cili akuzohej se me rastin e furnizimit me derivate të naftës, kishte plotësuar dokumente fiktive, me ç’rast sipas prokurorisë, kishin keqpërdorur detyrën zyrtare.⁵¹⁶ Këtë vendim e kishte vërtetuar edhe Gjykata e Apelit, e cila kishte refuzuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan kundër aktgjykimit lirues që gjykata e shkallës së parë, duke e liruar atë përfundimisht nga akuza.⁵¹⁷

⁵¹⁶ “Dy ish-drejtorët e Komunes së Klllokotit lirohen nga akuza për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 18 qershor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/dy-ish-drejtoreset-e-komunes-se-klllokotit-lirohen-nga-akuza-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵¹⁷ “Apeli vërteton pafajësinë për dy ish-drejtorët e Komunes së Klllokotit, të akuzuar për korrupsion”. Betimi për Drejtësi. 2 tetor 2018. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/apeli-verteton-pafajesine-per-dy-ish-drejtoreset-e-komunes-se-klllokotit-te-akuzuar-per-korrupsion/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

1.
Lirim

2. 2500
euro
gjobë

3. 600
euro
gjobë

	MIROSLAV STOLIQ Partia: ? Pozita shtetërore: Drejtor i Drejtorisë për Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini dhe Sporte në Kllokot Veprat penale: 1. “keqpërdorim i pozitës zyrtare”, 2. “keqpërdorim i pozitës zyrtare”, 3. “Cenim i të drejtave të punës dhe papunësisë” Gjykata: 1. Gjykata Themelore në Gjilan, 2. Gjykata Themelore në Gjilan, 3. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti Faza procedurale: 1. Lirim (Aktgjykim i formës së prerë) 2. 2500 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë) 3. 600 euro gjobë (Aktgjykim i formës së prerë)
---	--

Aktakuza 1 - Në aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Gjilan, të ngritur më 27 korrik 2016, thuhet se tashmë i akuzuari Miroslav Stoliq, në cilësinë e Drejtorit në Departamentin për Arsim në Komunën e Kllokotit, ka keqpërdorur pozitën dhe autoritetin zyrtar duke shkelur ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, me qëllim që të fitojë çfarëdo dobie për vete ose personin tjetër, apo t’i shkaktojë dëm personit tjetër, në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me ligjin.

Stoliq, sipas dispozitivit të aktakuzës, ka keqpërdor pozitën apo autoritetin zyrtar, në atë mënyrë që, në konkursin e shpallur të datës 11 mars 2014 me numër 4284/6 dhe të datës 13 gusht 2014 me numër 4973/6, ka pranuar në marrëdhënie pune tetë punëtorë ndihmës dhe pesë mësimdhënës në shkollën fillore “Marko Rajković” në fshatin Vërbovc, pa i përfillur procedurat e parapara me aktet ligjore, konkretisht me udhëzimin Administrativ 18/2009 të datës 18 shtator 2009.

Ndërkohë, gjatë vitit shkollor 2014/2015, sipas aktakuzës, për shkak të pagesës më tepër të punëtorëve ndihmës dhe mësimdhënësve, buxhetit të Republikës së Kosovës i ka shkaktuar dëm material në shumën prej 25.000 euro.

Procesi 1 - Gjykata Themelore në Gjilan, më 12 dhjetor 2018, e kishte liruar nga akuza për keqpërdorim të pozitës apo autoritetit zyrtar, të akuzuarin Stoliq. Më 23 mars 2019, ky aktgjykim i Themelores ishte vërtetuar edhe nga Apelit.⁵¹⁸

⁵¹⁸ Shënim: Përgjigja e zyrtarit të Gjykatës Themelore në Gjilan, Sabit Shkodra.

Aktakuza 2 - Sipas akuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të datës 25 shtator 2018, Miroslav Stoliq, duke qenë në pozitën e Drejtorit të Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kllokotit, me qëllim të përfitimit të interesit pasuror për personin tjetër përkatësisht Daniella Mirkoviqin, e pranuar në punë si infermiere më 11.01.2016, në Qendrën e Mjekësisë Familjarë në Kllokot, e cila kishte pranuar të ardhura personale gjerë më 01.02.2018, pa u lajmëruar fare në punë, përkatësisht dhe pa i kryer detyrat e punës për të cilat ishte pranuar. E për këtë sipas aktakuzës, i pandehuri Miroslav Stoliq nuk kishte ndërmarr asnjë veprim për shkëputjen e marrëdhënies së punës ndaj saj, me çka e ka dëmtuar buxhetin e komunës së Kllokotit në lartësi prej 9,979.90 euro.

Procesi 2 - Ish-drejtori i Drejtorisë për Arsim, Shëndetësi, Shërbime Sociale, Kulturë, Rini dhe Sport në Komunën e Kllokotit, Miroslav Stoliq, i akuzuar për keqpërdorim të pozitës zyrtare, është dënua më 2500 euro gjobë, nga Gjykata Themelore në Gjilan.⁵¹⁹, i cili vendim është bërë i plotfuqishëm.⁵²⁰

Aktakuza 3 - Sipas aktakuzës së ngritur më 7 qershor 2016, nga Prokuroria Themelore e Gjilanit, Miroslav Stoliq së bashku me tre të pandehur të tjerë akuzohen se më 5 janar 2016, në Drejtorinë e Arsimit – Komuna e Kllokotit, ia kishin mohuar të drejtën e punësimit të dëmtuarës L.H, në atë mënyrë që kjo drejtori kishte lidhur kontratë të punës me D.B për mësimdhënie në shkollën fillore “Gjon Serreçi”, në fshatin Mogillë të Vitisë. Sipas aktakuzës, punësimi nuk është bazuar në Udhëzimin Administrativ të MASHT-it, i cili kishte paraparë që kandidati duhet të ketë së paku 240 ECTS apo me sistem katër vjeçar, kurse D.B ishte punësuar me 180 ECTS.

Procesi 3 – Pas tre dështimeve radhazi për të mbajtur shqyrtimin gjyqësor lidhur me këtë rast, tre nga katër ish-anëtarët e komisionit vlerësues në Drejtorinë e Arsimit në Komunën e Kllokotit, përfshirë të akuzuarin Miroslav Stoliq, më 30 tetor 2019 kishin hyrë në negociim për marrëveshje për pranimin e fajësisë. Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, në seancën e mbajtur më 11 nëntor 2019, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Stoliq, duke i shqiptuar dënim me gjobë në shumë prej 600 euro,⁵²¹ ndërsa ndaj këtij vendimi është bërë ankesë nga të akuzuarit dhe do të trajtohet nga Gjykata e Apelit.

⁵¹⁹ Aprovohet marrëveshja për pranim fajësie, 2500 euro gjobë ndaj ish-drejtorit të Shëndetësisë në Kllokot, Betimi për Drejtësi, 16 janar 2020 (shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/aprovohet-marreveshja-per-pranim-fajesie-2500-euro-gjobe-ndaj-ish-drejtorit-te-shendetesise-ne-kllokot/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

⁵²⁰ Shënim: Përgjigja e zyrtarit të Gjykatës Themelore në Gjilan. 22.05.2020

⁵²¹ “Dënohen me gjobë tre të akuzuarit për cenim të të drejtave të punësimit në Kllokot”. Betimi për Drejtësi. 11 nëntor 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/denohen-me-gjobe-tre-te-akuzuarit-per-cenim-te-te-drejta-te-punesimit-ne-kllokot/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).



DEJAN VLLAJKOVIC

Partia: ?

Pozita shtetërore: Drejtor i Administratës Publike në Komunën e Kllokotit

Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjiilan

Faza procedurale: Refuzues (Aktgjykim i formës së prerë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore në Gjiilan më 20 dhjetor të vitit 2016, ka ngritur aktakuzë ndaj Dejan Vllajković, të cilin e ngarkon me veprën penale “keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar”. Vllajković, akuzohet se në cilësinë e drejtorit të Administratës në Komunën e Kllokotit, ka keqpërdor detyrën zyrtare për përfitime personale ose të personit tjetër, pasi që gjatë mandatit të tij, ka shkelur ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës, saktësisht Rregulloret e Thesarit për shpenzimet e parasë publike. Ai akuzohet se në mënyrë të kundërligjshme ka blerë mallra të ndryshme, derivate në SHPK “Euro Tafa”, ka kryer shërbime të riparimit të veturave në DPZ “Beka”, ku në bazë të ekspertizës financiare i ka shkaktuar dëm material buxhetit komunal në vlerë prej 5,248.00 euro.⁵²²

Procesi – Gjykata Themelore në Gjiilan më 22 nëntor 2017, kishte marr aktgjykim refuzues ndaj Vllajkovićit dhe kishte pushuar procedurën ndaj tij. Arsyetimin e këtij vendimi kryetari i trupit gjykues Naser Maliqi e mbështet në atë se është vërtetuar përmes provave se periudha kohore e keqpërdorimit të detyrës zyrtare nuk mund të përfshij periudhën pas 01.09.2010 deri më 29.09.2012 siç pretendon prokuroria, sepse është vërtetuar i akuzuari Vllajković është shkarkuar nga detyra e Drejtorit të Administratës më 01.09.2010.

⁵²² “Shtyhet seanca ndaj ish-drejtorit të Administratës në Komunën e Kllokotit”. Betimi për Drejtësi. 18 shtator 2017. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/shtyhet-seanca-ndaj-ish-drejtorit-te-administrates-ne-komunen-e-kllokotit/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

8 muaj
burgim

	NIKOLA NOJKIQ Partia: ? Pozita shtetërore: Drejtor për Buxhet dhe Financa në Komunën e Kllokotit Vepra penale: “Keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar” Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan Faza procedurale: Në proces
---	--

Aktakuza - Sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, të përpiluar më 22 qershor 2018, Nikola Nojkiq akuzohet se nga gushti 2015 e deri maj 2016, në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa në Komunën e Kllokotit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin e tij zyrtar, me qëllim të përfitimit, pa qenë i autorizuar ka bërë pranimin e të hollave në shumë prej 14,013.50 euro nga zyrtari Boban Bogdanoviq, arkëtarët Bislim Trena dhe Zhivorad Vesiq, të cilat të holla kanë qenë rrjedhojë e inkasimit të taksave për shërbime komunale. Gjithmonë sipas aktakuzës, i njëjti shumë prej 3,623.00 euro, i ka transferuar në llogarinë bankare të komunës, ndërsa nuk e ka dorëzuar shumë prej 10,390.50 euro, edhe pse ka qenë i obliguar t’i dorëzojë në bankë.

Procesi – Gjykata Themelore e Gjilanit, më 10 shkurt 2020, ka shpallur aktgjykim dënues ndaj të akuzuarit Nojkiq, duke i shqiptuar dënim prej tetë muaj burgim efektiv.⁵²³

⁵²³ “Akuzohet se nuk i dorëzoi të hyrat nga taksat komunale, burg efektiv ndaj ish-drejtorit në Kllokot”. Betimi për Drejtësi. 10 shkurt 2020. (Shih linkun: <https://betimiperdrejtesi.com/akuzohet-se-nuk-i-dorezoi-te-hyrat-nga-taksat-komunale-burg-efektiv-ndaj-ish-drejtorit-ne-kllokot/>). (Qasur për herë të fundit më 8 dhjetor 2020).

Lirim



DAVOR PETKOVIQ

Partia: LS

Pozita shtetërore: Drejtor i Arsimit në Komunën e Ranillugut

Vepra penale: “Cenim i të drejtave në marrëdhëniet e punës”

Gjykata: Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë

Faza procedurale: Lirim (Aktgjykim i shkallës së parë)

Aktakuza - Prokuroria Themelore më Gjilan më 11 tetor të vitit 2018, ka ngritur aktakuzë ndaj tashmë të akuzuarit Davor Petković, me arsyetimin se ai prej 1 shtatori të vitit 2015, e deri më tani, në cilësinë e drejtorit të Arsimit në Komunën e Ranillugut, me dashje nuk e ka zbatuar ligjin dhe kontratën kolektive për punësim apo ndërprerje të marrëdhënies së punës dhe bërjen e pagesës së punës për të dëmtuarën Katarina Ristiç-Iliq. I akuzuari të dëmtuarën nuk e ka futur në listën e pagave të punëtorëve të arsimit, ashtu që i njëjti në kundërshtim me ligjet e zbatueshme të arsimit, ka futur në listën e pagave dhe atë pa kualifikime përkatëse dhe pa qenë më parë punëtor të kësaj shkolle.

Procesi – Lidhur me këtë rast, është mbajtur seanca fillestare më 6 mars 2019 dhe është bërë konfirmimi i aktakuzës⁵²⁴, ndërsa pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata e ka liruar Petkovićin nga akuza, ndërsa lënda është duke u trajtuar nga Gjykata e Apelit.

⁵²⁴ “Nënkryetari i Ranillugut nuk e pranon fajësinë se të dëmtuarës ia kishte mohuar të drejtën e punësimit”. Betimi për Drejtësi. 6 mars 2019. (Shih linkun <https://betimiperdrejtesi.com/nenkryetari-i-ranillugut-nuk-e-pranon-fajesine-se-te-demtuare-ia-kishte-mohuar-te-drejte-e-punesimit/>). (Qasur për here të fundit më 4 dhjetor 2020).

